


UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË

Studime juridike



2

Tiranë, Dhjetor 2014

REDAKSIA

Prof. Dr. Paskal Haxhi, Kryetar
Prof. Dr. Kudret Çela, Anëtar
Prof. Luan Omari, Anëtar
Prof. Dr. Aurela Anastasi, Anëtare
Prof. Dr. Skënder Kacupi, Anëtare
Prof. Dr. Vasilika Hysi, Anëtare
Prof. Asoc. Dr. Argita Berisha, Anëtare
Prof. Asoc. Dr. Enkeleda Olldashi Anëtare

Sekretare shkencore:

Prof. Asoc. Dr. Enkeleda Olldashi

Adresa e redaksisë:

FAKULTETI I DREJTËSISË
TIRANË, ALBANIA
Tel/Fax: + (355) (4) 22 25 37
© Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Revista botohet me mbështetjen financiare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe me fondet e Fakultetit të Drejtësisë

Kopertina: Ilmi Shahu

Përgatiti për botim:

Shtëpia Botuese EUROPRINT shpk
Rruga Transballkanike, Vlorë - Albania
Cel. +355 (0) 692060553; +355 (0) 682012169
E-mail: info@europrint-al.com// www.botimet-europrint.com

ISSN - 2220-3990

PËRMBAJTJA

Prof. Dr. Kudret Çela	Kodi Civil Francez. Modeli i saktësisë shkencore dhe i qartësisë stilistike _____	5
Prof. Asoc. Dr. Ilir Rusi	Politikat dhe të drejtat e konsumatorit në BE _____	14
Prof. Dr. Vasilika Hysi	Politika penale për veprat penale kundër grave dhe fëmijëve _____	33
Dr. Sokol Mëngjesi Dr. Klodjan Skënderaj	Efikasiteti i mbrojtjes së rendit kushtetues _____	65
LLM. Fjoralba Caka	Selectiviteti material, si element i përcaktimit të ndihmës shtetërore që cënon tregun e lirë (pjesa e parë) _____	83
Dr. Fran Qafa	Familja, dhe mbrojtja që i ofrohet asaj nga legjislacioni penal. _____	107
MA Nertila Sulce	Trashëgimia ligjore sipas legjislacionit shqiptar, italian dhe atij gjerman _____	117
Doktorant Ervin Sulko	Ankimi individual në këndvështrimin Kushtetues krahasimor _____	134
Doktorante Elizabeta Imeraj	Trafikimi i qenieve njerezore si fenomen dhe si veper penale _____	151
Zaim Lakti	Monedha elektronike Bitcoin në kornizën ligjore Shqiptare _____	168
Prof. Dr. Ivana Jelić	Normes internationales régissant la responsabilité pour le génocide _____	188

ABSTRACT

Prof. Dr. Kudret Çela	French Civil Code _____	216
Prof. Asoc. Dr. Ilir Rusi	Policies and consumer rights in the EU _____	218
Prof. Dr. Vasilika Hysi	“Women and children as victim and crime policy Some reflections on changes of Penal Code (2012 - 2013) _____ _____	220
Dr. Sokol Mëngjesi Dr. Klodjan Skënderaj	Effectiveness of constitutional order Protection _____	222
LLM. Fjoralba Caka	Material selectivity as a criterion to define state aid that distorts competition (Part I) _____	224
Dr. Fran Qafa	Family, and the protection offered by the criminal legislation _____	226
MA Nertila Sulce	Legal succession in Albania, Germany and Italy (a comparison and things in common) _____	228
Doktorant Ervin Sulko	The individual complaint, a comparative constitutional overview _____	230
Doktorante Elizabeta Imeraj	Trafficking of human beings as a phenomenon and a criminal offense _____	232
Zaim Lakti	Bit coin according Albania legislation _____	234
Prof. Dr. Ivana Jelić	Normes internationales régissant la responsabilité pour le génocide _____	236

KODI CIVIL FRANCEZ MODELI I SAKTËSISË SHKENCORE DHE I QARTËSISË STILISTIKE

Prof. Dr. Kudret Çela¹

Hyrje

Më 21 mars të këtij vitij, Kodi Civil i Francës mbushi 210 vjet. Ky Kod njhet ndyshe në histori edhe si Kodi i Napoleonit, pasi ndryshoi emërtimin e tij tre vjet pas promulgimit, më 1807.

Në rrafshin historik, por edhe në atë bashkëkohor, Kodi përfaqëson një monument të shquar legjislativ, i mbështetur kryesisht në të drejtën romake dhe atë zakonore franceze. Kur shpërtheu Revolucioni francez, në vend njiheshin 65 kanune të përgjithshme dhe 300 variante kanunesh lokale. Ndërsa, në jug të Francës ndihej shumë ndikimi i së drejtës zakonore romake.

Diversiteti juridik krijonte një praktikë të keqe për vendin. Në këto kushte, koha diktonte unifikimin e ligjeve civile, kërkonte një kod civil, madje edhe kode të tjera unike për të gjitha degët e së drejtës.

Objektivët më kryesore që synonte të përmbushte Kodi ishin dy: unifikimi territorial e lingvistik i legjislacionit civil si dhe konsolidimi i regjimit të ri juridik, në luftë kundër sistemit të vjetër të së drejtës. Kodi², në tre librat përbërës të tij, sanksionoi idetë dhe parimet themelore si: parimi i laicitetit, i individualizmit, i lirisë i barazisë, i autoritetit.

¹ Profesor në Fakultetin e Drejtësisë të U.T.

² Kodi Civil, Dalloz, 1995-1996, përbëhet nga tre libra (pjesë), me 2283 nene, domethënë ka dy dispozita më shumë se botimi i parë i vitit 1804.

Kodi Civil Francez përfaqeson një monument të vyer legjislativ.

Ai ishte dhe mbetet model frymëzimi për kodifikime civile moderne të shumë vendeve, në mënyrë të veçantë në Europë dhe më gjërë. Në vendin tone, ky Kod ka patur ndikim të madh: Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare³, i vitit 1929 dhe, ai i Republikës së Shqipërisë⁴, i vitit 1994, u hartuan edhe nën ndikimin e sistemit ligjor civil francez.

Kodi Civil është model i saktësisë intelektuale dhe i qartësisë stilistike. Ai është gjithashtu kundërshtar i rreptë i sistemit të vjetër të së drejtës dhe pasionant në lexim.

Për rëndësinë e Kodit Civil, Bonaparti do të shprehej me krenari: “Lavdia ime e vërtetë nuk është fitorja e dyzetë betejave, Waterloo fshiu kujtimin e shumë fitoreve. Por, asgjë nuk mund të fshijë, madje do të jetojë pambarimisht, ky është Kodi im Civil”.

1. Kushtet historike dhe burimet e kodifikimit civil të Napoleon Bonapartit

Procesi i kodifikimit civil në Francë u zhvillua në kushtet e anarkisë të së drejtës dhe problemeve të shumta sociale e politike që përjetonte Franca. Lidhur me këto kushte historike, sociale, e juridike, Napoleoni do të nënvizonte sa mbylli anarkinë dhe solli rregull, rrëzoi feudalizmin dhe solli barazinë për të gjithë, pavarësisht besimit fetar, luftoi monarkinë e vjetëruar të Regjimit të vjetër, sepse rruga tjetër, siç thoshte ai, do të ishte shkatërimi i gjithë vlerave të Revolucionit.

Në këtë kontekst social, politik e juridik të Francës e të Europës mesjetare e moderne, lidhur me kodifikimin, dy ishin autoritetet e mëdha: kisha dhe monarkia. E drejta kanonike ishte sinteza admiruese e së drejtës romake dhe e mendimit kristian që konsistonte në një tërësi vendimesh dhe refleksionesh të evolucionit juridik e tributar. Monarkia kërkonte kodifikim për unifikimin territorial dhe administrativ, kërkonte të shëmbej

³ Kodi Civil, Mbretëria Shqiptare, Vlorë 1928, shih dhe A. athanaili, “Edrejta civile e Shqipërisë para revolucionit popullor dhe pronësia e personave”, Tiranë 1956, f.1-2.

⁴ Kodi Civil i RSH.

totalisht e drejta e vjetër dhe të miratohej një Kod i vërtetë⁵.

Fjala “kodifikimi” vjen nga latinishtja “Codicem facere”, që do të thotë “të bësh kod”. Juristët francezë, të ngarkuar me hartimin e Kodit, përtej objektivave politike të vetëkuptuara, ngulmonin në këtë proces për funksionet teknike (terapia kundër hallakatjes dhe mosnjohjes, moskuptimit të rregullave të së drejtës, të unifikimit të tyre e sigurisë juridike, qartësisë së normave) dhe reformimin, sistematizimin e së drejtës. Në kuptimin e ngushtë, autorët ngulmonin se mund të flitet për kodifikim të vërtetë, kur ai bazohet në vullnetin e shprehur për organizimin shkencor të rregullave juridike, por dhe për saktësinë semantike. Para së gjithash, autorët shqetësoheshin se për organizimin në mënyrë koherente të rregullave të së drejtës, kërkohej paraprakisht autonomia intelektuale e sajë, fjalori rigoroz. Ndryshe, Kodi do të ishte abuziv.

Autorët e Kodit Civil përdorën burime shumë të ndryshme për përgatitjen e tij si, e drejta romake, veprat e juristëve të mëdhenj të shekullit 18 si Pothier, parimisht në fushën e së drejtës së detyrimeve, të trashëgimisë, e të së drejtës së pronësisë. Ata përdorën të drejtën kanonike për rregullat matrimoniale, të drejtën zakonorepër raportet ndërmjet bashkëshortëve, veçanërisht lidhur me pushtetin e burrit dhe të regjimit të përbashkët, pushtetin atëror, disa dispozita për servitutet dhe të drejtën e trashëgimisë, ordonancat e mbretërve të Francës për aktet civile të shtetit, dhurimin dhe testamentin, provën, të drejtën e Revolucionit (që u kualifikua “E drejta e ndërmjetme” nga historianët). Tek kjo e drejtë, ata shqyrtuan martesën, hipotekën, trashëgiminë në disa dimensione. Legjislacioni revolucionar ishte modifikuar gjërësisht. Katër projekte të Kodit Civil ishin relevantë mbi të drejtën e ndërmjetme (tranzitore). Shumë burime doktrimore kanë patur kontributin e tyre në përgatitjen e Kodit Civil, veçanrisht doktrinën, veprat, përvojat, sidomos të Pothier, Domat, Grotins, Pufendorf, Wolff, Barbeyrac, Buorjon, Ferriere, Argon.

Pas nominimit të komisionit, dhe punës së kryer, projekti u redaktua dhe iu komunikua Gjykatës së Kasacionit.

Legjislatorë të vjetër revolucionarë dhe autorë të projektit

⁵ “Enciklopedia e përgjithshme, botim shqip, f.632.

të Kodit si Oudat, Merlin de Donai dhe Target, shprehën rezervë. Ata ishin në opozicion me sistemin hipotekues dhe zgjerimin e kuotave të disponibilitetit. Më pas, drafti u kaloi gjyqtarëve, të cilët formuluan disa verezjtje dhe, më në fund, projekti i kaloi Këshillit të Shtetit.

Kodi Civil i Napoleonit, i miratuar më 1804, përfaqëson projektin e pestë zyrtar të kodifikimit. Për një pjesë të doktrinës bashkëkohore, ai përfshiu, pas ekzaminimit, ligjin mbi trashëgiminë, të votuar me 25 mars 1800, i cili shërbeu si test për përcaktimin e kuotave të disponibilitetit, të rishikimit strikt të barazisë juridike. Punimet e përgatitjes të Kodit janë shumë të njohura dhe të publikuara nga dy këshilltarët e Shtetit: Locre dhe Fenet. Sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Shtetit ka asistuar në të gjitha seancat e diskutimet të të gjithë Kodit dhe ka publikuar “Legjislacioni civil, tregtar dhe penal në Francë”, në 31 vëllime (1827-1932). Së dyti, ai konsakroi, në 15 vëllime (1827-1828), “Përmbledhje komplete të punimeve të përgatitjes të Kodit Civil”. Vetë Napoleon Bonaparti ka qenë shumë i angazhuar në procesin e kodifikimit civil, ishte kryetar i Komisionit. Mori pjesë dhe drejtoi personalisht më shumë se gjysmën e seancave të mbledhjeve të komisionit⁶.

2. Struktura dhe parimet e Kodit Civil Francez

Kodi Civil Francez i vitit 1804, përmbante 2281 nene, të sistemuar në tre libra (pjesë). Libri i Parë, titullohet “Personat”; Libri i Dytë, titullohet “Të mirat dhe modifikimet e ndryshme të pronësisë, “ndërsa Libri i Tretë, titullohet “Mënyrat e ndryshme të fitimit të pronësisë”.

Kodi u është shmangur dhënies së definicioneve të mëdha lidhur me institutet juridike⁷.

Libri i Parë i Kodit Civil titullohet “Personat”. Në këtë pjesë, sanksionohen të drejtat civile (të drejtat civile, respektimi i korpusit human, studimi gjenetik i karakteristikave të personit nga treguesit gjenetik të tij); nacionaliteti francez, dispozita të përgjithshme, nacionaliteti francez nga origjina, nga adoptimi,

⁶ “Le petit Larousse”, Paris 1999, f.1191.

⁷ A.Aliu, “E drejta civile”, Prishtinë 2013.

nga lindja në Francë, mënyrat e fitimit të nacionalitetit, humbja e nacionalitetit, aktet civile të shtetit, dispozita të përgjithshme, aktet e lindjes, ndryshimi i emrit dhe i mbiemrit, aktet e martesës, aktet e vdekjes, ratifikimi i akteve civile nga shteti (titulli I dhe II i Librit të Parë).⁸

“Banimi”, është një titull tjetër (titulli III), që zë vend në Librin e Parë të Kodit Civil. Në këtë titull, sanksionohen kuptimi i banimit, jepet dallimi ndërmjet personave fizikë dhe atyre moralë, trajtohet banimi special, mbrojtja e banimit etj.

Titulli IV i këtij Libri është “Të munguarit”. Në këtë pjesë trajtohen juridikisht prezumimi i personit të munguar.

Kur personi mungon në vendin e banimit ose rezidencë dhe, pala e interesuar ose Ministria Publike e konstaton këtë gjë, shpallet prezumimi i mungesës të personit. Kodi jep procedurën e hollësishme të veprimeve juridike për të arritur në fazën e deklarimit të mungesës. Nëse pas deklarimit të mungesës, rezulton se personi i deklaruar i zhdukur (i munguar) është i gjallë, gjykata shpall anulimin e vendimit të deklarimit të munguar të personit⁹.

Titulli emërtohet “Martesa”, që zë një shtrirje të madhe në numër dispozitash, nga neni 144 deri 228. Në këtë titull jepet rregullimi juridik, cilësia dhe kushtet e martesës. Më tej, trajtohen formalitetet relative të celebrimit të martesës, pengesat e sajë. Pjesa e martesës vazhdon me detyrimet që lindin prej sajë, të drejtat dhe detyrat respektive të bashkëshortëve. Libri i Parë, si një hapsirë e gjerë normash juridike, vijon, pas regjimit të martesës, me “Divorcin”. Këtu, parashikohen rastet e divorcit, procedura e tij, pasojat e divorcit, efektet e tij mbi fëmijët, zgjidhja e konfliktit në rastin e divorcit etj.

“Birësimi” parashikohet në titullin VII të Librit të Parë.

Në këtë titull, jepen dispozitat e përbashkëta për birësimin legjitim dhe birësimin natyral, prezumimin relativ të birësimit, veprimet relative të birësimit, konfliktet relative për vendosjen e birësimit, asistenca mjekësore, birësimi ligjor, prezumimi i prindërve, provat e birësimit ligjor, legjitimi i martesës dhe i

⁸ Duhet vënë në dukje se struktura e Kodit Civil Francez ka diktuar, në një masë të konsiderueshme, edhe struktura të kodeve civile të vendeve të tjera.

⁹ A.Nuni, “E drejta civile” Pjesa I, trajton gjerësisht këto institute të së drejtës civile në kuptimin e mësipërm, bashkëkohor.

autoritetit të drejtësisë. Ndërsa, tek birësimi natyral, përfshihen efektet e birësimit natyral dhe mënyrat e vendosjes në përgjithësi, njohja e fëmijëve natyralë, veprimet për kërkimin e atësisë dhe të amësisë si dhe veprimet finale respektive.

Ky libër vijon me titullin VIII, që emërtohet “Birësimi adoptiv”, ku trajtohen juridikisht adoptimi i plotë, kushtet, gjykata për adoptimin e plotë, efektet juridike të adoptimit të thjeshtë. Titulli IX emërtohet “Autoriteti prindëror”, ku në 16 dispozita jepet regjimi juridik i këtij autoriteti. Formulimi bazik është ai se fëmijët e të gjitha moshave duhet të respektojnë etërit dhe nënat e tyre. Zhvillohet më tej kjo çështje, përmes normave të së drejtës civile, si, asistenca edukative, kompetencat e gjykatës të të miturve, të miturit, kujdestaria dhe emancipimi, organizimi dhe funksionet e kujdestarisë. Në titujt X, XI parashikohen minorenët dhe kujdestaria për emancipimin e tyre si dhe madhorët dhe mbrojtja e tyre nga ligji.

Libri i Dytë i Kodit Civil Francez, emërtohet “Të mirat dhe mënyrat e ndryshme të pronësisë” dhe përmban pesë tituj.

Në titullin I, që emërtohet “Ndarjet e të mirave”, sanksionohen patundshmëritë (sendet e palujtëshme), ato të luajtëshme si dhe të mirat në raport me posedimin. Titulli II i këtij libri, rregullon të drejtën e përfshirjes të produkteve të sendit, të atyre të inkuorporuar me sendin, të drejtat relative mbi sendet e palujtëshme si dhe këto të drejta mbi sendet e luajtëshme. Titulli III, përfshin uzufuktin, përdorimin, dhe banimin, të drejtat dhe detyrimet e uzufuktierit. Titulli IV, sanksionon servitutet ose shërbimin funksional, regjimi juridik i tyre etj.

Në Librin e Tretë, përfshihen rregullimi juridik i trashëgimisë, testamenti¹⁰, kontratat e detyrimeve, kontrata e martesës, mandati, transaksionet, kompromisi, privilegjet dhe hipoteka dhe, më në fund, jepet rregullimi juridik i parashkrimit (kuptimi, përmbajtja, llojet e tij, duke fiksuar edhe afatet konkrete të parashkrimit.¹¹

10 A.Nuni, L.Hasneziri “Leksione të pronësisë dhe trashëgimisë”, Tiranë 2008, në faqet 13, 71, 303, 583, 655 trajtojnë sipas kësaj fryme, institutet e pronësisë dhe trashëgimisë, sipas konceptit bashkëkohor të parashtruar më sipër.

11 Siç shihet, edhe nga vetë përshkrimi i mësipërm, struktura e Kodit Civil Francez është shkencore dhe bashkëkohore.

Kodi Civil ka meritën historike se në të trumfuan një numër parimesh që i korespondojnë ideve të fuqishme për qëndrueshmërinë e tij si, laiciteti, individualizmi, liria, barazia, autoriteti. Laiciteti shprehet në atë se parashikimet e Kodit ndajnë përfundimisht të drejtën civile nga e drejta kanonike. Kështu për shëmbull, martesë është një kontratë civile dhe celebrimi civil është i detyrueshëm, ai fetar është fakultativ.

Individualizmi në Kodin Civil frymëzohet nga filozofia e Deklaratës të të drejtave të njeriut, të viti 1789, e konvertuar në gjuhën juridike të dispozitave ligjore respektive.

Liria, përveç vlerave shpirtërore dhe politike, është gjithashtu edhe ekonomike. Industrializimi profilon mendimin liberal edhe në veprime juridike. Kjo shprehet sidomos në të drejtën e pronësisë e në të drejtën kontraktore.

Barazia, sanksionohet në Kodin Civil për të gjithë individët. Parimi juridik civil i barazisë, fshiu të gjithë privilegjet e partikularizmit të vjetër. Barazia, tashmë u adresojë të gjithëve në sferën e marrëdhënieve juridike civile.

Autoriteti, më në fund, është padyshim një vizion bonapartist që shfaqet dukshëm në raportet ndërmjet bashkëshortëve (autoriteti i burrit mbi gruan, për shëmbull, nenet 213, 371 të Kodit). Autoriteti spikat edhe në rastet e kontratës së punës, të ofertës të sajë nga padroni (nenet 1780 dhe 1781).

Përfundime dhe rekomandime

Nga trajtesa historike e juridike e Kodit Civil Francez, me rastin e 210 vjetorit të miratimit të tij, mund të jepem disa përfundime e rekomandime. Kodi Civil Francez është modeli i saktësisë shkencore dhe i qartësisë stilistike, ky është përfundimi i parë.

Dhe përfundimi tjetër, e universal, do të ishte ai se analiza dhe vlerësimi objektiv i kushteve konkrete si dhe i rrethanave historike të shoqërisë, të çështjeve, institucioneve dhe burimeve të së drejtës, janë të domosdoshëm për sintezën

shkencore dhe zgjidhjen e drejtë të problemeve. Nëse Kodi Civil Francez (Kodi i Napoleonit, i vitit 1804), rezultoi i suksesshëm, kjo spjegohet edhe me atë se kodifikuesit francezë, tepër të kualifikuar dhe me shumë përvojë në hartimin e Kodit, mbajtën mirë parasysh rrethanat historike e kushtet konkrete sociale, ekonomike, juridike e politike të Francës së asaj kohe si dhe vokacionin demokratik, perëndimor të sajë. Në këtë vështrim, meritë të veçantë kanë sidomos katër juristët e shquar francezë: Tronshet, Portalis, Meleville dhe Bigot de Preameneu.

Përfundimi i tretë do të ishte ai se hartimi i një Kodi në përgjithësi, e sidomos ai Civil në veçanti, ka rëndësi të veçantë për regullimin juridik shkencor të marrëdhënieve ekonomike e pasurore, e për rrjedhje, për stabilitetin juridik, ekonomik e social të shoqërisë¹². Këtë verteton më së miri edhe përvoja pozitive e funksionimit të Kodit Civil të Napoleonit përgjatë periudhës, tashmë mbi dy shekulle.

Qartësia stilistike e Kodit, është një vlerë tjetër e shtuar e tij që konstatohet lehtë.

Ndër rekomandimet që do të dëshironim të paraqisnim në këtë shkrim, është edhe ai se legjislacioni ynë civil dhe jo vetëm, por dhe drejtësia në vendin tonë, kanë nevojë për reformim, për modernizim dhe forcim të luftës, kundër korrupsionit. Kjo mund të arrihet duke mbajtur në vëmendje edhe profilin, strukturën dhe përmbajtjen e instituteve përbërëse të Kodit Civil Francez, sidomos çështjet që lidhen me të drejtën pronësisë, por dhe të së drejtës e të drejtësisë aktuale në Francë, dhe më gjërë, në fushën civile, penale, administrative, të punës, të organizimit etj.

Ngritja e nivelit të performancës juridike të ekspertëve tanë në fushën e kodifikimit, përbën domosdoshmëri të kohës. Për këtë, do të rekomandonim organizime më të shpeshta të seminareve, konferencave shkencore e trajnime të specialistëve përkatës në kuadrin e projekteve të asistencës teknike në drejtësi.

Për edukimin ligjor në fakultetet e drejtësisë, publike e private, do të rekomandonim zhvillimin e një moduli të ri të

12 Ph. Malaurie, L.Aynes "Droit Civil" Paris 1990, f.9, 23, 27 si dhe M.de Juglart "Cours de Droit Civil", Paris, f.31, 93, 96.

lëndës me zgjedhje, “Kodifikimi”.

Nxitja e botimeve në revista shkencore, kombëtare, dhe ndërkombëtare, monografive, teksteve universitare etj, në fushën e së drejtës civile, do të rriste më tej cilësinë e mendimit juridik shqiptar si dhe zbatimin e drejtë në praktikë të tij sipas standarteve bashkëkohore europiane të procesit kodifikues civil, dhe më gjerë.

Bibliografi

1. Michel de Juglart “Cours de Droit Civil”, Paris 1964
2. Ph. Malaurie – L. Aynes “Droit Civil”, Paris 1990.
3. “Le petit Larouse”.
4. Gerard Cornu “Vocabulaire juridique”, Paris 1990.
5. Black’s Law Dictionary” (1891 - 1991).
6. Oksford “Enciklopedia e përgjithshme”, Tiranë.
7. A. Nathanaili “E drejta civile Shqipërisë para revolucionit popullor”, Tiranë, qershor 1956.
8. A. Nuni “E drejta civile “ (Pjesa I), Tiranë 2010.
9. A. Aliu “E drejta civile “, Prishtinë 2013.
10. “Code Civil “, Dalloz 1995 - 1996.
11. “Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare”.
12. “Kodi Civil i RSh “.

POLITIKAT DHE TË DREJTAT E KONSUMATORIT NË BE

Prof. Asoc. Dr. Ilir Rusi

1.1 Progresi i Bashkimi European në fushën e të drejtave të konsumatorit

Në fushën e të drejtave të konsumatorit, Bashkimi European ka bërë progres të rëndësishëm në përputhje me objektivin e saj themelor për të vënë konsumatorët në zemër e Tregut Unik. Nga gjashtëdhjetë e një veprimeve të përfshira në axhendën e saj, aktualisht pesëdhjetë janë përfunduar dhe njëmbëdhjetë janë duke u ndjekur. Garantimi i sigurisë së ushqimit, i produkteve joushqimore dhe i shërbimeve është një element themelor i një politike të shëndoshë të konsumit. Standarde të larta të sigurisë dhe zbatimi i tyre efektiv janë bazë për një treg funksional të vetëm në të cilën konsumatorët evropiane mund të ketë besim.

Në shkurt 2013, Komisioni miratoi "Paketën për Sigurinë dhe Mbikqyrjen e Produktit" që përmban një propozim për një rregullore së re mbi sigurinë e produkteve të konsumit zëvendëson Direktivën e tanishme Përgjithshëm Product Safety, një propozim për një Rregullore të re për mbikëqyrjen e tregut, dhe një mbikëqyrje shumëvjeçare të tregut në përputhje me Planin e veprimit për 2013-2015, me 20 veprimet që kanë për qëllim sigurimin e produkteve të sigurta dhe në përputhje BE.

Në lidhje me gjithçka më sipër, theksi është vënë në identifikimin e produktit dhe gjurmueshmërinë. Për më tepër, duhet theksuar se aktiviteti i zbatimit është rritur përmes mbikëqyrjes më shumë të përbashkët dhe të vendosur në treg

nga autoritetet kombëtare në të gjithë Bashkimin Evropian.

Paralelisht, plani shumëvjeçar i mbikëqyrjes së tregut paraqet një listë ambicioze të 20 veprimeve që do të ndërmerren deri në vitin 2015, ku koordinimi i veprimtarisë zbatuese nga ana e Komisionit mund të sjellë përfitime të prekshme për kryerjen e mbikëqyrjes së tregut në terren.

Ndryshimet kryesore të ndjekura nga paketa janë:

Përshtatja e detyrimeve të përgjithshme të operatorëve ekonomik për të siguruar sigurinë e të gjithë produkteve të konsumit me përgjegjësi të qarta për prodhuesit, importuesit dhe shpërndarësit.

Gjurmueshmëri e përmirësuar të produkteve të konsumit në të gjithë zinxhirin e furnizimit - duke bërë të mundur një reagim të shpejtë dhe efektiv për problemet e sigurisë (p.sh. nga konsumatorët dhe tërheqje nga të gjitha shpërndarësit).

Mjetet më efektive për të zbatuar sigurinë dhe kërkesat e tjera të lidhura me produktin dhe për të marrë masa kundër produkteve të rrezikshme dhe jo në përputhje në të gjithë sektorët nëpërmjet një grupi të vetëm rregullash koherente për mbikëqyrjen e tregut.

Krijimi i një sistemi më bashkëpunues i mbikëqyrjes së tregut në të gjithë BE-në.

Procedurat e efektshme për njoftimin e produkteve të rrezikshme, dhe bashkëpunim për alarme të shpejta (RAPEX) dhe informacione të tjera të mbikëqyrjes së tregut si përsëmbull, Sistemi i Informacionit dhe Komunikimit për Mbikëqyrjen e Tregut (ICSMS).

Paralelisht me paketën e sigurisë së produktit, vitet e fundit përpykje të veçanta janë vënë në sigurimin e bashkëpunimit të duhur ndërmjet doganave dhe autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut. Gjithashtu janë zhvilluar mjete për të lehtësuar detyrën doganore dhe për të siguruar një qasje të përbashkët për sigurinë e produktit dhe kontrollet e përputhshmërisë së mallrave të importuara në BE, si dhe nivel kombëtar.

Duke pasur parasysh vëllimin e lartë të produkteve të importuara, sidomos nga Kina, të globalizimit të zinxhirit të furnizimit dhe evoluimin e vazhdueshëm të tregjeve, bashkëpunimi ndërkombëtar është një shtyllë e rëndësishme e

politikës së sigurisë të produkteve të BE-së.

Komisioni në këtë aspekt punon ngushtë me autoritetet e partnerëve të saj kryesorë tregtarë duke ndjekur e objektivat e "mbikqyrjes" dhe "sigurisë në burim".

Në tetor 2012, Komisioni organizoi për herë të tretë "Javën e Sigurisë së Produktit" ndërkombëtar që mbloodhi së bashku profesionistë të sigurisë produkt të konsumit dhe palët e interesuara nga e gjithë bota, që përfaqësojnë rregullatorët, industrinë, organizatat e konsumatorëve, standarde-bërësve dhe labororet e kontrollit.

Sistemi "RAPEX-Kinë" është një sistem shkëmbimi i informacionit ndërmjet BE-së dhe Kinës. Mes viteve 2006 dhe mesit të vitit 2013 autoritetet kineze hetuan 2405 njoftime RAPEX. Ata kanë marrë masa, duke përfshirë edhe ndalesa të eksportit, kundër produkteve të rrezikshme në 1.379 raste ku ishin në gjendje të gjenin burimin e prodhuesit përgjegjës.

Samiti i tretë BE-Kinë-SHBA "Consumer Product Safety" u mbajt më 28-29 qershor 2012 në Shtetet e Bashkuara dhe u fokusua në një qasje bashkëpunuese mes shteteve duke siguruar mbikqyrjen sigurinë e produktit nga fabrika deri në dyqanin e shitjes.

Në tetor 2013, veprimi i parë i përbashkët i zbatimit të sigurisë së produkteve ndërmjet dhjetë shteteve anëtare të BE-së dhe Kinës arriti në një konkluzion të përbashkët.

Kjo është pjesë e një bashkëpunimi afatgjatë me autoritetet kineze ndërmjet Komisionit dhe Ministrisë përkatëse kineze në e realizuar në vitin 2012. Qëllimi i këtij projekti është të sigurojë që produktet e pasigurta të mos arrijnë në Europë dhe për të lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut të të dy palëve. Palët kanë zhvilluar një protokoll për shkëmbimin e informacionit midis autoriteteve kineze dhe autoritetet e mbikëqyrjes së tregut evropiane. Në fillim të vitit 2014 ata do të kryejnë shkëmbimet e para në informata praktike në lidhje me lodra që vijnë nga Kina në disa porte në BE dhe do të kryejë testimin e produktit të përbashkët për disa nga këto produkte.

1.2 Rishikimi i kuadrit ligjor në BE

Çështja e sigurisë në lidhje me shërbimet e akomodimit turizmit ka qenë temë e debatit në vitet e fundit në Bashkimin Europian. Në qershor 2012, është mbledhur një seminar për të kuptuar konkluzionet e palëve të interesuara për nevojën e rishikimit të Rekomandimit 86/666/EEC¹ dhe mundësinë për të përdorur një iniciativë vullnetare për sigurinë nga zjarri të zhvilluar nga shoqatat e hoteleve, restoranteve dhe kafeneve në Evropë (HOTREC) të njohur si MBS (Menaxhimi, Building, Systems).

Më 25 janar 2012 në një konferencë të hapur është diskutuar mundësia për të zhvilluar një ombrellë evropiane për skemat e cilësisë turistike për të rritur sigurinë e konsumatoreve dhe besimin në produktet e turizmit dhe të inkurajojnë profesionistët e turizmit që bëjnë përpjekje të vërtetë për të përmirësuar shërbimin.

Qëllimi i kësaj iniciative është që të mbrojë në mënyrë të vazhdueshme konsumatorët evropianë duke përdorur shërbime të akomodimit të turizmit në të gjithë BE-në kundër rrezikut të zjarrit nga, përhapja e flakëve dhe të tymit dhe rreziqe të tjera që lidhen me përdorimin e këtyre shërbimeve, pavarësisht nga zgjedhja, ose destinacioni i akomodimit.

Duhet se propozimet për rishikimin e legjislacionit evropian të pajisjeve mjekësore janë miratuar në shtator të vitit 2012. Ato përbëhen nga propozime për rregullimin e pajisjeve 100 mjekësore dhe pajisjet vitro101 diagnostike mjekësore

Në vendet e BE-së ekziston objektivi për të siguruar vetëm pajisjet medicinale të cilat janë të besueshme, të sigurta dhe të përshtatshme për qëllimin duhet të tregëtohen, bazuar në zhvillimet e fundit shkencore dhe teknologjike. Proceset e kontrollit janë propozuar të forcohen akoma më shumë.

Në të njëjtën kohë rregullat e reja ruajnë fleksibilitetin e legjislacionit që në shumë raste u jep konsumatorëve të BE qasje në pajisje të reja në një fazë të hershme. Kështu rregullat e reja dhe më të qarta do të nxisin risi, dhe ata do të lehtësojë tregtinë

¹ Rekomandimi i Këshillit të datës 22 dhjetor 1986“Mbi sigurinë nga zjarri në hotelet ekzistuese”

ndërmjet vendeve të BE në të mirë të pacientëve dhe prodhuesit. Ndryshimet kryesore të paraqitura nga Rregulloret janë:

- Shtrirja më e gjerë dhe më e qartë për legjislacion, e cila është zgjeruar për të përfshirë disa produkte të reja (p.sh. implantet për qëllime estetike) ku sqarohet në lidhje me testet gjenetike;
- Përditësim i rregullave dhe klasifikimit të rrezikut, si dhe kërkesat e sigurisë dhe të performancës, për të mbajtur ritmin me progresin teknologjik dhe shkencor;
- Rregulla të rrepta për caktimin dhe mbikëqyrjen më të fortë të organeve kompetente të njoftuara nga autoritetet kompetente kombëtare;
- Më shumë kompetenca, për të siguruar testimin e plotë dhe kontrole të rregullta tek prodhuesit, duke përfshirë inspektimet e paparalajmëruara të fabrikës;
- Detyrime më të qarta për prodhuesit, importuesit dhe shpërndarësit, të cilat zbatohen edhe në rastin e shërbimeve diagnostike dhe shitjet në internet;
- Kërkesa të rrepta për prova klinike për të mbështetur vlerësimin e pajisjeve;
- Përforësim i rregullave për vigjilencë dhe mbikëqyrjen e tregut;
- Përmirësimi i bazës së të dhënave “Eudamed”¹⁰² në pajisje për të siguruar informacion të plotë për produktet në dispozicion në tregun e BE-së;
- Gjurmueshmërinë e pajisjeve në të gjithë zinxhirin e furnizimit për të bërë të mundur një përgjigje të shpejtë dhe efektive në rast të problemeve të sigurisë;
- Rritja e koordinimit mes autoriteteve kombëtare, me Komisionin mbështetje shkencore, teknike dhe logjistike.
-

Në korrik 2013 një rregullore e re e BE-se 1223/2009 hyri në aplikimin për të forcuar sigurinë e produkteve kozmetike dhe riorganizuar kuadrin për të gjithë operatorët në sektorin kozmetikës². Rregullorja siguron një regjim të fortë, të njohur ndërkombëtar, e cila përforcon sigurinë e produktit duke marrë

² Rregullorja e re e BE-se 1223/2009

në konsideratë zhvillimet e fundit teknologjike, duke përfshirë përdorimin e mundshëm të materialeve të imëta. Ajo gjithashtu kontribuon në informacion më të mirë në lidhje me përmbajtjen e kozmetikës.

Ndryshimet më të rëndësishme të kësaj rregulloreje përfshijnë:

- Kërkesat e forcuara të sigurisë për produktet kozmetike: Prodhuesit duhet të ndjekin kërkesat specifike në përgatitjen e një raporti të sigurisë së produktit para daljes së një produkti në treg.
- Prezantimi i nocionit të 'personit përgjegjës': Vetëm produktet kozmetike për të cilat një person fizik ose juridik është caktuar në kuadër të BE-së si "person përgjegjës" mund të vendoset në treg.
- Njoftimi i centralizuar i të gjitha produkteve kozmetike të vendosura në tregun e BE - nëpërmjet produkteve kozmetike të BE-së. (Portal Njoftimi - CPNP) .
- Një person përgjegjës do të ketë detyrë të njoftojë efekte serioze të padëshirueshme për autoritetet kompetente kombëtare. Autoritetet do të mbledhin informacion që vjen për shëmbull nga përdoruesit dhe profesionistë të shëndetit, dhe do të jetë të detyruar për të ndarë informacionin me vendet tjera anëtare të BE-së.

Theksojmë se sigurimi i një niveli të lartë të shëndetit për njerëzit, kafshët dhe bimët është një objektiv i Traktatit të BE-së. Me kalimin e kohës BE-ja ka zhvilluar një trup të plotë të ligjit për të parandaluar dhe për të menaxhuar rreziqet për shëndetin e kafshëve dhe bimëve dhe të garantojë sigurinë e zinxhirit të ushqimit në BE dhe nivelin kombëtar. Ligji në këto fusha të politikave zbatohet me anë të një pakete të përbashkët të rregullave mbi kontrollet zyrtare që duhet të kryhen nga autoritetet kompetente në Shtetet Anëtare të BE.

Në maj 2013 Komisioni publikoi një propozim për rishikimin e rregullave mbi kontrollet zyrtare, për të krijuar një kornizë ligjore për të gjitha kontrollet zyrtre përgjatë tërë zinxhirit agro-ushqimor, me qëllim për të forcuar mekanizmat zbatues për rregullat përkatëse të BE-së dhe të mundësojë një zbatim më

efikas të kontroleve zyrtare. Në veçanti, rregullat e reja kanë për qëllim nxitjen e funksionimit normal të tregut të brendshëm në zinxhirin agro-ushqimor, si dhe mbajtjen e një niveli të lartë të njeriut, të kafshëve dhe mbrojtjes së shëndetit të bimëve dhe mirëqenien e kafshëve në të gjithë gjatësinë e zinxhirit.

Propozimi u bë me qëllim që të rriste transparencën e kontroleve zyrtare të kryera nga autoritetet kombëtare, dhe i lejon autoritetet e përfshira që në kushte të caktuara të publikojnë informacion për rezultatet e kontroleve mbi operatorët individualë, si dhe për krijimin e "skemave të vlerësimit" ku konsumatorët mund të konsultohen me të dhëna për ecurinë e shitjes, restorantet dhe biznese të tjera.

Rregullat të qarta për transparencë pritet të fuqizojë konsumatorët e Bashkimit Europian për të monitoruar efikasitetin dhe performancën e autoriteteve të tyre kombëtare. Konsumatorët gjithashtu mund të monitorojë më mirë performancën e operatorit, për shembull nëpërmjet skemave ushqimore të shitësve me pakicë. Konsumatorët pritet të përfitojnë nga rregullat që sigurojnë aftësinë e autoriteteve kombëtare për të adresuar shqetësimet ndërkufitare, kur ato lindin, dhe për të kryer kontrollet zyrtare në produktet e tregtuara në internet. Së fundi, kërkesat specifike për autoritetet kompetente për të kryer kontrollet zyrtare të drejtuara në zbulimin dhe luftimin e praktikave mashtruese dhe detyrimin për ato autoritete të ndihmojnë njëri-tjetrin përmes kufijve në rast të shkeljeve ndërkufitare të rregullave të zinxhirit agro-ushqimore pritet të japin rritje siguri për konsumatorët si për vërtetësinë dhe sigurinë e asaj që ata hanë.

Së bashku me propozimin e Majit 2013, për të përforcuar kontrollet zyrtare të sigurisë së ushqimit, Komisioni propozoi për të rishikuar kuadrin ligjor të qeverive në lidhje me shëndetin e kafshëve, shëndetit të bimëve dhe materiale riprodhuese bimore.

Paketa e përfshirë me propozime ligjore për rregullimin e shëndetit të kafshëve në BE,³ bazuar në parimin se "parandalimi është më i mirë se kurrë" synon të përmirësojë standardet për të siguruar një sistem të përbashkët me qëllim për të zbuluar

³ Bazuar në parimin se "parandalimi është më i mirë se kurrë"

sëmundjet, për trajtim shëndetësor ushqimor.

Ky sistem u zgjeruara, me shumë shtete për të aplikuar rregullat më të mira për identifikimin dhe regjistrimin dhe pritet të mbështetet nga ata që punojnë për të mbrojtur rrjetin e ushqimit, si fermerët dhe veterinarët, të cilët kanë aftësi për të reaguar shpejt dhe për të kufizuar përhapjen e sëmundjes dhe për të minimizuar ndikimin e tij në bagëti si dhe për konsumatorët.

Për më tepër, Bashkimi Europian po sheh si mundësi përmirësimin e regjimit ekzistues shëndetësor bimorë për të parandaluar dëmtuesit dhe për të mbrojtur kultivuesit e bimëve si dhe sektorin e pyjeve. Kjo mundësi, edhe përmes ndryshimeve ligjore më shumë do të përqëndrohet në tregtinë e rrezikut të lartë që vjen nga vendet e treta dhe rritjen gjurmueshmërinë së materialit fidanor në tregun e brendshëm. Legjislacioni i propozuar gjithashtu paraqet mbikqyrje më të mirë dhe çrënjosjen e hershme të llojeve të reja dëmtuese dhe kompensimin financiar për kultivuesit e goditur nga dëmtuesit.

Së fundi, në këtë fushë Bashkimi Europian propozon për rregullat më të thjeshta dhe fleksibël për tregtimin e farave dhe materialit tjetër riprodhues bimor me qëllim për të siguruar produktivitet, përshtatshmëri dhe diversitet të prodhimit të Evropës e kulturave si dhe për të lehtësuar tregtinë e tyre. Rregullat e reja shërbejnë për të përmirësuar dhe testuar varieteteve të reja, materiale, varietete tradicionale etj.

Në përgjithësi, konsumatorët pritet të përfitojnë nga produkte më të sigurta dhe një sistem më efektiv dhe transparent të kontrolleve përgjatë zinxhirit.

1.3 Sjellja e konsumatorit në BE

Duhet theksuar se shqetësimet e konsumatorëve janë të integruara në politikat kombëtare dhe të BE-së. Mbledhja e të dhënave dhe analiza në nivel të BE lehtëson krahasimet.

Gjetjet nga të dhënat e fushës Konsumatorit, studimet e tregut dhe hulumtimi i sjelljes së tij kanë ndikuar politikën e BE në fusha të ndryshme me interes për konsumatorët.

Sistemi “Scoreboard” në BE monitoron kushtet kombëtare të konsumit dhe integrimin e tregut të vetëm nga perspektiva

e konsumatorit. Një rezultat i publikuar në maj 2012, tregoi se mjediset e konsumit ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme në të gjithë shtetet anëtare të BE, me kushtet më të favorshme në Europën Veriore dhe Evropën Perëndimore. Ky sistem ka identifikuar vazhdimësinë e praktikave të padrejta tregtare dhe njohurive të ulëta të drejtave të konsumatorëve mes konsumatorëve dhe bizneseve. Ajo ka treguar gjithashtu se, pavarësisht nga rritja e qëndrueshme së tregtisë në vitet e fundit, konsumatorët janë shumë më pak të sigurt në lidhje me blerjen online nga vendet e tjera të BE-së në krahasim me vendet brenda BE-së. Gjithashtu ka gjetur se ka dallime të rëndësishme socio-demografike në kushte të konsumit.

Kërkime të mëtejshme janë të nevojshme për të kuptuar arsyet themelore për këto dallime.⁴

Disa studime të tregut (për pajisje elektrike dhe elektronike, mishit, ofrimin e shërbimeve të internetit, skemave vullnetare të etiketimit të ushqimit dhe produkte me përmbajtje dixhitale janë përfunduar në vitin 2012 dhe 2013:

Studimi mbi mallrat elektrike dhe elektronike, botuar në shkurt 2012, sheh diferencat e çmimeve mes vendeve, dallimet në zgjedhjen e konsumatorit në tregjet kombëtare, çmimet dhe disponueshmërinë e shitjeve në internet. Është gjetur se konsumatorët në disa vende anëtare mund të kursejnë deri në 35% të çmimit kur blejnë jashtë vendit. Kur blejnë në vendin e tyre, konsumatorët ende mund të shpëtojnë 5% mesatarisht nga shitja online. Përveç kësaj, shitjet online të ofrojnë produkte që nuk janë në dispozicion në dyqane.

Studimi mbi produktet e mishit, publikuar në maj të 2013, gjeti, data e etiketës, çmimi dhe vendin e origjinës janë informacioni i kërkuar më shumë dhe ky informacion është gjithashtu në përgjithësi në dispozicion të tyre (por më pak në dyqanet e kasapëve). Ndërsa konsumatorët duket se kujdesen për ndikimin e konsumit të mishit në shëndet, vetëm pak shikojnë për informacion në lidhje me vlerat ushqyese.

Rezultatet e anketës tregojnë që konsumatorët janë të vetëdijshëm për skemat e etiketimit të ushqimit, blejnë produkte

4 Kontrata e re kornizë për ofrimin e studimeve të tregut u nënshkrua në dhjetor 2013.

të etiketuara, besojnë se ka përfitime për këto produkte dhe janë në një farë mase të gatshëm të paguajnë një çmim premium për to. Megjithatë, besimi i konsumatorit në informacionin e treguar në etiketat produktit dhe nivelin e të kuptuarit të këtij informacioni është mjaft i kufizuar.

Disa studime të tjera (për karburantet e automjeteve, makinave të përdorura, ndjeshmërisë së konsumatorit, kanë filluar gjatë vitit 2011-2014:

Studimi mbi karburantet e automjeteve të tregut (që u finalizua në prill 2014) heton kushtet e konsumit në këtë treg duke kërkuar ndër të tjera në të kuptuarit e konsumatorit dhe transparencën e informacionit të dhënë nëpërmjet kanaleve të ndryshme, perceptimet mbi qëndrueshmërinë e karburantit, disponueshmëria e lëndëve djegëse të ndryshme ndaj shitësit, dhe çmimet e shitjes me pakicë të karburantit.

Gjetjet e studimeve mund të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së hartimit të politikave në fusha të tilla si telekomi, shërbimet financiare, të energjisë, e-tregtisë, dhe opsionet e politikave ndaj atyre që prodhojnë përfitime më të prekshme për konsumatorët evropianë.

Gjykimet e sjelljes së konsumatorit mundësojnë politikë-bërësit për të krahasuar opsionet në kushte më realiste dhe për të gjetur zgjidhje politike të problemeve në fjalë.

Pas krijimit të një kontrate të re kornizë për studime të sjelljes së konsumatorit evropian në janar 2012, kanë nisur trembëdhjetë studime të tilla në fusha të ndryshme të politikave në mënyrë që të gjendet se si njerëzit marrin vendime në fusha të ndryshme, dhe për të provuar efektet e politikës alternative, mjetet juridike kur të dhënat tregojnë se konsumatorët dështojnë.

Në shtator 2013 u zhvillua një conference 114 e tretë e nivelit të lartë (pas atyre në vitin 2008 dhe 2010) ku u dha një pasqyrë e kësaj gjendje 115, si dhe gjetjet specifike të studimeve të kryera deri më tani.

Shumë nga studimet e sjelljes nisur që nga janari 2012 kanë një fokus konsumin. Në këto studime trajtohet transparenca dhe krahasueshmëria e llogarive bankare, matja e energjisë, etiketimi i ushqimit, paketat e udhëtimit, etiketimin CO2 në makinë, ligji i konsumatorit për blerjet ndërkuftare, tarifat e fshehura

për përdorimin e kartave të kreditit dhe të kujdesit shëndetësor ndërkufitar si dhe një studim për shitje të përbashkëta europiane 116.

Një numër studimesh të mëtejshme janë në vazhdim ose të planifikuara për t'u nisur në vitin 2014. Në veçanti, studimi në vazhdimësi në lidhje me konsumin në lojrat e bixhozit online ka për qëllim për të shqyrtuar se si është e mundur për të mbrojtur më mirë të miturit në lojra online. Një tjetër studim i ardhshëm do të shqyrtojë qëndrimet e konsumatorëve, kur është fjala për leximin, të kuptuarit dhe për të pranuar termat dhe kushtet në fushën e të drejtës së konsumatorit.

Konsumatorët në BE duhet të marrin informacion të qartë, të thjeshtë dhe transparent në kohën dhe në vendin vendin e duhur për të marrë vendime optimale blerjeje. Me pak fjalë, ka një limit se sa informacion të konsumit mund ose dëshiron konsumatori të përvetësojë në hapat e ndryshme të procesit të blerjes, pasi më shumë informacion ndonjëherë nuk është gjithmonë më mirë për konsumatorët. Megjithatë, në qoftë se duhet, kërkesat rregullatore të informacionit (ligji i përgjithshëm i konsumit apo të legjislacionit për produkte apo shërbime të veçanta) mund të kontribuojnë në fuqizimin e konsumatorit.

Njohja më e mirë e të drejtave të konsumatorëve në mesin e bizneseve dhe SME-ve kontribuon në zvogëlimin e numrit të konflikteve, dhe lehtëson zgjidhjen e tyre miqësore.

Rrjeti Enterprise Europe (EEN), me kapacitet prej rreth 600 shoqatave anëtare të saj në BE dhe më gjerë për të shpërndarë informacion mbi legjislacionin e konsumatorit për tregtarët, duke përfshirë NVM-të, dhe për të rritur vetëdijen e tyre për të drejtat e konsumatorëve, luajnë një rol të rëndësishëm në përpjekje për të rritur njohuritë e bizneseve në Direktivën e të Drejtave të Konsumatorit, që ka hyrë në fuqi nga 13 qershor 2014 duke futur detyrime të reja për tregtarët.

Qendrat evropiane të konsumit sigurojnë konsumatorët me informacion mbi të drejtat e tyre në gjuhën e tyre dhe të ndihmojnë ata në zgjidhjen e kontesteve ndërkufitare me tregtarët që ndodhen në shtetet e tjera anëtare.

Në vitin 2012 dhe 2013 rrjeti ECC ka regjistruar rreth 145.000 kontakte të drejtpërdrejta me konsumatorët.

Ajo ka ndihmuar për të zgjidhur rreth 65.000 ankesa gjatë raportimit periodik. Dy të tretat e ankesave janë zgjidhur nga konsumatorët vetem në sajë të këshillës që kishin marrë nga ECCs. Në rastet e tjera, të ECCs nga të dy vendet kanë punuar së bashku dhe kishin rezultate pozitive në zgjidhjen miqësore me tregtarët në rreth gjysmën e rasteve.

Duhet theksuar se, në fazën para-kontraktuale informacioni i produktit është më i pasur, kompleks dhe teknik.

Ndërkohë konsumatorët e BE-së por edhe në shumë vende të botës gjithnjë e më shumë po përdorin internet dhe mjetet offline, botime, faqet e internetit dhe aplikacione telefonash për të krahasuar produktet dhe shërbimet. Por duhet theksuar se, jo të gjitha mjetet e tilla të sigurojnë informacion të saktë e të qartë dhe të besueshëm⁵.

1.4 Fushatë për të drejtat e konsumatorit në BE

Një fushatë për rritjen e ndërgjegjësimit, në lidhje me të drejtat e konsumatorit dhe ku për të gjetur këshilla dhe informata në rast të një mosmarrëveshje shitës-konsumator u zhvillua në Rumani prej qershorit 2012 deri deri në korrik 2013. Përgatitjet për një fushatë të ngjashme kanë nisur në Kroaci në shtator 2014.

Rritja e ndërgjegjësimit në lidhje me të drejtat e konsumatorit dhe qasje më të mirë në informacion dhe këshilla në lidhje me të drejtat e konsumatorëve sidomos nëpërmjet internetit dhe mediave sociale, si dhe përmirësimin autoriteteve përkatëse, duhet të ndihmojë për të përmirësuar zbatimin e rregullave për mbrojtjen e konsumatorëve, dhe për të rritur pajtueshmërinë me obligimet e të drejtave të konsumit nga komuniteti i biznesit.

Në 2013 një fushatë u përgatit për të rritur ndërgjegjësimin e konsumatorëve dhe tregtarëve për të drejtat dhe obligimet e tyre që rrjedhin kryesisht nga transpozimi i direktivave të BE-së kombëtare (në veçanti Direktiva e Praktikave të Padrejta Tregëtare.

⁵ Samiti i Konsumatorëve "Consumer Summit" përmban një sërë rekomandimesh për përmirësimin e transparencës dhe përdorimit të mjeteve të krahasimit, si dhe cilësisë së informacionit që ata ofrojnë. Rezultatet nga ky studim priten në korrik të 2014-tës dhe mund të informojnë mbi politika të mundshme, të tilla si zhvillimi i udhëzimeve horizontale mbi funksionimin e mjeteve të krahasimit

Kjo fushatë mbështetet nga një numër i shteteve kryesore anëtare për të arritur qëllimet e saj, por gjithashtu do të ofrojë mundësi të bashkëpunimit me palët e interesuara në të gjitha Shtetet Anëtare që janë të gatshëm për të marrë pjesë për llogari të tyre.

Fushata filloi në mars 2014 duke u përqëndruar, së bashku me të drejtat kryesore që rezultojnë nga direktivat ekzistuese, edhe për të drejtat e reja⁶ që rrjedhin nga Direktiva e të Drejtave të Konsumatorit, e cila hyri në fuqi më 13 qershor 2014.

Konsumatorët në BE gjithnjë e më shumë mbështeten në internet për të kërkuar informacion mbi të drejtat e tyre. Faqet e internetit tërheqëse dhe të rëndësishme kursejnë kohë për konsumatorët dhe i ndihmojnë ata me të lehtë të gjetur informacionin që ata kanë nevojë.

Në këtë kontekst, një numër faqesh interneti u ridizejnuan me një version on-line i "Europa Diary" që u botua në vitin 2012 dhe u përditësua në 2013; me informacion për qytetarët në europa.eu rreth të drejtave të konsumatorit u përqendrua në faqe konkrete për qytetarët kurse informacioni për përdoruesit profesionistë në faqen e internetit DG SANCO për konsumatorët u ringrit në 2013; ndërkohë website i ri "Agjenda digjitale për Evropën" përmban informacione të rëndësishme për konsumatorët, si dhe informacion mbi legjislacionin e BE-së gjithashtu mbron konsumatorët në sektorin e komunikimeve elektronike.

Puna për të rinovuar dhe të rritur e informacionit për konsumatorët për të drejtat e tyre në internet ka vijuar në vitin 2012 me lëshimin Kodit të Drejtave Online të BE-së si mjet për ngritjen e vetëdijes për të drejtat e qytetarëve të BE-së në mjedisin digjital dhe besim frymëzues dhe të besimit të konsumatorëve në mënyrë që të promovojë përdorimin më të madh të shërbimeve online në BE. "You Guide" u krijua më 21 shtator 2012, ndërkohë, kodi i ri i të drejtave të BE-së në internet është publikuar në internet për qasje të lehtë nga qytetarët dhe konsumatorët në dhjetor 2012.

Kodi i pajis qytetarët dhe konsumatorët me një përmbledhje të të drejtave të tyre kryesore nën legjislacionin e BE të cilat

6 Të cilat rrjedhin nga Direktiva e të Drejtave të Konsumatorit, e cila hyri në fuqi më 13 qershor 2014.

janë relevante për mjedisin digjital. Këto të drejta janë tani në dispozicion në një botim të vetëm dhe faqet e internetit të dedikuara konsumatorëve duke bërë të mundur për të gjetur një përmbledhje dhe shpjegime për të drejtat dhe detyrimet e tyre ligjore, të përcaktuara në mënyrë transparente dhe të kuptueshme. Këto të drejta themelore sipas ligjit të BE-së shërbejnë për të mbrojtur qytetarët dhe konsumatorët përshembull, duke përdorur shërbimet në internet, duke blerë mallra në internet, dhe në raste të konfliktit me ofruesit e shërbimeve.

Një faqe dedikuar të Kodit të drejtave të BE-së në internet është në dispozicion në agjendën digjitale për faqen e internetit të Evropës me përmbledhjet e këtij Kodi në versionin e plotë në dispozicion në të gjitha gjuhët dhe është shumë e lehtë për të shkarkuar online. Një seksion i ri për të drejtat në internet është publikuar në website-in “youreurope” me informata shtesë praktike në lidhje me këto të drejta për tu kuptuar më lehtë nga qytetarët dhe konsumatorët.

Në maj 2013, shërbimet e Komisionit nisën një fushatë informacioni për të rritur ndërgjegjësimin e konsumatorëve në lidhje me të drejtat e tyre të kreditit dhe për të inkurajuar ata për të krahasuar e për të blerë produktin e kredisë më të përshtatshëm për nevojat e tyre.

Fushata u zhvillua në katër shtete anëtare të përzgjedhura si pilot grupi (Irlandë, Maltë, Spanjë dhe Qipro) dhe vazhdoi deri në shkurt 2014. Qëllimi i tij ishte për të rritur ndërgjegjësimin për konsumatorët e të drejtave të tyre, kur ata të marrin kredi, bazuar në Consumer Credit Directive (ÇD). Motoja e kësaj fushate ishte "Kërkoni kredi? Mos nënshkruani. Ju keni të drejta". Kjo fushatë u fokusua në pesë të drejtat kryesore dhe konsumatorëve të moshës mes 18 dhe 35 vjeç. Efektiviteti dhe ndikimi i fushatës është që të vlerësohet. Në bazë të rezultateve, fushata mund të zgjatet për të Shteteve Anëtare të tjera përgjatë viteve 2014-2015.

1.5 Mbrojtja e Konsumatorit në BE

Rrjeti i Bashkëpunimit të Mbrojtjes së Konsumatorit u krijua për të lejuar autoritetet kombëtare të zbatimit të punojnë ngushtë së bashku për të siguruar pajtueshmërinë me rregullat për mbrojtjen e konsumatorëve në të gjithë BE-në dhe për të trajtuar rastet e shkeljes ndërkufitare. Bashkëpunimi i Mbrojtjes së Konsumatorit (CPC) Rregullorja (2006/2004/EC) siguron mekanizmat e nevojshëm të bashkëpunimit të autoriteteve kombëtare, duke i lejuar ata për të ndërmarrin veprime në emër të konsumatorëve të vendosura në një vend tjetër.

Rregullorja CPC parashikon një rishikim për ndryshime që duhet të përfundojë deri në fund të vitit 2014.

Një evolim i jashtëm është kryer në 2012-2013 dhe janë diskutuar përmirësimet e mundshme të Rregullores gjatë një debati të nivelit të lartë në Samitin e Konsumatorit mars 2013.

136 Opsione të ndryshme për të forcuar bashkëpunimin e zbatimit janë vënë në një konsultim publik më 11 tetor 2013.

Rishikimi i rregullores CPC në BE pritet të çojë në një nivel më të lartë të pajtueshmërisë me legjislacionin për mbrojtjen e konsumatorit në të gjithë tregun e brendshëm. Kjo mund të kontribuojnë në rritjen e besimit të konsumatorit dhe kufizim të dëmit të konsumatorit për shkak të praktikave të këqija nga tregtarët. Nivelet shumë homogjene të zbatimit në tregun e brendshëm mund të kontribuojnë për më shumë konkurrencë dhe transparencë në tregjet e BE-së. Gjatë periudhës së raportimit Rrjeti Gjyqësor European (EJN) në ka intensifikuar punën për çështjet e konsumit dhe miratoi një udhëzues praktik “Guide on Small Claims” . Guide e re krijon lehtësira për qytetarët e zakonshëm për të hyrë në gjykata dhe të kërkuar zgjidhjen e kërkesave me vlerë të vogël shpejt dhe pa pasur nevojë të shpenzojnë shuma të mëdha parash për këshilla ligjore.

Për më tepër, takimi i pikave të kontaktit të rrjetit në shtator 2013 ishte pjesërisht i përkushtuar për të drejta e konsumatorit.

Çështjet, të cilat i shërbejnë një qëllimi të dyfishtë në EJN: për të shpërndarë informacion në lidhje me zhvillime të konsumit për rritjen e ndërgjegjësimit të ligjit në mesin e

avokatëve (shembull: Raporti mbi Zbatimin e Directives Praktikave të Padrejta Tregtare) dhe për të analizuar lidhjet mes së drejtës së konsumatorit dhe Procedurës Civile (shembull: praktika gjyqësore nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë në kushte të padrejta) me qëllim zbatimin efikas të ligjit të konsumatorit. Përveç kësaj, në faqen e internetit EJM është në proces portali “Justice” për të përmirësuar qasjen në informata për kontestet civile ndërkufitare për publikun e gjerë.

Komisioni miratoi mars 2013 një Komunikim dhe një Report të cilat ofrojnë një vlerësim të parë të zbatimit të Direktivës së Praktikave të Padrejta Tregtare (UCPD) në Shtetet Anëtare, si dhe një përshkrim të veprimeve të nevojshme për të maksimizuar përfitimet e saj. Raporti arriti në përfundimin se përpjekje të mëtejshme për zbatimin duhet të bëhet nga shtetet anëtare për të garantuar një nivel të lartë të mbrojtjes së konsumatorëve, dhe se Komisioni mund të marrë një rol më aktiv në nxitjen e një aplikim koherent të Direktivës në veçanti në lidhje me praktikave të pandershme. Raporti ka identifikuar fushat kryesore prioritare për: të udhëtimit dhe të transportit,

Shërbimet e Komisionit rregullisht organizojnë seminare tematike me zbatuesit kombëtare për çështjet e reja në këto fusha. Dy seminare të tilla janë organizuar në vitin 2013 (për çështje digjitale dhe çështjeve të udhëtimit / e transportit).

Diskutimet në punëtori mund të sigurojnë të dhëna për Udhëzuesin mbi UCPD, e cila është planifikuar për rishikim në vitin 2014. Për më tepër, Komisioni do të zhvillojë, në bashkëpunim me shtetet anëtare, të caktuar për zbatimin e Direktivës, i cili do të zbulojë të metat dhe dështimet.

Puna ka nisur drejt zhvillimit të një Database të Ligjit të Konsumit (për konsumatorët, zbatuesit dhe praktikuesit ligjorë) nëpërmjet konsolidimit të database Praktikave Tregtare të Padrejta dhe një Database e përmbledhjes së Acquis në këtë fushë.

Baza e të dhënave e krijuar rishtazi ka për qëllim që të ketë të gjitha funksionet e një databaze të praktikave të padrejta tregtare me përmirësimet e duhura. Ligji konsumatorit dhe baza e të dhënave është menduar të përditësohen rregullisht me qëllim që të kthehet në një mjet themelor për arritjen e

konvergencës midis shteteve anëtare në zbatimin e Direktivës dhe të kontribuojë për të forcuar zbatimin. Këto masa duhet të kontribuojnë në uljen në mënyrë efikase dhe në vazhdimësi përtej kufijve ose në disa shtete anëtare të BE-së.

Në janë ndjekur dhe ndërmarra një numër veprimesh, duke përfshirë ato legjislative, që synojnë dëmshpërblimin e konsumatorit si para gjykatave dhe përmes mekanizmave jashtëgjyqësorë.

Legjislacioni i ri për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve (ADR) dhe Rezolutën Online Mosmarrëveshjeve (ODR)

Legjislacioni i ri për ADR dhe ODR në BE është miratuar në qershor 2013. Direktiva ADR⁷ do të sigurojë që konsumatorët mund të zgjidhin në mënyrë alternative mosmarrëveshjet e tyre kontraktuale me tregtarët në pothuajse të gjithë sektorët e biznesit (përfshirë zbatohen vetëm për shëndetin dhe sektorin e arsimit e lartë) në një mënyrë të lehtë, të shpejtë dhe të lirë. Nuk ka ndryshim nëse mallrat ose shërbimet janë blerë online apo offline, brenda apo jashtë kufijve.

Sipas Rregullores ODR, një platformë e gjerë e BE-online do të jetë ngritur për mosmarrëveshjet që lindin nga transaksionet online. Platforma do të lidhë të gjitha njësitë ekonomike e kombëtare të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve dhe do të veprojë në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së. Shtetet anëtare janë të detyruara të implementojë Direktivën ADR deri në korrik 2015. Platforma ODR pritet të jetë operacionale nga janari i vitit 2016.

Ndërmjetësimi është një nga metodat më efikase të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve (ADR). Direktiva e Ndërmjetësimit mbulon ndërmjetësimin në kontestet ndërkufitare që dalin në çështjet civile dhe tregtare. Një studim është nisur për të vlerësuar transpozimin dhe zbatimin e Direktivës; rezultatet e tij pritet të publikohet përgjatë vitit 2014.

“The European Small Claims Procedure” procedura (ESCP) ka për qëllim thjeshtimin dhe përsheptimin e procesit gjyqësor brenda BE-së bazuar në kërkesa me vlerë të ulët, duke ulur shpenzimet e procesit gjyqësor. Për të bërë procedura më të qasshme për publikun shërbimet e Komisionit botuan një

⁷ Miratuar në qershor 2013

udhëzues praktikë në 2013. Më 19 nëntor 2013 u miratua gjithashtu një propozim për të rishikuar procedurën në mënyrë që të sjellë më shumë pretendime brenda objektivit të tij dhe për ta bërë atë më të kapshëm nga modernizimi i mëtejshëm dhe duke e thjeshtuar atë.

Promovimi dhe riorganizimi i dëmshpërblimeve kolektive mund të përmirësojë qasjen në drejtësi duke ruajtur shpenzimet e procesit gjyqësor për qytetarët dhe konsumatorët kur një numër i madh personash dëmtohet nga një praktikë në lidhje me shkeljen e të drejtave të parashikuara sipas ligjit të Unionit të BE-së.

Në qershor 2013 Komisioni ka lëshuar një rekomandim, duke i ftuar Shtetet Anëtare që të ketë mekanizma rregullimi më kolektive në vend, për të siguruar qasjen efektive në drejtësi. Dëmshpërblimet kolektive lejojnë shumë pretendime të ngjashme ligjore dhe gjykata shmang kështu shumë procedura të ndryshme individuale. Komisioni rekomandon që një numër parimesh të përbashkëta për mekanizmat e dëmshpërblimit kolektive të zbatohet në të gjitha vendet anëtare në mënyrë që qytetarët dhe kompanitë mund të zbatojë të drejtat e tyre sipas ligjit të BE nëse këto janë shkelur. Rekomandimi synon të sigurojë një qasje koherente horizontale për dëmshpërblime kolektive në Bashkimin Evropian pa harmonizimin e sistemeve të Shteteve Anëtare. Mekanizmat kombëtare korrigjuese duhet të jenë në dispozicion në fusha të ndryshme ku ligji i BE-së u dhuron të drejta për qytetarët dhe kompanitë, sidomos në fushën e mbrojtjes së konsumatorit, konkurrencës, mbrojtjen e mjedisit dhe shërbimeve financiare.

Legjislacion dhe akte komunitare

1. Traktati i Maastrichtit, 07 shkurt 1992
2. Traktati i Amsterdami, 2 Tetor 1997
3. Traktati i Lisbonës, 13 Dhjetor 2007
4. Traktati mbi Funksonimin e Bashkimit European, 01 Dhjetor 2009
5. Direktiva 84/641/CEE “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative që lidhen me sigurimin e drejtpërdrejtë, me përjashtim të sigurimit të jetës” datë 10/12/1984
6. Direktiva 85/577/CEE “Për kontratat e lidhura jashtë qendrave të tregtimit”, datë 20/12/1985
7. Direktiva 87/102/CEE “Për kredinë konsumatore”
8. Direktiva 89/646/CEE, “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative që lidhen me ndjekjen e institucioneve të kreditit”, datë 15/12/1989
9. Direktiva 90/314/CEE “Për paketat e udhëtimit”, datë 13/06/1990
10. Direktiva 92/49/CEE, “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative që lidhen me sigurimin, me përjashtim të sigurimit të jetës”, datë 18/06/1992
11. Direktiva 93/13/CEE “Mbi Kushtet e Padrejta”, datë 05.04.1993
12. Direktiva 1999/44/CE “Mbi disa aspekte të shitjes dhe garancisë për mallrat e konsumit”, datë 25/05/1999
13. Direktiva 2002/65/EC në lidhje me “Tregtinë në largësi të shërbimeve financiare konsumatore”.
14. Direktiva 2004/39/EC “Për instrumentet financiare të tregut”
15. Direktiva 2005/29/CE “Në lidhje me praktikat e padrejta tregtare”, datë 11/05/2005
16. Direktiva 2006/48/EC “Në lidhje me veprimtarinë e institucioneve të kredisë”
17. Direktiva 2009/22/EC “Mbi vendimet administrative dhe gjyqësore për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve”, datë 23.04.2009
18. Direktiva 2011/83/UE “Mbi të drejtat e konsumatorëve”, datë 25/10/2011

POLITIKA PENALE PËR VEPRAT PENALE KUNDËR GRAVE DHE FËMIJËVE

Refleksione mbi ndryshimet në kodin penal (2012- 2013)

Prof. Dr. Vasilika Hysi¹

1.0 Kriminalizimi i veprave kundër grave dhe fëmijëve – orientimi i politikës penale europiane

Politika penale formohet dhe ndryshon nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm, mes të cilëve janë nevoja për një përgjigje ndaj formave të reja të krimit dhe mbrojtja e grupeve shoqërore të veçanta, mes të cilëve gratë dhe fëmijët.

Në tërësinë e ndryshimeve të bëra në politikën penale, do të analizohen ndryshimet që adresojnë më shumë mbrojtjen e grave dhe të fëmijëve në përgjithësi dhe dhunën në familje, në veçanti.

1.1 Viktimizimi i grave dhe fëmijëve – shqetësim ndërkombëtar në rritje

Raportet ndërkombëtare tregojnë se rreth më shumë se gjysma e njerëzve në botë që jetojnë në varfëri ekstreme janë fëmijë dhe se dhuna ndaj fëmijëve nuk është një përjashtim, por një rregull në botë².

¹ Autorja është deputete, kryetare e Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut, Kuvendi i Shqipërisë, pedagoge me kohë të pjesshme në Departamentin e së Drejtës penale, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

² *Is the word better a better place for children? 25 years of the Convention on the Rights of the Child.* UNICEF, Shtator 2014, faqe 29 dhe 35. Ky botim gjendet edhe në faqen zyrtare të UNICEF në internet: http://www.unicef.org/publications/files/CRC_at_25_Anniversary_Publication_26Sept2014.pdf

Gjithashtu, dhuna në familje është një shqetësim botëror e problem global i shëndetit publik që kërkon masa urgente³. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetit, 35 për qind e grave në botë kanë qenë viktime të dhunës fizike dhe/ose seksuale nga partneri ose jo partneri i tyre; 30 përqind e grave kanë qenë viktime të dhunës së partnerit të tyre.

Nëse i referohemi rastit të Shqipërisë, sipas raportit të INSTAT për 2013⁴, numri i rasteve të dhunës në familje të raportuara në polici është rritur ndjeshëm, nga 94 raste në vitin 2005, në 2526 raste në vitin 2012. Po sipas këtij studimi, 59,4 për qind e grave (më shumë se 1 në 2 gra) kishin pësuar dhunë në familje në martesë/marrëdhënie intime “gatë jetës” dhe 53,0 për qind e grave (1 në 2 gra) po përjetonin dhunë në familje “aktualisht” (brenda 12 muajve para intervistës).

Gratë dhe fëmijët janë viktime të krimit brenda dhe jashtë vendit, kryesisht viktime të trafikimit të qënieve njerëzore, të shfrytëzimit për prostitucion, punës së detyruar, lypësi dhe qëllime të tjera jo të ligjshme. Sipas raportit global për trafikimin e qënieve njerëzore, 67 për qind e viktimave në botë janë gra, 13 për qind janë vajza dhe 9 për qind djem⁵. Sipas raportit të Bashkimit Europian⁶, 80 për qind e viktimave të trafikimit janë gra dhe rreth 1000 fëmijë të mitur të identifikuar përdoren për shfrytëzim seksual në vendet e BE-së.

Kjo është vetëm një pjesë e tablosë së dhimshme të gjendjes së grave dhe fëmijëve në shek. XXI, e cila duhet të ndryshojë përmes politikave globale, rajonale dhe masave që duhet të marrin shtetet në nivel kombëtar.

3 Shih “Global and regional estimates of violence against women: prevalence and health effects of intimate partner violence and non-partner sexual violence”, Raport i Organizatës Botërore të Shëndetit, 2013. Ky raport gjendet edhe në internet në adresën:

http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/85241/1/WHO_RHR_HRP_13.06_eng.pdf?ua=1

4 Dr. Robin N. Haarr, *Dhuna në familje në Shqipëri, Vrojtim kombëtar me bazë popullatën*, 2013, f. 1.

Ky raport gjendet edhe në faqen zyrtare të INSTAT në adresën:

http://www.instat.gov.al/media/225812/dhuna_ne_familje_ne_shqiperi_2013.pdf

5 *Global Report on Trafficking in Human beings*, UNDCP, 2009, f. 48. Ky raport gjendet i botuar në adresën: http://www.unodc.org/documents/Global_Report_on_TIP.pdf

6 *Trafficking in human beings 2010-2014: eradicating the slave trade*, EU report, 17 Tetor 2014. Të dhëna të plota gjenden në adresën: http://europa.eu/rapid/press-release_IP-14-1164_en.htm

1.2 Politika penale europiane në mbrojtje të grave dhe fëmijëve

Gjatë këtyre viteve janë miratuar një sërë aktesh ndërkombëtare që përcaktojnë standarde për masat që duhet të marrin shtetet për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje, krimeve ndaj grave, fëmijëve. Konventa e Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”⁷, e njohur ndryshe si Konventa e Stambollit, përbën instrumentin e parë ndërkombëtar me fuqi ligjore që parashikom masa të gjithanshme për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje⁸. Dhuna kundër grave konsiderohet shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër tyre.

Konventa e Stambollit, në nenin 3, gërma “a” të saj, jep përkufizimin e dhunës kundër grave⁹ që nënkupton *të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private. Po në këtë nen, gërma “b” jepet përcaktimi i dhunës në familje* që nënkupton *të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose nësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish-bashkëshortëve ose partnerëve, ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.*

Para ratifikimit të Konventës së Stambollit, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin “Për parandalimin e dhunës në marrëdhëniet familjare”¹⁰, ndryshuar i cili synon parandalimin dhe kufizimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj.

7 Ratifikuar me ligjin 104/2012 të Kuvendit të Shqipërisë.

8 *Të lirë nga frika, të lirë nga dhuna*, Manual për parlamentarët, Konventa e Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (botim i Këshillit të Europës, botim shqip, f. 18.

9 Në konceptin gra në kuptimin e konventës përfshihen edhe vajzat nën moshën 18 vjeç (neni 3, gërma “f” e Konventës së Stambollit).

10 Ligji 9669, datë 18.1.2.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Ligji parashikon masa të përshtatshme ligjore për mbrojtjen e pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimë të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara. Ligji, ndonëse i miratuar më parë se sa konventa, jo vetëm që parashikon format e dhunës në familje, por detajon nocionin “pjesëtarë të familjes” (neni 3)¹¹.

Ligji “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës¹²” i miratuar para ratifikimit të Konventës së Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual”¹³ parashikon masat mbrojtëse dhe mekanizmat në mbrojtje të fëmijëve.

Krahas këtyre konventave, Këshilli i Europës ka miratuar edhe konventa të tjera në fushën e krimit të organizuar, të trafikimit të qënieve njerëzore, të krimit kompjuterik dhe një sërë rekomandimesh në këtë fushë të cilat shërbëjnë si udhërrëfyese në politikën penale shqiptare dhe që mbrojnë gratë dhe fëmijët.

2.0 Politikë penale mes shtesave dhe ndryshime në pjesën e përgjithshme dhe tëposaçme të kodit penal

Në vitin 2012 dhe 2013, kodi penal (k.p) pësoi ndryshime në pjesën e përgjithshme dhe të posaçme të tij, pjesë e së cilës ishin mbrojtja e grave dhe fëmijëve nga forma të ndryshme të krimit, përfshirë dhunën në familje. Ndryshimet në pjesën e posaçme të kodit penal kanë sjellë shtimin e veprave penale, ndryshime, plotësime ose saktësime të rregullimeve ekzistuese. Disa ndryshime u diktuan nga rritja e kriminalitetit, të tjera ishin përmbushje e nevojave për të përshtatur legjislacionin penal shqiptar me standardet ndërkombëtare.

11 “Pjesëtarë të familjes” janë: a) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja apo ish–bashkëshorti/ja apo ish partneri/ja bashkëjetues; b) vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar; c) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja i personave të parashikuar në shkronjën “b”;) gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e adoptuar të bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es; d) vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 muajve të fundit; dh) fëmijët e bashkëshortëve apo partnerëve bashkëjetues.

12 Ligji Nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”

13 Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën me ligjin nr. 10071, datë 9.2.2009, të botuar në Fletoren Zyrtare nr. 21, datë 6 Mars 2009, Faqe 1353. Ky ligj ka hyrë në fuqi më 1 Korrik 2010.

2.1 Mbrojtja e të miturve nga keqtrajtimi e abuzimi- përparësi e politikës penale shqiptare

Të miturit janë viktima të keqtrajtimit e abuzimeve në familje dhe jashtë saj. Studimet kombëtare¹⁴ tregojnë se 39 për qind e fëmijëve janë viktima të dhunës fizike dhe 69 për qind viktima të dhunës psikologjike. Fëmijët e intervistuar pohuan se keqtrajtohen fizikisht dhe/ose psikologjikisht në familje.

Megjithëse keqtrajtimi i fëmijëve është një fenomen i vjetër, kodi penal i vitit 1995 nuk e parashikonte atë si vepër penale. Në seksionit IX “ Veprat penal kundër fëmijës, martesës dhe familjes”, fillimisht parashikohej braktisja e fëmijëve të mitur (neni 124). Ky nen u ndryshua në vitin 2001¹⁵ duke rritur moshën e fëmijëve të mbrojtur në rast braktisje nga 14 vjeç në 16 vjeç. Argumenti i sjellë për këtë ndryshim ishte se fëmijët nën 16 vjeç nuk kanë të drejtë të punojnë dhe mundësi të sigurojnë mjetet e tyre për jetesë.

Fëmijët janë viktima, jo vetëm të braktisjes, por edhe të shfrytëzimit për punë, për të lypur ose veprimtari të tjera të paligjshme. Sipas raporteve ndërkombëtare, në vitin 2013¹⁶, rreth 19 për qind e fëmijëve të moshës 5-14 vjeç punojnë dhe se fëmijë shqiptarë shfrytëzohen në vende perëndimore. Sipas raportit të INSTAT dhe ILO¹⁷ në vitin 2010, në Shqipëri janë rregjistruar 9.1 për qind e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç që shfrytëzohet brenda vendit.

Megjithëse, Shqipëria ka ratifikuar konventën “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” në vitin 1992, vetëm në vitin 2008 u parashikua si vepër penale keqtrajtimi i të miturit (neni 124/b)¹⁸, duke parashikuar dy format e tij: keqtrajtimin fizik dhe psikologjik të të miturit nga personi që është i detyruar të

14 Studimi “Dhuna ndaj Fëmijëve në Shqipëri” në kuadër të Studimit Epidemiologjik Ballkanik mbi Abuzimin dhe Neglizhimin e Fëmijëve (B.E.C.A.N) - CRCA, 2013

15 Ndryshuar paragrafi i me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 34.

16 *Child labour in Europe: a persisting challenge*: <http://www.coe.int/en/web/commissioner/-/child-labour-in-europe-a-persisting-challenge-1#more-305>

17 *Working children in the Republic of Albania - The results of the 2010 National Child Labour Survey*. Ky studim gjendet i botuar edhe në internet në adresën: http://www.ilo.org/ippec/Informationresources/WCMS_202853/lang--en/index.htm

18 Nr.9859, datë 21.1.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, shtesa e propozuar me nismën e deputetes Majlinda Bregu.

kujdeset për të dhe detyrimin e të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur ose për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij.

Ndryshimet e bëra në vitin 2008 përmirësuan mbrojtjen penale të të miturve, por disa veprime kundër të miturit si: shfrytëzimi, shtytja ose përdorimi i të miturit për të punuar nga persona të tjerë të familjes nuk dënoheshin. Problemi i lindur në praktikë me zbatimin e kësaj dispozite ishte formulimi “*personi që është i detyruar të kujdeset për të*”.

Ky rregullim ishte jo i plotë dhe nuk mbronte fëmijët nga keqtrajtimet e personave të tjerë të familjes. Studimet tregojnë se fëmijët shfrytëzohen edhe nga pjesëtarë të tjerë të familjes ose të afërm. Me ndryshimet e bëra në vitin 2012, neni 124/b u amendua dhe u plotësua përsëri, duke parashikuar si subjekte të veprës penale prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor ose çdo person që është i detyruar të kujdeset për fëmijën.

Duke qenë se pasojat e keqtrajtimit të të miturve janë të ndryshme, ligjvënësi riformuloi dhe saktësoi edhe kuptimin e nocionit “*dëmtim i zhvillimit të fëmijës*” duke parashikuar në ligj qartësisht se bëhet fjalë për dëmtimin e zhvillimit mendor dhe/ose fizik, arsimimin e tij. Kuptimi dhe zbatimi i njëjtë i kësaj dispozite mund të ishte zhvilluar edhe nga praktika gjyqësore, por fakti që në praktikë pasojat lidheshin me shumë me dëmtimin fizik, sesa atë psikologjik e detyruan ligjvënësin të riformulonte përmbajtjen e nenit 124/b të kodit penal, duke saktësuar llojet e pasojave që mund të vijnë nga kjo veprë penale. Gjithashtu, në varësi të pasojave të veprës penale, ligjvënësi parashikoi si veprë penale në rrethanë rënduese rastet kur vepra shkakton dëmtim të rëndë të shëndetit ose vdekjen e miturit.

Me ndryshimet e bëra, përmbajtja e kësaj dispozite përafrohet me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të ligjit “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”¹⁹ dhe konventën “Për të drejtat e fëmijës”.

Një nga problemet që kërkon zgjidhja në praktikë është

19 Fëmija mbrohet nga çdo formë e: a) dhunës fizike dhe psikologjike; b) ndëshkimit trupor dhe trajtimit poshtëruës e denigrues; c) diskriminimit, përjashtimit dhe fyerjes; ç) keqtrajtimit dhe braktisjes; d) mospërfilljes dhe neglizhimit; dh) shfrytëzimit dhe abuzimit; e) dhunës seksuale. Neni 22 parashikon se fëmija mbrohet nga shfrytëzimi ekonomik, si dhe nga kryerja e çdo pune që: a) paraqet rreziq; b) cenon edukimin c) dëmton shëndetin; ç) dëmton zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror; d) është e detyruar. 2. Ndalohet marrja në punë e fëmijës nën moshën 16 vjeç. Fëmija nga moshja 14 deri në 18 vjeç mund të punësohet në punë të lehta që nuk dëmtojnë shëndetin dhe formimin e tij, sipas kushteve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

zbatimi i drejtë i këtij rregullimi për personat që ushtrojnë të drejtën prindërore, në rastet kur prindërit e humbasin atë dhe të afërmit e fëmijës nuk kanë mundësi të kujdesen për fëmijën.

Sipas ligjit²⁰, (neni 29) fillimisht vlerësohet mundësia e vendosjes së fëmijës pranë pjesëtarëve të tjerë të familjes së fëmijës, përfshirë këtu edhe anëtarët e familjes në kuptimin e gjerë të konceptit «familje», duke nënkuptuar anëtarët e familjes së zgjeruar.

Në pamundësi të kësaj zgjedhjeje, fëmijës së privuar në mënyrë të përkohshme a të përhershme nga mjedisi i tij familjar ose kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në këtë mjedis, i sigurohet një përkujdesje alternative si: a) vendosja në një familje birësuese; b) vendosja në një familje alternative ose në një institucion të përkujdesit për fëmijët. Këto alternativa janë të nevojshme, por ndërkohë përmbajnë mundësinë e zgjerimit të rrethit të personave që mund të abuzojnë me fëmijën.

Në kushte të tilla, zbatimi i nenin 124/b duhet të shihet në raport me këtë rreth subjektsh të mundshme që ofrojnë përkujdesje ndaj fëmijës.

2.2 Krime seksuale dhe mbrojtja e grave dhe fëmijëve

Studimet tregojnë se krimet seksuale po gjejnë rregullime më të plota dhe të krahasueshme, por ende ka dallime në legjislacione të ndryshme²¹. Disa vite më parë, për shkak të përcaktimeve ligjore dhe sistemeve ligjore të ndryshme, studimi dhe krahasimi i krimeve seksuale ka qënë i vështirë në nivel evropian²². Shqipëria ofronte të dhëna zyrtare të pjesshme dhe kishte vështirësi për të përafuar konceptet juridike të kodit penal shqiptar me përkufizimet standarte ndërkombëtare.

Seksioni i krimeve seksuale në kodin penal ka ndryshuar herë pas here, sidomos pas vitit 2001²³.

20 Neni 21 i ligjit “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” i cit.

21 Aeibi, M, Akdeniz, G, Barclay, G, etj “ *European Sourcebook of Crime and Criminal Justice, Statistics*, 2014, HEUNI, f.37. Ky botim gjendet edhe në internet në adresën: http://www.heuni.fi/material/attachments/heuni/reports/qrMWOCVTF/HEUNI_report_80_European_Sourcebook.pdf

22 Killas, M, G, Barclay, G, Smith, P, Hysi, V. etj “ *European Sourcebook of Crime and Criminal Justice, Statistics*, 2003, WODC f.30. Ky botim gjendet edhe në internet në adresën: <http://www3.unil.ch/wpmu/europeansourcebook/>

23 *Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001.*

Të gjitha dispozitat e këtij seksioni ndryshuan në vitin 2001 dhe me pas, një pjesë e tyre ndryshuan përsëri në vitin 2012 dhe 2013.

Ndryshimet e kryera²⁴ kanë synuar mbrojtjen më të mirë të disa kategorive sociale siç janë gratë, fëmijët, personat në pamundësi për t'u mbrojtur, bashkëshortët dhe bashkëjetuesit, shtimi i krimeve seksuale, përveç marrëdhënie seksuale. Për herë të parë, u kriminalizua ngacmimi seksual, kryerja e marrëdhënies seksuale me forcë mes bashkëshortëve ose bashkëjetuesve dhe u bë dallimi mes dhunës seksuale, marrëdhënies seksuale, veprave të turpshme dhe ngacimit seksual.

Megjithë ndryshimet e bëra, ka mendime dhe sugjerime për të bërë ndryshime dhe amendime të tjera në këtë seksion.

Në mendimin tonë, do të ishte e rekomandueshme që ndryshimet ligjore të kryera së fundmi të vlerësohen për efektin e tyre në parandalimin e veprave seksuale ndaj grave dhe fëmijëve. Për këtë qëllim, njohja më e mirë e mbrojtjes juridiko penale që ofron legjislacioni penal shqiptar dhe ndërjegjesimi i grave dhe vajzave viktimave të veprave penale seksuale për të raportuar krimet e pësuar, do të mundësojë njohjen reale të përhapjes së këtyre krimeve dhe profilit të viktimave të tyre.

E nënvizojmë këtë fakt, pasi statistikat zyrtare tregojnë se niveli i raportit dhe procedimit të krimeve seksuale është në nivele të ulta në Shqipëri, krahasuar me vendet e tjera europiane²⁵, ndërkohë që nga raportet kombëtare dhe ndërkombëtare, Shqipëria renditet në vendet me nivel të lartë të dhunës kundër grave dhe fëmijëve.

Marrëdhëniet seksuale

Mbrojtja e fëmijëve nën moshën 14 vjeç ose që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale është forcuar duke parashikuar forma të reja veprash penale dhe dënime më të ashpra, madje për vepra penale të veçanta ka një orientim drejt dënimeve fikse,

²⁴ Ndryshimet kanë qënë nisma të Këshillit të Ministrave, të deputeteve, ose organizatave të shoqërisë civile

²⁵ Aeibi, M, Akdeniz, G, Barclay, G, etj “ *European Sourcebook of Crime and Criminal Justice, Statistics*, 2014, vep. cit. f. 63-65. Ky botim gjendet edhe në internet në adresën: <http://www.heuni.fi/en/index/publications/heuniereports/europeansourcebook.html>

një tendencë e kritikuar²⁶, si në rastin e paragrafit të dytë të nenit 100; parashikimi i dënimeve të larta në minimum, jo më pak se 25 vjet ose jo më pak se 30 vjet burgim, parashikimi i dënimit me burgim të përjetshëm (paragrafi i tretë i nenit 100, neni 107/a paragrafi 3 dhe 4).

Konventa Europiane “Për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familjes” ju rekomandon shteteve nënshkruese të kriminalizojnë marrëdhëniet seksuale mes bashkëshortëve ose bashkëjetuesve pa dëshirën e njërit prej tyre.

Ky rekomandim u zbatua, në vitin 2013, duke parashikuar një paragraf të ri nënenin 102 të kodit penal. Ky parashikim ishte edhe si përgjigje e problematikës së dalë në praktikë. Studimet tregojnë se gratë shqiptare janë viktimat të dhunës seksuale edhe nga bashkëshortët/ bashkëjetuesit e tyre (7.5 për qind e grave)²⁷.

Dhuna seksuale

Legjislacioni penal shqiptar konsideronte si krim seksual kryerjen e marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur, me dhunë ose pa dhunë, kur bëhet fjalë për persona nën moshën 14 vjeç; ose që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale ose me dhunë në rastet e të miturve 14- 18 vjeç ose kundër të rriturve.

Për mirëqënien e të miturit, janë të dëmshme jo vetëm marrëdhëniet seksuale, por edhe veprime të tjera që kodi penal shqiptar nuk i parashikonte më parë.

Ligjvënësi kriminalizoi ushtrimin e dhunës seksuale (Neni 107/a), nëpërmjet kryerjes së veprimeve me natyrë seksuale në trupin e një personi tjetër me objekte dhe ka konsideruar si veprë penale në rrethana rënduese kur vepra kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë, ose kundër fëmijëve të moshës katërbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç, kur kryhet ndaj një të mituri që nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç ose një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, pavarësisht nëse kryhet me dhunë apo jo si dhe kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit.

26 Elezi, I dhe Elezi, E: *Historia e së drejtës penale*, botim SHBLU, 2011, f. 231.

27 Dr. Robin N. Haarr, *Dhuna në familje në Shqipëri, Vrojt看 kombëtar me bazë popullatën*, vep. e cit. f. 37.

Zbatimi i kësaj dispozite në praktikë dhe krijimi i praktikës gjyqësore të konsoliduar rreth saj kërkon që kjo dispozite e re të kuptohet dhe dallohet qartë nga dispozitat e tjera të kodit penal që bëjnë fjalë për veprat e turpshme dhe marrëdhëniet seksuale. Nga pikëpamja e studimeve kriminologjike, krahasues ndërkombëtare, Shqipëria do të mund të kapërcejë vështirësitë e hasuara deri më sot për të matur dhe krahasuar tendencat e krimeve seksuale me vendet e tjera të Europës²⁸

Veprat e turpshme

Veprat penale të turpshme janë parashikuar në kodin penal të vitit 1995 (neni 108 i k.p) dhe me pas i janë nënshtruar ndryshimeve, fillimisht duke ashpërsuar dënimin (2001) dhe më pas duke bërë plotësime dhe saktësime (2013)²⁹. Shtesa e bëra në nenin 108 të Kodit penal synonte mbrojtjen në parim, së pari, të të miturit që nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç, me të cilin autori ka marrëdhënie familjare. Së *pari*, të të miturin që nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç, me të cilin autori ka marrëdhënie familjare.

Së *dyti*, përfshirja e qëllimshme e një të mituri që nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç ose i një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale si dëshmitar, në veprime me natyrë seksuale është vepër penale.

Së *treti*, propozimi i bërë nga një i rritur, me çdo mjet ose formë, për të takuar një të mitur që nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç ose një të mitur që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, me qëllim kryerjen e ndonjëres nga veprat penale të parashikuara në këtë seksion apo në seksionin VIII të kreut II të Kodit penal. Plotësimi i dispozitës u bë për shkak se përcaktimi i përmbajtjes së nenit “vepra të turpshme” ishte shumë i përgjithshëm, duke parashikuar vetëm fjalën veprime të turpshme. Krahas detajimit të këtij përcaktimi, u mundësia si vepër penale nxitja, inkurajimi i të miturit jo vetëm për të qënë viktimë aktive, por edhe dëshmitar. Një risi në ndryshimet e këtij neni është parashikimi si krim edhe i propozimit që i bëhet një të mituri për ta takuar atë për të kryer vepra seksuale.

²⁸ *Defining and registering Criminal Offences and Measures, Standards for a European Comparison*, edituar nga Jehle, J, M dhe Harrendorf, S. , botim i Universitetit të Göttingenit, 2010, f. 68-73.

²⁹ Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 24 dhe me nenin 23 të ligjit 144/ 2013.

Ngacmimi seksual

Sikurse është trajtuar edhe më lart, Kodi penal i vitit 1995 parashikonte veprat e turpshme ndaj fëmijëve nën moshën 14 vjeç dhe marrëdhëniet seksuale, por nuk parashikonte si krim ngacmimet seksuale. Viktima të ngacmime seksuale mund të jenë gratë dhe burrat, të rritur dhe të mitur. Për shkak të kësaj mangësie, kodi penal binte ndesh me detyrimet e përcaktuara në konventat ndërkombëtare.

Direktiva 2002/73/EC e Bashkimit Europian (BE), që ka amenduar Direktivën e BE-së për Trajtim të Barabartë e trajton ngacmimin seksual si diskrimim dhe kërkon që të gjitha legjislacionet e vendeve të BE të transplantojnë atë në legjislacionin e tyre. Sipas studimit të Komisionit Europian³⁰ ngacmimet seksuale janë një fenomen i përhapur në vendet e punës, nga të cilat preket më shumë gratë sesa burrat, por janë pak të raportuara. Konventa e Stambollit, në nenin 40 të saj, sanksionon detyrimin e shteteve për të parashikuar dënime penale për ngacmimin seksual.

Ndryshimet e bëra në kodin penal (neni 108/a) mbrojnë çdo person, burrë ose grua që mund të jetë viktimë e një sjelljeve verbale ose jo verbale të padëshiruar ose veprimeve fizike me natyrë seksuale që cënonjë dinjitetin, krijojnë një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues.

Nga pikëpamja e teknikës legjislative, dispozita është më e detajuar dhe përshkruese me qëllim që të shmanget çdo paqartësi në zbatimin e saj në praktikë, për me tepër, që kjo veprë hyn në veprat penale me natyrë diskriminuese dhe provueshmëria e saj mund të jetë e vështirë në praktikë, jo vetëm për shkak të natyrës së veprës, por edhe të aftësive profesionale të prokurorëve dhe gjyqtarëve në fushë. Gjithashtu, ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të veçantë të personit kur vepra penale kryhet kundër të miturve, në bashkëpunim, kundër disa personave,

30 Ann Numhauser-Henning and Sylvaine Laulom "Harassment related to Sex and Sexual Harassment Law in 33 European Countries, Discrimination versus Dignity", Komisioni Europian, 2012, f. 7.

Ky botim gjendet edhe në internet në adresën: http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/files/your_rights/final_harassment_en.pdf

më shumë se një herë. Parashkimi i kësaj vepre penale dikton nevojën e marrjes së masave përgatitore për të rritur efektivitetin e këtij ndryshimi, përfshirë trajnimin e punonjësve të policisë, prokurorisë, gjykatës, fushatat sensibilizuese në sektorin publik dhe privat, ndryshimet ligjore të mundshme lidhur me barrën e provës, shtrirjen e ofrimit të shërbimeve ligjore për asistimin e viktimave, etj.

Pornografia

Mbrojtja juridiko-penale e fëmijëve nga pornografia është përmirësuar gjatë 20 viteve të fundit.

Pornografia është sanksionuar nga Kodi penal (neni 117). Fillimisht është parashikuar si kundërvajtje penale që dënohej me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Veprimet që ndëshkoheshin ishin prodhimi, shpërndarja, reklamimi, importimi, shitja e botimi i materialeve pornografike në ambientet e të miturve.

Në vitin 2008³¹ neni 117 u ndryshua, duke shtuar një paragraf të ri që parashikonte si krim përdorimin e të miturit për prodhimin e materialeve pornografike, si dhe shpërndarjen ose publikimin i këtyre materialeve në internet ose në forma të tjera. Përfaqësuesit e organizatave të të drejtave të njeriut dhe të fëmijëve theksonin nevojën për plotësime dhe saktësime të tjera, të cilat u realizuan në vitin 2013³². Ligjberësi vendosi ta riformulojë përmbajtjen e nenin 117, për shkak të ndryshimeve të shumta që u bënë.

Së pari, u parashikuan dhe u saktësuan format e pornografisë si: prodhimi, shpërndarja, reklamimi, importimi, shitja e botimi i materialeve pornografike në mjediset ku ka fëmijë, me çdo mjet ose formë. Shtimi i togfjalëshit “me çdo mjet ose formë” është një formulim i hapur që mundëson dënimin e çdo forme nxjitje pornografie që mund të tregojë praktika.

Së dyti, paragrafi i dytë i kësaj dispozite u plotësua, duke dënuar jo vetëm personat që përdorinin fëmijë për prodhimin e materialeve pornografike, shpërndajnë dhe publikojnë në internet ose në forma të tjetër materiale të tilla, por edhe personat

31 Shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr.9859, datë 21.1.2008, neni 1.

32 Neni 29 i ligjit 144/2013.

që prodhojnë, importojnë, ofrojnë, vënë në dispozicion, transmetojnë, ose posedojnë pornografinë e fëmijëve, si dhe krijimi i aksesit në mënyrë të vetëdijshme në të, me çdo mjet ose formë. Ky riformulim zgjeron rrethin e personave që duhet të marrin masa për ndalimin e pornografisë dhe të aksesit të fëmijëve në to.

Së treti, në vitin 2013, në riformulimin e bërë, u parashikuan tre elementë të rinj në paragraf të tretë të nenit 117 të k.p, konkretisht: rekrutimi, shtrëngimi ose bindja e fëmijës për të marrë pjesë në shfaqje pornografike si dhe marrja pjesë në shfaqje pornografike që përfshijnë fëmijët³³.

Ndryshimet e bëra kanë nevojë të shoqërohen edhe me masa jo penale për të parandaluar pornografinë mes internetit dhe përdorimin e fëmijëve në këto rrjete.

2.3 Veprat penale kundër lirisë së personit

Raportet e organizatave ndërkombëtare tregojnë se zhdukja me forcë është një fenomen i përhapur në botë, në vende ku demokracia mungon ose është e dobët. Viktima të veprave penale të zhdukjes me forcë janë edhe gratë e fëmijët.

Shqipëria ka ratifikuar konventat e Kombeve të Bashkuara³⁴ që lidhen me torturën, keqtrajtimet dhe zhdukjen me forcë të personit si dhe protokollat shtesë të konventave që synojnë të mbrojnë gratë dhe fëmijët.

Në vitin 2013 në kodin Penal u shtua një nen (neni 109/c) i cili parashikon si vepër penale zhdukjen me forcë, nëpërmjet arrestimit, burgimit, rrëmbimit ose çdo forme tjetër heqjeje lirie të personit, nga funksionarët publikë ose nga persona që veprojnë me autorizimin, mbështetjen ose miratimin e tyre, shoqëruar me mospranimin e faktit të heqjes së lirisë ose me fshehjen e fatit të personit ose vendit në të cilin ndodhet ai, duke i mohuar ndihmën dhe mbrojtjen e nevojshme, sipas ligjit.

33 Konventa e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” parashikon të drejtën e shteteve të bëjnë rezerve për kufizimin e plotë ose të pjesshëm të aplikimit në paragrafeve të veçantë të këtij neni kur si në rastet e aksesit në pornografinë e të miturve ose pjesëmarrjes në performanca pornografike që përfshijnë pjesëmarrjen e të miturve (neni 20 dhe 21 I Konventës).

34 Për çdo informacion lidhur me konventat dhe protokollat shtesë të ratifikuara nga Shqipëria, shih: http://tbineternet.ohchr.org/_layouts/TreatyBodyExternal/Treaty.aspx?CountryID=2&Lang=EN

Paragrafi i 1 dhe 2 të nenit 109/c parashikohen rregullime të përgjithshme të mënyrës objektive të kryerjes së kësaj vepre penale dhe të subjekteve të mundshme të saj, përfshirë edhe atë të posaçëm. Paragrafi i 3 dhe 5 i tij sanksion mbrojtjen e veçantë të fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen si dhe parashikohet si vepër penale marrja e paligjshme e fëmijëve që janë subjekt i një zhdukjeje me forcë, ose e fëmijëve, babai, nëna ose përfaqësuesi ligjor i të cilëve është bërë subjekt i një zhdukjeje me forcë, apo e fëmijëve të lindur gjatë periudhës së zhdukjes me forcë.

2.4 Të miturit dhe gratë – viktimat të trafikimit edhe brenda vendit

Trafikimi për prostitucion bëhet brenda dhe jashtë vendit. Rritja e shfrytëzimit të grave dhe vajzave për prostitucion brenda vendit diktoi ndryshimet në nenin 110/a³⁵, paragrafi b, duke sanksionuar përveç trafikimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë edhe trafikimin e personave të rritur brenda vendit. Gjithashtu, dënimi me burgim u shtua në minimum e tij, nga 5 vjet në 8 vjet burgim.

Duke marrë shkas nga fakti se gratë janë më shpesh viktimat të trafikimit dhe në vështirësi më të mëdha për të parandaluar viktimizimin e largimin nga rrjeti kriminal, ligjvënësi bërinjë dallim gjinor, thënë ndryshe, diskriminimi gjinor pozitiv, që synon mbrojtjen e grave dhe vajzave që kanë më pak mundësi për t'u mbrojtur dhe shpëtuar nga tutorët e tyre.

Kështu, në vitin 2013 u shtua një paragraf që parashikon se trafikimi ndaj një personi të rritur të gjinisë femërore dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Përveç kësaj, duke qenë se shpesh viktimat rekrutohet nën përdorimin e dhunë fizike dhe psikike, personat veprojnë në bashkëpunim, ligjvënësi parashikon një dënim më të rëndë kur vepra vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, sjell pasoja të rënda për shëndetin, ose rrezikon jetën e tij (paragrafi "c", neni 110/a).

³⁵ Neni 26 i ligjit 144/2013 për disa shtesa e ndryshime.

Kriminalizimi i veprimeve që lehtësojnë ose mundësojnë trafikimin dhe dekriminalizimi i veprave penale të kryera nga viktimat e trafikimit

Trafikimi i njerëzve nuk është e vetmja e keqe që mund të pësojë një person, por shpesh viktimat detyrohet të bëhet autor/e veprës penale. Me qëllim parandalimin e shërbimeve të paligjshme dhe të detyruara, në vitin 2013, u shtua si veprë penale **përfitimimi ose përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar**, ose i shërbimeve që janë objekt i shfrytëzimit nga trafikimi³⁶. Në rastet se përdoren shërbimet që ofrohen nga fëmijët dhe personi ka dijeni se personi është i trafikuar, vepra penale konsiderohet në rrethanë rëndësuese.

Trafikimi i qënive njerëzve lehtësohet mes veprimeve që kryhen nga persona të ndryshëm si: falsifikimi, zotërimi ose sigurimi i dokumentit të identitetit, i pasaportave, i vizave ose i dokumenteve të tjera të udhëtimit apo mbajtja, heqja, fshehja, dëmtimi ose shkatërrimi i tyre. Për të parandaluar dhe ndëshkuar të gjitha veprimet lehtësuese të trafikimit, në kodin penal u shtua një veprë e re penale (Neni 110/c) që dënon veprimet e mësipërme që kanë shërbyer për trafikimin e personave të rritur, edhe pa pasur dijeni për këtë fakt.

Në mbrojtje të veçantë të fëmijëve, është parashikuar që veprime të tilla, kur kanë mundësuar trafikimin e fëmijëve ose nga vepra penale kanë ardhur pasoja të rënda, cilësohen si vepra penale në rrethana rëndësuese.

Në vitin 2013 u shtua një nen në kodin penal (neni 52/a i k.p) që parashikon përjashtimin ose uljen e dënimit për bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe viktimat. Personi i dëmtuar nga veprat penale, që lidhen me trafikimin e personit, mund të përfitojë përjashtimin nga dënimi, për kryerjen e veprave penale gjatë periudhës së trafikimit dhe në masën që ka qenë i detyruar t'i kryejë ato veprime apo mosveprime të kundërligjshme” (neni 52/a, paragrafi 2).

36 Ligji nr. 144/2013, ka shtuar nenin 110/b.

2.5 Shfrytëzimi i prostitucionit

Trafikimi i qënieve njerëzore bëhet për arsye të ndryshme, mes të cilave shfrytëzimi për prostitucion. Kodi penal i 1995 në fillimet e tij nuk parashikonte shfrytëzimin e prostitucionit, por vetëm favorizimin e tij (Neni 114). Si favorizim i prostitucionit konsiderohej shtytja, ndërmjetësimi ose marrja shpërblim për ushtrimin e prostitucionit. Në paragrafin e dytë të këtij neni parashikohej se kryerja e veprimeve të mësipërme dënohej më rëndë kur kryheshin ndaj një të miture ose me anë të përdorimit të dhunës. Me ndryshimet e kryera në vitin 1998³⁷, krahas ndryshimit të titullit të dispozitës u shfuqizua paragrafi i dytë i kësaj dispozite, ndërkohë që u shtua një vepër e re penale “Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese” (neni 114/a), sipas të cilit mbrohen të gjithë të miturit, jo vetëm të miturat, pra nuk kishte dallime gjinore për viktimat e shfrytëzimit të trafikimit.

Në vitin 2014, ligjvënësit i rikthen paragrafin e dytë të kësaj dispozitës (nen 114 i k.p), duke e rikonceptuar dhe zgjeruar përmbajtjen e saj. Sipas riformulimit të ri, dënohen më rëndë veprimet ndaj të miturve, ndaj disa personave, shfrytëzimi i prostitucionit me persona me të cilët ekzistojnë lidhje të afërta gjinie, krushqie, kujdestarie, ose duke përfutuar nga raportet zyrtare, ose kur kryhet në bashkëpunim, ose më shumë se një herë, ose nga persona të ngarkuara me funksione shtetërore dhe publike. Zgjerimi i rrethit të subjekteve, veprimet e të cilave cilësohen se vepër penale në rrethana rënduese, garanton një mbrojtje më të plotë të viktimave, pavarësisht marrëdhënie mes tyre.

2.6 Trafikimi i fëmijëve

Trafikimi i fëmijëve është një nga format më të rënda të shfrytëzimit të fëmijëve. Megjithëse, një fenomen shqetësues prej viti 1992, kodi penal nuk parashikonte një vepër penale të veçantë që të kriminalizonte trafikimin e fëmijëve deri në tin 2001.

37 Ndryshohet titulli dhe shfuqizohet paragrafi II me ligjin nr.8279, datë 15.1.1998, neni 2.

Përgatitja për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara “Për krimin e organizuar”, njohur ndryshe si Konventa e Palermos dhe dy protokolleve shtesë³⁸ si dhe rritja e rasteve të trafikimit të fëmijëve, diktoi nevojën e parashikimit në kodin penal të veprës penale të trafikimit të fëmijëve (neni 128/b) në vitin 2001³⁹. Paragrafi 2 i nenin 128/b të k.p parashikonte si veprë penale në rrethana rënduese bashkëpunimin në këtë veprë, përsëritjen, ose trafikimin e kryer me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike ose psikike të të dëmtuarit për të kryer veprime të ndryshme, që sjell pasoja të rënda për shëndetin.

Dënimi penal është teje i rëndë, duke parashikuar dënim me burgim të përjetshëm, kur nga vepra ka ardhur si pasojë vdekja e fëmijës.

Ratifikimi i konventës së Palermos dhe dy protokolleve shtesë diktoi nevojën e saktësimit të formulimit të kësaj veprë⁴⁰, duke bërë përkufizimin e trafikimit sipas formulimit të dhënë në protokollin shtesë. Në vitin 2008⁴¹ në këtë dispozitë shtohet fjala “shitja”, ndërsa ndryshimet në nenin 128/b të kryera në vitin 2013⁴² adresuan ashpërsimin e dënimit me burgim pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese për deklarimin antikushtetues të zbatimit të dy dënimeve kryesore ndaj personit të kryente një veprë penale. Krahas heqjes së dënimit me gjobë, u rrit minimumi i dënimit me burgim nga shtatë vjet në dhjetë vjet.

2.7 Martesa dhe mbrojtja juridiko-penale- objekt rregullimesh ligjore

Martesa dhe bashkëjetesa gjejnë mbrojtje juridiko-penale në kodin penal të vitit 1995. Në nenit 130 të këtij kodi parashikohet si kundërvajtje penale shtrëngimi ose pengimi për të filluar ose vazhduar bashkëjetesën ose shtrëngimi për të zgjidhur martesën.

38 “Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” dhe dy protokolleve shtesë të saj, “Protokolli kundër trafikimit të migranteve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare” dhe “Protokolli për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve” është bërë me ligjin Nr. 8920, datë 11.7.2002.

39 Trafikimi i fëmijëve me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

40 Ndryshuar me ligjin nr.9188, datë 12.2.2004, neni 3.

41 Neni 3 i ligjit nr.9859, datë 21.1.2008, i cituar.

42 Neni 31 i ligji 144/2013

Meqënëse detyrimi për martesë mund të bëhet brenda dhe jashtë vendit, me ndryshimet në kodin penal 2013⁴³, u parashikua si kundërvajtje penale kërkesa e qëllimshme ndaj një të rrituri ose fëmije për të shkuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim detyrimin e tij për të lidhur martesë. Në mendimin tim, kërkesa për martesë ndaj një fëmije duhet të kishte një rregull të veçantë, në krahasim me detyrimin e një të rrituri, nëse mbajmë parasysh aftësitë kufizuara që ka i mituri për të kuptuar pasojat e këtij veprimi dhe rreziqet që mund të ketë i mituri për t'u mashtruar dhe kthyer viktimë e trafikimit.

2.8 Gratë dhe fëmijët mbrohen jo vetëm nga kanosja, por edhe nga përndjekja

Kodi penal parashikon kanosjen serioze për vrasje të rëndë dhe për plagosje të rëndë (neni 84 ik.p). Praktika tregon se një person mund të jetë viktimë e kërcënimeve ose ngacmimeve që çënojnë sigurinë vetjake të tij me synim për të shkaktuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi ose frikë për sigurinë vetjake ose për ta detyruar personin të ndryshojë mënyrën e tij të jetesës, ose për shkaktuar ankth dhe frikë një të afërmi ose të një personi, me të cilin ka lidhje shpirtërore.

Në vitin 2012, në kodin penal u shtua një figurë e re penale “Përndjekja” (neni 121/a). Qëllimi i kësaj dispozite është të mbrojë tre grupe kryesore personash:

së *pari*, çdo person;

së *dyti*, personat që janë në lidhje familjare kur vepra penale kryhet nga ish-bashkëshorti, ish-bashkëjetuesi ose personi që ka pasur lidhje shpirtërore me të dëmtuarin, duke parashikuar një dënim më të rëndë, dënimin bazë i shtohet 1/3 e dënimin me burgim).

Së *treti*, të miturit, gratë shtatzënë ose një person të pazotë për t'u mbrojtur, si dhe kur kryhet nga një person i maskuar ose shoqërohet me mbajtjen ose me përdorimin e armëve (neni 121/a, paragrafi 3 i k.p).

Ndonëse kjo dispozitë e re nuk mbron vetëm gratë dhe fëmijët, personat që përndiqen më shumë janë gratë dhe vajzat.

43 Neni 32 i ligjit 144/2013

2.9. Dhunë në familje -tashmë vepra penale sipas kodit penal shqiptar

Sipas studimeve kombëtare dhe ndërkombëtare raportimi i dhunës në familje është në nivele të ulta⁴⁴. Shifra e veprave penale në familje të paraportuara varion nga një vend në tjetrin dhe varet nga një sërë faktorësh. Në vendin tonë, familja dhe marrëdhëniet në familje janë trajtuar për një kohë të gjatë si çështje personale ku të tretët nuk mund të ndërhyjnë.

Për rrjedhojë, dhuna në familje nuk denoncohej.

Me ndryshimet e bëra në vitin 2012, për herë të parë në Kodin penal u shtua neni 130/a⁴⁵ i titulluar “Dhuna në familje”. Ky nen parashikon tre nivele të dhunës në familje:

Së *pari*, rrahjen dhe çdo vepër tjetër dhune në personat në marrëdhëniet familjare. Gjatë debateve parlamentare pati diskutime për llojet e veprimeve dhe mosveprimeve që do të përfshiheshin në këtë figurë vepre penale. Duke qënë se format e dhunës fizike janë të ndryshme dhe se nuk mund të ketë një listë shteruese të formave të dhunës, ligjvënësi vendosi të parashikojnë përmbajtjen e këtij neni një shprehje “*dhe çdo formë tjetër*”. Ky përcaktim është i njohur edhe më parë në kodin penal, konkretisht në nenin 90 të tij. Duke mbajtur parasysh llojet e dhunës në familje, dhuna në familje nënkupton çdo veprim ose mosveprim që cenon integritetin fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij.

Së *dyti*, kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë në marrëdhëniet familjare. Fillimisht, kodi penal parashikonte si kundërvajtje penale kanosjen dhe plagosjen e rëndë, pa bërë dallim për motivet e kanosjes⁴⁶. Gjatë periudhës 2001- 2012 është ndërhyrë katër herë në kodin penal duke shtuar si vepra penale të posaçme kanosjen serioze për hakmarrje ose për gjakmarrje⁴⁷,

44 Holly Johson, Natalia Ollus, Sami Nevala “*Violence Against women, an International Perspective*”, HEUNI dhe Springer, Janar 2008, f 65. Sipas vërtetimit të INSTAT dhe UNDP, për vitin 2013, vetëm 8,4 për qind e grave që kishin përjetuar dhunë në familje “gjatë jetës” dhe 7,1 për qind e atyre që po përjetonin “aktualisht” dhunë në familje kishin kërkuar ndonjëherë ndihmë për dhunën në martesë/marrëdhënien e tyre intime. Për më shumë shih: *Dhuna në familje në Shqipëri: Vërtetimi kombëtar me bazë popullatën 2013*. Raporti i vërtetimit gjendet e botuar edhe në internet në adresën: <http://www.undp.org/content/dam/albania/docs/Vrojtim%20Kombetar%20Dhuna%20ne%20Familje%20ne%20Shqiperi%202013.pdf>

45 Neni 17 i ligjit 23/2012.

46 Neni 84 i kodit penal, të ndryshuar.

47 Neni 83/a shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 12; ndryshuar me ligjin nr.9686, datë

kanosjen me motive racizimi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik⁴⁸. Me ndryshimet e vitit 2012, ligjvënësi parashikoi si vepër penale të veçantë kanosjen serioze për vrasje ose plagosjen e rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort/ bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale. Ky ndryshim u pasua me ashpërsim të dënimit, pasi u hoq dënimi me gjobë si një dënim alternativ i dënimit me burgim dhe ky i fundit u rrit nga një vit në tre vjet.

Së *treti*, plagosja e lehtë më dashje, pra plagosja e kryer me dashje që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, u parashikua si në një paragraf më vete i nenit 130/a, (paragrafi 3).

Elementi i përsëritjes së veprave penale të mësipërme parashikohet në një paragraf të veçantë të po këtij neni.

Megjithë risitë që solli ky rregullim ligjor, dispozita nuk parashikoi dënimin e dhunës së asistuar, pra rastet kur vepra penale kryhet në prani të fëmijës. Duke vlerësuar rastet e praktikës, kur dhuna në familje kryhet në prani të fëmijëve dhe pasojat e veprave penale të tilla të fëmijët, në vitin 2013, paragrafi i fundit i nenit 130/a u plotësua duke shtuar togfjalëshin “*ose në praninë e fëmijëve*”. Nisur nga fakti që viktimat të dhunës në familje nuk janë vetëm bashkëshortët, rrethi i subjekteve që mbrohen në mënyrë të posaçme nga dhuna në familje, është i përcaktuar në ligjin për masat për parandalimin e dhunës në marrëdhëniet familjare⁴⁹ ku përfshihen: bashkëshorti, ish-bashkëshorti, bashkëjetuesi ose ish-bashkëjetuesja, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale.

Parashikimi i disa prej formave të dhunës në familje me ndryshimet e vitit 2012, nuk preku dispozitat e kodit penal që parashikon vrasjen dhe plagosjen e rëndë në familje.

Në vitin 2013⁵⁰ në kodin penal u shtuan dy vepra penale të posaçme: vrasja me dashje për shkak të marrëdhënieve familjare parshikon si vepër penale e cilësuar në një nen të veçantë (neni 79/c) dhe për të cilën dispozita parashikon dënim me burgim

26.2.2007, neni 8.

48 Shtuar me ligjin nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 12.

49 Neni 3, pika 3 e ligjit.

50 Ligji 144/ 2013

jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm dhe plagosja e rëndë e kryer kundër personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, ose kur ka sjellë si pasojë vdekjen⁵¹. Si pjesë e rishikimit të politikës penale ishte vepra penale e vrasjes së foshnjës së porsalindur që nga kundravajtje penale⁵² konsiderohet krim që dënohet vetëm me burgim deri në pesë vjet.

2.10 Dallimi mes vetvrasjes dhe shkaktimi i vetvrasjes-një sfidë për zgjidhje

Vepra penale e shkakimit të vetvrasjes ka shkaktuar debate mes punonjësve të teorisë dhe praktikës. Statistikat gjyqësore tregojnë se numri i procedimeve penale për shkaktim vetvrasjeje është rritur. Sipas raportit të Prokurorit të Përgjithshëm⁵³ tendenca e procedimeve penale ka njohur luhate të mëdha gjatë periudhës 2005-2013, duke shënuar 65 raste në vitin 2012 dhe 202 raste në vitin 2009. Në fakt, në praktikë ka pasur vlerësime të ndryshme lidhur me këtë lloj vepre penale.

Në të shumtën e rasteve, vetvrasjet në familje janë konsideruar si raste fatkeq për shkak të depresionit ose kushteve ekonomike e sociale të viktimës në familje dhe jo veprimeve të familjarëve ose bashkëjetuesit. Duke qenë një krim që ndodh në familje shpesh pa dëshmitarë, ose në prani të autorit të shkakimit të vetvrasjes ose familjarëve të tij, shkaktimi i vetvrasjes paraqet vështirësi të provuara, në kushtet kur pjesëtarët e familjes nuk mund të detyrohen të dëshmojnë kundër një pjesëtari të familjes dhe kur personi i dyshuar si autor nuk mund të vetakuzohet.

Në rrethana të tilla, krahas nevojës së një hetimi sa më të plotë dhe objektiv dhe trajnimit të punonjësve të policisë, prokurorëve dhe gjykatës, ishte e nevojshme dhe përmirësimi i përmbajtjes së nenin 99 të Kodit penal⁵⁴.

51 Neni 18 I ligjit 144/2013

52 Neni 17, i ligjit 144/2013. Më parë kodi penal parashkonte dënim me gjobë ose burgim deri në dy vjet. Me ndryshimet e kryera, dënimi është vetëm me burgim nga një deri në pesë vjet.

53 Raporti vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm paraqitur në Kuvendin e Shqipërisë, f. 67.

54 Neni 19 i ligjit 144/2013.

Kështu, fjalët “në vartësi materiale apo çfarëdolloj vartësie tjetër”, u zëvendësuan me fjalët “në varësi ose nga personi me të cilin ka marrëdhënie familjare ose bashkëjetese”. Ky ndryshim u shoqërua me ashpërsimin e dënimit, pra dënimi me gjobë nuk parashikohet më, ndërsa dënimi me burgim u rrit në tre vjet.

Ndryshimet e kryera janë të dobishme, por nuk zgjidhin vështirësitë që hasen në praktikë lidhur me të provuarit e shkakut të vetvrasjes. Trajnimi më mirë i punonjësve të policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve dhe hetimi objektiv i plotë dhe i gjithanshëm rasteve të tilla do të mundësojë që politika penale për vepra të tilla të jetë efektive.

3.0 Jo vetëm inkrimim i veprave penale kundër grave dhe fëmijëve, por edhe ashpërsim i politikës së dënimeve

Politika penale për veprat penale të dhunës në familje, kundër fëmijëve dhe grave ka ndryshuar mes shtesave dhe ndryshimeve të bëra edhe në pjesën e përgjithshme të kodit Penal. Disa institute të pjesës së përgjithshme të së drejtës penale u amenduan. Nëse do të përmbliidhim me pak fjalë ndryshimet e politikës penale për vepra penale të dhunës në familje, kundër fëmijëve dhe grave mund të thuhet pa hezitim se humanizmi i dënimit është kufizuar kur bëhet fjalë për dënimin e veprave penale ndaj grave e fëmijëve.

3.1 Ashpërsimi i dënimeve penale – orientimi konstant i politikës penal për dhunën ndaj grave dhe fëmijëve

Një nga tendencat e politikës penale është ashpërsimi i dënimeve penale mes disa ndërhyrjeve në kodin Penal.

Së *pari*, minimumi dhe/ose maksimumi i dënimit me burgim është rritur për disa vepra penale që përbëjnë shqetësim publik.

Së *dyti*, dënimi me gjobë, i parashikuar më parë në disa dispozita konkrete nuk parashikohet më si i tillë.

Së *treti*, për shkak të vendimit të Gjykatës Kushtetuese⁵⁵, gjykata nuk mund të zbatojë dënimin me burgim dhe dënim me gjobë njëkohësisht.

55 Raporti vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm paraqitur në Kuvendin e Shqipërisë

Së *katërti*, koncepti i dënimit të shtuar ka ndryshuar duke përbërë shumën e përgjithshme të dënimeve për secilin veprë penale. Deri para këtyre ndryshimeve, dënimi më i rëndë i shtuar nuk mund të kapërcente shumën e përgjithshme të dënimeve të caktuara veç e veç, as kufirin më të lartë të parashikuar për llojin e dënimit të dhënë. Me ndryshimet e kryera në nenin 55, pas paragrafit të parë u shtua një paragraf i ri që parashikon se dënimi më i rëndë i shtuar në rastin kur personi ka kryer një krim kundër jetës me dashje, me përdorimin pa leje të armëve luftarake dhe municionit, përbëhet nga shuma e përgjithshme e dënimeve për secilën veprë penale.

Së *pesti*, dënimi me burgim të përjetshëm parashikohet për disa vepra penale.

Së *gjashti*, lirimi me kusht nuk zbatohet për disa vepra penale dhe është parashikuar periudha e sigurisë juridike, gjatë së cilës nuk mund të zbatohet lirimi me kusht.

Së *shtati*, kushtet dhe kriteret ligjore të zbatimit të alternativave të dënimit me burgim, kushtet që duhet të përmbushë një person ndaj të cilit gjykata ka vendosur vënien e të dënuarit në provë kanë ndryshuar.

3.2 Ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji – një mundësi me pak në rastet e dhunës në familje

Kodi penal parashikon uljen e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji (neni 53) në raste të veçanta, kur çmon që vepra dhe autori i saj paraqesin rrezikshmëri të pakët dhe janë të pranishme disa nga rrethana lehtësuese. Ulja e dënimit nënkupton caktim i një dënimi nën minimumin ose një lloj dënimi më të butë se ai që parashikon dispozita përkatëse.

Duke qenë se në hetimin e veprave penale të dhunës në familje zbatohet si rrethana lehtësuese pendimi i autorit, ligjvënësi ndërhyri në këtë institut duke parashikuar se personi mund të përfitojë ulje dënimi vetëm kur nuk është e pranishme asnjë rrethanë rënduese⁵⁶.

Ky ndryshim ligjor mund të krijojë probleme në praktikë

⁵⁶ Neni 8 i ligjit 144/2013 bëri një ndryshim në nenin 53 të kodit penal sipas të cilit, pas fjalëve “rrethanave lehtësuese” shtohen fjalët “dhe nuk është e pranishme asnjë rrethanë rënduese”.

kur bëhet fjalë për rastet e krimeve në familje, kur autori/aja të ketëqënë viktimë e dhunës sistematike në familje dhe për shkak të rrethanave të kryerjes së veprës penale bëhet autor/e e një veprë penale. Pozita e dyfishtë viktimë-autore e krimit rëndohet më shumë edhe nga fakti se disa rrethana lehtësuese nuk konkurojmë me rrethanat rënduese, kur bëhet fjalë për rastet e dhunës në familje.

3.3 Një vlerësimin ndryshe i zbatimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese

Kodi penal parashikon rrethanat lehtësuese dhe rënduese (neni 48 dhe 49 i k.p). Kodi nuk përmban kritere të qarta për peshën që mban secila nga rrethanat në masën e dënimit dhe çfarë duhet të mbajë parasysh gjykata kur vërtetohet prania e një ose më shumë rrethanave. Duke qenë se në praktikë kishte kuptim dhe zbatim të ndryshëm dhe të gabuar të rrethanës lehtësuese të parashikuar në shkronjën “a” dhe “e” të nenit 48 të kodit penal⁵⁷, konkretisht në ndryshimet e bëra në vitin 2013 u parashikua se rrethana lehtësuese “kur vepra është kryer e shtyrë nga motive me vlera pozitive morale e shoqërore” nuk lehtëson dënimin kur vepra penale është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike ose aftësinë e kufizuar. Edhe kur marrëdhëniet ndërmjet personit që ka kryer veprën penale dhe të dëmtuarit janë normalizuar, ky fakt nuk lehtëson dënimin e një personi që ka kryer një veprë penale ndaj fëmijëve ose një veprë penale të dhunës në familje.

Ky ndryshim do tën dikojë në ashpërsimin e dënimit me burgim. Përveç sa më sipër, në vitin 2013 u shtua një rrethanë rënduese e re “kryerja e veprës penale në kohën që personi është nën një urdhër mbrojtjeje” dhe zgjeroi fushën e mbrojtjes së personave, duke përfshirë si veprë penale rënduese kur personi përfiton nga marrëdhëniet e bashkëjetesës⁵⁸.

57 Lehtësojnë dënimin rrethanat që vijnë: a) Kur vepra është kryer e shtyrë nga motive me vlera pozitive morale e shoqërore; e) kur marrëdhëniet ndërmjet personit që ka kryer veprën penale dhe të dëmtuarit janë normalizuar.

58 Shkronja “g” ndryshoi :“g) kur vepra është kryer duke përfituar nga marrëdhëniet familjare, të bashkëjetesës, të miqësisë, të mikpritjes;”.

3.4 Urdhërat e mbrojtjes dhe mbikqyerja elektronike-risi në parandalimin e dhunës në familje

Ligji “Për masat parandaluese të dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar parashikon masa mbrojtëse në rastet e dhunës në familje, ndër të cilat janë urdhëri i mbrojtjes dhe urdhëri i menjëhershëm i mbrojtjes⁵⁹. Ligji “Për mbikqyrjen elektronike të personave të cilëve u është kufizuar lëvizja”⁶⁰ parashikon se mbikqyrja elektronike zbatohet edhe ndaj personave ndaj të cilëve është lëshuar, me vendim gjyqësor, një urdhër mbrojtjeje ose një urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje, sipas neneve 17 dhe 19 të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006

“Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar (neni 4, gërma ç).

Bazuar në analizën gjyqësore e studimet e organizatave të shoqërisë civile që ofrojnë mbështetje për viktimat e dhunës në familje⁶¹, rezulton se numri i vendimeve gjyqësore për pengim të zbatimit të vendimeve të gjykatës nga personat ndaj të cilëve me vendim gjyqësor është dhënë një urdhër mbrojtjeje, është rritur. Vetëm gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë, në vitin 2011 kishte dhënë një vendim për veprën penale të parashikuar nga neni 321, ndërsa në vitin 2012 ka dhënë 4 vendime të tilla. Ligjvënësi, në vitin 2012 bëri një shtesë në nenin 321 të kodit Penal, duke shtuar një paragraf të ri i cili sanksionon si veprë penale kryerjen e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës, në lidhje me detyrat e lindura nga urdhrat e mbrojtjes të dhëna prej saj.

Në vijim të këtij ndryshimi, në vitin 2013 u bë edhe një shtesë tjetër sipas së cilës kryerja e veprës penale, gjatë kohës që personi është nën urdhër mbrojtjeje ose nën mbikëqyrje, elektronike cilësohet si veprë penale e kryer në rrethana rënduese⁶².

59 Neni 10 i ligjit 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

60 Ligji nr.10 494, datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”. Ky ligj ka hyrë në fuqi në 1 prill 2012.

61 Njohja dhe zbatimi i standardeve të barazisë gjinore në procesin gjyqësor. Raport mbi gjetjet kryesore nga monitorimi i vendimeve të Gjykatave të shkallës së I-rë, të Rretheve Gjyqësore Tiranë, Durrës, Shkodër e Vlorë. 1 Janar 2011- 1 qershor 2012, Botim i Qendrës për Nisma Ligjore dhe Qytetare, Dhjetor 2013, f. 54.

62 Neni 6 i ligjit 144/2013.

3.5 Politika penale për bashkëpunëtorët e veprave penale

Zbulimi dhe hetimi i veprave penale të krimit të organizuar ka nevojë për bashkëpunimin me të dëmtuarin ose nga pjesëtarë të grupit kriminal. Me ndryshimet e bëra në nenin 52/a në vitin 2013, dënimi mund të ulet deri në gjysmën e dënimit të parashikuar për veprën e kryer prej tij, kur personi që ka kryer një rën nga veprat penale bashkëpunon dhe ndihmon organet e ndjekjes penale në luftën kundër tyre ose, sipas rastit, në zbulimin e personave të tjerë, që kryejnë krime të tilla.

Autori i trafikimit, në raste të veçanta, kur konkurrojnë edhe rrethana lehtësuese në favor të tij, ky person mund të përjashtohet nga dënimi”.

3.6 Alternativa e dënimit me burgim “një mollë e ndaluar” në rastet e dhunës në familje

Alternativat e dënimit me burgim u zgjeruan me ndryshimet e bëra në kodin penal⁶³ dhe në ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale⁶⁴ në vitin 2008. Qëndrimi në shtëpi është një alternative e re që dëshmon jo vetëm ekonomi në ekzekutimin e dënimeve penale, por edhe humanizëm. Statistikat zyrtare të shërbimit të provës⁶⁵ tregojnë se gjatë periudhës 2009-2013, qëndrimi në shtëpi është zbatuar në 185 raste (1.95%) e të dënuarve.

Në rastet e dhunës në familje, alternativa e qëndrimit në shtëpi nuk mund të zbatohet për shkak të kushteve dhe kriteret ligjore që përcakton kodi penal.

Sipas nenin 59/a të ndryshuar në vitin 2013⁶⁶, gjykata nuk mund të vendosë vuajtjen e dënimit të dhënë me qëndrim në shtëpi për gratë shtatzëna ose nëna me fëmijë, nën moshën 10 vjeç, që jetojnë me të dhe për baballarët, që kanë përgjegjësi prindërore për fëmijën, që jeton me të, nën moshën 10 vjeç, kur nëna e tij ka vdekur ose është e pazonja për t’u kujdesur për

63 Ligji Nr.10 023, datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

64 Ligji nr.10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar.

65 Shih te dhënat statistikore në adresën: <http://www.sherbimiproves.gov.al/index.php/al/aktiviteti-yne/te-dhena-statistikore>

66 Neni 10 i ligjit 144/2013 që ndryshon nenin 59/a të kodit penal.

të, nëse ai/ajo ata kanë kryer një krim ndaj bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es ose fëmijës së tij/saj.

Një nga problemet që rezulton në praktikë është se kujdestaria për fëmijët e mitur në rastet e familjeve me një prind, ose kur të dy prindërit janë të privuar nga liria. Nga takimet dhe intervistat me gra të privuara nga liria, rezulton se ato nuk kanë të dhëna për gjendjen e fëmijëve ose fëmijët e mitur mbahen nga të afërm të të dënuarës, pa pasur një vendim gjyqësor për kujdestarinë e tyre. Zgjidhja e problemeve që lidhen me kujdesin ndaj fëmijës kërkojnë forcim të rolit të institucioneve sociale në sistemin e drejtësisë penale.

Krahas këtyre probleme, rëndësi ka parandalimi i dhunës në familje, pas përfundimit të dënimit nga autori i veprës penale. Trajtimet e grave të dhunuara nuk janë të vetmet programe që duhet të afrohen në rastet e dhunës në familje. Programet duhet të adresojnë trajtime, jo vetëm për viktimat e dhunës, por edhe për autorin e saj. Duke qenë se alkooli dhe droga konsiderohen si dy faktorë që nxisin dhunë në familje dhe në shoqëri, krahas programeve sociale në kodin penal u shtua një nen (neni 60/a) i cili shton detyrimet që duhet të përmbushë i dënuarini rast se ndaj tij, gjykata ka vendosur vënien në provë të tij.

Ndaj të dënuarit të vënë në provë, i cili është në kushtet e varësisë kronike ndaj alkoolit ose lëndëve narkotike, gjykata mund të vendosë detyrimin për t'iu nënshtruar trajtimeve mjekësore për heqjen dorë nga përdorimi i alkoolit ose drogës.

3.7 Humbja e përgjegjësisë prindërore dhe veprat penale kundër fëmijës

Dënimi penal me burgim shoqërohet edhe me një dënim plotësues të ri “humbja e përgjegjësisë prindërore”, parashikuar nga neni 30, pika 10 dhe neni 43/a. Sipas këtij neni humbja e përgjegjësisë prindërore jepet nga gjykata ndaj personit që e ushtron përgjegjësinë prindërore në dy raste:

së pari: personi dënohet si autor ose bashkëpunëtor në një veprë penale ndaj fëmijë;

së dyti, personi është bashkëpunëtor me fëmijën në kryerjen e një veprë penale”.

Zbatimi i këtij dënimi plotësues kërkon një qasje më të gjerë sesa ajo penale në trajtimin e rasteve të abuzimit të fëmijëve dhe një kombinim të zbatimit të ligjit penale me atë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe kodin e Familjes.

3.8 Lirimi me kusht – një mundësi me pak për të dënuarit për vepra penale kundër grave dhe fëmijëve

Lirimi me kusht i të dënuarit është shprehje e humanizmit të ligjit penal. Si formë të reagimit të ashpër ndaj krimeve me rrezikshmëri shoqërore, ligjvënësi e orientoi politikën penale drejt vendosjes së kufizimeve të lirimimit me kusht. Ndërhyrjet në kodin penal⁶⁷, lidhur me zbatimin e këtij neni kanë qënë vetëm dy herë, por shumë të thella brenda një harku kohor 12 vjeçar. Konkretisht, në nenin 64 të kodit penal është ndërhyrë duke parashikuar:

Së *pari*, përcaktimin e kriterëve ligjore më të forta për të përfituar të drejtën për të kërkuar lirimimin me kusht.

Së *dyti*, ndalimit të zbatimit të lirimimit me kusht për veprat penale të vrasjes për gjakmarrje (neni 78/a), vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare (neni 79/c), për marrëdhëniet seksuale dhe homeseksuale me pasojë (paragrafi i tretë i nenit 100 i k.p.).

Deri në vitin 2012, kodi penal nuk kishte kufizime për natyrën e veprës penale të kryer që personi të përfitonte lirinë me kusht. Në vitin 2012, u shtua një nen të ri (neni 65/a) i emërtuar *Periudha e sigurisë* sipas të cilës gjykatës i njihet e drejta që në dhënien e vendimit, mund të vendosë edhe caktimin e një periudhe sigurie, gjatë së cilës nuk lejohet zbatimi i nenit 64 të Kodit penal kur ekziston një nga rrethanat e parashikuara në këtë nen. Si rrethana të tilla janë: kur vepra është kryer kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen; kur vepra është kryer duke përfituar nga marrëdhëniet familjare ose të bashkëjetesës; kur kryerja e veprës penale është shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, fenë, kombësinë, gjuhën, bindjet politike, fetare ose sociale (neni 65/a, gërma “c”, ç, d). Periudha e sigurisë shtrihet për afatin kohor nga tre të katërtat e dënimit të dhënë nga gjykata deri në kohëzgjatjen e plotë të dënimit penal.”

⁶⁷ Neni 7 i ligjit nr.8733, datë 24.1.2001 dhe neni 12 i ligjit nr.144/2013.

4.0 Përfundime

Gratë dhe të miturit gëzojnë një mbrojtje juridiko-penale të përmirësuar gjatë viteve të fundit. Politika penale është ashpërsuar pas shtesave dhe ndryshimeve të bëra në kodin penal sidomos në vitet 2012 dhe 2013. Orientimet e politikës penale drejt kriminalizimit dhe shumë pak nga dekriminalizimi dhe depenalizimi kanë sjellë një ashpërsim të dënimeve penale për veprat penale që përbëjnë shqetësim kombëtar dhe ndërkombëtar. Natyra dhe shpeshësia e ndryshimeve do të kërkojnë kohë për krijimin e një praktike gjyqësore të unifikuar dhe të konsoliduar në fushë. Ndryshimet e politikës penale kanë nevojë të vlerësohen si në efektet e parandalimit të dhunës në familje, kundër fëmijëve, edhe nga aspekti financiar, pra, vlerësimi i kostos së shërbimeve sociale për fëmijët, viktimën, rehabilitimin e të dënuarve dhe pasojat në mjedisin familjar.

Përmirësimi i mbrojtjes së grave dhe fëmijëve do të rritet, nëse punonjësit e policisë, prokurorët dhe gjyqtarët do të njohin mirë jo vetëm ligjin, por edhe praktikat më të mira në mbrojtjen e grave dhe të fëmijëve. Krahas zbatimit të drejtë të politikës penale, masat sociale për kufizimin e faktorëve të riskut dhe nxitjen e faktorëve parandalues të krimit duhet të marrë përparësi. Rritja dhe forcimi i rolit të institucioneve sociale në sistemin e drejtësisë penale është jo vetëm i nevojshëm, por mëse i domosdoshëm.

Literatura

1. Aeibi, M, Akdeniz, G, Barclay, G, etj “ *European Sourcebook of Crime and Criminal Justice, Statistics*, 2014, HEUNI, f.37. Ky botim gjendet edhe në internet në adresën: http://www.heuni.fi/material/attachments/heuni/reports/qrMWoCVTF/HEUNI_report_80_European_Sourcebook.pdf
2. Ann Numhauser-Henning and Sylvaine Laulom “*Harassment related to Sex and Sexual Harassment Law in 33 European Countries, Discrimination versus Dignity*”, Komisioni Europian, 2012. Ky botim gjendet edhe në internet në adresën: http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/files/your_rights/final_harassment_en.pdf
3. *Child labour in Europe: a persisting challenge*: <http://www.coe.int/en/web/commissioner/-/child-labour-in-europe-a-persisting-challen-1#more-305>
4. “*Dhuna ndaj Fëmijëve në Shqipëri*” në kuadër të Studimit Epidemiologjik Ballkanik mbi Abuzimin dhe Neglizhimin e Fëmijëve (B.E.C.A.N), CRCA, 2013.
5. Elezi, I dhe Elezi, E: *Historia e së drejtës penale*, botim SHBLU, 2011.
6. Holly Johson, Natalia Ollus, Sami Nevala “*Violence Against women, an International Perspective*”, HEUNI dhe Springer, Janar 2008.
7. Killas, M, G, Barclay, G, Smith, P, Hysi, V. etj “*European Sourcebook of Crime and Criminal Justice, Statistics*, 2003, WODC. Ky botim gjendet edhe në internet në adresën: <http://www3.unil.ch/wpmu/europeansourcebook/>
8. *Defining and registering Criminal Offences and Measures, Standards for a European Comparison*, edituar nga Jehle, J, M dhe Harrendorf, S., botim i Universitetit të Götigenit, 2010.
9. *Is the word better a better place for children? 25 years of the Convention on the Rights of the Child*. UNICEF, Shtator 2014, faqe 29 dhe 35. Ky botim gjendet edhe në faqen zyrtare të UNICEF në internet: http://www.unicef.org/publications/files/CRC_at_25_

Anniversary_Publication_26Sept2014.pdf

10. “*Global and regional estimates of violence against women: prevalence and health effects of intimate partner violence and non-partner sexual violence*”, Raport i Organizatës Botërore të Shëndetit, 2013. Ky raport gjendet edhe në internet në adresën: http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/85241/1/WHO_RHR_HRP_13.06_eng.pdf?ua=1
11. *Global Report on Trafficking in Human beings*, UNDCP, 2009, f. 48. Ky raport gjendet i botuar në adresën: http://www.unodc.org/documents/Global_Report_on_TIP.pdf
12. *Njohja dhe zbatimi i standardeve të barazisë gjinore në procesin gjyqësor. Raport mbi gjetjet kryesore nga monitorimi i vendimeve të Gjykatave të shkallës së I-rë, të Rretheve Gjyqësore Tiranë, Durrës, Shkodër e Vlorë*. 1 Janar 2011- 1 qershor 2012, Botim i Qendrës për Nisma Ligjore dhe Qytetare, Dhjetor 2013.
13. Raporti vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm paraqitur në Kuvendin e Shqipërisë, Tiranë 2014.
14. Robin N. Haarr, *Dhuna në familje në Shqipëri, Vrojtim kombëtar me bazë popullatën*, 2013, f. 1. Ky raport gjendet edhe në faqen zyrtare të INSTAT në adresën: http://www.instat.gov.al/media/225812/dhuna_ne_familje_ne_shqiperi_2013.pdf
15. *Të lirë nga frika, të lirë nga dhuna*, Manual për parlamentarët, Konventa e Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (botim i Këshillit të Europës, botim shqip.
16. *Trafficking in human beings 2010-2014: eradicating the slave trade*, EU report, 17 Tetor 2014. Të dhëna të plota gjenden në adresën: http://europa.eu/rapid/press-release_IP-14-1164_en.htm
17. *Working children in the Republic of Albania - The results of the 2010 National Child Labour Survey*. Ky studim gjendet i botuar edhe në internet në adresën: http://www.ilo.org/ipecl/Informationresources/WCMS_202853/lang-en/index.htm

Kode, ligje, vendime gjyqësore

1. Kodi penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar
2. Kodi i procedurës penale, i ndryshuar
3. Ligji nr.145/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
4. Ligji nr.144/2013 “Për disa shtesa në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
5. Ligji 23/ 2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
6. Ligj nr.10.494, datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike në fushën penale”.
7. Ligji nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”
8. Ligji nr.10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar.
9. Ligji nr.10 023, datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
10. Ligji nr.9859, datë 21.1.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
11. Ligji nr. 9669, datë 18.1.2.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.
12. Ligji nr. 8733, datë 24.1.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
13. Vendimi 47, datë 26.07.2012 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

EFIKASITETI I MBROJTJES SË RENDIT KUSHTETUES

Dr. Sokol Mëngjesi

Dr. Klodjan Skënderaj

1. Mënyrat e mbrojtjes së rendit kushtetues

Në çdo shoqëri të organizuar ndërtohet një sistem i tërë juridik që në misionin e vet midis të tjerash ka për qëllim të garantojë një bashkëjetesë harmonike midis anëtarëve të shoqërisë dhe të garantojë ecurinë normale të jetës politike shoqërore e kulturore të një vendi. Për këtë qëllim ligjvënësi përdor sanksione të caktuara që shërbejnë si mënyra mbrojtjeje ndaj sjelljeve devijante të anëtarëve të shoqërisë. Siç është e njohur sanksionet që disponon ligjvënësi në arsenalin e vet janë kryesisht civile, administrative dhe penale. Këto sanksione parashikohen për të përballuar sjelljet devijante të anëtarëve të shoqërisë duke mbajtur parasysh natyrën dhe intensitetin e sjelljes devijante, e thënë me fjalë të tjera ruhet proporcionaliteti midis mjetit të përdorur dhe qëllimit të synuar.

Pa dyshim nga të gjitha sanksionet që ligjvënësi disponon, sanksionet penale janë sanksionet më të ashpra, nëpërmjet të cilave synohet mbrojtja e atyre vlerave moralë – shoqërore të cilat ligjvënësi i konsideron kaq shumë të rëndësishme, saqë pa respektimin e të cilave nuk mundet të ruhet një bashkëjetesë harmonike në shoqëri. Nëpërmjet këtij procesi këto vlera nga vlera thjesht moralë – shoqërore, shëndërrohen në “vlera juridike” apo “benifite juridike” të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal. Benifitet juridike në vija të përgjithshme mund të kategorizohen në benifite juridike personale, që i përkasin

individit siç janë “jeta”, “shëndeti”, “liria personale”, “liria e besimit”, “prona”, etj., si dhe në benifite juridike shoqërore, siç janë “monedha”, “mjedisi”, “trashëgimia kulturore”, “vërtetësia e dokumentave”, etj.

Nëpërmjet këtyre benifiteve juridike të mbrojtura posaçërisht nga ligjvënësi penal, shteti synon të mbrojë “ambjentit”, ku anëtarët e shoqërisë zhvillohen dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre të përditshme, si dhe benifite utilitare të individit¹.

Përveç këtyre benifiteve juridike të sipërcituara, shteti si i vetmi garant i tyre, është i detyruar të mbrojë edhe vetveten, në mënyrë që të krijojë stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e nevojshme për të përmbushur më pas funksionin e tij garantues të sqaruar më sipër. Në këtë aspekt mbrohen elementë të domosdoshëm të nocionit të shtetit si “integriteti territorial”, “pavarësia dhe pozicioni i shtetit në arenën ndërkombëtare”, “rendi kushtetues”, “rendi dhe siguria publike”, etj. Nëpërmjet procesit të parashikimit dhe të fortifikimit të mbrojtjes së këtyre elementëve me sanksione penale edhe këto elementë shndërrohen, ashtu sikurse edhe vlerat moralo – shoqërore të cituara më sipër, në benifite juridike.

Përsa i përket rendit kushtetues, duke marrë në konsideratë faktin se ky rend mbrohet specifikisht nga ligjvënësi penal, duke u parashikuar sanksione penale për këdo që e cënon këtë rend, paraprakisht mundet të themi se ekziston një sistem mbrojtës efektiv, përderisa mënyrë tjetër më efikase se sa mbrojtja penale nuk ekziston. Përveç këtij fakti, në këtë punim analiza do të jetë më e detajuar dhe do të fokusohet në dimensionet e mbrojtjes. Kjo do të thotë që do të analizohet fakti nëse dispozitat penale janë hartuar apo jo, në një mënyrë të atillë që të garantojnë një mbrojtje të plotë dhe të gjithanshme të rendit kushtetues.

Për këtë qëllim në fillim do të analizojmë në vija të përgjithshme veprat penale kundër rendit kushtetues të

¹ Duhet të theksojmë se këto benifite juridike të individit janë ikumenike, që do të thotë se mbrohen në çdo kohë e në çdo vend, në çdo shoqëri pavarësisht fazës së zhvillimit të kësaj shoqërie, rendit të vendosur etj. Për më tepër shiko Ismet Elezi, *E drejta penale zakonore e shqiptarëve*, Tiranë 1983, Ismet Elezi, *Zhvillimi historik i legjisllacionit penal në Shqipëri*, Shtëpia Botuese “albin”, Tiranë, 1997, Ismet Elezi, *Mendimi juridik shqiptar*, Shtëpia Botuese “albin”, Tiranë, 1999, Ismet Salihu, Ismet Elezi, *Zhvillimi historik i legjisllacionit penal në Shqipëri*, Studime Juridike 2009, ku lehtësisht do të konstatohet se edhe në vendin tonë qysh në fillimet e para të shfaqjes së të drejtës penale, mbrojtjes së këtyre benifiteve juridike u është kushtuar një rëndësi e veçantë dhe parësore.

parashikuara nga ligjvënësi penal dhe në vijim do të vazhdojmë me një analizë më specifike të veprimeve konkrete kundër rendit kushtetues.

2. Veprat penale kundër rendit kushtetues

Veprat penale kundër rendit kushtetues janë të parashikuara në seksionin e dytë të kreut të pestë të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal (nenet 219 – 225 KP). Duke u nisur nga mënyra e cënimit të rendit kushtetues veprat e parashikuara në këtë seksion mundet t'i kategorizojmë në tre grupe.

Në grupin e parë hyjnë atentati (neni 219 KP), kryengritja (neni 221 KP) dhe thirrjet për armatosje ose marrje pa të drejtë e komandës (neni 222 KP). E përbashkëta e veprave të grupit të parë konsiston në faktin se të treja këto vepra penale janë të parashikuara si vepra penale me anë subjektive më të gjerë se sa ana objektive, ose e thënë ndryshe si vepra penale qëllimi, sepse në të treja rastet parashikohet si qëllim i autorit përmbysja e rendit kushtetues. Pra bëhet fjalë për vepra rreziku potencial, sepse në këto raste veprimet e autorit duhet të jenë objektivisht të përshtatshme të çojnë në përmbysjen e rendit kushtetues. Përshtatshmëria objektive e veprimeve të autorit për përmbushjen e qëllimit, përbën një element të pashkruar të anës objektive në të gjitha veprat penale me anë subjektive më të gjerë se sa ana objektive, ose ndryshe e veprave penale të qëllimit. Përshtatshmëria objektive do të thotë që veprimet e autorit duhet të kenë krijuar kushte të tilla rreziku, që në kushte normale situata të drejtohet në rrezik konkret dhe në vijim në dëmtim të benifitit juridik.

Në grupin e dytë hyn kompleti (neni 220 KP). Po të shikohet përmbajtja e kësaj vepre penale konstatohet se bëhet fjalë, e theksojmë për nga përmbajtja dhe jo për nga formaliteti, për veprime parapërgatitore kundër rendit kushtetues, të ngritura nga ligjvënësi penal në piedestalin e një vepre penale autonome.

Në grupin e tretë hyjnë thirrjet publike për veprime të dhunshme (neni 223 KP), krijimi i partive dhe shoqatave antikushtetuese (neni 224 KP) si dhe shpërndarja e shkrimeve antikushtetuese (neni 225 KP). Veprat e grupit të tretë përbëjnë vepra rreziku potencial dhe mund të konsiderohen

për nga përmbajtja, si veprime parapërgatitore kundër rendit kushtetues. Këto vepra nuk hyjnë në kategorinë e dytë për arsye sepse komploti (neni 220 KP) lidhet me veprime parapërgatitore të një vepre penale konkrete (atentati), kurse veprimet parapërgatitore të parashikuara nga nenet 223, 224 dhe 225 KP janë abstrakte dhe nuk lidhen me parapërgatitjen e ndonjë vepre penale konkrete. Pra siç rezulton qartë nga analiza e përgjithshme e veprave penale të parashikuara në seksionin e dytë të kreut të pestë të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, vepra penale kryesore kundër rendit kushtetues është atentati (neni 219 KP) dhe për këtë arsye do të vijojmë studimin analitik të kësaj vepre penale. Njëpërmjet kësaj analize do të shpjegohen midis të tjerash nocionet rend kushtetues dhe përmbysja e tij, nocionet të cilat hasen gjithashtu edhe në veprat e tjera penale të kategorisë së parë. Gjithashtu këto nocione shërbejnë për gjithë interpretimin e veprave penale të këtij seksioni, pasi rendi kushtetues është benifiti juridik i mbrojtur me veprat penale të parashikuara në këtë seksion dhe siç është e vetëkuptueshme në të drejtën penale përcaktimi i saktë i përmbajtjes së benifitit juridik përbën një ndër kushtet thelbësore për interpretimin e saktë të veprave penale. Njëpërmjet interpretimit të saktë të përmbajtjes së benifitit juridik, kombinuar gjithashtu edhe me interpretimin e atentatit si një ndër veprat kryesore kundër rendit kushtetues do të arrijmë në qëllimin e këtij punimi, pra në analizimin final të dimensioneve të mbrojtjes së rendit kushtetues dhe së fundmi të efikasitetit të këtij sistemi mbrojtës.

3. Analiza juridike e veprës penale të atentatit

Në nenin 219 të Kodit Penal parashikohet vepra penale e atentatit *“Kryerja e vrasjeve, rrëmbimeve, torturave apo akteve të tjera të dhunës kundër përfaqësuesve më të lartë të shtetit, me qëllim për të përmbysur rendin kushtetues, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm”*.

Atentati parashikohet si vepër penale me subjekt të përgjithshëm², ç’ ka do të thotë se çdokush mundet të jetë autor

2 Ismet Elezi, *E drejta penale e Republikës së Shqipërisë, Pjesa e Posaçme*, Shtëpia Botuese “albin”, Tiranë, 1999, Ismet Elezi, *E drejta penale, Pjesa e Posaçme*, Shtëpia Botuese “Erik”, Tiranë, 2007.

i kësaj vepre, mjafton të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale, që në rastin konkret është 14 vjeç, përderisa bëhet fjalë për një vepër, e cila parashikohet nga ligjvënësi si krim.

Subjekt pasiv i kësaj vepre penale janë përfaqësuesit më të lartë të shtetit. Në doktrinën teorike³, pa ndonjë argumentim konkret dhe të thelluar është mbështetur ideja se nocioni “përfaqësues më të lartë të shtetit” përfshin Presidentin e Republikës, Kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin, Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, deputetët, ministrat si dhe të gjithë personat që barazohen me ta⁴. Mungesa e një shpjegimi të arsyetuar na bën të dyshojmë për vërtetësinë e këtij mendimi.

Nuk mundet kurrsesi të mohojmë faktin se përcaktimi me ekzaktësi i nocionin “përfaqësues më të lartë të shtetit” është tepër i vështirë, përderisa nuk ekziston asnjë dispozitë konkrete ligjore që të përcaktojë përmbajtjen e këtij nocioni.

Në këtë këndvështrim mundet të themi se teknika legjislativë e përdorur në formulimin e kësaj vepre penale është e gabuar dhe e papërshtatshme⁵. Nga ana tjetër domosdoshmëria e përcaktimit të përmbajtjes së këtij nocioni është e evidente.

Përcaktimi i saktë i këtij nocioni na lejon të bëjmë një interpretim të saktë doktrinal të kësaj vepre penale, duke patur parasysh faktin që ky nocion përbën një ndër elementët themelor të anës objektive të veprës penale të atentatit. Në këto kushte e vetmja rrugë është ajo teorike, dhe që të jetë e saktë duhet të jetë produkt i një analize të gjerë dhe të detajuar, duke marrë në konsideratë ratio-n e kësaj dispozite, pra qëllimin e ligjvënësit dhe ç’ka ai ka synuar që të mbrojë me këtë vepër penale si dhe natyrën e kësaj vepre.

Duhet t’u nisim analizën tonë duke pranuar faktin se me sensin e zhargonit të përditshëm dhe kufijëve gjuhësor të nocionit “përfaqësues më të lartë të shtetit”, nuk vihet në dyshim që në këtë kategori hyjnë Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit,

3 Bëhet fjalë vetëm për trajtimin teorik të këtyre veprave penale, pasi në praktikë nuk ka patur ndonjë rast, për këtë arsye ne nuk disponojmë ndonjë praktikë gjyqësore, ku të mbështetem për interpretim të bërë nga gjykatat për këto vepra në tërësi, apo për elementë të tyre specifik në veçanti.

4 Ismet Elezi, E drejta penale e Republikës së Shqipërisë, Pjesa e Posaçme, Shtëpia Botuese “albin”, Tiranë, 1999, Ismet Elezi, E drejta penale, Pjesa e Posaçme, Shtëpia Botuese “Erik”, Tiranë, 2007.

5 Mbjamë këtë qëndrim duke patur parasysh parimin kushtetues “nullum crimen nulla poena sine lege”, që përbën gurin themelor të të drejtës penale dhe udhëzuesin kryesor veçanërisht të ligjvënësit penal, i cili për të qënë kosekuent dhe në përputhje me këtë detyrim kushtetues, duhet të formulojë vepra penale të sakta duke shmangur çdo lloj paqartësie veçanërisht në anën objektive të tyre.

Kryeministri si dhe personat që i zëvendësojnë këta të fundit në ushtrimin e kompetencave dhe funksioneve të parashikuara nga ligji.

Natyrshtëm lind pyetja nëse konsiderohen edhe persona të tjerë si përfaqësues më të lartë të shtetit apo jo?

Nëse do të ishim tepër strikt në zbatimin e parimeve të së drejtës penale, pa dyshim që përgjigja do të ishte negative, por duke marrë parasysh qëllimin e kësaj dispozite, si dhe vullnetin e ligjvënësit rezulton ndryshe. Ky mendim përforcohet edhe nëse marrim në konsideratë komponentët mbi të cilët ne do të bazohemi në analizën tonë, pra natyrën e kësaj veprë penale si dhe benefitin juridik të mbrojtur prej saj. Të dy këta faktorë janë thelbësor dhe me impakt të drejtpërdrejtë në interpretimin e dispozitave penale materiale.

Siç do të analizohet edhe në vijim, për nga natyra atentati parashikohet si një vepër penale me anë subjektive më të gjerë se sa ana objektive, ose e thënë ndryshe si një vepër penale qëllimi. Pra në këtë vepër si edhe në të gjitha veprat e tjera të kësaj kategorie, autori synon në përmbushjen e një qëllimi të caktuar. Kjo do të thotë që veprimi i autorit, duhet të jetë objektivisht i përshtatshëm për përmbushjen e qëllimit, që në rastin konkret është përmbysja e rendit kushtetues. Në këtë mënyrë, kriteret orientuese për të përcaktuar rrethin e personave që konsiderohen si përfaqësues më të lartë të shtetit mendojmë se janë dy.

Së pari personi duhet të ushtrojë detyra të parashikuara drejtpërdrejt nga Kushtetuta, në kuadër të një funksioni gjithashtu kushtetues. Së dyti këta persona të ushtrojnë detyra të tilla dhe të kenë një rol të tillë në organizimin e strukturës dhe funksionimit të shtetit, që nëse pengohen për të ushtruar funksionet e tyre, individualisht ose në kombinacion me pengimin e ushtrimin të funksioneve të përfaqësuesve të tjerë të shtetit, të sjellin përmbysjen e rendit kushtetues. Për t' u bërë më i kuptueshëm kriteri i dytë, sqarojmë se këta persona duhet të kenë një rol të caktuar gjatë aktivizimit të procedurave të jashtëzakonshme që parashikon Kushtetuta, për normalizimin e rendit kushtetues pas ndonjë çrregullimi eventual.

Dy kriteret e vendosura përbëjnë një rregull të përgjithshëm, kështu që gjykimi nëse një person konsiderohet përfaqësues i

lartë i shtetit ose jo, do të bëhet në bazë të rregullit të mësipërm, duke patur parasysh njëkohësisht edhe dispozitat kushtetuese. Një analizë e hollësishme për të përcaktuar rrethin e personave që konsiderohen si përfaqësues më të lartë të shtetit nuk mundet të bëhet në kuadër të kësaj teme, pasi i tejkalon qëllimet e saj.

Në një rast konkret mundet që të plotësohet vetëm një prej dy kriterëve, për këtë arsye nuk kemi të bëjmë me një person që hyn në kategorinë e përfaqësuesve më të lartë të shtetit, me kuptimin sigurisht që ka ky term në kuadrin e kësaj vepre penale. Kështu p.sh. Avokati i Popullit, megjithëse është një person që ushtron një funksion kushtetues, nuk konsiderohet si një prej përfaqësuesve më të lartë të shtetit, për arsye se nuk ka asnjë rol gjatë aktivizimit të procedurave të jashtëzakonshme për normalizimin e rendit kushtetues në rast çrregullimi, ashtu siç parashikohen këto procedura nga vetë Kushtetuta. Shkëputemi përkohësisht nga kjo problematikë me qëllim që të analizojmë elementët e tjerë të kësaj vepre penale, për t' u rikthyer sërish në kuadrin e kësaj problematike dhe sqarimin më të plotë të saj, bazuar sigurisht edhe në analizën e elementëve të tjerë të anës objektive dhe subjektive.

Si mënyra të kryerjes së kësaj vepre (modus operandi) janë parashikuar nga ana e ligjvënësit kryerja e vrasjeve, rrëmbimeve, torturave apo akteve të tjera të dhunës, kundër përfaqësuesve më të lartë të shtetit⁶. Termat “vrasje”, “rrëmbim”, “torturë” dhe “akte të tjera të dhunës” përdoren në këtë vepër penale me kuptimin që kanë këto terma përkatësisht në nenet 76 “Vrasja me dashje”, 109 “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit”, 86 “Tortura” dhe 90 “Dëmtime të tjera me dashje” të Kodit Penal.

Veprimet e autorit duhet të jenë objektivist të përshtatshme për të shkaktuar përmbysjen e rendit kushtetues. Duke nisur nga ky konstatim, duhet të sqarojmë se kur një vrasje, një rrëmbim, një torturë apo një akt tjetër dhune kundër një përfaqësuesi më të lartë të shtetit, është objektivist i përshtatshëm të shkaktojë përmbysjen e rendit kushtetues. Për të qënë më të saktë dhe në një përpjekje për të zbardhur çdo anë të errët të kësaj vepre penale, duhet të sqarojmë edhe faktin nëse për të patur këtë

6 Ismet Elezi, E drejta penale e Republikës së Shqipërisë, Pjesa e Posaçme, Shtëpia Botuese “albin”, Tiranë, 1999, Ismet Elezi, E drejta penale, Pjesa e Posaçme, Shtëpia Botuese “Erik”, Tiranë, 2007.

vepër penale të konsumuar, mjafton një vrasje, një rrëmbim, një torturë ose një akt tjetër dhune apo nevojiten dy apo më shumë veprime të tilla.

Për t' i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve duhet të kemi parasysh faktin se bëhet fjalë për një vepër penale rreziku potencial⁷, që do të thotë se nga kjo vepër penale duhet të krijohet një rrezik potencial për rendin kushtetues. Në këto kushte kryerja e një vrasjeje, një rrëmbimi, një torturë apo një akti tjetër dhune kundër një përfaqësuesi më të lartë të shtetit, për të mos thënë që është e pamundur, shumë vështirë krijon një rrezik potencial për rendin kushtetues. Një veprim i tillë ndoshta përbën një burim rreziku, por ende larg rrezikut potencial, siç kërkohet në rastin e atentatit, për të patur konsumim të kësaj vepre penale.

Për të krijuar rrezik potencial, një prej veprimeve të parashikuar në këtë dispozitë do të duhet të kryhet si një veprim i integruar në kuadrin e një plani konkret. Ky plan duhet të parashikojë edhe veprime të tjera që janë programatizuar për t' u kryer nga autori apo bashkëpuntorët e tij. Vetëm kur një vrasje, një rrëmbim, një torturë apo një akt tjetër dhune, kundër një përfaqësuesi të lartë të shtetit, kryhet në kuadrin e këtij plani të përcaktuar, që ka si qëllim final përmbysjen e rendit kushtetues, është veprim objektivisht i përshtatshëm për të përmbysur rendin kushtetues dhe atentati konsiderohet vepër e konsumuar.

Arrijmë kështu në konkluzionin se edhe një vrasje, një rrëmbim, një torturë apo një akt tjetër dhune mjafton për të patur konsumim të veprës penale të atentatit. Arsyeja është e thjeshtë, dhe kjo për faktin se nëse një veprim i tillë përbën një veprim të integruar në kuadrin e një plani të mirëorganizuar, qëllimi final i të cilit është përmbysja e rendit kushtetues, krijon kushte të tilla që çojnë në realizimin e një rreziku konkret dhe së fundmi në përmbushjen e rrezikut, pra përmbysjes së rendit kushtetues.

Vërtetësia e këtij mendimi, pra që një vrasje, një rrëmbim, një torturë apo një akt tjetër dhune mjafton për të patur konsumim të veprës penale të atentatit, vetëm nëse përbën një veprim të integruar në kuadrin e një plani të mirëorganizuar, qëllimi final

⁷ Nga kjo pikëpamje veprat penale ndahen në vepra penale rreziku abstrakt, vepra penale rreziku potencial dhe vepra penale rreziku konkret.

i të cilit është përmbysja e rendit kushtetues, përforcohet edhe më tej po të kemi parasysh natyrën e kësaj vepre penale.

Në këtë aspekt atentati parashikohet si tentativë⁸ e përmbysjes së rendit kushtetues, që është ngritur nga ligjvënësi penal në kuadrin e një vepre penale të plotë⁹. Tek tentativa është e pakontestueshme ekzistenca e një plani kriminal¹⁰, i cili fillon të konkretizohet por nuk përfundon.

Një analizë më e hollësishme nevojitet për interpretimin e termave “torturë” dhe “akte të tjera dhune” kundër përfaqësuesve më të lartë të shtetit, si mënyra për kryerjen e veprës penale të atentatit. Kryerja e torturës apo akteve të tjera të dhunës kundër përfaqësuesve më të lartë të shtetit, si veprime të vetme të pashoqëruara nga veprime të tjera, nuk mundet të përbëjnë mënyra të kryerjes së kësaj vepre penale. Këto veprime në vetvete nuk mundet të konsiderohen si mënyra të kryerjes (modus operandi) së atentatit. Edhe në rast se ndodhin, atëherë do të karakterizohen përkatësisht si plagosje, dëmetime të tjera me dashje etj., dhe autori do të mbajë përgjegjësi në bazë të dispozitave respektive penale. P.sh në rast se autori kryen torturë kundër Presidentit të Republikës apo Kryetarit të Kuvendit ose kundër përfaqësuesve të tjerë më të lartë të shtetit, ose në rast se godet me grushta një nga personat e mësipërm dhe gjithçka përfundon në kuadrin e kësaj ngjarjeje, nuk mundet të pretendojmë se bëhet fjalë për atentat.

Këto veprime mundet të konsiderohen si mënyra të kryerjes së veprës penale të atentatit, kur përdoren si mjete shtrënguese, për të detyruar të dëmtuarin në ndërrmarjen apo mosndërrmarrjen e një veprimi të caktuar. P.sh. në rastin e mësipërm nëse autori torturon apo kryen veprime të dhunshme (goditje me grushta,

8 Në këtë pikë të studimit fjala “tentativë” nuk përdoret me kuptimin që ka ky nocion si institut i pjesës së përgjithshme të të drejtës penale, por me kuptimin që ka ky term në zhargonin e përditshëm, pra si një përpjekje për përmbysjen e rendit kushtetues.

9 Siç u sqarua edhe në shënimin pararendës formalisht nuk mundet të flasim për tentativë, pasi në vetvete vetë përmbysja e rendit kushtetues nuk parashikohet në asnjë dispozitë si vepër penale më vete. Nuk duhet të krijojmë përshtypje të gabuara se përmbysja e rendit kushtetues nuk dënohet, ajo dënohet që në një fazë të mëparshme, akoma kur është në përpjekje çka do të thotë që është e dënueshme edhe kur është përmbysur pasi logjikisht përmbysja kalon nga përpjekja. Duhet të theksojmë gjithashtu se përzgjedhja e ligjvënësit të dënojë përpjekjen e përmbysjes së rendit kushtetues, duke mos pritur që të përmbysset rendi kushtetues dhe në këtë moment të aktivizohet mekanizmi penal është absolutisht e drejtë pasi në këtë moment asgjë nuk do të kishte më kuptim. I njëjti trajtim bëhet edhe në legjislacione të tjera shiko Dionisis Spinellis, Die Entwicklung des griechischen Strafrecht in den letzten dreißig Jahren, ZStW, 1983

10 Krahasimi që bëjmë këtu me tentativën është i drejtë, pasi pavarësisht se formalisht nuk mundet të flasim për tentativë për nga përmbajtja thelbësore kjo është një tentativë e mirfilltë e përmbysjes së rendit kushtetues.

rrajhe etj.) kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit apo kundër ndonjë përfaqësuesi tjetër të lartë të shtetit dhe e detyron të heqë dorë nga ushtrimi i detyrave kushtetuese, apo të pezullojë përkohësisht ushtrimin e detyrave kushtetuese, atëherë normalisht këto veprime mundet të konsiderohen si mënyra të kryerjes së atentatit.

Nën këtë këndvështrim këto veprime barazohen për nga rëndësia e pasojës që shkaktojnë¹¹ me vrasjen dhe rrëmbimin. Si përfundim mundet të themi se atentati kryhet nëpërmjet torturës ose akteve të tjera të dhunës, vetëm në rast se këto veprime sjellin si pasojë pengimin e ushtrimit të detyrave kushtetuese të funksionarëve më të lartë të shtetit dhe në këtë rast do të nevojitet jo thjesht dhe vetëm të vërtetohet kryerja e torturave apo akteve të tjera të dhunës, por edhe që nëpërmjet këtyre veprimeve të jetë arritur pengimi i ushtrimit të detyrave nga ana e përfaqësuesit më të lartë të shtetit.

Pengesa në ushtrimin e detyrave kushtetuese mundet të jetë e përhershme, ose e përkohshme. Në rast se pengesa është e përkohshme, atëherë ajo duhet të zgjasë aq sa është e nevojshme për aktivizimin e procedurave të jashtëzakonshme që parashikon Kushtetuta, për normalizimin e çrregullimit të krijuar.

Kjo gjë vlen edhe në rastin kur si mënyrë e kryerjes së atentatit përdoret rrëmbimi, pasi edhe në këtë rast përfaqësuesi i lartë i shtetit pengohet përkohësisht nga ushtrimi i detyrave kushtetuese. Përderisa i referohemi rrëmbimit, duhet të pranojmë se kjo mënyrë funksionon edhe si mjet shtrëngues, sikurse tortura dhe aktet e tjera të dhunës dhe vlen edhe në këtë rast interpretimi referuar më sipër për këto dy mënyra të kryerjes së veprës penale. Por rrëmbimi mundet, ashtu sikurse vrasja, të sjellë automatikisht pasojën e nevojshme për të patur konsumim të kësaj vepre penale. Kjo ndodh në rastin kur funksionari i lartë i shtetit pengohet në ushtrimin e detyrave kushtetuese për arsye se ndodhet nën pushtetin fizik të autorit.

11 Kur flasim në këtë pikë për rëndësinë e pasojës që shkaktojnë, nënkuptojmë sigurisht qëllimin që synon autori të arrijë nëpërmjet kryerjes së këtyre veprimeve dhe jo pasojën në kuptimin stricto sensu të këtij termi, pasi në këtë kuptim të fundit pasoja e vrasjes apo e rrëmbimit, vdekja dhe privimi i lirisë personale respektivisht, pa dyshim që ndryshojnë thelbësisht nga pasoja e torturës apo akteve të tjera të dhunës, dinjiteti njerëzor dhe shëndeti respektivisht.

Atentati parashikohet si një vepër penale me anë subjektive më të gjerë se sa ana objektive, ose vepër penale qëllimi, për arsye se autori sipas parashikimeve të kësaj dispozite synon në përmbysjen e rendit kushtetues. Në këto vepra penale duhet të pranohet, që veprimi kriminal të jetë objektivisht i përshtatshëm¹² për të realizuar përmbysjen e qëllimit. Kështu në rastin konkret është e nevojshme të sqarohet se kur kemi përmbysje të rendit kushtetues.

Për të përcaktuar përmbajtjen e termit “përmbysje e rendit kushtetues” do të duhet më parë të përcaktojmë përmbajtjen e termit “rend kushtetues”.

Me rend kushtetues¹³ kuptohet tërësia e normave kushtetuese, të cilat përbëjnë rregullat bazë për të orientuar jetën shoqërore dhe politike në një vend¹⁴. Pra e gjithë jeta shoqërore – politike që zhvillohet në Republikën e Shqipërisë rregullohet nga parimet themelore dhe instututet bazë që parashikon Kushtetuta.

Po të shikojmë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë vëmë re se ajo është e strukturuar në 18 pjesë: pjesa e parë me titull “Parimet themelore”, pjesa e dytë me titull “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, pjesa e tretë me titull “Kuvendi”, pjesa e katërt me titull “Presidenti i Republikës”, pjesa e pestë me titull “Këshilli i ministrave”, pjesa e gjashtë me titull “Qeverisja vendore”, pjesa e shtatë me titull “Aktet normative dhe marrëveshjet ndërkombëtare”, pjesa e tetë me titull “Gjykata Kushtetuese”, pjesa e nëntë me titull “Gjykatat”, pjesa e dhjetë me titull “Prokuroria”, pjesa e njëmbëdhjetë me titull “Referendumi”, pjesa e dymbëdhjetë (shfuqizuar), pjesa e trembëdhjetë me titull “Financat publike”, pjesa e katërbëdhjetë me titull “Kontrolli i Lartë i Shtetit”, pjesa e pesëmbëdhjetë me titull “Forcat e armatosura”, pjesa e

12 Ekziston një plejadë e tërë doktrinalistësh penalë, kryesisht të huaj, të cilët të frymëzuar nga parimet e të drejtës penale si një e drejtë e veprimit dhe jo e mendimit, kanë hedhur idenë, që duket se ka fituar gjithmonë e më shumë terren, se tek të gjitha veprat penale të qëllimit, pra me anë subjektive më të gjerë se sa ana objektive, pranojnë se në anën objektive të tyre ekziston edhe një element i pashkruar i anës objektive – përshtatshmëria objektive e sjelljes së autorit për të arritur qëllimin kriminal. Në këtë mënyrë këta doktrinalistë pranojnë se rikuporohet defekti i dënimit të një elementi subjektiv të pambuluar nga një element i anës objektive dhe e drejta penale qëndron në nivelin klasik të dënimit të veprimit dhe jo të mendimit. Duket se ky mendim është i saktë dhe duhet pranuar.

13 Për interpretimin e nocionit “rend kushtetues”, Simeonidu-Kastanidu, *Cënimet e rendit kushtetues*, Sakula, Athinë, 1988.

14 Për më tepër dhe në mënyrë më të detajuar Aurela Anastasi, *E drejta kushtetuese*, Shtëpia Botuese “PEGI”, Tiranë 2004.

gjastëmbëdhjetë me titull “Masat e jashtëzakonshme”, pjesa e shtatëmbëdhjetë me titull “Rishikimi kushtetues” dhe pjesa e tetëmbëdhjetë me titull “Dispozita kalimtare dhe të fundit”.

Të gjitha këto dispozita parashikojnë rregulla që kanë të bëjnë me 1-Parimet themelore, 2-Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, 3-Strukturën dhe organizimin e funksionimit të shtetit dhe 4-Dispozitat kalimtare. I gjithë ky sistem (rend), që përfshin nga njëra anë tërësinë e rregullave të parashikuara nga Kushtetuta dhe nga ana tjetër zbatimin e tyre në praktikë, në mënyrë që jeta shoqërore – politike e vendit të zhvillohet normalisht, përbën rendin kushtetues të instaluar.

Përderisa përcaktoam përmbajtjen e nocionit “rend kushtetues” është më e lehtë të përcaktojmë dhe kuptimin e “përmbysjes së rendit kushtetues”. Kështu me përmbysje të rendit kushtetues, do të kuptohet veprimtaria që eliminon rendin kushtetues të instaluar dhe vijon ose me vendosjen e një rendi të ri, ose me një gjëndje kaotike të paorganizuar.

Por gjithsesi kriteri thelbësor në përmbysjen e rendit kushtetues është fakti që jeta shoqërore – politike e vendit nuk udhëhiqet më nga rregullimet kushtetuese që ekzistojnë më parë. Është e rëndësishme të theksojmë faktin se kur flasim për përmbysje të rendit kushtetues, nuk nënkuptojmë çdo shmangie nga rregullat që parashikon Kushtetuta.

Gjatë zhvillimit normal të veprimtarisë shoqërore – politike të vendit është llogjike që mundet të shkelen rregullat, apo të çënohen funksione të parashikuara nga Kushtetuta.

Kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se bëhet fjalë për përmbysje të rendit kushtetues. Edhe vetë legjislatori kushtetues e ka patur të qartë se këto situata janë mëse të mundshme, dhe për këtë arsye ka parashikuar në Kushtetutë “rregulla të jashtëzakonshme” për të përballuar këto situata, pa u krijuar ndonjë impakt negativ për ecurinë normale të jetës shoqërore – politike të vendit. Në këtë mënyrë kur shkelen rregulla, apo çënohen funksione të parashikuara nga Kushtetuta, aktivizohen këto “rregulla të jashtëzakonshme”, që përbëjnë në një farë mënyre “valvula sigurie”, për të rivendosur dhe risjellë normalitetin në veprimtarinë e përditshme shoqërore – politike të vendit.

Nëse edhe pas aktivizimit të këtyre rregullave të jashtëzakonshme nuk arrihet normaliteti në veprimtarinë shoqërore – politike të vendit, atëherë themi se kemi të bëjmë me përmbysje të rendit kushtetues, përderisa Kushtetuta aktuale nuk mundet të “funksionojë” dhe t’i japë zgjidhje situatës së krijuar.

Kur i referohemi veprimtarisë normale shoqërore – politike të vendit nënkuptojmë përgjithësisht funksionimin normal të tre pushteteve (ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor), të institutit të Presidentit të Republikës, si arbitër i tre pushteteve, garant i kushtetues dhe simbol i unitetit të kombit, si dhe i gjithë funksioneve të tjera që parashikohen dhe rregullohen nga Kushtetuta.

Le të japim një shembull për të kuptuar më saktë gjithë sa kemi analizuar më sipër. Nëse dikush vret ose rrëmben Presidentin e Republikës, normalisht që krijon një situatë anormale dhe të çekulibruar, por kjo nuk do të thotë se ka përmbysur rendin kushtetues. Në nenin 91 pika 1 të Kushtetutës citohet se:

“Kur Presidenti i Republikës është në pamundësi të përkohshme për të ushtruar funksionet e tij ose kur vendi i tij mbetet vakant, Kryetari i Kuvendit zë vendin dhe ushtron kompetencat e tij.”

Gjithashtu në nenin 91 pika 2 të Kushtetutës citohet se:

“Në rast se Presidenti nuk mund të ushtrrojë detyrën për më shumë se 60 ditë, Kuvendi, me dy të tretat e të gjithë anëtarëve, vendos dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila vërteton përfundimisht shkakun e pamundësisë. Në rast të vërtetimit të pamundësisë, vendi i presidentit mbetet vakant dhe zgjedhja e Presidentit të ri fillon brenda 10 ditëve e vërtetimit të pamundësisë.”

Rregullat e parashikuara nga neni 91 i Kushtetutës, mundet t’i konsiderojmë si “rregulla të jashtëzakonshme”, në sensin që aktivizojnë një procedurë, për të risjellë normalitetin në një rast të jashtëzakonshëm të mundshëm. Me aktivizimin e kësaj procedure në kushte të zakonshme rivendoset normaliteti dhe jeta shoqërore – politike e vendit vijon në rregullsinë e mëparshme. Por nëse autori ose autorët ndërrmarrin edhe veprime të tjera që pengojnë këtë procedurë, p.sh. nëse vrasin ose rrëmbejnë edhe Kryetarin e Kuvendit, zëvendësit e tij, si dhe anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë që të mos arrihet zgjedhja e Presidentit

të ri, nëpërmjet kësaj procedure kushtetuese, atëherë me siguri që kemi të bëjmë me përmbyesje të rendit kushtetues.

Kjo ndodh për arsye se në këtë rast Kushtetuta aktuale nuk mundet të përballojë një situatë të caktuar dhe një prej instituteteve më thelbësore që parashikon nuk mundet të funksionojë me gjithë efektet negative që mundet të sjellë situata e krijuar.

4. Cili është rendi kushtetues i mbrojtur posaçërisht nga ligjvënësi penal?

Në të gjitha dispozitat që parashikohen në seksionin e dytë të kapitullit të pestë të pjesës së posaçme të Kodit Penal, ligjvënësi i referohet vetëm rendit kushtetues, pa ju referuar ndonjë rendi konkret. Në këtë mënyrë pyetja që lind natyrshëm ka të bëjë me faktin se cilin rend kushtetues mbron ligjvënësi me këto vepra penale? Më konkretisht në rast se Kushtetuta ndryshon, duke krijuar një rend të ri kushtetues, këto dispozita penale do të mbrojnë rendin e ri kushtetues apo rendin e mëparshëm?¹⁵ Përgjigja e kësaj pyetjeje nuk është fare e thjeshtë, për arsyen e përmëndur në vijim. Në rast se pranojmë se dispozitat për të cilat po flasim, mbrojnë çdo rend kushtetues, që eventualisht mundet të krijohet pas përmbyesjes së rendit kushtetues aktual, atëherë ekzistenca e këtyre veprave penale nuk kanë asnjë vlerë. Kjo për arsye se çdo herë që krijohet një rend kushtetues, rendi i mëparshëm automatikisht jo vetëm që nuk mbrohet, por ekziston mundësia që të zhvleftësohet dhe për rrjedhojë mbështetësit e tij të dënohen. Edhe në rast se pranojmë që këto dispozita mbrojnë rendin kushtetues aktual, atëherë lind pyetja si do të zbatohen këto dispozita të cilat ka mundësi në kushtet e reja të krijuara të mos merren parasysh si dispozita që vijnë në kundërshtim të hapur me rendin e ri të krijuar.

Në rastin e fundit ekziston edhe një argument tjetër, si është e mundur të “ngrijmë” zhvillimin politik në një shoqëri, duke kërcënuar njëkohësisht me sanksione penale çdo “mendim reformator”, duke konsideruar apriori se rendi kushtetues aktual është më perfekt dhe vetëm këtë rend duhet të mbrojmë.

¹⁵ Për më tepër në lidhje me këto problematika Sokol Mëngjesi, *Interpretimi sistematik i pjesës së posaçme të Kodit Penal shqiptar, krahasuar me doktrinën penale greke*, Sakula, Athinë, 2011.

Historia e njerëzimit ka treguar se sistemet politike të organizimit shoqëror kanë qënë dhe janë në evoluim të vazhdueshëm, në kërkim të “drejtësisë absolute”, që është dhe synimi i shkencave juridike, por i destinuar në “dështim”, sepse drejtësia absolute ka qënë dhe do të jetë një nocion relativ, të cilit shkencat juridike vetëm t’i afrohen munden. Ky diskutim dhe analiza e hollësishme e këtij debati i tejkalon kufijtë e kësaj teme dhe besojmë edhe të vetë shkencave juridike.

Gjithsesi duke patur parasysh dilemat e shtruarra për debat dhe nevojën e marrjes së një pozicioni në lidhje me këtë debat arrijmë në këto konkluzione.

Nevoja e mbrojtjes së rendit kushtetues aktual është padyshim një e dhënë e pakontestueshme, sepse nuk mundet të pretendojmë që ekzistenca e dispozitave penale për të cilat po flasim është pa kurrfarë vlere. Nga ana tjetër nevoja e perfeksionimit të rendit kushtetues konsiderohet e drejtë dhe ndoshta proces domosdoshmërisht i nevojshëm. Për këtë arsye konsiderohet më i saktë mendimi që të pranojmë se me këto dispozita mbrohet rendi kushtetues aktual dhe çdo rend tjetër i krijuar më vonë, por me një kusht që ky rend të krijohet me një procedurë të ligjshme, të bazuar në rendin kushtetues aktual, i cili gradualisht mundet të ndryshojë në një masë të tillë saqë mos të ketë më asgjë të ngjajshme me rendin mbi të cilin është bazuar.

Nisur nga konkluzioni në të cilin sapo arritëm duhet të theksojmë edhe disa gjëra të tjera që kanë të bëjnë si me dimensionet e mbrojtjes së rendit kushtetues, ashtu edhe me garancitë që duhet të ketë çdo qytetar shqiptar në lidhje me bazat e rendit kushtetues demokratik. Rendi kushtetues në bazë të veprave penale të parashikuar në këtë seksion mbrohet vetëm si unitet, pra i gjithë rendi në tërësi. Jemi të mendimit se ekziston nevoja e mbrojtjes jo vetëm e gjithë rendit në tërësi, por edhe e elementëve të veçantë dhe thelbësor të rendit kushtetues të cilat në një farë mënyre mundet t’i konsiderojmë edhe si bazat e rendit kushtetues aktual. Të tillë elementë mundet të konsiderojmë si institute politike të një rëndësie të veçantë të parashikuara nga Kushtetuta, ashtu edhe parime thelbësore mbi bazën e të cilave është i ndërtuar rendi aktual kushtetues.

Kjo për arsye sepse destabiliteti i rendit kushtetues krijohet dhe ky i fundit çënohet rëndë edhe në rast se çënohet institute apo parime thelbësore të rendit kushtetues. Në këtë aspekt nuk ka arsye pse ligjvënësi penal mos të dënojë një person apo grup personash të cilët dëmtojnë rëndë një institut të veçantë politik në funksionet e tij p.sh. Parlamentin apo Presidentin e Republikës. Nuk ka asnjë arsye pse ligjvënësi penal mos të parashikojë edhe forma të tjera që çënojnë themelet e rendit kushtetues, por të mjaftohet në dënimin vetëm të përpjekjeve për të përmbysur rendin kushtetues në total. Në legjislacione të tjera të botës mbrohet rendi kushtetues jo vetëm në total, ashtu sikundër e mbron edhe ligjvënësi ynë, por mbrohen edhe institute të veçanta të rendit kushtetues, p.sh. është e parashikuar në kuadrin e veprave kundër rendit kushtetues tentativa e vrasjes së Presidentit të Republikës, të Kryeministrit apo të Kryetarit të Kuvendit, pengimi i Presidentit të Republikës, të Kryeministrit apo të Kryetarit të Kuvendit, të ushtrojnë funksionet e tyre kushtetuese, dënohet gjithashtu uzurpimi me dhunë i këtyre funksioneve kushtetuese edhe në rast se këto veprime nuk krijojnë asnjë rrezik për përmbysjen e rendit kushtetues në total. Kjo ndodh për arsye se siç u theksua edhe më sipër këto veprime pavarësisht se nuk vënë në rrezik përmbysjen e rendit kushtetues në total, krijojnë një destabilitet serioz në jetën politike të vendit, gjë të cilën pa dyshim që e mbron ligjvënësi penal nëpërmjet parashikimit të veprave dhe sanksioneve penale. Duhet të theksojmë faktin se shumica e këtyre veprimeve janë të parashikuara si të dënueshme edhe në Shqipëri, si p.sh. tentativa e vrasjes së Presidentit të Republikës, së Kryeministrit apo të Kryetarit të Kuvendit, por në sanksione të tjera të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal¹⁶. Të njëjtën gjë mundet të themi edhe për uzurpimin e institucioneve të rëndësishme politike. Fakti i parashikimit të këtyre veprimeve në seksione apo kapituj të tjerë të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal të krijojnë përshtypjen se me këto veprime nuk çënohet rendi kushtetues, por benefite të tjera juridike, që përbëjnë objekt parësor mbrojtjeje në

16 Kemi përshtypjen se këto veprime të kundraligjshme dhe penalisht të dënueshme do të duhet të specifikoheshin më mirë edhe në kuadrin të faktit se kur kryhen personalisht ndaj këtyre personave dhe kur kryhen ndaj këtyre personave që personalizojnë pushtetin nëpërmjet funksioneve kushtetuese që ata kryejnë, Schultz, *Der strafrechtliche Begriff der Gewalt*, Schw.Z.St., 1952.

seksionet apo kapitujt përkatës. Të krijohet përshtypja se midis benfitive të tjera juridike dhe rendit kushtetues ligjvënësi penal ka konsideruar se prevalon mbrojtja e benifitit tjetër juridik ndaj rendit kushtetues. Në këtë këndvështrim për arsye sistematike, por edhe doktrinale do të konsiderohej më e drejtë përmbledhja e të gjitha këtyre veprimeve dhe parashikimi i tyre në seksionin e veprave penale kushtetuese, qoftë edhe në mënyrë sinjifikative. Në këtë mënyrë mbrojtja penale ndaj rendit kushtetues do të konsideroj sigurisht më e plotë dhe më efektive. Rast tjetër tipik është edhe kategoria e veprave penale kundër zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, të cilat janë të parashikuara të veçuara nga veprat kundër rendit kushtetues në një tjetër kapitull.

Këto vepra pa dyshim që mbrojnë sistemin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike, por nga ana tjetër nuk mundet të mohohet fakti se këto vepra në fundit të fundit çënojnë bazën e rendit kushtetues demokratik.

Më sipër ne shtruan problemin e rendit kushtetues konkret që mbrohet me anë të këtyre veprave penale dhe arritëm në përfundimin se nga mënyra e formulimit të këtyre veprave, ligjvënësi penal padyshim që mbron rendin aktual kushtetues, por edhe çdo rend tjetër juridik të përmirësuar dhe të ndryshuar. Në këtë pikë do të donim të theksonim se pavarësisht se zgjidhja që dhamë është më optimalja, në kushtet konkrete do të duhej që të paktën ligjvënësi penal disa parime thelbësore të rendit kushtetues demokratik t' i kishte parashikuar edhe në ligjin penal. Kjo nevojë bëhet akoma edhe më e evidente po të marrim në konsideratë faktin që në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë nuk ekzistojnë dispozita të ngajshme si në vende të tjera të zhvilluara demokratike, ku parashikohet se disa dispozita që përbëjnë themelet e rendit kushtetues demokratik janë të pandryshueshme dhe përbëjnë të ashtëquajturat “bërthamat e forta kushtetuese”. Reflektimi ndaj këtyre mendimeve besojmë se është domosdoshmëri dhe besojmë detyrë si e ligjvënësit penal ashtu edhe e ligjvënësit kushtetues, po të marrim në konsideratë faktin se sa të shpeshta dhe sa të thella kanë qënë ndryshimet kushtetuese që në një farë mënyre e kanë ndryshuar shpesh fizionominë e rendit kushtetues në Shqipëri.

Kjo situatë besojmë se më tepër se sa destabiliteti që krijon

në jetën politike organizative të vendit, krijon burime të forta rreziku për ndryshim total të sistemit, duke e lënë të ekspozuar haptazi rendin kushtetues pa kurrfarë mbrojtje. Në këtë aspekt kemi mendimin se dispozita garantuese të Kushtetutës, të cilat duhen të parashikohen edhe si të pandryshueshme, paraqiten si nevojë emergjente në vendin tonë, duke garantuar në këtë mënyrë sistemin nga luhajtjet e vullnetit politik të momentit.

Bibliografia

1. **Aurela Anastasi**, *E drejta kushtetuese*, Shtëpia Botuese “PEGI”, Tiranë 2004
2. **Dionisis Spinellis**, *Die Entwicklung des griechischen Strafrecht in den letzten dreibig Jahren*, ZStW, 1983
3. **Fehmi Abdiu**, *Mbi figurën e Kryetarit të Shtetit në Shqipëri*, Avokatia 4-5, Tiranë 2013
4. **Ismet Elezi**, *E drejta penale zakonore e shqiptarëve*, Tiranë 1983
5. **Ismet Elezi**, *Zhvillimi historik i legjislacionit penal në Shqipëri*, Shtëpia Botuese “albin”, Tiranë, 1997
6. **Ismet Elezi**, *E drejta penale e Republikës së Shqipërisë, Pjesa e Posaçme*, Shtëpia Botuese “albin”, Tiranë, 1999
7. **Ismet Elezi**, *Mendimi juridik shqiptar*, Shtëpia Botuese “albin”, Tiranë, 1999
8. **Ismet Elezi**, *E drejta penale, Pjesa e Posaçme*, Shtëpia Botuese “Erik”, Tiranë, 2007
9. **Ismet Salihu, Ismet Elezi**, *Zhvillimi historik i legjislacionit penal në Shqipëri*, Studime Juridike 2009
10. **Simeonidu-Kastanidu**, *Cënimet e rendit kushtetues*, Sakula, Athinë, 1988
11. **Schultz**, *Der strafrechtliche Begriff der Gewalt*, Schw. Z. St., 1952
12. **Sokol Mëngjesi**, *Interpretimi sistematik i pjesës së posaçme të Kodit Penal shqiptar, krahasuar me doktrinën penale greke*, Sakula, Athinë, 2011

SELEKTIVITETI MATERIAL, SI ELEMENT I PËRCAKTIMIT TË NDIHMËS SHTETËRORE QË CËNON TREGUN E LIRE¹ (PJESA E PARË)

LLM, Fjoralba Caka

1. Vështrim i përgjithshëm

Një nga shtyllat kryesore të Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Europian (referuar në vijim si MSA)², e cila përkon edhe me një nga kriteret e Kopenhagenit për vendet që duan të anëtarësohen në BE, është krijimi i një tregu funksional, ku veprojnë rregullat e konkurrencës dhe tregut të lirë.

Në këtë drejtim vet MSA përmban një sërë parashikimesh për liberalizimin e tregut midis Bashkimit Europian dhe Shqipërisë, parashikime për të garantuar një konkurrencë të lirë midis operatorëve privat, si edhe parashikime që ndalojnë ndërhyrjen e shtetit në ekonomi, kur kjo prish rregullat e tregut dhe konkurrencës. Reformat në këtë drejtim janë të rëndësishme dhe suksesi në realizimin e tyre do të kontribuojë në avancimin e proceseve integruese të vendit. Ky punim do të ketë në fokus ndihmën shtetërore, si një nga detyrimet që burojnë prej MSA, dhe vecanërisht një nga elementet e tij, selektivitetin. MSA parashikon ndalimin e ndihmës shtetërore që shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën, duke favorizuar

¹ Një falenderim i posaçëm për këtë artikull shkon për Institutin Max Planck for Comparative and Private International Law, në Hamburg, pranë të cilit është bërë kërkimi shkencor për punimin në këtë fushë, si edhe Prof. Christa Jessel-Host për të gjithë ndihmën dhe mbështetjen e dhënë. Trajtimi dhe përfundimet në këtë punim, janë të autorit dhe nuk lidhen me qëndrime zyrtare të Institutit.

² Ligji Nr.9590 Pwr Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë Komuniteteve Europiane dhe Shteteve Anetare te tyre”, Fletore Zyrtare Nr.87, fq. 2955

ndërmarrje të caktuara ose prodhime të caktuara.³

Për më tepër, MSA jo vetëm sanksionon se duhet të ndalohen praktikatat e ndihmës shtetërore që shtrëmbërojnë rregullat e konkurrencës, por vendos edhe një standard përkundrejt të cilës do të vlerësohen këto praktikata. Neni 71(2) i MSA-së parashikon se vlerësimi i ndihmës shtetërore në kundërshtim me MSA, do të bëhet sipas nenit 107 të Traktatit për Funkzionimin e Bashkimit Europian (TFBE) si edhe praktikës së Bashkimit Europian për interpretimit të këtij neni.⁴ Kjo do të thotë se praktikatat interpretuese të Gjykatave të Bashkimit Europian si edhe Komisionit të Bashkimit Europian për nenin 107 TFBE, janë të rëndësishme të ndiqen që në këtë fazë të para-anëtarësimit, çka e bën njohjen e praktikës në këtë drejtim të rëndësishme për praktikuesit dhe studiuesit e kësaj fushe.

Me qëllim kontrollin dhe autorizimin e ndihmës shtetërore u ngrit me vendim të Këshillit të Ministrave⁵ në 2006 Komisioni i Ndihmës Shtetërore⁶. Ky organ kontrollon nëse një ndihmë shtetërore është e paligjshme apo jo, urdhëron rikthimin tek organet shtetërore të ndihmës shtetërore të dhënë, kur kjo ndihmë është cilësuar e paligjshme, përgatit raporte vjetore për Komisionin e Bashkimit Europian si edhe organizatat e tjera ndërkombëtare lidhur me ndihmën shtetërore që ka dhënë Shqipëria, si edhe autorizon dhënien e ndihmës shtetërore.

Sipas nenit 71(2) të cituar më sipër, praktikatat e ndihmës shtetërore duhet të vlerësohen në bazë të nenit 107 TFBE, si edhe instrumenteve interpretuese të BE lidhur me këtë nen. Kjo do të thotë se vet Komisioni i Ndihmës shtetërore duhet të kushtojë kujdes vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian, i cili ka ekskluzivitetin e interpretimit të Traktateve të BE, si edhe udhëzimeve të Komisionit në interpretimin e këtij neni.

³ Neni 71(1)(iii) i Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë Komuniteteve Europiane dhe Shteteve Anetare të tyre. Ligj Nr.9590, datë 27.07.2006, Flet.Zyrtare Nr.87, fq. 2955

⁴ Neni 71(2) i MSA: "2. Praktikatat në kundërshtim me këtë nen do të vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet ... 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Europian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit." Neni 87 i Traktatit Themelues i Komunitetit Europian, është tani neni 107 i Traktatit për Funkzionimin e Bashkimit Europian (Traktati i Lisbonës)

⁵ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.182, datë 21.3.2006, Fletore Zyrtare Nr.0, fq.30

⁶ Në fakt ngritja e Komisionit të Ndihmës Shtetërore u parashikua që me Ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", edhe pse ngritja e tij u bë një vit më vonë me vendim të Këshillit të Ministrave.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë shkurtimisht nocionin e ndihmës shtetërore sipas nenit 107(1) TFBE, duke u ndalur më specifikisht tek elementi i selektivitetit, si element thelbësor për ndihmën shtetërore.

2. Nocioni i ndihmës shtetërore që shtrëmbëron tregun dhe konkurrencën e lirë (neni 107(1) TFBE)

Akademikët, bazuar në jurisprudencën e Gjykatave të BE dhe praktikën e Komisionit të BE kanë artikuluar pesë kritere për të identifikuar nëse një masë shtetërore bie në lëmin e zbatimit të Nenit 107(1) TFBE:⁷ Këto janë: (i) Ndhimja duhet të jepet nga shteti apo nga burime shtetërore (ii) Ndhimja duhet ti japë një avantazh ekonomik marrësit (iii) Ndhimja duhet të jetë selektive (iv) Ndhimja duhet të prekë tregtinë midis Shteteve Anëtare (iv) Ndhimja duhet të prekë konkurrencën në tregun e përbashkët European. Këto kritere janë kumulative, që do të thotë se duhet të ekzistojnë të gjitha së bashku në mënyrë që një ndihmë të cilësohet si e papajtueshme me Traktatin.⁸

2.1. Ndhimja shtetërore jepet nga shteti ose nëpërmjet burimeve shtetërore

Elementi i parë thelbësor i ndihmës shtetërore është që subjekti që e jep atë është një nga shtetet anëtare. Koncepti i “shtetit anëtar”, në nenin 107(1) TFBE është interpretuar në mënyrë të zgjeruar. Gjykata e Drejtësisë është shprehur se ndihma e dhënë nga organet rajonale dhe lokale të shteteve anëtare, cilido qoftë statusi i tyre, konsiderohen ndihma shtetërore për zbatimin e Traktatit.⁹ Gjykata ka shkuar më tej në vendimin e saj *C-78/76, Steinike dhe Weinlig*, ku është shprehur se kur është çështja tek subjekti që jep ndihmën, nuk është e nevojshme të bëhet dallimi nëse ndihma jepet drejtpërdrejt nga shteti, apo në mënyrë të

⁷ Nicolaidis, Phedon, Mihalis Kekelekis, and Philip Buyskes. *State aid policy in the European Community: A guide for practitioners*. Vol. 16. Kluwer law international, 2008, fq. 10; Quigley, Conor, and Anthony M. Collins. *EC State aid law and policy*. Hart Pub, 2003, fq.32; Bacon, Kelyn. *European Community law of State aids*. Oxford University Press, 2009, fq. 24

⁸ Biondi, Andrea, Piet Eeckhout, and James Flynn, eds. *The law of state aid in the European Union*. Oxford University Press, 2004. fq 5

⁹ Çështja C-248/84, Republika Federale e Gjermanisë k. Komisionit [1987] RGJE 4013, para. 17

tërthortë nga organet publike ose private të themeluara, ose të emëruar nga shteti për administruar ndihmën.¹⁰

Kjo do të thotë se neni 107 (1)TFBE zbatohet për dhënien e ndihmave që janë në diskrecionin e shtetit, pa qenë e nevojshme për të bërë një dallim nëse ndihma jepet nga agjentët e shtetit apo ndërmarrjeve të kontrolluara nga shteti.¹¹

Nga ana tjetër, ndihma shtetërore kërkon edhe transferim të burimeve shtetërore. Gjykata është shprehur se në mënyrë që të ketë një transferim të burimeve publike, dhënia e ndihmës nga shteti duhet të prekë buxhetin e autoritetit public.¹²

Me fjalë të tjera, ndihma e dhënë duhet të ketë pasojë buxhetore për shtetin. Përparësia ekonomike që ndërhyrja shtetërore i jep ndërmarrjeve, sipas nenit 107(1) TFBE, duhet të financohet nga burime shtetërore. Transferim, për efekt të nenit 107(1) TFBE do të konsiderohet, jo vetëm kur në kuptimin e parë të fjalës transferohen burime financiare nga shteti tek ndërmarrjet, por edhe në ato raste kur shteti merr përsipër detyrime të mundshme financiare për të ndihmuar ndërmarrje të caktuara.¹³ Edhe pse neni 107(1) TFBE thotë “ndihmë e dhënë nga shteti ose nëpërmjet burimeve shtetërore”, GJED e ka bërë të qartë se lidhësa “ose”, në kundërshtim me atë çfarë mund të thonë rregullat gramatikore- është kumulative dhe jo alternative.¹⁴ Siç rezulton nga praktika gjyqësore këto janë dy kushte të veçanta dhe kumulative: pra, ndihma e dhënë jo vetëm që duhet ti atribuohet shtetit, por ndërhyrja shtetërore duhet të përfshijë një transferim të burimeve shtetërore.

Në qoftë se vetëm një prej këtyre kushteve është plotësuar, masa nuk do të konsiderohet ndihmës shtetërore.¹⁵

10 Çështja C-78/76 *Firma Steinike und Weinlig k. Republikws Federale tw Gjermanisw* [1977] RGJE 595, para. 21

11 Çështja C-290/83, *Komisioni k. Republikws sw Francws* [1985] RGJE 439, para 14

12 P. Nicolaides et al., “State Aid Policy in the European Community”, op.cit.supra, fq. 12.

13 Shih Njofitimn e Komisionit “*Pwr Zbatimin e Rregullave tw Ndhimws Shtetwrore Pwr Zbatimin e Masave qw Lidhen me Taksimn Direkt tw Bizneseve*”, FZ C 384, 10.12.1998, parag.10

14 Wishlade, Fiona and Rona Michie. “Pandora’s box and the Delphic oracles: EU cohesion policy and state aid compliance. European Policy Research Paper, 2009, fq. 5

15 Heidenhain, Martin, ed. *European state aid law*: Beck, 2010, fq. 33; Bacon, Kelyn. *European Community law of State aids*, op.cit.supra, fq.69

2.2. Ndihma shtetërore i jep një avantazh (ekonomik) marrësit

Lidhur me nocionin e “avantazhit”, Gjykata e Drejtësisë është shprehur se koncepti i ndihmës mbulon një gamë të gjerë masash, të tilla si subvencionet, grantet, kreditë apo garancitë e dhëna nga shteti. Ndihma shtetërore konsiston në një avantazh të dhënë nga autoritetet publike për një ndërmarrje, pa kundërpaguesë, ose kundrejt një pagese e cila nuk i korrespondon vlerës së avantazhit të përfituar (ndërhyrje positive e shtetit). Nga ana tjetër, Gjykata është shprehur se edhe ato edhe ato masa që zbusin barrën financiare që një ndërmarrje do të mbante në kushtet normale të tregut, do të konsiderohen ndihma shtetërore në bazë të nenit 87 (1) (e ashtuquajtura ndërhyrje negative).¹⁶ Raste të tilla të ndërhyrjes negative të shtetit mund të përmendim: furnizimin e mallrave apo shërbimeve në një normë preferenciale, reduktim të kontributit të sigurimeve shoqërore për ndërmarrje të caktuara, përjashtimet tatimore, produktet dhe shërbimet që shteti i shet me çmime tepër të ulëta, si edhe çdo përparësi ekonomike që shteti i pa patur arsye objektive

2.3. Ndihma duhet të favorizojë disa ndërmarrje apo prodhimin e disa produkteve të caktuara (kriteri selektivitetit)

Një masë shtetërore do të konsiderohet selektive kur ajo favorizon një grup të caktuar ndërmarrjesh, një sektor të ekonomisë, apo një zonë të caktuar gjeografike, apo prodhimin e disa produkteve të caktuara. Selektiviteti mund të jetë material ose gjeografik.¹⁷ **Selektiviteti material** konsiderohet si një ndihmë që i jepet ndërmarrjeve të caktuara, një sektori të caktuar, apo një industrije të caktuar. Raste të tjera të selektivitetit material mund të konsiderohet edhe ndihmat e dhëna ndaj një grupi ndërmarrjesh për shkak të karakteristikave të përbashkëta që ato kanë, si psh. përmasat e aktivitetit, biznes i vogël apo i

¹⁶ See P. Nicolaidis et al., “State Aid Policy in the European Community”, ibid. fq. 21- 22

¹⁷ Wishlade, Fiona. *When are tax advantages state aids and when are they general measures?* Europ. Policies Research Centre, University of Strathclyde, 1997. fq. 10

madh, apo karakteri ndërkombëtar i ndërmarrjeve, apo natyra dhe tipi i aktiviteteve që ato kryejnë.¹⁸

Nga ana tjetër, Gjykata ka njohur si raste të selektivitetit material masat që favorizojnë produktet kombëtare të destinuar për eksport¹⁹, taksat favorizuese për qëndrat e koordinimit²⁰ apo masa favorizuese në fushën e punësimit për ndërmarrje të caktuara²¹ etj.

Selektiviteti gjeografik konsiston në ato raste kur ndihma i është dhënë një ndërmarrjeje të lokalizuar në një rajon të caktuar ose në një zonë të caktuar.²² Kështu psh, një skeme shtetërore që parashikonte se ndërmarrjet do të përfitonin lehtësim nga taksat, nëse ishin regjistruar në një zonë të caktuar, dhe ri-investonin përfitimet e tyre tërësisht apo pjesërisht na atë zonë, është konsideruar si selective dhe në kundërshtim me nenin 107(1) TFBE.²³

2.4. Ndhimja shtetërore prek tregtinë midis shteteve anëtare

Sipas jurisprudencës së Gjykatës së Drejtësisë, do të konsiderohet se ndihma ka prekur tregtinë midis vendeve anëtare, atëherë kur ndihma financiare e shtetit përforcon pozitën e një ndërmarrjeje në krahasim me ndërmarrjet e tjera konkurruese në tregun e përbashkët.²⁴ Pra, nëse pozita konkurruese dhe shkëmbimi tregtar i mallrave dhe shërbimeve për ndërmarrjen

18 Vendim i Komisionit 2003/81/KE i 22 Gushtit 2002 Për implementimin e skemave të ndihmës shtetërore në Spanjë, për qëndrat e koordinimit në Vizcaya C-48/2001, FZ L 31, 6.2.2003, pp. 26–31, para. 11–12 and 32; Vendim i Komisionit 2003/755/KE, 17 shkurt 2003 për skemat e ndihmës shtetërore të zbatuara në Belgjikë për koordinimin e qendrave të Belgjikës, FZ L 282, 30.10.2003, fq. 25–45, para. 13 dhe 104.

19 Çështja C-6-11/69 *Komisioni k. Francës*; Çështja C-57/86 *Greqia k. Komisionit*, RGJE 2855. Shih edhe: Çështja Bacon, Kelyn, op.cit. para. 2.118, fq84

20 Çështja C-182 dhe 217/03 *Belgjika dhe Forum 187 k. Komisionit*, [2006], RGJE I-5479.

21 Çështja T-239 and 323/04 *Italia dhe Brandt k. Komisionit*, [2002] RGJE II-4259, para 53,

22 Bacon, Kelyn. *European Community Law of State Aids*. Oxford University Press, 2009. Para. 2.116, fq.83; C-248/84 *Gjermania k. Komisionit*, 1987, RGJE 4013, Çështja T-308/00 *Salzgitter k. Komisionit*, 2004, para.38, lënë në fuqi në me vendimin e apelit C-408/04 P *Komisioni k. Salzgitter para 119*

23 Çështja N-96/2000, Vendim i Komisionit i datës 28.6.2000 (OJ C 266, 16.9.2000). Raporti XXX-të për Politikën e Konkurrencës 2000; Çështje të tjera të selektivitetit gjeografik mund të përmendim: C-88/03, *Republika e Portugalisë k. Komisionit të Komuniteteve Europiane (çështja e Azoreve)* [2006], RGJE I-07115; Çështja C-211/04, *Qeveria e Gjibraltarit, Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda e Veriut k. Komisionit të Komuniteteve Europiane*, [2008], RGJE II-03745; Çështja C-428-434/06, *Unión General de Trabajadores de La Rioja (UGT-Rioja) dhe të tjerë k. Juntas Generales del Territorio Histórico de Vizcaya*, [2008] RGJE I-06747 etj.

24 Çështja C-730/79 *Philip Morris k. Komisionit* [1980] RGJE 2671, para.11

që merr ndihmë shtetërore është rritur, apo nëse është ulur niveli i tregtisë për ndërmarrjet e tjera konkurruese për ndërmarrjet që nuk janë përfshirë në skemën e ndihmës, ndërhyrja do të konsiderohet ndihmë shtetërore në kundërshtim me nenin 107(1) TFBE²⁵.

Megjithatë, sikundër edhe në disiplin të tjera, edhe në përcaktimet e ndihmës shtetërore vlen parimi i vjetër romak “*de minimis non curat lex*”. Për këtë arsye, Komisioni është i angazhuar në hartimin e udhëzimeve mbi pragjet dhe kushteve të tjera se kur një ndihmë konsiderohet “*de minimis*” dhe, si i tillë, përjashtohet nga zbatimi i nenit 87 (1).²⁶

2.5. Ndihma shtetërore shtrembëron konkurrencën e lirë

Gjykata, në çështjen *Belgjika k. Komisionit*, ka deklaruar se „konsiderohet se konkurrenca është shtrembëruar, në qoftë se ndihma në fjalë ka forcuar pozicionin konkurrues të marrësit në raport me konkurrentët e saj”²⁷. Kjo do të thotë se gjykata do të marrë parasysh pozitën e ndërmarrjes përfituese para marrjes së ndihmës dhe pas saj, e në qoftë se kjo pozitë është përmirësuar, atëherë ndihma do të konsiderohet në kundërshtim me nenin 107(1) TFBE.²⁸ Gjykata nuk ka pranuar argumentet të palëve të tipit, ndërmarrja ka vuajtur nga disavantazhet e tjera dhe se ndihma thjesht kërkoi të minimizonte këto avantazhe e ta sillte ndërmarrjen në një pozitë të barabartë me të tjerat.²⁹

Kështu, do të konsiderohet se ndërhyrja e shtetit ka prodhuar efekte çrregulluese për konkurrencën, edhe në rastet kur ndihma nuk e përmirëson në terma absolutë pozicionin e ndërmarrjes në lidhje me konkurrentët e saj, por thjesht e sjell ndërmarrjen përfituese në një pozitë të barabartë me ndërmarrjet e tjera që operojnë treg.³⁰ Për më tepër, neni 107(1) TFBE kap edhe ato masa që kërcënojnë të shtrembërojnë konkurrencën“, kështu që çdo masë e shtetit që **faktikisht ose potencialisht** çrregullojnë

25 Quigley, Conor, and Anthony M. Collins. *EC State aid law and policy*. Hart Pub, 2003, fq. 55

26 Shih: Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 1998/2006 15 Dhjetor 2006, “Mbi zbatimin e nenit 87 dhe 88 të Traktatit dhe ndihmës de minimis” FZ. L 379, 28.12.2006

27 Çështja C- 234/84, *Belgjika k. Komisionit* [1986] ECR 2263, para 22

28 Quigley, Conor, and Anthony M. Collins. *EC State aid law and policy*. op.cit. fq. 51

29 P. Nicolaidis et al., “State Aid Policy in the European Community”, ibid., pg 40, para 4.

30 Çështja C-173/73, *Republika e Italisë k. Komisionit të Komuniteteve Evropiane* [1974], RGJE 00709

konkurrencën do të jetë në kundërshtim me Traktatin.³¹

Neni 107(1) TFBE për më tepër ndalon edhe ato masa që kanë predispozitën për të ndryshuar kushtet e konkurrencës në të ardhmen. Kjo nuk do të thotë se ekziston ndonjë prezumim, në bazë të të cilit një masë është automatikisht e papajtueshme me Traktatin, pasi çdo masë duhet të shqyrtohet për të parë efektin e saj në treg, nëse masa ka ndryshuar ose mund të ndryshojnë kushtet normale të konkurrencës ndërmjet ndërmarrjeve.

Gjykata e Drejtësisë ka deklaruar në mënyrë të qartë se Komisioni ka detyrimin për të provuar, rast pas rasti, se ndërhyrja publike në favor të një ndërmarrjeje në fakt ka, ose mund të ketë shtrembëruar në të vërtetë konkurrencën.

3. Sektiviteti si element thelbësor i ndihmës shtetërore

3.1. Dallimi midis masave me karakter selektiv dhe masave të përgjithshme të politikës ekonomike

Duke qënë se selektiviteti është një nga kushtet bazë që një masë të konsiderohet si ndihmë shtetërore, rrjedh se masat me karakter të përgjithshëm ekonomik, nuk do të ndalohen nga neni 107(1) TFBE. Në praktikën e Komisionit dhe Gjykatës shpesh ka patur debat nëse një masë e caktuar ka karakter selektiv apo të përgjithshëm, dhe sado i lehtë mund të tingëllojë ndryshimi, shpesh në praktikë vija ndarëse është shumë e hollë.

Një masë e politikës së përgjithshme ekonomike është konsideruar një masë nga e cila përfitojnë të gjitha ndërmarrjet në një territor, pa dallim, dhe që zbatohen në mënyrë uniforme.³² Si masa me karakter të përgjithshëm mund të përmendim psh. taksat të cilat zbatohen mbi të gjithë agjentet ekonomikë në një shtet anëtar. Nga ana tjetër Gjykata e Drejtësisë ka sqaruar se numri i madh i ndërmarrjeve përfituese nuk e bën masën selektive. Kështu, në çështjen *Maribel*³³ Gjykata e Drejtësisë shqyrtoi nëse një masë shtetërore e cila parashikonte se ndërmarrje të caktuara përfitonin reduktim të kontributeve të sigurimeve shoqërore, do të konsiderohej si selektive.

31 Heidenhain, Martin, ed. *European state aid law*. op.cit. fq. 55-56

32 Bacon, Kelyn. op.cit. supra, para 2.122, fq 85

33 Çështja C-75/97 *Mbretëria e Belgjikës k. Komisionit* ('Maribel') [1999] RGJE I-3671

Nga skema në fjalë përfitonin shumë ndërmarrje në sektorë të ndryshëm, si psh industria kimike, industria metalurgjike dhe ato të përpunimit të metalit, një numër i madh industrish transporti ndërkombëtar, përshtirë transportin detar dhe ajror, industria e fruta-perimeve (*hortikultura*) apo pyjëtaria.

Megjithatë, Gjykata vendosi se “as numri i madh i ndërmarrjeve përfituese, as diversiteti dhe rëndësia e sektorëve të industrisë ku bëjnë pjesë këto ndërmarrje, nuk e bën masën në fjalë masë të përgjithshme të politikës ekonomike.”³⁴

Nga ana tjetër, në çështjen *CETM*, GJED ka thënë se nuk përjashtohet që një masë e përgjithshme shtetërore të konsiderohet si ndihmë selektive dhe specifike, nëse metoda e zbatimit të saj i jep një avantazh ndërmarrjeve të caktuara apo prodhimit të mallrave të caktuar, duke përjashtuar ndërmarrjet tjera nga përfitimi”³⁵ Komisioni është shprehur po ashtu se, edhe ndihmat që potencialisht janë të hapura për të gjitha ndërmarrjet, mund të konsiderohen si ndihmë shtetërore, nëse autoritetet publike veprojnë mbi baza diskrecionare, dhe përcaktojnë rast pas rasti nëse/dhe në çfarë shkalle mund të përfitojnë ndërmarrjet nga masa.³⁶ Ky arsytim u soll për herë të parë në çështjen *Kimberly Clark*³⁷. Këtu, edhe pse ndihma e dhënë nuk kufizohet vetëm për ndërmarrje të vecanta, skema në vetvete u konsiderua selektive pasi autoriteti shtetëror kishte diskrecionin të vendoste dhe të ndryshonte disa elementë të skemës lidhur me ndërmarrjet përfituese, si psh shuma e ndihmës dhe kushtet në të cilat ajo përfitohet.³⁸

GJED në këto raste ka theksuar se nuk ishte e domosdoshme të provohej se sjellja e shtetit ishte abuzive, por mjaftonte të tregohej se organi shtetëror ka efektivisht diskrecionin për të

34 Çështja C-75/97 *Mbetëria e Belgjikës k. Komisionit* (“Maribel”) [1999] RGJE I-3671, para 32

35 Heidenhain, Martin, ed. *European state aid law*. Beck, 2010, para 64, fq. 46

36 Heidenhain, Martin, ed. *European state aid law*. op.cit. para 65, fq 47

37 Çështja C-241/94 *Franca k. Komisionit*, 1996, RGJE I-4551, para 23, 24.

38 Ky vendim u pasua nga të tjerë: Çështja C-256/97, *Déménagements-Manutention Transport SA (DMT)* [1999], RGJE I-03913, para 27; Çështja C-480/98 *Spanja k. Komisionit (Magefesa)*, RGJE I-08717, para 19, Çështja T-36/99, *Lenzing AG k. Komisionit të Komuniteteve Europiane* [2004], RGJE II-03597, para 129-33; T-152/99 *Hijos de Andrés Molina, SA (HAMS) k. Komisionit të Komuniteteve Europiane* [2002], RGJE II-03049, para 157, Çështjet T-92 dhe T-103/00, *Territorio Historico de Álava-Diputacion Foral De Álava k. Komisionit*, RGJE II-1390, para 31; C-295/97, *Industrie Aeronautique e Meccaniche Rinaldo Piaggio SpA v International Factors Italia SpA (Piaggio)* [1999] RGJE I-03735, para 39, C-200/97 *Ecotrade Srl v Altiforni e Ferriere di Servola SpA* [1998], RGJE I-07907, para 40, C-241/94 *Republika e Francës k. Komisionit të Komuniteteve Europiane* [1996], RGJE I-04551 para 23

vendosur lidhur me dhënien e ndihmës dhe kushtet për dhënien e saj.³⁹

Si përfundim mund të themi se, edhe për të dalluar një masë selektive nuk ka rëndësi numri i ndërmarrjeve përfituese, sektorëve, fakti nëse skema është e hapur apo jo për të gjithë.

Ajo që ka rëndësi është efekti: një ndërhyrje është selective vetëm nëse ajo i shtrin efektet tek një numër i caktuar ndërmarrjes apo në një sektorë të caktuar, apo për disa produkte të caktuara.⁴⁰ Nëse ndërhyrja shtetërore nuk i jep përparësi një ndërmarrje të caktuara apo një sektori të caktuara, në krahasim me ndërmarrje apo sektorë të tjerë, atëhere ajo nuk e dëmton konkurrencën apo tregun, si rrjedhojë nuk do të bjerë brenda fushës së zbatimit të nenit 107(1) TFBE.

3.2. Kur një masë shtetërore konsiderohet selektive? Testi i selektivitetit material⁴¹

Një ndërhyrje është selektive nëse ajo i shtrin efektet tek një numër i caktuar ndërmarrjesh apo në sektorë të caktuar, apo për disa produkte të caktuara duke përjashtuar të tjerat.⁴² Gjykata në përcaktimin e selektivitetit material ndjek një test tre shkallësh.⁴³ Së pari përcakton sistemin e referimit në të cilin do të krahasohen ndërmarrjet dhe konstaton nëse ka trajtim të diferencuar të ndërmarrjeve, së dyti analizon nëse trajtimi i diferencuar është diskriminues, apo rrjedhojë e pashmangshme e ndërhyrjes së shtetit në një sektor, së treti nëse trajtimi i diferencuar mund të justifikohet nga natyra apo struktura

39 Çështjet T-127, 129, 148/99 *Diputacion Foral De Álava k. Komisionit*, 2002 RGJE II1275, para 154, Çështjet T-92 dhe 103/00, *Territorio Historico de Álava- Diputacion Foral De Álava k. Komisionit*, RGJE II-1390, para 35, T-36/99 *Lenzing* [2004], cit.supra, para 132

40 Çështja T-55/99 *Confederación Española de Transporte de Mercancías (CETM) AG k. Komisionit të Komuniteteve Europiane* [2002], RGJE II-03207, para, 39, T-152/99, *HAMSA*, cit.supra, para 156

41 Selektiviteti gjeografi ka disa specifika të vecanta në analizë dhe nuk do të jetë objekt i këtij trajtimi. 42 Çështja T-55/99, *CETM*, cit.supra, para, 39, T-152/99, *HAMSA*, cit.supra, para 156

43 Shih: Bousin, Julie, and Jorge Piernas. "Developments in the Notion of Selectivity." *Eur. St. Aid LQ* (2008): 634; Romariz, Cristina. "Revisiting Material Selectivity in EU State Aid Laë – Or "The Ghost of Yet-To-Come". *Eur. St. Aid LQ* (2014): 39-49. Akademikë të ndryshëm janë të ndarë në këtë pikë. Ka edhe nga ata autorë që mbështesin idenë se testi i selektivitetit shkon përkorë Njofrimin të Komisionit për Taksat Indirekte për Bizneset dhe aplikojnë një test dy shkallësh: Shih Rossi-Maccanico, Pierpaolo. "Notion of Indirect Selectivity in Fiscal Aids: A Reasoned Review of the Community Practice, The." *Eur. St. Aid LQ* (2009): 161; Bartosch, Andreas. "Is there a need for a Rule of Reason in European State aid law? Or how to Arrive at a Coherent Concept of Material Selectivity?." *Common Market Law Review* 47, no. 3 (2010): 729-752.

e sistemit. Në këtë punim do të analizohet sesi Gjykatat e Bashkimit Europian dhe Komisioni i BE kanë analizuar hapin e parë të testit të selektivitetit, ndërkohë që dy fazat e tjera të testit do të analizohen në punimin pasues.

3.2.1. Hapi i parë: përcaktimi i një sistemi refermi

Sipas Gjykatës së Drejtësisë sistemi referimit përcaktohet duke krahasuar operatorët të cilat janë një një “situatë të krahasueshme, lidhur me objektivat që synon të realizojë kjo masë shtetërore.”⁴⁴ Gjykata ka sqaruar se krahasimi duhet të shtrihet midis ndërmarrjeve që ndodhen brenda një shteti anëtar.⁴⁵

Për të ilustruar sesi Gjykata dhe Komisioni përcaktojnë sistemin e referimit, mund të referohemi tek çështja *Adria Wein*. Në çështjen *Adria Wein* u analizua nëse ligji austriak për taksat për energjinë elektrike dhe gazin natyror përbënte ndihmë shtetërore sipas nenit 107(1)TFBE. Sipas ligjit austriak, legjitimoheshin të përfitonin nga uljet e taksave të energjisë, vetëm ndërmarrjet të cilat prodhonin mallra. Gjykata Kushtetuese Austriake e referoi çështjen para Gjykatës së Drejtësisë ky shtroi pyetjen nëse ulja e taksës së energjisë për gazin natyror dhe energjinë elektrike, vetëm për ndërmarrjet aktiviteti i të cilave konsistonte kryesisht në prodhimin e mallrave, do të konsiderohej ndihmë selektive. Sipas qeverisë Austriake masa në fjalë ishte pjesë e një “pakete të përgjithshme masash”⁴⁶ e si rrjedhojë nuk ishte selektive. Për më tepër, ajo argumentoi se masa nuk ishte selektive, pasi administrimi i saj “bazohej në kritere objektive dhe përfitonin një numër shumë i madh ndërmarrjesh”.⁴⁷

Gjykata e Drejtësisë, fillimisht sqaroi se masat me karakter të përgjithshëm nuk përbëjnë ndihmë shtetërore.

44 Çështja C-143/99 *Adria-Wien Pipeline GmbH and Wietersdorfer & Peggauer Zement- Werke GmbH v Finanzlandesdirektion für Kärnten* [2001] RGJE I-8365, para 41, C-409/00 *Spanja k. Komisionit* [2003] RGJE I-1487, para.47; C-308/01 *GIL Insurance Ltd dhe të tjerë k. Komisionerëve të Doganës dhe Akcizës (GIL Insurance)* [2004], RGJE I-04777, para 68, C-172/03 *Wolfgang Heiser k. Finanzamt Innsbruck (Heiser)* [2005] RGJE I-01627, para 40, C-88/03 *Portugalia k. Komisionit të Komuniteteve Europiane* [2008] RGJE II-591 para 88-96

45 Çështja C-408/04 *P. Komisioni i Komuniteteve Europiane k. Salzgitter AG (Salzgitter II)* [2008] RGJE I-2767, para. 109

46 Çështja C-143/99 *Adria-Wien Pipeline*, cit.supra. para 43

47 Çështja C-143/99 *Adria-Wien Pipeline*, cit.supra. para 45

Gjykata tha se: “*një masë shtetërore, nga e cila përfitojnë të gjitha ndërmarrjet në territorin kombëtar, pa dallim, nuk përbën ndihmë shtetërore, pavarësisht aktivitetit që ato kryejnë*”.⁴⁸

Nga ana tjetër, duke u nisur nga jurisprudenca e saj e mëparshme, Gjykata e Drejtësisë u shpreh se furnizimi me energji, **në kushte preferenciale** për disa ndërmarrje, mund të cilësohet si ndihmë shtetërore dhe se për të përcaktuar nëse ka trajtim preferencial duhet që të bëhet “testi i selektivitetit”.

Gjykata sqaroi se për testin e selektivitetit, ka rëndësi të përcaktohet së pari *nëse masa shtetërore favorizon disa ndërmarrje apo prodhimin e disa produkteve* “**në krahasim me ndërmarrje të tjera**” të cilat janë në një situatë ligjore dhe faktike të krahasueshme, lidhur me objektivat që synon të arrijë masa në fjalë”.⁴⁹ Pra, për të krahasuar nëse disa ndërmarrje kanë trajtim preferencial në raport me të tjerat, duhet përcaktuar një sistem referimi, përkundrajt të cilit do të bëhet krahasimi. Sistem referimi do të jenë të gjitha ndërmarrjet, të cilat janë në një situatë ligjore dhe faktike të krahasueshme përsa i përket objektivave të masës.

Problemi i parë që mund të burojë nga ky formulim, është si do të përcaktohet sistemi i referimit për ato raste ku ndërmarrja nuk ka pozicion unik në treg, dhe kur nuk ka ndërmarrje të tjera në situatë ligjore dhe faktike të krahasueshme?

Ky problem është ngritur në çështjet *OTE* dhe *La Poste*, ku Komisioni kontatoi se nuk ishte e mundur të gjendej një sistem referimi për të bërë krahasimin, pasi nuk kishte operatorë të tjerë të ngjashëm në treg. Zgjidhja që dha Komisioni ishte se, në të të tilla raste, si sistem reference për krahasimin do të përdoret **situata e ndërmarrjeve para dhe pas zbatimit të ndihmës**.⁵⁰ Nëse ndërmarrja në fjalë ka marrë një ndihmë, të cilën nuk do ta kishte marrë në kushte normale të tregut, atëherë ndihma do të konsiderohet selektive dhe ndërhyrja e shtetit si ndërhyrje në kundërshtim me nenin 107(1) TFBE.

48 Çështja C-143/99 *Adria-Wien Pipeline*, cit.supra. para. 35

49 Çështja C-143/99 *Adria-Wien Pipeline*, para 40

50 Vendim i Komisionit i datës 10 Maj 2007 Mbi Ndhimën Shtetërore 2/06 (ex N 406/05), lidhur me skemën vullnetare të pensioneve në Greqi *OTE* [2008] OJ L243/7; Vendimi i Komisionit i datës 10 Maj 2007 mbi Ndhimën Shtetërore të implementuar nga Franca në lidhje me reformën për financimin e pensioneve për nëpunësit civil që kishin punuar për *La Poste* [2008] OJ L63/16.

Problemi i dytë që ka ngjallur ky formulim i Adria Wein lidhur me sistemin e referimit, është se për krahasim do të merren ndërmarrje që janë në situatë ligjore apo faktike të krahasueshme për nga **objektivat** që do të arrijë masa.

A do të thotë kjo se për të përcaktuar masën si selektive apo jo ka rëndësi jo vetëm efekti, por edhe qëllimi i masës?

Nëse edhe ky formulim i Adria-Wein ka dashur të theksojë se edhe **qëllimi** ka rëndësi në cilësimin e një ndërhyrje si ndihmë shtetërore, atëherë kjo çështje përbën një qëndrim të ndryshëm nga praktika e mëparshme e Gjykatave, ku vetëm efekti ka rëndësi për cilësimin e një ndërhyrjeje si të tillë.

Në fakt ky artikulum i Gjykatës, solli paqartësi në jurisprudencë çka duket edhe në çështjen *Dutch Nox* vetëm disa vite më vonë. Në *Dutch Nox* çështja për objekt shqyrtimi ishte nëse skema hollandeze për emetimin e oksidit të nitrogjenit përbënte ndihmë shtetërore. Holanda, në zbatim të Direktivës 2001/81 për tavanin e emetimit të oksidit të nitrogjenit, hartoi një skemë, ku i shpërndante 250 ndërmarrjeve më të mëdha ndotëse, të drejta për të tregtuar emetimin e oksidit të nitrogjenit. Holanda ia dha këtë të drejtë vetëm ndërmarrjeve që kishin të një kapacitet termik më të madh se 20 megavat (20MVth). Holanda njoftoi Komisionin lidhur me skemën dhe ky i fundit doli me vendim se skema në fjalë përbënte ndihmë shtetërore sipas nenit 107(1) TFBE.⁵¹ Sipas Komisionit, autoritetet hollandeze i kanë dhënë një avantazh disa ndërmarrjeve të caktuara, duke iu ofruar atyre kuota të emetimit të oksidit të nitrogjenit, pa asnjë kundërshpërblim. Këto ndërmarrje mund të shesin kuotat e emetimit ose ti blejnë ato në tregun e emetimit të oksidit të nitrogjenit, çka i jep mundësi të rrisin asetet e tyre, apo të shmangin gjorbën nëse sasia e emetimit të oksidit të nitrogjenit ishte më e madhe se ajo e lejuar.⁵²

51 Vendim i Komisionit i datës 24 Qershor 2003, Ndihmë Shtetërore Nr. 35/2003, Holanda- skema e tregtimit të emetimit të Oksidit të Nitrogjenit [2003] OJ C227/8

52 Sipas Direktivës 2001/81 KE, shtetet anëtare duhet të marrin masa për të përcaktuar sasinë maksimale (tavan) të emetimit të oksidit të nitrogjenit. Në zbatim të kësaj direktive, Holanda vendosi se sasia maksimale e emetimit për 250 ndërmarrjet e mëdha industriale do të ishte 55 kiloton oksid nitrogjeni. Cdo ndërmarrje do të kishte një limit të emetimit të oksidit të nitrogjenit në mjedis, të cilin nuk duhet ta kalonte. Në fund të cdo viti, autoritetet hollandeze do të hetonin nëse ndërmarrjet e kishin kaluar tavanin maksimal të emetimit të oksidit të nitrogjenit. Për ndërmarrjet që do të kishin kaluar këtë tavan, autoritetet hollandeze do të vendosnin gjorbë. Sipas skemës së ngritur nga qeveria hollandeze, ndërmarrjeve të mëdha industriale, iu jepej mundësia të blinin kuota të emetimit të oksidit të nitrogjenit nga ndërmarrje të

Sipas Komisionit ndihma është selektive, sepse ajo i ofrohet vetëm ndërmarrjeve që kanë një kapacitet termik mbi 20 MËth, duke përfshirë ndërmarrjet e tjera. Kjo ndihmë është selektive e si rrjedhojë do të konsiderohet si ndihmë shtetërore në kundërshtim me nenin 107(1) TFBE.

Hollanda e goditi vendimin në Gjykatën e Përgjithshme. Sipas qeverisë hollandeze, masa në fjalë nuk ishte selektive pasi ajo shtrihej për rreth 250 ndërmarrje industriale, të cilat nuk i përkisnin një sektori të caktuar, por sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Gjykata e Përgjithshme iu referua Adria-Wein lidhur me testin e selektivitetit; sipas Gjykatës së Përgjithshme, masa në fjalë shtrihet vetëm për ndërmarrjet e mëdha, pasi këto janë edhe ndotësit më të mëdhenj, dhe se kriteri objektiv (kapaciteti i energjisë termike 20MVth) është në pajtim **me qëllimin** që do të arrijë masa, i cili është mbrojtja e mjedisit”.⁵³

Sipas Gjykatës së Përgjithshme, kriteri për zbatimin e masës në fjalë është objektiv, e nuk ka asnjë ngjyrim të selektivitetit gjeografik apo sektorial.⁵⁴ Gjykata e Përgjithshme argumentoi se:

“përsa i përket qëllimit që do të arrijë masa dhe detyrimit specifik që rëndon mbi ndërmarrjet e mëdha industriale, *situata ligjore dhe faktike e ndërmarrjeve që përmbushin tavanin e emetimit të oksidit të nitrogjeni, nuk mund të konsiderohet e krahasueshme me ndërmarrjet për të cilat nuk zbatohet ky tavan*”.⁵⁵ [Theksim i autorit].

Sipas Gjykatës së Përgjithshme, Komisioni nuk arriti të provonte se ndërmarrjet që konsumonin më shumë se 20 MVth ishin në një situatë të krahasueshme me ndërmarrjet që e tjera që nuk përfshiheshin në skemën në fjalë, si rrjedhojë masa nuk mund të konsiderohej selektive⁵⁶. Ky vendim i Gjykatës së Përgjithshme i shtoi paqartësitë lidhur me nocionin e ndihmës shtetërore.

tjera, që ishin më eficientë në treg. Kështu ndërmarrjet që kishin emetuar oksid nitrogjeni më pak se limiti i vendosur për to, mund të shisnin kuotat e tyre të emetimit dhe të gjeneronin të ardhura. Ndërmarrjet që e kishin tejkaluar limitin e emetimit të oksidit të nitrogjenit nga ana tjetër, mund të blinin kuota nga ndërmarrjet e tjera, për të justifikuar teprcën e emetuar, në mënyrë që të shmangnin gjobën nga autoritetet hollandeze.

53 Çështja T- 233/04, *Mbretëria e Hollandës k. Komisionit* [2008] RGJE II-591 para 88

54 Çështja T- 233/04, *Mbretëria e Hollandës k. Komisionit* [2008] RGJE II-591 para, 88

55 Çështja T- 233/04, *Mbretëria e Hollandës k. Komisionit* [2008] RGJE II-591, para 90

56 Çështja T- 233/04, *Mbretëria e Hollandës k. Komisionit* [2008] RGJE II-591, para 91&96

Në këtë vendim, mbrojtja e mjedisit si objektiv që synonte të arrinte masa, u mor në konsideratë për të gjykuar mbi karakterin selektiv të masës. Sipas këtij vendimi, qëllimi dhe shkaku i miratimit të një mase duhet të vlerësohen për të përcaktuar nëse masa ishte selective ose jo. Sic u konstatua me të drejtë edhe nga akademikët, kjo vinte në kundërshtim me parimin e konsoliduar të gjykatës, se ndihma shtetërore duhet të vlerësohet në bazë të efekteve/pasojave që sjell e jo shkakut apo qëllimeve të ndërhyrjes shtetërore.⁵⁷

Komisioni e goditi vendimin e Gjykatës së Përgjithshme në Gjykatën e Drejtësisë. Megjithatë, para se të jepej vendimi i Gjykatës së Drejtësisë për Dutch Nox, një tjetër çështje me rrjedhoja interesante u gjykuara nga Gjykata Europiane e Drejtësisë, çështja British Aggregates. Faktet në British Aggregates shkruarimisht ishin këto. Në 2002, Mbretëria e Bashkuar nëpërmjet *Ligji për Financat* (The Finance Act) vendosi një taksë të re për agregatët në Mbretërinë e Bashkuar.

Taksa ishte 1.60 Paund Britanik për ton për agregatët e importuara dhe për agregatët e natyrore⁵⁸ të nxjerra në Mbretërinë e Bashkuar. Nga kjo taksë përjashtoheshin agregatët e exportuar si edhe agregatet e ricikluara. Qëllimi i taksës ishte të ulte nxjerrjen e agregateve natyrore në Britaninë e Madhe si edhe të nxiste përdorimin e agregateve të ricikluara.⁵⁹

Shoqata Britanike e Agregateve e pretendoi se taksa ishte selective dhe kundërshtoi në Gjykatën e Përgjithshme vendimin e Komisionit të datës 24 Prill 2002, i cili kishte vendosur të mos e cilësonte taksën për agregatet si ndihmë shtetërore. Sipas Gjykatës së Përgjithshme, për shkak se fusha nuk është e harmonizuar, shtetet anëtare kanë të drejtë të vendosin detyrime/taksa që i cmojnë të nevojshme për mbrojtjen e mjedisit. Shtetet anëtare kanë të drejtë të vendosin prioritet e tyre lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe të përcaktojnë mallrat apo shërbimet të cilat do të jenë objekt i detyrimeve taksore që i shërbejnë

⁵⁷ Basin, Julien dhe Jorge Pirnas. "Development in the notion of selectivity". EStAL QL. (4) 2008, fq. 640

⁵⁸ Agregatet natyrore (zhavorret, rërat dhe shkëmbinj të thërmuar) janë burime esenciale dhe të parinovueshme të cilat mund të përdoren si në infrastrukturë ashtu dhe në veprat e ndërtimeve të tjera. [Sqarim i autorit]

⁵⁹ Bartosch, Andreas. "Is there a need for a Rule of Reason in European State aid law? Or how to Arrive at a Coherent Concept of Material Selectivity?" Common Market Law Review 47, no. 3 (2010): 729-752.

mborjtjes së mjedisit⁶⁰. Pasi tha këtë Gjykata e Përgjithshme pohoi:

“Në parim, fakti që një taksë ambientaliste është një masë e vecantë, e cila shtrihet për lloje të caktuara mallrash dhe shërbimesh, dhe jo pjesë e një sistemi të përgjithshëm taksimi, i cili zbatohet njëlloj për të gjitha aktivitetet, të cilat kanë impakt të njëjtë mbi mjedisin, nuk do të thotë se ato aktivitete të ngjashme të cilat nuk janë subjekte të taksës, përfitojnë avantazh.”⁶¹

Gjykata e Përgjithshme për më tepër pohoi se kjo çështje e ndryshme nga *Adria-Wein*, pasi ketu shtrohet për objekt gjykimi fusha e zbatimit të taksës së mjedisit, gje e cila është në kompetencën e shteteve anëtare, ndërsa në *Adri-Wein*, Gjykata shqyrtoi nëse përjashtimi nga taksa energjise e një kategorie të vecantë ndërmarrjesh, ato të cilat merreshin me prodhimin e mallrave, ishte selektive apo jo.⁶²

Shoqata Britanike e agregateve e goditi vendimin e Gjykatës së Përgjithshme para Gjykatës së Drejtësisë. Në opinionin e tij të datës 17 Korrik 2008, Avokati i Përgjithshëm tha se duke u nisur nga praktika “*çështja nëse është përmbushur kushti i selektivitetit, duhet të vlerësohet rast pas rasti, për të vlerësuar nëse, nën dritën e natyrës, qëllimit dhe metodës së zbatimit dhe efekteve, masa në fjalë i jep avantazhe në mënyrë ekskluzive disa ndërmarrjeve apo disa sektorëve.*”⁶³ Sipas AP Mengozzi, qasja e Gjykatës së Përgjithshme në këtë çështje shkon përkundër praktikës së vendosur nga Gjykata, sipas së cilës: as natyra fiskale apo ekonomike, as qëllimi social i masës së shtetit në fjalë, as objektivat për mbrojtjen e mjedisit që shteti ndjek, nuk janë të mjaftueshme për të përjashtuar ata nga fusha e zbatimit të nenit 107.⁶⁴

Ai theksoi se “neni 87 KE (tani 107(1) TFBE) nuk bën dallim midis masave, duke u nisur nga qëllimi apo objektivat pse ato vendosen, por i cilëson ato vetëm duke u nisur nga efekti”.

60 T-210/02 *British Aggregates k. Komisionit* [2006] RGJE II-2789, para. 115

61 T-210/02 *British Aggregates k. Komisionit* [2006] RGJE II-2789, para. 115

62 T-210/02 *British Aggregates k. Komisionit* [2006] RGJE II-2789, para. 120-121

63 Opinion i Avokatit të Përgjithshëm Mengozzi në Çështjen C-487/06 P, *British Aggregates*, para 82

64 Opinion i Avokatit të Përgjithshëm Mengozzi në Çështjen C-487/06 P, *British Aggregates*, para para 95, 96

Në këtë pikëpamje objektivat e ndjekura do të merren në konsideratë vetëm kur vlerësohet nëse është e pajtueshme masa me tregun e përbashkët. Avokati i Përgjithshëm Mengozzi⁶⁵ propozoi të rrëzohej vendimi Gjykatës së Përgjithshme.

Ai adoptoi një test klasik të selektivitetit. Gjykata e Drejtësisë së BE mbështeti opinionin e Avokatit të Përgjithshëm Mengozzi dhe rrëzoi arsyetimin e Gjykatës së Përgjithshme⁶⁶.

Sipas Gjykatës edhe pse mbrojtja e mjedisit përbën një nga objektivat themelore të Komunitetit, nevoja për të mbrojtuar mjedisin, edhe pse legjitime, nuk mund të justifikojë anashkalimin e masave me karakter selektiv, të cilat bien brenda fushës së zbatimit të nenit 107(1) TFBE. Ajo çka bie në sy tek gjuha e Gjykatës, është se në përcaktimin e sistemit të referimit, Gjykata e Drejtësisë ka ometuar pjesën “*përsa i përket qëllimit që ndjek masa*” nga formula e Adria-Wein. Në paragrafin 82 të vendimit thuhet:

(...) Për të përcaktuara nëse një masë është selektive, është e përshtatshme të analizojmë nëse, në kontekstin e një sistemi të caktuar ligjor, ajo masë i jep avantazh disa ndërmarrjeve, në krahasim me ndërmarrje të tjera të cilat janë në një situatë ligjore dhe faktike të krahasueshme (shiko, inter alia, Çështjen C-409/00 *Spanja* k. Komisionit [2003] ECR I-1487, paragrafi 47; *Portugalia* k. Komisionit, paragrafi 54; dhe Bashkim Çështjesh C-428/06 deri C-434/06 *UGT-Rioja dhe të Tjerë* [2008] ECR I-0000, paragrafi 46).⁶⁷

Gjykata e Drejtësisë duke ometur pjesën “*lidhur me objektivat që synon të realizojë masa*” nga formula e Adria-Wein, duket se bën një interpretim të ngushtë të nocionit të ndihmës shtetërore, bazuar në doktrinën e efektit, sipas të cilit në shqyrtimin e një mase publike Komisioni nuk mund të bëjë dallim duke u nisur nga shkaqet apo objektivat e masës, por e përcakton atë vetëm mbi bazën e efekteve, pra nëse një masë i jep përparësi disa ndërmarrjeve, duke përjashtuar të tjera. A do të thotë kjo se *Adria-Wein* nuk është më një precedent i vlefshëm?

65 Opinion i Avokatit të Përgjithshëm Mengozzi në Çështjen C-487/06 P, *British Aggregates*, ibid.

66 Çështja C-487/06 P, *British Aggregates Association* k. Komisionit të Komuniteteve Europiane dhe Mbretërisë së Bashkuar [2008] RGJE I-10515

67 Çështja C-487/06 P, *British Aggregates Association* k. Komisionit të Komuniteteve Europiane dhe Mbretërisë së Bashkuar [2008] RGJE I-10515, para. 82

Në fakt, Gjykata e Drejtësisë vazhdon dhe referon *Adria-Wein* edhe në paragrafe të tjerë të vendimit, psh. në paragrafin 88, apo 89. Për këtë arsye ka autorë që thonë se ometimit të pjesës “qëllimi që ndjek masa” nga paragrafi 82 i vendimit të Gjykatës së Drejtësisë në *British Aggregates*, nuk duhet ti jepet shumë rëndësi.⁶⁸ Pavarësisht këtij qëndrimi, unë jam e mendimit se ometimi i qëllimit nga paragrafi 82 nuk ishte edhe aq i rastësishëm, sepse kur gjykata në kllapa përmend praktikën e saj për testin e selektivitetit, në këtë paragraf nuk përmend *Adria-Wein*. Po kështu paragrafët pasues theksojnë rëndësinë që ka efekti, e jo qëllimi në përcaktimin e masës. Në paragrafin 84 Gjykata theksoi se “objektivat e ndjekura nga masat shtetërore nuk mjaftojnë për të përjashtuar masat nga klasifikimi si “ndihmë” për efekt të nenit 87 KE [tani 107 TFB]”⁶⁹.

Në paragrafin 85, ajo risolli edhe njëherë praktikën e konsoliduar se “neni 87(1) KE nuk i klasifikon masat si ndihmë shtetërore në bazë të shkakut ose objektivave, por në bazë të efektit.”⁷⁰

Ndoshta qëllimi i Gjykatës, ka qënë që objektivi/qëllimi i masës të mos merret shumë në konsideratë në përcaktimin e sistemit të referimit (selektivitetit *prima facie*), por në një fazë të mëvonshme, në fazën tjetër kur analiza vazhdon me justifikimin e masës. Kjo me qëllim, që shtetet anëtare të mos kishin mundësi të përjashtonin direkt që në fazën e para selektivitetin e masës, me arsye të ndryshme të politikës ekonomike, sociale etj. Megjithatë, edhe pse doktrina e efektit mbizotëron edhe për kriterin e selektivitetit, praktika e këtyre çështjeve tregon se ky nuk është kriter absolut, masa mund të justifikohet nga natyra apo struktura e sistemit. Po kështu analiza e qëllimit është e rëndësishme është, për të justifikuar masës mbi bazën e nenit 107(3) TFB.⁷¹ Disa muaj më vonë pas këtij vendimi, Gjykata e Drejtësisë nxjerr vendimin e apelit për *Dutch Nox*.

68 Michael Honoré. *Selectivity and Taxation – Reflections in the Light of Case C-487/06 P*, British Aggregates Association. *European State Aid Law* (4) (2009) fq. 532

69 Çështja C-487/06 P, *British Aggregates*, cit. supra, para. 84

70 Çështja C-487/06 P, *British Aggregates*, cit. supra, para. 85

71 Vet Gjykata e Drejtësisë u shpreh se: “objektiva si mbrojtja e mjedisit do të merren në konsideratë për të vlerësuar mbi pjtueshmërinë e masave shtetërore me tregun e përbashkët sipas nenit 107(3) TFB (Çështja C-487/06 P *British Aggregates Association*, cit. supra, ibid. para 91-92)

Edhe pse mund të pritej, që Gjykata në këtë vendim të bënte të qartë vendin që zë qëllimi i masës në analizën e kriterit të selektivitetit, kjo nuk ndodhi. Gjykata e Drejtësisë në *Dutch Nox*, e risjelle edhe njëherë në tryezë formulën e Adria-Wein për sistemin e referimit, edhe pse nuk e analizon qëllimin e masës në hapin e parë të testit të selektivitetit. Analiza e Gjykatës së Drejtësisë për përcaktimin e sistemit të referimit është interesant, ndaj do të sjellim shkurtimisht argumentet e saj.

Gjykata e Drejtësisë së pari sqaroi se **ekzistenca i një kriteri objektiv, për të përcaktuar numrin e ndërmarrjeve që do të përfitojnë nga ndihma, nuk e bën në vetvete masën selektive**, por thjesht tregon se ndërhyrja e shtetit është pjesë e një skeme të ndihmës shtetërore dhe jo një ndihmë me karakter individual.⁷²

Një kriter objektiv për të përcaktuar cilët janë përfituesit, do të thotë se kriteri për përfitimin e masës nuk është subjektiv, pasi një kriter subjektiv e bën masën automatikisht selektive.⁷³ Lidhur me qëllimin/objektin e masës si bazë për të përcaktuar sistemin e referimit, Gjykata e Drejtësisë tha:

(...) Gjykata e Përgjithshme, bazuar në paragrafët 34 dhe 41 të Adria-Wien Pipeline., *më të drejtë konfirmon* se, një masë shtetërore është ndihmë, nëse favorizon disa ndërmarrje apo prodhimin e disa mallrave, në krahasim me ndërmarrje të tjera, të cilat janë në një situatë ligjore dhe faktike të krahasueshme, përsa i përket objektivave që do të arrijë masa në fjalë.

(...) Më pas [Gjykata e Përgjithshme] në paragrafët 91 e vijim [të vendimin të saj] sqaroi se *Komisioni nuk provoi në vendimin e goditur, se ndërmarrjet e tjera, të ndryshme nga ato që ishin subjekte të masës në fjalë, janë objekt i detyrimeve të njëjta që buronin nga ai vendim, e si rrjedhojë do të konsideroheshin se ishin në një situatë të krahasueshme me atë ndërmarrjeve që mbuloheshin nga skema në fjalë.*⁷⁴[Theksim i autorit]

Pra, Gjykata e Drejtësisë në këtë çështje risjell edhe njëherë të plotë kriterin e *Adria-Wein* në përcaktimin e sistemit të referimit.

72 Çështja T- 233/04, *Mbretëria e Hollandës k. Komisionit* [2008] RGJE II-591, para 50; cit Spanja k. Komisionit C-409/00 [2003] RGJE I-1487 para 48, 49

73 Çështja T- 233/04, *Mbretëria e Hollandës k. Komisionit* [2008] RGJE II-591, para 55; Megjithatë, Gjykata e Drejtësisë njohe se nuk ishte kriteri objektiv për përfitimin e ndihmës, që e kishte cuar Gjykatën e Përgjithshme në përfundimin se masa nuk ishte selektive. Shih para. *ibid.* para. 55

74 Çështja T- 233/04, *Mbretëria e Hollandës k. Komisionit* [2008] RGJE II-591, para. 52

Megjithatë, Gjykata e Drejtësisë në *Dutch NOx* nuk u ndal të analizonte mënyrën sesi do të përcaktohej sistemi i referimit dhe çfarë rëndësie do të kishtë qëllimi/objektivi i masës në përcaktimin e sistemit të referimit.

Gjykata e Drejtësisë u kufizua të thoshte se barra e provës për të përcaktuar nëse disa ndërmarrje ndodhen në një situatë të krahasueshme ligjore dhe faktike, **duke u nisur nga objektivat e masës**, i takon Komisionit.⁷⁵ I gjithë debati ligjor më pas, u përqëndrua tek argumenti nëse Komisioni kishte arritur apo jo të provonte selektivitetin e masës. Gjykata e Drejtësisë tha:

“64. Sic është konfirmuar edhe nga palët gjatë procesit, çdo ndërmarrje e cila emeton Oksid Nitrogjeni gjatë veprimtarisë së saj, duhet të respektojë kufizimet për emetimin si edhe ta reduktojë atë, qofshin këto ndërmarrje që janë ose jo subjekte të masës [shtetërore] në fjalë. Për të përmbushur detyrimet e parashikuara në ligjin kombëtar, vetëm ndërmarrjeve subjekte të masës [shtetërore] në shqyrtim iu jepen përparësitë e parashikuara në paragrafin më sipër, çka përbën një përparësi në favor të tyre, e cila nuk gëzohet nga ndërmarrjet e tjera në një situatë të krahasueshme.

65. Në këtë kuadër, nuk ka pse të kërkohej që Komisioni të shkonte të analizonte me tepër detaje në vendimin e tij. Në rastin e një programi ndihme, ai [Komisioni] mund të kufizohet me shqyrtimin e karakteristikave të programit në fjalë, në mënyrë që të përcaktojë... nëse duke u nisur nga kushtet e programit, përfitueseve [të programit] iu jepet një avantazh i konsiderueshëm në raport me konkurrues të tjerë (...).”⁷⁶

Përsa më sipër, Gjykata e Drejtësisë doli në përfundimin se Komisioni e ka përmbushur barrën e provës, pasi ai ka arritur të konstatojë se kompanitë që emetonin më shumë oksid nitrogeni, edhe ato që emetonin më pak dhe të cilat ishin lënë jashtë skemës, ishin nën të njëjtit detyrim ligjor për të reduktuar emetimin e oksidit të nitrogenit, **ishin në një situatë të krahasueshme**.⁷⁷ Pra në analizë të fundit Gjykata e Drejtësisë këtu nuk e analizoi qëllimin/objektivin e masës si kriter për përcaktimin e sistemit të referimit.

75 Çështja T- 233/04, *Mbretëria e Hollandës k. Komisionit* [2008] RGJE II-591, para. 62

76 Çështja T- 233/04, *Mbretëria e Hollandës k. Komisionit* [2008] RGJE II-591, para.64, 65

77 Çështja T- 233/04, *Mbretëria e Hollandës k. Komisionit* [2008] RGJE II-591, para. 66, 67

Gjykata e Drejtësisë u distancua analiza e qëllimit apo objektit të masës, duke thënë që ajo që mjafton të provojë Komisioni është se nga programi i ndihmës avantazhi i jepet disa ndërmarrjeve dhe jo disa ta tjerave, pra duke, duke iu rikthyer heshturazi doktrinës së efektit.

Bibliografia

Libra:

1. Bacon, Kelyn. *European Community law of State aids*. Oxford University Press, 2009
2. Biondi, Andrea, Piet Eeckhout, and James Flynn, eds. *The law of state aid in the European Union*. Oxford University Press, 2004.
3. Heidenhain, Martin, ed. *European state aid law*. Beck, 2010
4. Nicolaidis, Phedon, Mihalis Kekelekis, and Philip Buyskes. *State aid policy in the European Community: A guide for practitioners*. Vol. 16. Kluwer law international, 2008
5. Quigley, Conor, and Anthony M. Collins. *EC State aid law and policy*. Hart Pub, 2003

Artikuj:

1. Wishlade, Fiona. *When are tax advantages state aids and when are they general measures?.* Europ. Policies Research Centre, University of Strathclyde, 1997.
2. Basin, Julien dhe Jorge Pirnas. “*Development in the notion of selectivity*”. *Eur. St. Aid LQ* (2008): 634-644
3. Michael Honoré. “*Selectivity and Taxation – Reflections in the Light of Case C-487/06 P, British Aggregates Association.*” *Eur. St. Aid LQ* (2009): 527-537
4. Bartosch, Andreas. “*Is there a need for a Rule of Reason in European State aid law? Or hoë to Arrive at a Coherent Concept of Material Selectivity?.*” *Common Market Law Review* 47, no. 3 (2010): 729-752.
5. Rossi-Maccanico, Pierpaolo. “*Notion of Indirect Selectivity in*

Fiscal Aids: A Reasoned Review of the Community Practice. Eur. St. Aid LQ (2009): 161-171

6. Romariz, Cristina. "Revisiting Material Selectivity in EU State Aid Law – Or "The Ghost of Yet-To-Come". Eur. St. Aid LQ (2014):39-

Cështje të Gjykatave të Bashkimit Europian:

1. Çështja C-88/03, *Republika e Portugalisë k. Komisionit të Komuniteteve Europiane* (çështja e Azoreve), [2006], RGJE I-07115
2. Çështja C-143/99, *Adria-Wien Pipeline GmbH and Wietersdorfer & Peggauer Zementwerke GmbH v Finanzlandesdirektion für Kärnten* [2001] RGJE I-8365
3. Çështja C-159/01, *Hollanda k. Komisionit*, [2004] RGJE I-4461
4. Çështja C-172/03, *Wolfgang Heiser k Finanzamt Innsbruck (Heiser)* [2005] RGJE I-01627
5. Çështja C-182 dhe 217/03 *Belgjika dhe Forum 187 k. Komisionit*, [2006], RGJE I-5479.
6. Çështja C-200/97, *Ecotrade Srl v Altiforni e Ferriere di Servola SpA*[1998], RGJE I-07907
7. Çështja C-211/04, *Qeveria e Gjibraltarit, Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda e Veriut k. Komisionit të Komuniteteve Europiane* [2008], RGJE II-03745
8. Çështja C-222/04, *Ministria e Ekonomisë dhe Financave k. Cassa di Risparmio në Firenze* [2006] RGJE I-289
9. Çështja C-241/94 *Republika e Francës k. Komisionit të Komuniteteve Europiane* [1996], RGJE I-04551
10. Çështja C-251/97 *France k. Komisionit* [1999] RGJE I-6639
11. Çështja C-256/97, *Déménagements-Manutention Transport SA (DMT)* [1999], RGJE I-03913
12. Çështja C-295/97, *Industrie Aeronautiche e Meccaniche Rinaldo Piaggio SpA v International Factors Italia SpA (Piaggio)* [1999] RGJE I-03735,
13. Çështja C-308/01 *GIL Insurance Ltd dhe të tjerë k Komisionerëve të Doganës dhe Akcizës (GIL Insurance)* [2004], RGJE I-04777
14. Çështja C-351/88, *Spanja k. Komisionit* [2002] RGJE I-8031
15. Çështja C-353/95 *Tierce Ladbroke k. Komisionit* [1997] RGJE I-7007

16. Çështja C-408/04 P *Komisioni i Komuniteteve Europiane k. Salzgitter AG* (Salzgitter II) [2008] RGJE I-2767
17. Çështja C-409/00 *Spanja k. Komisionit* [2003] RGJE I-1487
18. Çështja C-428-434/06, *Unión General de Trabajadores de La Rioja (UGT-Rioja) dhe të tjerë k Juntas Generales del Territorio Histórico de Vizcaya*, [2008] RGJE I-06747
19. Çështja C-480/98 *Spanja k. Komisionit (Magefesa)*, RGJE I-08717
20. Çështja C-487/06 P, *British Aggregates Association k. Komisionit të Komuniteteve Europiane dhe Mbretërisë së Bashkuar* [2008] RGJE I-10515
21. Çështja C-75/97 *Mbretëria e Belgjikës k. Komisionit ('Maribel')* [1999] RGJE I-3671
22. Çështja *Italia k. Komisionit* [1974] RGJE 709
23. Çështja T- 233/04, *Mbretëria e Hollandës k. Komisionit* [2008] RGJE II-591
24. Çështja T- 233/04, *Mbretëria e Hollandës k. Komisionit* [2008] RGJE II-591
25. *Spanja k. Komisionit C-409/00* [2003] RGJE I-1487
26. Çështja T-210/02 *British Aggregates k. Komisionit* [2006] RGJE II-2789
27. Çështja T-239 and 323/04 *Italia dhe Brandt k. Komisionit*, [2002] RGJE II-4259, para 53,
28. Çështja T-269, 271, 272/99 *Diputacion Foral de Guipuzcoa k. Komisionit* [2002] RGJE
29. Çështja T-36/99, *Lenzing AG k. Komisionit të Komuniteteve Europiane* [2004], RGJE II-03597
30. Çështja T-55/99 *Confederación Española de Transporte de Mercancías (CETM) AG k. Komisionit të Komuniteteve Europiane* [2002], RGJE II-03207
31. Çështje të Bashkuara C-72/91 dhe C-73/91 *Firma Sloman Neptun Schiffahrts AF k. Seebetriebsrat Bodo Ziesemer der Sloman Neptun Schiffahrts AG*, [1993] RGJE I-887
32. Çështjet T- 346-348/99 *Diputacion Foral de Guipuzcoa k. Komisionit* [2002] RGJE II-4259
33. Çështjet T-127, 129, 148/99 *Diputacion Foral De Álava k. Komisionit*, 2002 RGJE II1275
34. Çështjet T-92 dhe 103/00, *Territorio Historico de Álava- Diputacion Foral De Álava k. Komisionit*, RGJE II-1390,

35. T-152/99 *Hijos de Andrés Molina, SA (HAMSA) k. Komisionit të Komuniteteve Europiane* [2002], RGJE II-03049

Vendime të Komisionit të Bashkimit Europian:

1. Njoftimin i Komisionit Për Zbatimin e Nenit 107(1)TFBE për Taksimën Direkt mbi Biznesin, OJ 1998 C-384/3, p 68
2. Vendim i Komisionit 2003/755/KE, 17 Shkurt 2003 për skemat e ndihmës shtetërore të zbatuara në Belgjikë për koordinimin e qëndrave të Belgjikës, FZ L 282, 30.10.2003
3. Vendim i Komisionit 2003/81/KE, 22 Gushtit 2002 “Për implementimin e skemave të ndihmës shtetërore në Spanjë, për qëndrat e koordinimit në Vizcaya” C-48/2001, FZ L 31, 6.2.2003
4. Vendim i Komisionit i datës 10 Maj 2007 Mbi Ndihmën Shtetërore 2/06 (ex N 406/05), lidhur me skemën vullnetare të pensioneve në Greqi OTE [2008] OJ L243/7
5. Vendim i Komisionit i datës 24 Qershor 2003, Ndihmë Shtetërore Nr. 35/2003, Hollanda- skema e tregimit të emetimit të Oksidit të Nitrogjenit [2003] OJ C227/8
6. Vendimi i Komisionit i datës 10 Maj 2007 mbi Ndihmën Shtetërore të implementuar nga Franca në lidhje me reformën për financimin e pensioneve për nënpunësit civil që kishin punuar për La Poste [2008] OJ L63/16.
7. N-96/2000, (OJ C 266, 16.9.2000).

Të tjera:

1. Ligj Nr. 9590, datë 27.07.2006, Për Ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë Komuniteteve Europiane dhe Shteteve Anetare te tyre”, Flet. Zyrtare Nr. 87
2. Opinion i Avokatit të Përgjithshëm Mengozzi në Çështjen C-487/06 P, British Aggregates

FAMILJA, DHE MBROJTJA QE I OFROHET ASAJ NGA LEGJISLACIONI PENAL

Dr. Proces Fran Qafa

1. Familja si qelize baze per zhvillimin e shoqerise

Themelet e ndertimit dhe mirfunksionimit te shoqerise gjenden aty ku fillon jeta, zhvillimi, bashkejetesa, komuniteti dhe risocializimi i brezave njezore. Ky zinxhir ne dukje i nderlikuar perben ate qe quhet familje. Struktura dhe vitaliteti i saj i ngjan sic e quajne romaket e lashte “shteti ne miniature” termi i mesiperme i referohet jo vetem permbajtjes sociale por edhe juridike normative. Keshtu per te eleminuar esencen e problematikes ngrihen disa hipoteza paraprake:

1. Pse analiza e personalitetit dhe karakterit te kategorive te ndryshme te personave ndalojne ne qendren e rrethit vicioz te familjes?

2. Cilat jane faktoret primare dhe sekondare qe cojne ne degradimin dhe kriminalitet ne familje?

3. Si paraqitet raporti i familjes me pushtetin shteteror?
Si ndikon ky i fundit ne permiresimin apo injorimin e saj.

4. Cilat jane pergjegjesite e shoqerise ne ruajtjen e standarteve te familjes?

5. Metodrat e ofruara politike, sociale, juridike qe i sherbejne familjes.

Familja eshte mjedisi i pare social qe ne ndodhemi ne momentin kur behemi pjestare te shoqerise njezore.

Te gjitha gjendemi ne nje mjedis te perbere nga pjestaret e familjes. Struktura fillon nga kryetari.

Pra burri ne funksionin e babait, bashkeshortit, qe buron nga natyra biogjenetike, normat juridike ne fuqi ne nje shtet te caktuar. Me pas gruaja me steriotipin e brishte, social, ne rolin e nenes dhe bashkeshortes. Si dhe anetaret e tjere te paralindur dhe paslindur. I gjithë ky komunitet qendron ne simbioze.

Si rrjedhoje brenda kesaj simbioze implementohen rregulla “quasi-juridike”, ndonese jo ne kuptimin e mirfillte.

Por specifikisht familja i vendos ne optiken e saj autentike.

Aspekti social; komunikimi, liria e shprehjes, e mendimit, formimit kulturor, si dhe arsimimit. Mirqenia ekonomike nepermejet disponimit te nje buxheti, ndryshimi i statuseve qe perbejne arritje ose ndryshime ne gjendjen aktuale. Morali dhe etika, dy elemnte te rendesishme per gjetjen e kodit hyres ne shoqeri, drejt aritjes se suksesit dhe permbushjes se standarteve kualifikuese. Pra me fjale te tjera perbejne “corpus iuries” qe shfaqen ne teresine publike shoqerore. Ajo qe perben celesin e trajtimit eshte analiza dhe efektiviteti i rregullave qe perbejne familjen.

Familja shqiptare ka pesuar ndryshime te medha. Kete fakt e proklamojme si nga ndryshimi i struktures dhe funksioneve, faktoreve te liberealizimit dhe librave me norma juridike (kodet qe saktesojene sjelljet ne raport me teresine). Keshtu nga kanunet, burimet triumfuese te se drejtes ne Shqiperi eshte kaluar ne nje legjislacion supra-liberal te nderhyrjes dhe sanksionimit te dukurive tabu, ne familjen shqiptare. Perberja e familjes, roli i anetareve te saj, emancipimi ne kuader te te drejtave, ekonomike, politike, ndryshimi i stilit te jeteses, fuqia levizese e shpejte e liberalizimit ne kohet modern. Duke nenkuptuar rritjen e kerkesave, socializimi temporan ne shoqeri, fryma e interesit publik ne kuader te atij social, zgjerimi i aktivitetit publik. Mirpo, keto faktore i sherbejne familjes shqiptare edhe per tu shenderruar ne nj institucion torture, dhune dhe kriminaliteti.

Ne qofte se kriminalitetin e kemi kerkuar ne labirinhet e shoqerise tani e gjejmë me lehtësi edhe ne strukturen e familjes. Ne dukje paraqitet komplekse por relaiteti eshte i thjeshte dhe ordiner. Megjithate gjerat e thjeshta jane me te nderlikuarat per tu zgjidhur. Evolucioni i familjes shqiptare eshte shoqesuar me ndryshime rrenjesore ne funksionimin e saj.

Faktoret tranzitore do te grupohen: kultura patriakale, partneriteti i varur martesor, ndryshimi i mentalitetit te perceptimit te ceshtjeve, varesia ekonomike, impotenca e anetareve te saj. Situata paradoksale e krijuar rrit cilesine e veprave penale te konsumuara brenda familjes.

Njoftimet mediatike jane beret e perdorshme per perhapje dhune dhe veprave te tjera penale ne nivel familjar. Por madhesia, tipologjia, gjenezja, kultura patriakale, mentale, maskiliste duhen kerkuar ne burimet e se drejtes zakonore shqiptare.

2. Ligji penal ne fushen familjare

E drejta penale si disipline objektive e inkorporuar ne legjislacionin shqiptar, perben epiqendren nga ku burojne nendegjet e saj. Ajo ngarkohet me detyren e mbrojtjes dhe sigurimit te vlerave vitale te shtetit, shoqerise si e tere dhe individit ne vecanti. Si e tille, funksionon dhe gjen zbatueshmerine permes Kodit Penal, Kodit te Procedures Penale, projekt-drafteve unike ligjore ne nje fushe te caktuar. Por rrenjet e saj zgjaten edhe drejt shkencave te tjera me objekte te ndryshme por me nje qellim te perbashket. Si kriminalogji-penalogji, kriminalistike, mjekesi ligjore, psikiatri, shkenca sociale qe synojne studimin e individit

Ligji penal familjar. Pikerisht, e drejta penale (pozitive qe identifikon shtetin-familjen) plotesojne njera-tjetre.

Mes te drejtes penale dhe asaj familjare ekziston nje lidhje e ngushte ne lemin e rregullit te institutit te martesese dhe familjes. E drejta familjare percakton kushtet, procedurat per lidhjen e martesese dhe nderprerjen e saj, raportet ne familje mes bashkshorteve prinderve dhe femijeve. Institute te rendesishme qe lidhen me familjen si adoptimi, kujdestaria, mbrojtja, ushqyerja, pra obligime familjare ligjore qe i takojne anetareve me te rritur kundrejt atyre me te vegjel ne familje. Mbrojtja e familjes fillon me inkorporimin e ligjit penal, si baze e bashkeveprimit ku jane "pre e akteve qe cenojen mardheniet familjare" dhe kete me ane te denimt. Parashikon vepra penale kunder martesese, te miturve, e pjestareve te tjere te saj. Natyrshem lind pyetja. Pse ligji objektiv nderhyn ne rregullimin e familjes si ne sferen private intime dhe shoqerore?

Ne te vertete qe legjislacioni penal pozitiv i cdo shteti, mbron dhe siguron vlerat qe ruajne pasurine njerezore. Megjithate jo te gjitha mund te gjejne vend ne legjislacionin pozitiv, por ato me te rendesishmet pa te cilat personi si njeri qytetar dhe bashkesi njerezore. Vlera pa te cilat nuk do te jete e mundur ekzistenca normale e shoqerise dhe individit si specialitet i nje lloji te vecante "homo-sapiens".

3. Interpretimi i dispoziatve me permbajte te veprave penale ne fushen e familjes

Kodi Penal me Seksionin IX parasheh- Vepra penale kunder femijeve, martesese dhe familjes

Ne menyre imediate legjislacioni penal mbron kategorite-strukturen rrenje te ndertimit te shoqerise, femijet, martesen, familja. Ne kontributin shumevjecar te shoqerise shqiptare per ruajtjen dhe sigurimin e zakoneve te mira qe ushqejne rritjen e nje brezi te shendetshem, femijet.

Fuqizimi mbi themele te forta te institucionit te martesese, si akt juridik me pasoja shteterore dhe sociale, fetare dhe si etniteti qe fuqizon shkallen e fuqizimit te shoqerise dhe familjes.

Optika e pushtetit te shtetit nuk mund te injorohet, anetaret e saj, qe bejne pjese ne institucionet private dhe intim si familja.

Kategorite e mbrojtjes, objekti i mbrojtjes, shkaqet, elementet cilesues rrethanore te dispoziatave sipas rastit.

Korniza e ngushte e interpretimit te saj, hapësira e lirise brenda kuadrit. Hipotezat qe mund te ngrihen nese ka te tilla, raporti mes aktit te kundraligjshem dhe sanksionve ekzistuese.

3.1.4. Braktisaj e femijeve te mitur¹

Braktisja e femijeve te mitur, perben veper penale permes se ciles autoret mbajne pergjegjesi ligjore. Objekt i kesaj vepre jane mbrojtja e interesave me te larte te femijes, paprekshmeria e te drejtave dhe lirive te tij per kujedes mbrojtje, zhvillim te shendetit mendor fizik. Subjektet percaktohen drejtperdrejt nga dispoziata (prinderit, perfaqesuesit ligjore) roli i te cileve eshte

¹ Neni 124 I Kodit Penal te RSH (ndryshuar paragrafi 1 me ligjin nr 8733 date 24.01.2001)

perjegjesi ne mirerritjen dhe edukimin e femijes.

Termtat me delikate qe preken jane te drejtat themelore te femijeve. E drejta per zhvillim, e drejta per familje, rritje dhe zhvillim te kapaciteteve si qenie njerezore, sociale me prespektive. Rasti i kundert, i lenies ne meshire te fatit dhe braktisjes, demtojne jo vetem individin por dhe instancat kombetare, nderkombetare ne perpjekjen shume shekullore per integrimin e praktikave te tilla. Menyra e realizimit te vepres eshte duke e braktisur me veprim apo mosveprim

3.2. Keqtrajtimi ite miturve.²

Objekt i kesaj vepre penale eshte keqtrajtimi i vazhdueshem fizik dhe mendor, me veprime dhune, te jashtme dhe te brendshme, nga persona qe me ligj detyrohet ta shmangin ate.

Parashikohen gjithashtu objekte te tjera dytesore qe sjellin pasoja nga shkaku primar i vepres penale. Cenim integriteti moral dhe dinjiteti, pune e detyruar ne moshe te kundraligjshme qe degradojne zhvillimin psikiko-fizik te femijes, perplasje me detyrimet, ambjente te ndryshme nga kufijte e ciklit jetesor dhe zhvillimor. Jeta e femijes se mitur, e drejta e patjetersueshme dhe pacenueshmeria, rezikohet nga faktori familje dhe shoqeri. Mundesia e ofrimit te kushteve te tilla; aftesi fizike motorike, komunikim, zgjidhje te problemeve me logjike, aftesi sociale, emeocionale, humbasin karakterin dhe inkurajimin, ne mungese te menaxhimit dhe keqtrajtimit familjar.

Ratio-legis e organit legjislativ qendron ne abservimin e duhur te sanksioneve penale ne marveshje me realitetin e ofruar shqiptar. Subjekti i normes ligjore rendon poziten e prinderve apo cdo personi te lidhur me familjen ne rastin konkret. Mosveprimi si element i anes objektive, jep pasivitetin e bashkefajtorit ne krim. Situata te tilla ekzaminohen nga ekspertet mjeko-ligjot, psikologe, punonjes sociale etj.

2 Neni 124/b I Kodit Penal te RSH

3.3. Mosdhenia e mjeteve per jetese³

Kodi Penal, nepermjet mosdhenies se mjeteve per jetese prek jo vetem mardheniet familjare te rregulluara nga Kodi i Familjes, konkretisht mbi pasojat e zgjidhjes se marteses, detyrimet prinderore dhe bashkeshortore, kujdestarise se prindit ndaj femijes pas zgjidhjes se marteses, me vendim gjyqesor.

Pushteti gjyqesor dhe organet ekzekutive te ketij pushteti kane tagrin e shtregimit ne rast moszbatimi. Subjekti eshte pale e procesit gjyqesor civil, te perfshire penal per shkak te rezikshmerise ose pasojave qe mund te vijne.

Rendi i subjekteve ne kete rreze paraqitet i tille: femijet e mitur kategori e brishte, prinderit e moshuar, te paafte nga ana mjekesore per pune. Mungesa e nje minimum jetik shkakton pasoja te renda, dhe per analogji, konsiderohet si quasi-vjedhje e pasurise vetjake. Bashkeshortet e divorcuar kane detyrime ndaj njeri-tjetrit, kur jane me paaftesi te perkohshme ose te perhershme per pune, qe nuk kane te ardhur apo burime te tjera per te siguruar buxhet aksesor kunder kryesorit.

3.4. Vepra te tjera penale kundrjet femijes

- **Marrja e padejte e femijes⁴**

Marrja e padrejte e femijes, duke e larguar prej personit qe ushtron autoritetin prindror ose qe i eshte besuar per ritje dhe edukim, si dhe mosdorezimi i femijes prindit tjetër ne zbatim te vendimit gjyqesor, perben kundravajtje penale

- **Nderrimi i femijes⁵**

Nderrimi i femijeve i bere me pakujdesi nga personeli ku femijete mbahen per rritje, mjekim ose ne shtepi lindjeje, perben kundravajtje penale

3 Neni 125 I Kodit Penal te RSH

4 Neni 127 I Kodit Penal te RSH

5 Neni 128 I Kodit Penal te RSH

- **Fshehja ose nderrimi me dashje i femijes⁶**

Fshehja ose nderrimi me dashje i femijes denohet me burgim nga tre deri ne tete vjet.

Ne keto tre dispozita ligjore dallohen elemente te perbashket te vepres penale. Objekt jane te gjitha mardheniet juridiko-penale te vedosuara per te mbrojtur interest e femijeve, autoritetin prinderor, mohimin nga e drejta biologjike, ligjore sociale qe i njihet prinderve dhe femijes. Ana objektive realizohet me veprime aktive te drejteperdrejta te autorit, per ardhjen e pasojave. Subjekti dhe ana subjektive lehtesojne identifikimin e vepres. Subjekti eshte i posacem ne shumicen e cilesuar por mund te jete dhe i pergjithshem. Veprat i perkasin personelit mjekesor te fushes se pediatrie, maternitetit.

3.5. Shtytja e te miturit ne krim⁷

Ketu shohim te koordinuar dy problem, e para: krijimi i nje ambjenti qe kercenon dhe rezikon perosonalitetin e te miturit, se dyti: rritjen e kriminalitetit ne prespektiven e brezave.

Kodi mbron interesat me te larta te te miturit, nga ofertat e personave me te ritur per te kryer krim. Korniza ligjore e quan vepren penale me pasoja thjesht formale, pa identifikuar ardhjen e atyre materiale. Thjesht veprimi ne rolin e nxitesit, joshjes perben veper penale. Efekti i pasojave formale, reale dhe praktike, ndihen ne reagimin e te miturit para dhe pas ngjarjes.

3.6. Vrasja per shkak te marrdhenieve familjare

Kjo eshte nje dispozite qe godet ashpër, dhe me drejtesi fenomenet kriminale ne familje. Ajo implementon elementet kryesore te formes se krimit, si ana subjektive, vrasja me dashje te drejteperdrejte ose indirekte, qe bazohet ne deshiren dhe parashikimin e pasojave. Subjektet posacerisht preklamohen ne dispozite.

6 Neni 128/b I Kodit Penal te RSH

7 Neni 129 I Kodit Penal te RSH

Edhe denimi eshte zgjedhur ne perputhje me ratio-homos, me masen 25 vjet deri ne burgim te perjetshem.

Matematika sasiore eshte e barabarte me kualitetin e vepres.

Ne kete veper viktima dhe agresori jane te lidhur me njeri tjetrin si te njohur. Krijimi i raporteve te afersise lejon nderhyrjen e kritereve shkencore aksesore ne plotesimin e krimi: natyra e viktimes, stili i jeteses, rutina e perditshme, pikat e forta dhe te dobeta te karakterit duke i perdorur ne favorin e tij etj.

Ne pergjithesi ambjenti ku realizohet kjo veper eshte nje ambjent i mbylur qe nuk i jep mundesine viktimes qe te reagoje dhe te shmange pasojat.

3.7. Plagosja e rende me dashje dhe plagosja e rende nga pakujdesia⁸

Plagosja e rende me dashje ose nga pakujdesia brenda familjes si cilesim juridik nuk perfshihen ne llojin e vecante te veprave penale kunder familjes, apo ne kodin e familjes.

Dimensioni i gjere i realizimit te kesaj vepre, i jep karakter te pergjithshem ne vepra penale kunder shendetit, te kryera me dashje. Fakti qe ne dispozitat qe parashikojne vepra penale ne fushen e familjes nuk parashikohen keto vepra kjo nuk do te thote qe ato te perjashtohen.

3.8. Vepra te turpshme

Te miturit e rrezikuar nga abuzimet seksuale, ne shkalle te njohjes familjare apo me gjere duke komplikuar procesin seksual hormonal dhe riprodhues. Nga veprime-mjete te ndryshme qe demtojne organet, shendetin e te miturit, e theksuar kjo para pjekurise seksuale. Studimet dhe statistikat kane aritur ne konkluzionin se ky krim ne ¼ e rasteve kryhen nga persona te panjohur. Me se shumti abuzimi ne kto lloj rastesh ndodh nga persona me problem mendore, dhe realizohet ne forme jo te plote por gjithsesi kjo shkakton trauma dhe probleme ne mirerritjen e femijes. Per te mbrojtur femijen nga abuzime te kesaj natyre eshte i nevojshme nje kujdes i vazhdueshem, duke filluar qe nga koha qe jane ende te vegjel.

⁸ Neni 88 dhe 91 I Kodit Penal te RSH

Raporti i femijes me te afermit duhet te jete neutral dhe jo shume i afert. Per femijet qe kane pesuar nje abuzim te kesaj natyre duhet bere nje prezantim me programe dhe skema ligjore per te kerkuar ndihme ne rast abuzimesh.

Veper penale e denueshme eshte dhe kryerja e mardhenieve seksuale me dhune, me te rritur ose midis bashkeshorteve apo bashkejetuesve pa pelqimin e tyre. Mjedisi favorizues ne kete rast eshte familja raporti burre-grua ne sferen intime.

Njohja e afert manipulon lehte viktimen per moskallezim penal ne polici apo prokurori. Nje sere veprash te tjera penale te perfshira ne kete kategori permendim: “mardhenie seksuale apo homoseksuale me te mitur”, “mardhenie seksuale apo homoseksuale me dhune me te mitur”, “Mardhenie seksuale ose homoseksuale me persona ne gjini apo ne kujdestari”.

3.9. Shtrengimi ose pengimi per te bashkejetuar apo lidhur martesë⁹

Nje sjellje e tille rregullohet nga Kodi i Familjes ne titullin “Martesa”. Rregjim qe perfshin klauzola te vecanta, mbi natyren e lidhjes se martesës dhe vlefshmerine e saj.

Pikepamjet e ineterpretimit jane ligjore dhe sociale.

Ne kodin penal kjo dispozite paraqitet ne kete forme: “shtrengimi apo pengimi per te filluar apo vazhduar bashkejetesen ose shtrengimi per te zgjidhur martesën, perben kundravajte penale” ndersa ne Kodin e familjes dispoziten qe ka lidhje me kete pjese e shohim te paraqitur si me poshte:”martesa e lidhur ne kushtet kur njeri nga bashkeshortet gjendet nen ndikimin e kanosjes, pa te cilen nuk do te lidhej martesë, shpallet e pavlefshme.”

9 Neni 130 I Kodit Penal te RSH

Konkluzione

Perfundimisht duhet bere nje thirrje ndaj viktimave te cdo lloj dhune ne familje, grave, nenave, femijeve, qe te vene ne levizje organet kompetente per parandalimin e akteve te metejshme kriminale. Denoncimi qe i perket luftes se perbashket fillon nga vetja. Ne kete rast qendresa ndaj faktit eshte vendimtar ne eliminimin apo zhvillimin e metejshme te fenomenit.

Deklarata per kallezimin e nje krimi te kesaj natyre nuk eshte turp por nje e drejte kushtetuese ligjore, qe mbrohet nga shteti.

Rendesia e trajtimit te ketij fenomeni qendron mes dy dilemave ne antiteze me njera-tjetren. Retrospektiva-perspektiva, paraqitja e dukurive te se kaluaraes-qendrim i perhershem drejt caktut te zhvillimit. Nese mjaftohemi me fabulen e se kaluares thjesht duke i renditur fjalet dhe paraqitur faktet rezikojme te mbetemi aty. Por te dish te germosh ne te kaluaren, te gjesht shkaqet, format, tipologjine, etnogjenezen, dhe te arrish te ristrukturosh dhe te fitosh nga gabimet e se kaluaraes, kjo perben arrijte.

Bibliografi

1. Kushtetuta e Republikes se Shqiperise
2. Kodi Penal i Republikes se Shqiperise (I azhornuar)
3. Kodi i Procedures Penale te Republikes se Shqiperise (I azhornuar)
4. Kodi i Familjes i Republikes se Shqiperise (I azhornuar)
5. E drejta Penale (Pjesa e Posacme) Prof. Dr. Ismet Elezi
6. E drejta Familjare (cikël leksionesh) Sonila Omari
7. Mendimi juridik shqiptare. Dr. Prof. Ismet Elezi. Shtepia botuese "Albin" Tirane 1999

TRASHËGIMIA LIGJORE SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR, ITALIAN DHE ATIJ GJERMAN

MA Nertila Sulce

1. Hyrje

Trashëgimia është një institucion i lashtë që njihet në të drejtën romake në XII Tabelat (viti 303 p.e.r) e ku kishte përparësi e drejta testamentare. Marrëdhëniet e trashëgimisë kanë lindur, atëhere kur lindi pronësia dhe do të ekzistojnë derisa të ekzistojë edhe vetë e drejta e pronësisë. Këto marrëdhënie janë zhvilluar duke ndjekur hapat e zhvillimit të shoqërisë dhe e kanë origjinën e tyre tek bashkësia primitive, megjithëse nuk mund të themi që në atë kohë kishtë të drejtë të mirëfilltë trashëgimie. E drejta feudale njihete vetëm trashëgiminë ligjore dhe referuar statusit juridik të femrës në trashëgim, aplikohet diskriminimi në favor të trashëgimtarit mashkull dhe ky botëkuptim dhe praktikë ka zgjatur deri në shekullin XVIII, përgjithësisht deri në revolucionet borgjeze. Në veprat e juristëve romakë, dispozitat që rregullonin të drejtën trashëgimore bënë pjesë në mënyrat e fitimit të pasurisë, e ashtuqujtura “mortis causa”¹.

Trashëgimia është instituti juridik në bazë të të cilit një ose më shumë persona marrin përsipër të qëniet titullar të trashëgimisë dhe të drejtave që rrjedhin prej saj për shkak të vdekjes së de cuius. Me vdekjen e personit disa të drejta dhe detyrime të tij shuhet, të drejtat dhe detyrimet jo pasurore, ndërsa disa të drejta dhe detyrime të tjera i transmetohen trashëgimtarëve të tij, të

1 Prof.Dr.A.Mandro, "E drejta romake", ribotim i katërt, SHB Emal, Tiranë 2011

drejtat pasurore absolute të të vdekurit². Trashëgimia për shkak të vdekjes përfshin pasurinë e trashëgimlënësit ose të drejta të caktuara të saj, duke përfshirë dhe të drejta reale, në radhë të parë të drejta pronësie. Trashëgimia *mortis causa* është e rregulluar nga norma, të cilat përbëjnë të drejtën e trashëgimisë, degë e të drejtës civile. Norma të tilla janë përgjithësisht të përfshira në Kodin Civil. Personat që janë titullarë të trashëgimisë të trashëgimlënësit ose një pjesë të saj quhen trashëgimtarë.

Në këtë artikull do të bëhet trajtimi i institutit të trashëgimisë kryesisht asaj ligjore sipas legjislacionit shqiptar duke e krahasuar me dy vende si Italia dhe Gjermania.

2. Trajtimi i institutit të trashëgimisë ligjore në Shqipëri

Në Kodin Civil të vitit 1994 marrëdhëniet e trashëgimisë janë rregulluar në pjesën e III, nenet 316-418.

Kuptimi i trashëgimisë si institut i të drejtës civile jepet në nenin 316 që thotë: “*Trashëgimia është kalimi me ligj ose me testament i pasurisë (trashëgimit) të personit të vdekur një ose më shumë personave (trashëgimtarë), sipas rregullave të caktuara në këtë Kod*”.

Trashëgimia me ligj zbatohet në ato raste kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament, ose ka lënë testament vetëm për një pjesë të pasurisë së tij, ose në rastet kur testamenti është shpallur pjesërisht apo tërësisht i pavlefshëm. Trashëgimia çelet në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit dhe rregullohet sipas ligjit të kohës kur është çelur, pra ligjit të kohës së vdekjes së trashëgimlënësit.³ Ka zotësi për të trashëguar personi që ka lindur gjallë në kohën e çeljes së trashëgimisë dhe që është në radhën e trashëgimtarëve ligjorë në rastin e trashëgimisë me ligj dhe të jetë trashëgimtar i caktuar me testament, në rastin e trashëgimisë testamentare. Thirrja e trashëgimtarëve ligjorë në trashëgim bëhet sipas kësaj radhe: Në radhë të parë thirren fëmijët, fëmijët e fëmijëve dhe bashkëshorti. Me fëmijë barazohen edhe të birësuarit, birësimi i të cilëve është bërë ligjërisht, të cilët nuk mund të trashëgojnë familjen e origjinës dhe as ajo nuk mund

2 Francesco Galgano “E drejta private”, Tiranë 2006, fq.964

3 Neni 318 i Kodit Civil

të trashëgojë ata. Në radhë të dytë thirren bashkëshorti kur është i vetmi trashëgimtar i radhës së parë, prindërit dhe personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit. Në radhë të tretë thirren në trashëgim personat e paaftë për punë, gjyshi dhe gjyshja, vëllezërit dhe motrat, si dhe fëmijët e vëllezërve dhe motrave të paravdekur. Në radhë të katërt thirren në trashëgim stërgjyshërit dhe stërgjyshet si dhe fëmijët e vëllezërve dhe motrave. Në radhë të pestë do të thirren të afërmit e tjerë deri në shkallë të gjashtë. Në radhë të gjashtë thirret shteti (neni 366). Në bazë të nenit 369 trashëgimtarët e një radhë të mëpasme thirren në trashëgim vetëm kur nuk ka trashëgimtarë të radhës së mëparshme. Trashëgimtarët e radhës së mëpasme thirren në trashëgim edhe kur trashëgimtarët e radhës së mëparshme janë deklaruar të padenjë për të trashëguar, kanë hequr dorë nga trashëgimi ose janë përjashtuar nga trashëgimi dhe në atë radhë nuk ka trashëgimtarë të tjerë.

Rezerva ligjore

Rezerva ligjore është kufizimi i lirisë së testatorit dhe detyrimi i tij që me anë të testamentit mos të përjashtojë nga trashëgimia fëmijët e tij të mitur, të paslindurit e tjerë të mitur në rastet kur ata trashëgojnë me zëvendësim, personat e paaftë për punë në rast se thirren në trashëgim, si dhe të mos çënojnë në asnjë mënyrë pjesën që u takon këtyre personave, me përjashtim të rasteve kur këta persona janë shpallur të padenjë për të trashëguar⁴.

Në momentin që çënohet rezerva ligjore nga ana e trashëgimlënësit testamenti është i pavlefshëm dhe ky është një konstatim që duhet të bëhet edhe nga gjykata.

3. Trajtimi i institutit të trashëgimisë ligjore në Itali

Tërësia e marrëdhënieve juridike që si pasojë e vdekjes së personit u transmetohen trashëgimtarëve të tij, quhet pasuri trashëgimore. Personi, të cilit i përkiste kjo pasuri merr emrin trashëgimlënës, ndërsa nëse trashëgimtarët janë më shumë se një quhen bashkëtrashëgimtarë.

⁴ Neni 379 i Kodit Civil

Personat, të cilët janë titullarë të të drejtave të caktuara, si reale dhe të kreditit quhen legatarë. *De cuius* duhet të jetë patjetër një person fizik, ndërsa trashëgimtarët dhe legatarët mund të jenë dhe persona juridikë. Nëse trashëgimtari është titullar i gjithë trashëgimisë ose një pjese të saj, në të gjitha raportet juridike aktive e pasive, të *de cuius*, duke marrë përsipër si të drejtat, ashtu dhe detyrimet, kemi të bëjmë me një trashëgimi me titull universal. Në rastin e legatarit, kemi të bëjmë me një trashëgimi me titull të veçantë, jo shumë të ndryshme nga ajo që ndodh në rastet e transferimeve të së drejtës mes të gjallëve. Trashëgimia çelet në momentin e vdekjes së personit, pikërisht në vendbanimim e fundit të tij (neni 456).

Në bazë të nenit 457/1 "*trashëgimia kalon ose nëpërmjet ligjit ose testamentit*". Në rastin e parë, kalimi nëpërmjet ligjit, trashëgojnë të afërmit e trashëgimlënësit, të ashtuquajturit trashëgimtarë të ligjshëm (neni 457/2); në rastin e dytë personi i vdekur duke disponuar pasurinë nëpërmjet testamentit ose dhurimit ka dëmtuar të drejtat që ligji u njeh të afërmeve të tij të caktuar, të ashtuquajtur trashëgimtarë ligjorë. Në të drejtën italiane me trashëgimi ligjore (Lat. *Successio ab intestato*) kemi të bëjmë kur personi i vdekur (ose *de cuius*) nuk ka marrë masat për të bërë testament, ose dhe kur ka bërë ai është absolutisht i pavlefshëm, anulohet ose bën testament vetëm për një pjesë të pasurisë.

Njihen tre forma të kalimit të trashëgimisë: a) trashëgimia testamentare: në qoftë se trashëgimlënësi ka bërë testament, trashëgimia i kalon personit ose personave të treguar në testament (neni 587); b) trashëgimia ligjore; c) trashëgimia e domosdoshme që e ndeshim në dy raste: 1) nëse trashëgimlënësi ka bërë testament, por ka lënë pas dore të afërm të tij të caktuar, të cilëve ligji u njeh të drejtën e trashëgimisë, brenda një kuote të caktuar trashëgimore; 2) nëse ai duke vdekur pa bërë testament, gjatë jetës së tij ka dhuruar të mira materiale në një masë të tillë që çënojnë të drejtën e trashëgimisë të të afërmeve.

Radha e thirrjes në trashëgim është: a) nëse ka fëmijë të ligjshëm natyralë ose të adoptuar, pasuria trashëgimore u kalon atyre në pjesë të barabarta; bashkëshortit nëse jeton i kalon gjysma ose 1/3 e pasurisë sipas rasteve nëse konkuron me një

fëmijë ose me shumë fëmijë; b) nëse nuk ka fëmijë 2/3 i kalojnë bashkëshortit dhe 1/3 u kalon prindërve, vëllezërve dhe motrave (nëse mungojnë prindërit, vëllezërit dhe motrat e gjithë pasuria i kalon bashkëshortit); c) nëse nuk ka fëmijë, as bashkëshort të gjallë, trashëgojnë prindërit, vëllezërit e ligjshëm dhe motrat e ligjshme (nëse mungojnë prindërit, e gjithë pasuria u kalon vëllezërve dhe motrave; nëse mungojnë vëllezërit dhe motrat pasuria i kalon prindërve). d) nëse asnjëri prej këtyre nuk është i gjallë, pasuria trashëgimore i kalon të afërmeve farefisnorë, pa dallim linje të drejtë ose të zhdrejtë, duke filluar nga shkalla më e afërt e deri në shkallën e gjashtë. Kur nuk të afërm në shkallën brenda shkallës së gjashtë pasuria trashëgimore i kalon shtetit⁵.

Kuotat e ndarjes

Këto janë të ndryshme në varësi të njerëzve që bashkëjetojnë pas de cuius:

- *pasardhësit por jo bashkëshorti*: trashëgimia është e ndarë në pjesë të barabarta mes fëmijëve. Nëse një fëmijë është i para vdekur dhe ka fëmijë të tij, ata trashëgojnë pjesën që do i takonte prindit të tyre duke e ndarë mes tyre në pjesë të barabarta, në bazë të së drejtës së përfaqësimit⁶. Kjo përcakton që fëmijët (dhe për të njëjtën të drejtë të gjithë pasardhësit) zëvendësojnë prindin që nuk mundet (për shkak të vdekjes ose përjashtimit për padenjësi) ose nuk do (për heqje dore) të trashëgojë.

Në praktikë midis pasardhësve ndodh një ndarje në bazë të shkallës që vihet përballë ndarjes së brezave dhe barqeve.

Shkalla ka të bëjë me një varg gjërash a dukurish që përbëjnë një të tërë dhe shkallë njerëzish është e njëjtë me breza njerëzish. Brezi është tërësia e të lindurve të një gjaku kundrejt pasardhësve dhe paraardhësve të tyre. Me bark kuptojmë tërësinë e fëmijëve që lind një nënë me një burrë. Për shembull, nëse de cuius ka një djalë të gjallë e tre nipër nga një djalë i paravdekur, djalë i gjallë do të ketë gjysmën e trashëgimisë dhe nipërit 1/6 secili.

Nuk ka dallim mes fëmijëve natyrorë, fëmijëve të ligjshëm; fëmijët e birësuar trashëgojnë nga birësuesit, por jo nga familjarët

⁵ Francesco Galgano "E drejta private", Tiranë 2006, fq.993

⁶ Kodi Civil nenet 467-469

e tyre.

- *pasardhësit e bashkëshortit*: bashkëshortit i takon gjysma e trashëgimisë nëse konkurren me një fëmijë të vetëm, $1/3$ nëse fëmijët janë dy ose më shumë. Ndarja mes fëmijëve bëhet si në rastin e përmendur më sipër dhe vlen gjithmonë e drejta e përfaqësimit (për fëmijët jo për bashkëshortin).

Për shembull, nëse de cuius ka bashkëshort, dy djem (ose vajza) dhe dy nipër nga një fëmijë i paravdekur, bashkëshortit i takon $1/3$, fëmijëve të gjallë $1/9$ secilit ($1/3$ e $2/3$) e nipërve $1/9$ secilit (gjysma e një të tretës së $2/3$).

- *bashkëshorti, por jo pasardhësit, paraardhësit ose të afërm të tjerë*: bashkëshortit i takon e gjithë trashëgimia (neni. 583 c.c.).

- *bashkëshorti, paraardhësit ose të afërm të tjerë, por jo pasardhësit*: bashkëshortit i shkojnë $2/3$, paraardhësve ose të afërmeve të tjerë⁷ $1/3$ (neni. 582 c.c.).

- *paraardhësit ose të afërm të tjerë, por jo bashkëshorti dhe pasardhësit*: e gjithë trashëgimia ndahet mes paraardhësve ose të afërmeve të tjerë. Ndarja ndjek këto rregulla: në përgjithësi, vëllezërit, motrat dhe prindërit e gjallë trashëgojnë në pjesë të barabarta, por prindërve ose dhe vetëm njërit i takon të paktën gjysma e trashëgimisë. Për pasardhësit e vëllezërve dhe motrave gjithashtu vlen e drejta e përfaqësimit. Për shembull, dy prindër dhe një djalë ndajnë trashëgiminë në tre pjesë të barabarta; një prind dhe një vëlla në dy pjesë të barabarta; dy prindër dhe dy vëllezër në katër pjesë të barabarta; një prind dhe dy vëllezër: gjysmë prindit, $1/4$ vëllezërve; dy prindërve dhe tre vëllezërve: $1/4$ secilit prej prindërve, $1/6$ secilit prej vëllezërve.

Në vend të vëllezërve të paravdekur trashëgojnë nipërit e tyre ose pasardhësit e tyre. Nëse për shkak të vdekjes ose të heqjes dorë nuk janë prindërit, por gjyshërit ose paraardhës të tjerë, atyre u takon pjesa që do i takonte një prindi të vetëm (kështu që nëse gjyshërit konkurrojnë me një vëlla të vetëm, këtij të fundit i takon gjysma e trashëgimisë, ndërsa nëse do të konkurronte me të dy prindërit do t'i takonte vetëm $1/3$).

Një prind i vetëm i gjallë që pranon trashëgiminë përjashton dhe gjyshërit e radhës së mëparshme (vepron kriteri i përgjithshëm

⁷ Me të afërm të tjerë nënkuptohet një kategori e tretë ku bëjnë pjesë: dajot, tezet, xhaxhallarët, hallat dhe kushurinjtë. Nuk bëhet dallim midis të afërmeve nga ana e nënës apo babait.

që radha pasardhëse përjashton radhën e mëparshme).

Ndarja bëhet mes paraardhësve të të njëjtës radhë dhe nëpërmjet linjave (gjysma i takon linjës amësore dhe gjysma linjës nga babai, duke përshkuar pemën gjenealogjike: për shembull, nëse ka një gjysh nga ana e babait dhe dy gjyshër nga ana e nënës, të parit i takon sa të tjerëve të bërësë bashku.

Të njëjtat rregulla vlejné për të ndarë kuotën e një të tretës që prindërve e/ose paraardhësve iu takon në prani të bashkëshortit: në këtë rast kuota minimale e paraardhësve është një e katërta, kurse ajo e të afërmve të tjerë në prani të paraardhësve reduktohet ne 1/12.

- Vëllezërit me baba dhe mama të ndryshme kanë gjysmën e vëllezërve gjermenë. Për shembull, nëse de cuius lë pas babanë, gjyshen nga ana e nënës, një vëlla me prindër të ndryshëm, një vëlla gjermenë dhe dy nipër nga një vëlla tjetër gjermenë të paravdekur, babai do ketë gjysmën e pasurisë, gjyshja nga ana e nënës nuk do marri asgjë, vëllai gjermenë një të pestën, vëllai tjetër një të dhjetën, dy nipërit një të dhjetën secili.

- *të afërm të tjerë deri në shkallë të gjashtë*: këtu vlen rregulli i përgjithshëm sipas të cilit trashëgimtarët e radhës pasardhëse përjashtojné ata të radhës paraardhëse dhe nuk vlen e drejta e përfaqësimit. Për këtë arsye, për shembull, nipërit dhe stërnipërit (që për përfaqësim janë të radhës së dytë edhe se duhet të ishin të të tretës ose të të katërtës) përjashtojné xhaxhallarët (që janë të të tretës); kushurinjtë (që nuk marrin të drejtat e xhaxhallarëve, sepse nuk vlen përfaqësimi) janë të përjashtuar nga xhaxhallarët. Midis të afërmve në të njëjtën radhë ndarja bëhet në bazë të brezave dhe jo në bazë të barqeve: për shembull, nëse ka dy dajo dhe tre xhaxhallarë, secili do të marrë 1/5 e trashëgimisë. Në praktikë radha e përparësisë është:

- më përpara xhaxhallarët (radha e tretë);
- më pas kushurinjtë e parë dhe stërxhaxhallarët (radha e katërt);
- më pas fëmijët e kushurinjve, kushurinjtë e prindërve (kushurinjtë të dytë) dhe vëllezërit e stërgjyshërve (radha e pestë);
- nipërit e kushurinjve, nipërit e stërxhaxhallarëve (pra kushurinjtë e dytë), kushurinjtë e gjyshërve dhe vëllezërit e stërgjyshërit të trashëgimisë ligjore.

- Nëse asnjëri nga këta të afërm nuk është i gjallë dhe nuk ekziston një testament, trashëgimia i kalon shtetit.

Janë të përjashtuar nga trashëgimia persona të tillë si: dhëndri, nusja, vjehrra, kunati etj.

Rezerva ligjore

Nëse trashëgimlënësi ka një bashkëshort ose ka pasardhës ose paraardhës, një kuotë e pasurisë trashëgimore u rezervohet atyre edhe kundër vullnetit të shprehur të trashëgimlënësit.

Kjo kuotë quhet *rezervë ligjore*, ndërsa pjesa tjetër e pasurisë trashëgimore, e cila mund të disponohet lirisht nga trashëgimlënësi quhet *kuotë e disponueshme*.

Në bazëtë nenit 536 kanë të drejtë të trashëgojnë rezervën ligjore: bashkëshorti, fëmijët e ligjshëm, natyralë dhe të adoptuar, paraardhësit e ligjshëm (duke përjashtuar paraardhësit natyralë) dhe ata të adoptuar (duke përjashtuar të adoptuarit në moshë madhore). Në lidhje me rezervën ligjore ligji bën dallim nëse bëhet fjalë për fëmijët, bashkëshortin ose paraardhësit.

Bëhet dallimi:

- nëse trashëgimlënësi ka vetëm një fëmijë këtij i takon gjysma e pasurisë trashëgimore.

- nëse trashëgimlënësi ka më shumë se një fëmijë, këtyre do iu takojë një kuotë baraz me $\frac{2}{3}$ e trashëgimisë.

- nëse trashëgimlënësi nuk ka fëmijë, por vetëm paraardhës të ligjshëm, këtyre u takon $\frac{1}{3}$ e pasurisë trashëgimore.

- nëse trashëgimlënësi ka vetëm bashkëshortin, këtij i takon gjysma e pasurisë trashëgimore.

- nëse përveç bashkëshortit trashëgimlënësi ka një fëmijë, këtij i takon $\frac{1}{3}$ e trashëgimisë dhe bashkëshortit $\frac{1}{3}$ tjetër.

- nëse përveç bashkëshortit trashëgimlënësi ka dy ose më shumë fëmijë, bashkëshortit do t'i takojë $\frac{1}{4}$ e trashëgimisë, ndërsa fëmijëve iu takon gjysma.

- nëse bashkëshorti konkurron me paraardhësit (kur nuk ka fëmijë), këtyre u takon gjysma e pasurisë trashëgimore, ndërsa paraardhësve u takon $\frac{1}{4}$. Në rastin kur personi që bën testament prek rezervën ligjore duke përdorur sipas dëshirës më shumë

se çbyn në kuotën e disponueshme, trashëgimtarët e ligjshëm mund të ngrenë *reduktim të kuotave*. Reduktimi i kuotave (neni 553 e në vazhdim) është një e drejtë që ligji ua njeh trashëgimtarëve ligjorë për të rimarrë kuotën ligjore nëpërmjet reduktimit të kuotave të trashëgimtarëve të ligjshëm (neni 553), disponimeve testamentare (neni 554), ose dhurimeve (neni 558) të bëra nga trashëgimlënësi. Kuotat e trashëgimtarëve të ligjshëm, disponimet testamentare dhe dhurimet eventuale të trashëgimlënësit reduktohen përpjestimisht në kufijtë e domosdoshëm për të plotësuar kuotën që u është rezervuar trashëgimtarëve të ligjshëm. Kuota e rezervuar trashëgimtarit të ligjshëm duhet të zvogëlohet nga dhurimet që ai ka marrë nga trashëgimlënësi, deri në atë pikë sa ai mund të humbasë të drejtën e trashëgimisë, në qoftë se vlera e të mirave materiale dhe e dhurimeve që ai ka marrë nga trashëgimlënësi gjatë jetës, të jetë e barabartë me kuotën që i rezervon ligji.⁸

Reduktimi i kuotave është një veprim matematikor-kontabël që i jep pasurisë së de cuius vlerën e asetëve duke zbritur detyrimet (i ashtuquajtur relictum) dhe të gjitha dhurimet e bëra nga ai gjatë jetës (të ashtuquajtura donatum).

Shuma e relictum dhe donatum përfaqëson pasurinë trashëgimore. Veprimi i reduktimit i nënshtrohet afateve të parashkrimit që janë dhjetë vjet.

- Ka pasur mospërputhje në doktrinë dhe jurisprudencë në lidhje se me cilin moment, duhet të lidhet ecja e afatit të parashkrimit, ai i çeljes së trashëgimisë apo i publikimit të testamentit.

Këtë gjë e kanë zgjidhur Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që kanë konsideruar si moment të ecjes së parashkrimit në rastin e disponimit testamentar, momentin kur trashëgimtari pranon trashëgiminë e de cuius dhe në rastin e dhurimit, momentin kur çelet trashëgimia. Veprimi i reduktimit drejtohet në radhë të parë drejt disponimeve testamentare dhe nëse ato nuk janë të mjaftueshme trashëgimtari ligjor drejtohet drejt dhurimeve.

Dhurimet reduktohen duke filluar nga dhurimi i fundit dhe duke u ngjitur në ato të mëparshme (neni 559).

8 Francesco Galgano "E drejta private", Tiranë 2006, fq.996

Nga paefektshmëria e disponimit të kundërshtuar me padinë e reduktimit rrjedh detyrimi i përfituesit të disponimit të deklaruar të paefektshëm që të kthejë pasurinë e patundshme që formonte objekt të aktit të disponimit; përsa i përket këtij kthimi, favorizohet kthimi në natyrë (neni 560).

4. Trajtimi i institutit të trashëgimisë në Gjermani

Kodi Civil Gjerman BGB (Bürgerlichesgesetzbuch) është i ndarë në pesë libra⁹ dhe e drejta e trashëgimisë trajtohet në librin e pestë (Erbrecht). Neni 1922/1 i Kodit Civil Gjerman thotë: ”*Me vdekjen e një personi, prona e atij personi (trashëgimia) kalon si një e tërë në një ose më shumë persona të tjerë (trashëgimtarët).*” Kanë të drejtë të jenë trashëgimtar vetëm personat që kanë lindur gjallë në momentin e çeljes së trashëgimisë dhe personat, të cilët nuk janë gjallë në momentin e çeljes së saj, por janë konceptuar dhe kanë lindur gjallë përpara çeljes së saj¹⁰. Njëlloj si në Itali, ku trashëgimia çelet në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit, në vendbanimin e fundit të tij, sipas ligjit gjerman gjithashtu gjykata kompetente e trashëgimisë është ajo e vendbanimit të fundit të *de cuius*.

Një përjashtim është parashikuar në Land del Baden-Württemberg, në të cilën kompetente për trashëgiminë janë “noterët shtetërorë”, në cilësinë e gjyqtarëve të trashëgimisë¹¹. Detyra kryesore e gjyqtarit të trashëgimisë është ajo e lëshimit të “çertifikatës së trashëgimisë” (Erbschein) dokument zyrtar, që përcakton se cilët janë trashëgimtarët dhe cilat janë kufizimet në lidhje me trashëgiminë.

Ai ka njërëndësi të madhe në kuptimin që ndryshime të mundshme legjislative pas hartimit të dokumentit, nuk vlejnë për trashëgiminë e hapur. Sipas të drejtës gjermane trashëgimtarët e *de cuius* janë të ndarë në bazë të radhëve farefisnore.

Ata të një radhe të mëpasshme përjashtojnë ata të një radhe të mëparshme.

⁹ Libri i parë-pjesa e përgjithshme ((Allgemeiner Teil), libri i dytë-disiplina e detyrimeve dhe kontratave (Recht der Schuldverhältnisse), libri i tretë-e drejta e të mirave dhe e pronësisë (Sachenrecht), libri i katërt-e drejta e familjes (Familienrecht) dhe libri i pestë-e drejta e trashëgimisë.

¹⁰ Neni 1923 Kodi Civil Gjerman

¹¹ <http://www.legalsl.com>

Trashëgimtarët e radhës së parë janë: pasardhësit trashëgim lënësit (fëmijët e ligjshëm, natyrorë ose të adoptuar, nipërit, stërnipërit etj).¹²

Trashëgimtarët e radhës së dytë janë: paraardhësit (prindërit), vëllezër e motra, përfshirë dhe pasardhësit e tyre.

Trashëgimtarët e radhës të tretë janë: gjyshërit, xhaxhallarët (dajot) dhe kushurinjtë të trashëgimlënësit.

Paraardhësit e gjyshërve nuk kanë asnjë të drejtë trashëgimie nëse trashëgon bashkëshorti i trashëgimlënësit.

Trashëgimtarë të radhës së katërt janë stërgjyshërit dhe pasardhësit e tyre. Trashëgimtarët e radhës së katërt nuk kanë asnjë të drejtë trashëgimie, nëse trashëgimlënësi ishte i martuar në momentin e vdekjes. Trashëgimtari nuk mund të heqë dorë nga trashëgimia nëse e ka pranuar atë ose periudha e heqjes dorë nga trashëgimia ka kaluar.¹³ Periudha e heqjes dorë mund të ushtrohet brenda gjashtë javëve kur trashëgimtari ka marrë vesh për trashëgiminë dhe titullin si trashëgimtar.

Nëse trashëgimlënësi e ka pasur vendbanimin e fundit jashtë shtetit ose trashëgimtari banon jashtë, periudha e heqjes dorë është gjashtë muaj¹⁴.

Trashëgimia e bashkëshortit të mbijetuar

Për bashkëshortin pasjetues vlen një rregull i veçantë; ligji parashikon që nëse bashkëshortët kanë jetuar nën një regjim ligjor të raporteve pasurore, në të ashtuquajturën "Zugewinnngemeinschaft–bashkësi e plusvlerave" parashikon:

- $\frac{1}{2}$ e trashëgimisë nëse ka pasardhës (fëmijë);
- $\frac{3}{4}$ e trashëgimisë nëse ka trashëgimtarë nga ana e prindërve ose pasardhës të tyre;
- $\frac{3}{4}$ e trashëgimisë nëse janë trashëgimtarë gjyshërit;
- $\frac{3}{4}$ e trashëgimisë + kuota e xhaxhallarëve (dajove) dhe pasardhës të tyre nëse ka një gjysh dhe trashëgimtarë nga ana e xhaxhallarëve;

12 Neni 1924 e në vazhdim i Kodit Civil Gjerman

13 Neni 1943 i Kodit Civil Gjerman

14 Neni 1944 Kodi Civil Gjerman

- e gjithë trashëgimia nëse nuk ka pasardhës, as prindër e gjyshër; stërgjyshërit nuk janë trashëgimtarë ligjorë.

Rezerva ligjore

Trashëgimia ligjore ndodh në favor të disa kategorive, të cilëve ligji iu njeh të drejtën për të trashëguar një pjesë të pasurisë, pavarësisht nga dispozitat e testamentit.

Trashëgimtarë ligjorë janë bashkëshorti pasjetues, fëmijët e ligjshëm dhe pasardhësit e tyre, fëmijët natyrorë dhe pasardhësit e tyre, si dhe prindërit e trashëgimlënësit. Kuota është 50% e trashëgimisë ligjore.

Pakti i trashëgimisë

Në Gjermani përveç testamentit, mundësia e dytë për të shfaqur vullnetin është pakti i trashëgimisë, pasojat ligjore të të cilit ndryshojnë nga ato të testamentit.

Pakti i trashëgimisë është një marrëveshje midis dy ose më shumë personave me anë të së cilës një subjekt vendos për trashëgiminë e vet. Ky është një veprim juridik i njëanshëm që bëhet nëpërmjet një akti të fundit vullneti jo të modifikueshëm, në mënyrë të njëanshme nga deklaruesi. Kjo është karakteristika që e dallon nga testamenti, që mund të revokohet në çdo moment. Pakti i trashëgimisë është një akt publik dhe lidhet personalisht nga palët para noterit.

Çertifikata e trashëgimisë

Çertifikata e trashëgimisë dëshmon statusin e trashëgimtarit në planin juridik. Zyrat kadastrale, bankat dhe në disa raste dhe institucionet e sigurimeve shoqërore, në raste trashëgimie, para se të procedojnë me transkriptimin e pasurive ose me pagimin e shumës së detyruar iu kërkojnë trashëgimtarëve të paraqesin çertifikatën e trashëgimisë. Kjo çertifikatë lëshohet nga gjykata kompetente për trashëgiminë, nëpërmjet kërkesës formale që bëhet pranë kësaj gjykate.

Në 02.07.2009 Bundestag miratoi ligjin për reformën për të drejtën e trashëgimisë dhe ndryshime në rastin e kufizimeve, ligj i cili mori miratimin dhe të Bundesrat më 18.09.2009. Reforma e vitit 2009¹⁵ u bë duke pasur parasysh ndryshimet dhe zhvillimet që pësoi shoqëria në vitet e fundit.

Para reformës testatori mund të përjashtonte vetëm kush ishte përgjegjës për: 1) një krim kundër jetës së tij, bashkëshortit të tij ose fëmijëve të ligjshëm; 2) keqtrajtime të mëdha në dëm të njërit prej këtyre personave; 3) shkelje të detyrimit për mbajtjen e testatorit nga ana e të detyruarit; 4) të pasurit e një jete të pamoralshme ose kundër rregullave të moralit.

Ky shkak i fundit i përjashtimit nga trashëgimia shumë i kritikuar për paqartësinë e tij u shfuqizua me reformën e vitit 2009 dhe në vend të tij u përfshi një arsye tjetër përjashtimi, që ka të bëjë me dënimin me të paktën një vit të personit që nuk i është dhënë dënimi me kusht. Sipas ligjit tëri për sa i përket dhurimit, për legjitimimin e tij merret parasysh nëse trashëgimia hapet brenda një viti nga fakti i dhurimit; më pas llogaritet 1/10 më pak çdo vit. Një përjashtim në fakt parashikohet për dhurimet midis bashkëshortëve për të cilët llogaritja e kohës fillon jo nga dhurimi, por nga data e divorcit ose e vdekjes së bashkëshortit. Para reformës vetëm fëmijët kishin të drejtë për një rritje të kuotës së tyre të trashëgimisë nëse kishin ndihmuar prindërit e tyre në nevojë dhe ndërkohë nuk ishin marrë me aktivitetin e tyre profesional. Tani çdo trashëgimtar i ligjshëm ka të drejtë për rritje të kuotës së tij të trashëgimisë si shpërblim për ndihmën e dhënë trashëgimlënësit, edhe nëse nuk ka hequr dorë nga aktiviteti profesional gjatë periudhës që ka asistuar de cuius.

Nëse trashëgimia përbëhet nga një pasuri e paluajtshme ose një kompani i thirruri në trashëgim mund të kërkojë që t'i bëhet shtyrja e pagesës në para të kuotës që i përket trashëgimtarëve të tjerë. Ndërkohë që përpara reformës, arsyeja për kërkesën për shtyrje pagese ishte ekzistenca e një situatë barre të veçantë, tani gjyqtari mund t'i referohet kriterëve të barazisë për vlerësimin e bazueshmërisë të kërkesës së shtyrjes; në këtë mënyrë evitohet që kush trashëgon shtëpinë familjare apo kompaninë, shpesh është i

¹⁵ Ligji hyri në fuqi më 01.01.2010.

detyruar që të shesi nën kosto atë që ka trashëguar për të kënaqur brenda një kohe të shkurtër pretendimet e trashëgimtarëve të tjerë. Me reformën e re u disiplinua trashëgimia e shtetit.

Nëse në momentin e hapjes së trashëgimisë, nuk ka as të afërm, as bashkëshort ose persona të tjerë të lidhur me *de cuius* dhe as testament, trashëgimtar është Landi, në të cilin trashëgimlënësi kishte vendbanimin e fundit, ose kur nuk është e verifikueshme Landi në të cilin kishte vendbanimin e zakonshëm trashëgimtar është shteti federal.

Gjërat e përbashkëta dhe dallimet midis trashëgimisë në Shqipëri, Itali dhe në Gjermani

Si në Shqipëri, Gjermani dhe Itali trashëgimia kalon tek trashëgimtarët nëpërmjet ligjit ose testamentit. Italia në dallim nga dy vendet e tjera njihet dhe një lloj tjetër trashëgimie që është *trashëgimia e domosdoshme*, ndërkohë që në Gjermani zbatohet edhe *pakti i trashëgimisë*. Pakti i trashëgimisë nuk lejohet në bazë të legjislacionit Italian Sistemet juridike të këtyre vendeve njohin dy tipe kryesore të testamentit: 1) ollograf, pra të shkruar nga dora e testatorit; 2) testamenti i bërë përpara noterit.

Sipas të treja legjislacioneve janë trashëgimtarë vetëm personat që kanë lindur gjallë në momentin e çeljes së trashëgimisë dhe personat të cilët nuk janë gjallë në momentin e çeljes së saj, por janë konceptuar dhe kanë lindur gjallë përpara çeljes së saj. Trashëgimia çelet në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit, në vendbanimin e fundit të tij dhe gjykata kompetente e trashëgimisë është ajo e vendbanimit të fundit të *de cuius*. Një përjashtim është parashikuar për Gjermaninë ku në Land del Baden-Württemberg, kompetente për trashëgiminë janë “noterët shtetërorë”, në cilësinë e gjyqtarëve të trashëgimisë. Detyra kryesore e tyre është ajo e lëshimit të “çertifikatës së trashëgimisë” (Erbschein)

Sipas legjislacionit shqiptar në radhë të dytë thirren përveç trashëgimtarëve të tjerë dhe personat e paafte për punë në ngarkim të trashëgimlënësit, të cilët mund të thirren dhe në radhën e tretë. Kjo kategori trashëgimtarësh nuk njihet nga

dy legjislacionet e tjera. Në rastin kur trashëgimlënësi nuk ka trashëgimtarë të tjerë pasuria trashëgimore i kalon shtetit. Gjermania bën dallim se trashëgimtar është Landi, në të cilin trashëgimlënësi kishte vendbanimin e fundit dhe në rastin kur nuk është e verifikueshme Landi në të cilin kishte vendbanimin e zakonshëm trashëgimtari, pasuria i kalon shtetit federal.

Sipas të drejtës gjermane e drejta për rezervën ligjore u takon si pasardhësve, prindërve, bashkëshortit të *de cuius* në rastin kur këta janë përjashtuar në bazë të një testamenti. E drejta italiane iu rezervon një kuotë të caktuar bashkëshortit, paraardhësve dhe pasardhësve. Në ndryshim nga këto dy legjislacione, rezerva ligjore në Shqipëri njihet vetëm për fëmijët e mitur të trashëgimlënësit, të paslindurit e tjerë të mitur kur ata trashëgojnë me zëvendësim dhe personat e paaftë për punë nëse thirren në trashëgimi.

Ndryshimi ndërmjet legjislacionit italian dhe gjerman në lidhje me rezervën ligjore është qënë të drejtën gjermane trashëgimtarët e ligjshëm, mund të kërkojnë rezervën e tyre ligjore ekskluzivisht në formën e një shume parash që i korrespondon vlerës që u takon. Sipas të drejtës italiane ata kanë të drejtën në çdo rast të një kuote të të mirave të trashëgimisë.

Përjashtimi nga trashëgimia ndodh pas një shprehje vullneti të dhënë nga *de cuius* në testament (e ashtuquajtura dispozitë negative) dhe përjashton nga mundësia për të qënë trashëgimtar atë person që mund të ishte si pasojë e trashëgimisë ligjore. Përjashtimi nuk ishte marrë nga Kodi i Napoleonit dhe akoma sot shumë legjislacione që bazohen në atë kod si Italia e pranojnë vetëm në masën që nuk i privon të legjitimuarit nga kuota e tyre e rezervës ligjore¹⁶. Përjashtimi nga trashëgimia është e pranuar nga legjislacione të tjera të civil law (Gjermania, Spanja, Austria, Zvicra, Greqia etj) dhe legjislacionet e common law, edhe ndaj të legjitimuarve të caktuar duke ndjekur një arsye të fortë ose motive të rënda. Në legjislacionin e Shqipërisë njihet sistemi i fitimit të trashëgimit në çastin e çeljes së saj.

Në Gjermani gjithashtu trashëgimtari merr përsipër trashëgiminë e trashëgimlënësit në momentin e çeljes së saj,

¹⁶ Në Itali para 2012 Gjykata e Apelit nuk e parashikonte përjashtimin nga trashëgimia të jo të legjitimuarve nëse nuk ishte e shoqëruar nga kontestimi i një trashëgimtari tjetër.

përveç rastit kur ai heq dorë nga trashëgimia¹⁷.

Përkundrazi në legjislacionin e Italisë trashëgimtari bëhet i tillë vetëm në momentin pas çeljes së trashëgimisë, e në këto raste kemi të bëjmë me pranimin e trashëgimisë.

Në legjislacionin e Italisë në rastin e cënimit të rezervës ligjore trashëgimtarëve ligjorë iu njihet e drejta e një veprimi reduktimi mbi disponimet testamentare, dhurimet dhe veprimi mund të preki dhe të mirat e fituara nga perona të tretë, ndërsa në legjislacionin e Gjermanisë parashikohet që trashëgimtarët ligjorë kanë thjesht një të drejtë krediti ndaj trashëgimtarëve testamentarë që përjashton mundësinë e veprimit kundrejt personave të tretë. Në legjislacionin shqiptar në momentin e cënimit të rezervës ligjore testamenti shpallet i pavlefshëm nga gjykata.

Përfundime

1. Me vdekjen e trashëgimlënësit si në legjislacionin shqiptar, italian dhe atë gjerman ndodh kalimi i pasurisë trashëgimore, i të drejtave dhe detyrimeve të saj, nga de cuius tek trashëgimtarët e tij.
2. Në të treja legjislacionet njihet kalimi i trashëgimisë me anë të ligjit ose me testament. Trashëgimia ligjore ndodh në rastet nëse mungon testament është plotësisht apo pjesërisht i pavlefshëm.
3. Me çeljen e trashëgimisë përcaktohet rrethi i trashëgimtarëve dhe pjesa që i takon secilit prej tyre.
4. Rezerva ligjore është ajo kuotë e pasurisë e trashëgimore, që i kalon disa kategorive të caktuara të trashëgimtarëve, pavarësisht nga vullneti i trashëgimlënësit.
5. Respektimi i rezervës ligjore është i detyrueshëm nga ana e trashëgimlënësit.
6. Trashëgimtarët e një radhe të mëpasshme përjashtojnë trashëgimtarët e një radhe të mëparshme dhenësë

¹⁷ Bëhet fjalë në këto raste për heqje dorë të menjëhershme

trashëgimlënësi është pa trashëgimtar pasuria e tij trashëgimore i kalon shtetit.

Bibliografia

1. Francesco Galgano, “E drejta private”, Tiranë 2006
2. Arta Mandro, “E drejta romake”, Tiranë 1996
3. Kodi Civil Italian
4. Kodi Civil Gjerman
5. A. Zoppini, Trashëgimia në të drejtën e krahasuar në R. Sacco *Traktat i të drejtës së krahasuar*, Torino, Utet, 2002
6. G. Petrelli, Mbi sigurinë e blerjeve nga trashëgimtarë e dhurues në revistën *Noterët*, n. 2/2005, faqe. 211 e vazhdim.
7. Ch. Hertel, Sistemet ligjore të botës-një vështrim ne revistën *Noter Ndërkombëtar*, n. 1-2/2009, faq. 128 e vazhdim.
8. Këshilli Kombëtar i Noterisë, Klauzola përjashtimi dhe profile moderniteti , Studio n. 339-2012/C
9. Këshilli Kombëtar i Noterisë, Reforma rezervuar të drejtave të legjitimuarve 2011
10. Kodi Civil i RSH
11. Kodi i Familjes
12. Nazmi Biçoku “E drejta e trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë”, Tiranë 2011
13. Ardian Nuni, Luan Hasneziri “E drejta civile III” (Trashëgimia), Tiranë 2010
14. Valentina Kondili “E drejta civile II Pjesa e posaçme Pronësia, të drejtat reale të përkohshme dhe trashëgimia”, Geer 2008
15. Juliana Latifi “E drejta civile, Trashëgimia”, Geer 2007
16. Agim Tartari “Trashëgimia në të drejtën ndërkombëtare private”, Tiranë Albin 1994.
17. <http://www.legalsl.com>
18. <http://www.wikipedia.com>
19. <http://www.juridical.com>

ANKIMI INDIVIDUAL NË KËNDVËSHTRIMIN KUSHTETUES KRAHASIMOR

Doktorant Ervin Sulko

Hyrje

Objekt i studimit në këtë punim, është ankimi i individit në Gjykatën Kushtetuese i konceptuar si një mjet procedural i cili mund të përdoret nga çdo qytetar sa herë që i shkelen të drejtat e tij themelore, brenda kuadrit të të drejtave për një proces të rregullt ligjor. Qëllimi i këtij punimi, është të jap një panoramë të plotë të këtij instituti, që nga origjina e tij, adoptimi nga Kushtetuta shqiptare e deri në parashikimin e tij nga sisteme të ndryshme të drejtësisë kushtetuese. Vlen për t'u theksuar se, në bazë të ankimit individual studiuesit e drejtësisë kushtetuese kanë filluar të bëjnë një klasifikim të ri të modeleve të drejtësisë kushtetuese. Kjo për faktin se jo të gjitha vendet e kanë adoptuar në mënyrë të njëjtë këtë institut, ai paraqet tipare të veçanta nga njëri sistem në tjetrin.

Origjinën e ankimit individual, si një institut mjaft i rëndësishëm i drejtësisë kushtetuese, e gjejmë fillimisht në Meksikë e më pas në Zvicër, Gjermani, Austri e Spanjë.

E drejta e individit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, është njohur në vendin tonë që me themelimin e saj, fill pas përmbysjes së regjimit socialist. Pavarësisht ndryshimeve që pësoi ky institut me Kushtetutën e vitit 1998, ai vazhdon të mbetet një mjet ankimi efektiv në sistemin e brendshëm të drejtësisë në vendin tonë. Në mbyllje, trajtohet një studim krahasues me vendet të Europës Perëndimore në lidhje me parashikimin

e ankimit të individit dhe rregullimin të tij, në legjislacionet përkatëse. Vihet re se, në vendet që e kanë adoptur këtë institut, ai paraqet dallime, si në drejtim të akteve që kundërshtohen, afatet brenda të cilit duhet të ushtrohet, apo edhe në drejtim të subjekteve që legjitimohen për ushtrimin e ankimit individual.

1. Lindja dhe afirmimi i ankimit individual

1.1 E drejta e individit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shkelje ose cenim të të drejtave themelore të njeriut, është një ndër instrumentet ligjorë i cili konkretizon parimin e shtetit të së drejtës, sipas të cilit shteti është i detyruar të garantojë mbrojtjen efektive të tyre. Kjo ka ardhur si rrjedhojë e njohjes së disa të drejtave subjektive në dokumentet dhe aktet ndërkombëtare më të rëndësishme, që u hartuan fill pas përfundimit të Luftës së dytë botërore e që më vonë kanë patur një rritje progresive duke ardhur deri në ditët tona. Krahas akteve ndërkombëtare ku sanksionohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të cilat tashmë janë bërë pjesë e së drejtës ndërkombëtare përgjithësisht të pranuar, edhe Kushtetutat e vendeve demokratike i njohën këto të drejta duke i vendosur në themel të vlerave njerëzore dhe të qytetërimit të kombeve. Si pikënisje për ekzistencën e këtij instituti kanë shërbyer të drejtat themelore të njeriut, ku ishte e nevojshme, krahas njohjes në dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare dhe të brendshme, edhe një mbrojtje efektive e tyre. Nga njëra anë kemi njohjen dhe garantimin e këtyre të drejtave në një rend juridik të caktuar dhe nga ana tjetër korrespondon detyrimi i shtetit për mbrojtjen e tyre, një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës.

1.2 Pikërisht në këtë periudhë disa vende fillojnë të parashikojnë në rendet e tyre juridike mundësinë e ankimit të individit në Gjykatën Kushtetuese. Origjinën e këtij instituti e gjejmë në Meksikë (i ashtuquajtur *amparo* meksikan) dhe në Zvicër, Austri, Gjermani (siç quhet në vendin e origjinës *Verfassungsbeschwerde*).

Ankimi i individit si një institut mjaft i rëndësishëm i drejtësisë kushtetuese, lindi për herë të parë në Meksikë, fillimisht me Kushtetutën e shtetit Yucatan më 1841 dhe më

vonë me Kushtetutën Federale të vitit 1857¹⁾. U krijua ai që njihet si *juicio de amparo*.

Amparo etimologjikisht do të thotë të mbrosh të drejtat e qytetarëve kundrejt shtetit, nëpërmjet një procedure të shpejtë. Ai kishte trajtën e një procedure që zhvillohej përpara një organi gjyqësor federal (jo vetëm në Gjykatën Supreme Federale) me nismën e individit të cilit i ishin cenuar të drejtat e tij themelore të mbrojtura nga Kushtetuta, nga akte administrative, gjyqësore ose të pushtetit ligjvënës. Individu mund të ishte person fizik ose person juridik privat apo publik. Gjithashtu, gjykata mund të pezullonte aktin objekt gjykimi dhe vendimi i saj kishte vetëm efekte *inter partes*. Vendosija e këtij instituti në Kushtetutën Federale ishte një formë mbrojtjeje shumë e zgjeruar dhe e përgjithshme. Mjafton të mendosh që individ i ankohej jo vetëm për shkelje të dispozitave kushtetuese për mbrojtjen e njeriut, por edhe për zbatim të gabuar të ligjeve. Shumë vende të tjera të Amerikës Latine si Kuba, Brazili, e adoptuan amparon.

1.3 Krahas Meksikës, ankimi i individit gjatë shekullit të XIX gjeti zbatim edhe në Zvicër (e ashtuquajtura *Statsrechtliche Beschwerde* kundër akteve të ligjvënësit, ekzekutive dhe gjyqësore, por vetëm të autoriteteve Kantonale), në Austri (*Beschwerde* vetëm kundër akteve administrative) dhe në Gjermani (*Verfassungsbeschwerde* fillimisht në kushtetutat e disa Landeve dhe më vonë në Kushtetutën Federale). Në rastin e Gjermanisë, ankimi i individit kryhej vetëm nëse ishin shteruar të gjitha shkallët e gjykimit.

Gjithashtu, parashikoheshin edhe forma të seleksionimit të çështjes, pranimit ose jo të saj për shqyrtim.

2. Tiparet e reja të ankimit individual në vende të ndryshme

2.1 Sot ankimi individual ka marrë karakteristika të veçanta sipas vendit ku u zhvillua të cilat i japin një trajtë të re, të ndryshme krahasuar me të kaluarën. Në Meksikë ku edhe lindi për të mbrojtur garancitë personale të individëve kundër ligjeve dhe akteve të nxjerra nga çfarëdo lloji autoriteti si dhe për të rregulluar sferën e kompetencës midis federatës dhe shteteve,

1 H. Fix-Zamudio, E.Ferrer, Mac-Gregor, *El derecho de amparo en el mundo*, Mexico, 2006.

tashmë *amparo* është shndërruar në një instrument procedural heterogjen. Në radhë të parë, ai shërben për mbrojtjen e jetës dhe lirive personale *habeas corpus*, për ankimin e ligjeve antikushtetuese, kundër vendimeve gjyqësore, për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative etj. Ky evoluim ka ndryshuar tiparet e *amparos* i cili u shndërrua nga një mjet mbrojtës për të drejtat themelore të njeriut në një mjet kontrolli për zbatimin në mënyrë korrekte të ligjeve nga ana e gjyqtarëve dhe e autoriteteve publike.

2.2 Në vendet e Amerikës Qendrore dhe Jugore ndihet ndikimi i *amparos* meksikan, por me disa dallime.

Karakteristikat e *amparos* në këto vende mund t'i përmbledhim si vijon: Spektri i gjerë i të drejtave të njeriut duke përfshirë këtu jo vetëm ato të sanksionuara nga kushtetuta, por edhe nga konventat ndërkombëtare, kufizimi, për sa i përket shkeljeve të të drejtave të njeriut vetëm në ato të kryera nga ana e disa autoriteteve shtetërore (ekzekutivi).

Gjithashtu, pjesa më e madhe e këtyre vendeve përjashtojnë ankimin ndaj akteve gjyqësore me anë të *amparos*, mungon filtri i pranimit të ankimeve etj.

2.3 Për sa i përket modelit gjerman, Gjykata Kushtetuese gjermane ka sot një sistem që mund të konsiderohet si i ngarkuar. Ajo ka një sërë kompetencash, çka e bën shumë të ngjashëm me modelin tonë, ose më mire të themi modeli ynë është shumë i ngjashëm dhe me atë gjerman.

Disa nga kompetencat kryesore të saj janë kontrolli abstrakt dhe konkret i ligjeve, shqyrtimi i ankimit individual, i kushtetutshmërisë së partive politike, i procedurave elektorale, referendare etj. Ajo që ka më shumë rëndësi për ne, është të analizojmë se si insituti i ankimit të individit ka evoluar në Gjermani në kohët e sotme. Ai përfshin një kategori mjaft të gjerë aktesh si ato ligjislative, aktet ekzekutive dhe gjyqësore. Lista e të drejtave të njeriut është taksative, vetëm ato të parashikuara në kushtetutë, por jurisprudenca e ka zgjeruar këtë kategori edhe më tej. Duhet të jenë shteruar rrugët gjyqësore të të gjitha shkallëve (parimi i subsidiaritetit) për të shkuar në Gjykatën Kushtetuese gjermane. Megjithatë, parashikohen dy përjashtime: në rastin kur ankimi ka një karakter të përgjithshëm

(kur janë një kolektivitet personash të interesuar për çështjen, kur çështja nuk ka një karakter vetëm lokal) si dhe në rastin kur vendimi i shkallëve më të ulëta i dhënë me vonesë do t'i sillte një dëm të pariparueshëm individit.

2.4 Sistemi i drejtësisë kushtetuese spanjolle në kohët e sotme paraqitet me një shumëllojshmëri kompetencash të Gjykatës Kushtetuese, duke nisur nga kontrolli kushtetues i ligjeve dhe akteve normative me fuqinë e ligjit, kontrolli paraprak i pajtimit të marrëveshjeve ndërkombëtare me kushtetutën, konfliktet e kompetencave midis shtetit dhe komuniteteve autonome, kushtetutshmëria e akteve normative etj. Në fund të këtyre kompetencave shtohet edhe *amparo kushtetues* i cili përdoret kundër akteve administrative, gjyqësore dhe parlamentare (jo ligjet).

2.5 Ndërsa në Itali ankimi individual nuk është parashikuar edhe në ditët e sotme. Megjithatë, përpjekjet për futjen e këtij instituti janë bërë qysh me miratimin e Kushtetutës italiane të vitit 1948, kur komisione të ndryshme punuan për përcaktimin e modelit të drejtësisë kushtetuese italiane.²⁾

Në projekt-kushtetutën (1946) e paraqitur ishin dy orientime kryesore. I pari kishte të bënte me konceptin e organizimit të drejtësisë kushtetuese me qëllim kryesor mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut të garantuara nga kushtetuta dhe tjetri kishte të bënte me një kontroll që pushteti ligjvënës mos të dilte nga tagrat e përcaktuara në kushtetutë. Me kushtetutën e vitit 1948 u njoh vetëm forma e dytë. Në këtë model mbizotëron gjykimi kushtetues i ligjeve i tipit incidental me synim interesin publik të përgjithshëm, respektimin e kushtetutës. Kjo ka bërë që forma e ankimit individual të mos gjejë vend.

Sipas doktrinës italiane, kjo nuk do të thotë se mbrojtja e të drejtave themelore të njeriut mbetet jashtë, ajo garantohet me të njëjtin intensitet edhe nëpërmjet formës së kontrollit incidental.

2.6 Siç shihet, ankimi i individit pranë Gjykatës Kushtetuese është njohur nga një numër i konsiderueshëm vendesh.

Ai paraqet disa avantazhe dhe dizavantazhe. Për sa i përket dobishmërisë së tij, ankimi individual paraqet formën më të lartë dhe kurorëzimin e shtetit të së drejtës nëpërmjet mundësisë që i

2 Elena Malfatti, Saule Panizza, Roberto Romboli. "Giustizia Costituzionale" Torino, 2007

jepet individit për t' u bër një faktor aktiv në fushën e të drejtave, ai kthehet në mbrojtës të lirive të tij. Individit në vende si Gjermania ka kontribuar për ta shndërruar drejtësinë kushtetuese nga një model që garanton kushtetutshmërinë e shtetit, në një model që mbron dhe garanton të drejtat themelore të individit. Ofron një sistem i cili garanton mbrojtjen e të drejtave themelore nga çdo shkelje e mundshme nga ana e gjyqtarëve, dhe në këtë mënyrë çdo njeri bëhet përgjegjës për të drejtat e tij.

Doktrina kushtetuese është ndalur edhe mbi aspektet negative të institutit të ankimit të individit. Dizavantazhi më i madh ka të bëjë në rrafshin praktik, me numrin e lartë të ankimeve individuale që mbërrijnë në Gjykatën Kushtetuese, pavarësisht filtrave të seleksionimit të parashikuar. Kjo ul edhe efektivitetin e këtij mjeti ankimi.

3. Ankimi individual në Kushtetutën shqiptare

3.1 Zgjedhja e vendit tonë për të vendosur në sistemin e drejtësisë kushtetuese shqiptare ankimin individual, është bërë qysh me themelimin e Gjykatës Kushtetuese. Kështu në ligjin nr. 7561 dt. 29.02.1992 “Për disa plotësime dhe ndryshime” në ligjin për Dispozitat Kryesore Kushtetuese, ndër kompetencat e Gjykatës Kushtetuese parashikohej edhe zgjedhja përfundimisht e ankesave të personave të paraqitura në rrugën e kontrollit kushtetues për shkeljen e të drejtave të tyre themelore nga aktet e paligjshme (neni nr. 24 pika 9).

Mundësia që i ofrohej individit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese ishte më e plotë dhe gjithëpërfshirëse.

Ajo i referohej çdo shkeljeje të të drejtave të njeriut dhe jo vetëm për një kategori të veçantë të drejtash. Natyrisht kjo përkthehet me detyrimin për shtetin e së drejtës që jo vetëm t'i sanksiononte të drejtat themelore të njeriut në Kushtetutë, por edhe të ofronte garancitë efektive për gëzimin e tyre.

Kjo shprehej me mundësinë e çdo individit për të vënë në lëvizje organin garant për zbatimin e Kushtetutës (Gjykata Kushtetuese) sa herë që të drejtat e tij shkeleshin nga akte të paligjshme.

3.2 Me Kushtetutën aktuale (1998) ankimi i individit është parashikuar në nenin nr. 131 gërma f) ku sanksionohet se, *Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.* Ajo që vihet re, është ngushtimi i rrethit të të drejtave themelore për të cilat mund të investohet Gjykata Kushtetuese. Individit mund të ankohet pranë Gjykatën Kushtetuese vetëm për shkeljen e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, ndryshe nga sa ishte parashikuar më parë ku individit shkonte përpara Gjykatës Kushtetuese për shkeljen e çdo të drejte themelore të parashikuar nga kushtetuta. Ky kufizim u justifikua me nevojën për të shmangur rrezikun që Gjykata Kushtetuese të kthehej në një shkallë të katërt gjykimi siç mund të konsiderohen ajo gjermane dhe spanjolle.

3.3 Për sa i përket organit të cilit i drejtohet ankimi individual në sistemin tonë është natyrisht Gjykata Kushtetuese është i vetmi organ kompetent për shqyrtimin e ankesave të tilla.

Në vende të tjera ai mund t'i drejtohet gjykatave të shkallëve të para (P.sh në Spanjë) ose një seksioni të veçantë të Gjykatës së Lartë.

Ndërsa, për sa u përket subjekteve, legjitimohen për të bërë ankimin individual personat fizikë si dhe personat juridikë, publikë ose privatë. Kjo është konfirmuar disa herë nga jurisprudenca jonë kushtetuese. Në fakt, në bazë të këtij pohimi qëndron neni nr. 16 pika 2 i Kushtetutës ku sanksionohet se; *“të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave, me thelbin e këtyre të drejtave, lirive detyrimeve”.* Në rendin tonë juridik janë titullarë të të drejtave themelore edhe personat juridik, por gëzimi i këtyre të drejtave u njihet në mënyrë të kufizuar sepse kushtëzohet nga vetë natyra e tyre si subjekte të së drejtës.

Nga kjo rrjedh se ata nuk mund të jenë titullarë të të drejtave të njeriut substanciale dhe për pasojë ata nuk legjitimohen për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për mbrojtjen e tyre. Por ata mund të jenë palë në proces dhe gëzojnë në mënyrë të barabartë me personat fizikë të gjitha të drejtat dhe garancitë

që ofron kushtetuta për një proces të rregullt ligjor. Ata mund t'i gëzojnë këto të drejta për aq sa përputhen me natyrën e tyre. Kjo i legjitimon personat juridikë të investojnë Gjykatën Kushtetuese për cënim të të drejtave themelore procedurale.

Një qëndrim të tillë ka mbajtur edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 22 dt. 26.07.2006. ku ndër të tjera ajo shprehet “*Në çështjen në shqyrtim kërkuesi është person juridik publik, i paditur në gjykim, dhe pretendon cënimin e parimeve procedurale kushtetuese. Këto parime nuk mund të cënohen, sepse janë elementë të së drejtës në tërësi që rrjedhin nga thelbi i shtetit të së drejtës dhe garantojnë barazinë e palëve në një proces gjyqësor. Prandaj, dhe ankimi në Gjykatën Kushtetuese për shkeljen e tyre mund të paraqitet nga çdo subjekt duke përfshirë këtu edhe personat juridikë publikë”.*

3.4 Me Kushtetutën aktuale duket se garantimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut është reduktuar, pasi Gjykata Kushtetuese mbron vetëm të drejtat themelore brenda procesit të rregullt ligjor dhe lë jashtë të drejta të tjera substanciale, edhe më të rëndësishme, të sanksionuara nga dispozita të tjera kushtetuese. Kjo zbeh edhe vetë qëllimin e instituit të ankimit individual që nënkupton mundësinë e çdo qytetari për të mbrojtur të drejtat e tij themelore.

Parimet e procesit të rregullt ligjor janë sanksionuar në nenin nr. 42 të Kushtetutës. Tek ne ai ka marrë emërtimin procesi i rregullt ligjor dhe në vende të tjera ka një emërtim të përafërt si “fair trial” “proces ekuitabël” “giusto processo” etj. Parimet e procesit të rregullt ligjor e kanë zanafillën e tyre në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut ku në nenin nr. 6 janë parashikuar të gjitha kriteret dhe standardet që duhet të plotësojë një organ gjyqësor për dhënien e drejtësisë.

Në vazhden e këtij parashikimi, pothuajse të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës (ndër këto edhe Shqipëria) parashikuan në Kushtetutat e tyre parimet dhe kriteret nga të cilat duhet të udhëhiqen organet gjyqësore.

Në vendin tonë neni 42 pika 2 i Kushtetutës sanksionon të drejtën për një proces të rregullt ligjor: “*Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një*

gjykimi të drejtë e publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”.

Gjithmonë në funksion të garantimit të shtetit të së drejtës, e drejta për një proces të rregullt ligjor ka të bëjë me dy aspekte kryesore: mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve si dhe detyrimin e organeve shtetërore për t'i respektuar ato duke ndjekur procedurat ligjore. Jo vetëm individit, por edhe shteti është subjekt i ligjit dhe i respektimit të tij.

3.5 Doktrina kushtetuese i ka dhënë një interpretim të zgjeruar kuptimit të procesit të rregullt ligjor. E drejta për një proces të rregullt ligjor nuk kufizohet vetëm në procesin e rregullt gjyqësor, por përfshin edhe procese të tjera që ushtrohen në organe të tjera publike të karakterit jashtëgjyqësor, siç mund të jenë procedurat administrative, parlamentare, të arbitrazhit, të ndërmjetësimit etj.

Në mënyrë të përmbledhur, ne do të rendisim disa nga të drejtat në kuadrin e procesit të rregullt ligjor si: *e drejta për një gjykim të drejtë dhe publik, gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj, gjykimi nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.*

Gjithashtu, bëjnë pjesë në grupin e të drejtave për një proces të rregullt ligjor, veçanërisht në procesin penal: *e drejta për t'u mbrojtur vetë ose me anën e një mbrojtësi ligjor, e drejta për të pasur kohën e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes, e drejta për t'u dëgjuar në seancë, e drejta për të qenë i pranishëm në gjykim, e drejta e ankimit, e drejta për t'u hetuar brenda afateve që parashikon ligji procedural penal, etj.*

3.6 Vitet e fundit kanë qenë të shpeshta vendimet e Gjykatës Kushtetuese mbi shkeljen e së drejtës së aksesit në gjykatë e cila është një e drejtë themelore në kuadrin e procesit të rregullt ligjor.

Ajo konsiston në të drejtën që ka çdo shtetas që t'i drejtohet gjykatës ose organeve të tjera shtetërore për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tij të ligjshme. Ajo nuk ka të bëjë vetëm me të drejtën për të hapur procesin, por edhe me të drejtën për të marrë një zgjidhje përfundimtare në lidhje me mosmarrëveshjen objekt gjykimi.

Gjthashtu, një rëndësi të veçantë merr edhe faza e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Ajo është mjaft e rëndësishme pa të cilën e drejta e shkelur nuk mund të themi se është rivendosur.³ E drejta për të kërkuar ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm hyn në kuadrin e të drejtave për një proces të rregullt ligjor.

3.7 Për sa i takon momentit kur duhet ushtruar e drejta e ankimit të individëve në Gjykatën Kushtetuese, neni nr. 131 gërma f) e kushtëzon me shterimin e mjeteve juridike për mbrojtjen e të drejtave për një proces të rregullt ligjor.

Por kur do të konsiderohen të shteruara mjetet juridike? Lidhur me këtë pyetje, përgjigjen e marrim nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese e cila është ndalur disa herë mbi këtë aspekt. Në vendimin nr. 1 dt. 25. 01.2010 ajo shprehet se: *juridiksioni kushtetues për shkeljen e të drejtave themelore për një proces të rregullt bëhet i mundur kur kërkuesi shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor. Shterimi nënkupton që kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi.*

Me shterim të mjeteve juridike do të kuptojmë dy aspekte kryesore: në radhë të parë, mjetet juridike konsiderohen të shteruara kur individi ka përdorur të gjitha hallkat apo shkallët e gjykimit në gjykatat e zakonshme dhe se në secilën prej tyre ka përdorur të gjitha mjetet e ankimit. Për shembull nëse një gjykim zhvillohet në gjykatën e apelit dhe individi ka pasur mundësinë e ankimit të vendimit të nxjerrë prej saj brenda një afati të caktuar dhe nuk e ka bërë, atëherë ai nuk legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese pasi nuk ka përdorur të gjitha mjetet e ankimit të vendosura në dispozicion nga legjislacioni procedural. Pra, shterimi i mjeteve juridike kërkon që individi të shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për rivendosjen e të drejtave të pretenduara⁴.

3 Shih vendimin nr. 6, datë 04.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese.

4 Shih vendimin nr. 26 dt. 08.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese.

Gjithashtu, kjo kërkon edhe që të gjitha pretendimet që individi ngre në Gjykatën Kushtetuese duhet t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca të paktën në thelb, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural.

3.8 Në mbyllje është e rëndësishme të dimë se cilat janë aktet që goditen nëpërmjet ankimit individual. Ankimet e individit drejtohen kundër vendimeve gjyqësore të cilat janë nxjerrë duke mos respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor.

Por kujdes, jo më kot ai është emërtuar proces i rregullt ligjor dhe jo “gjyqësor”, duke nënkuptuar se përfshihen në të jo vetëm procesi gjyqësor në tërësi, por edhe proceset e tjera të natyrës administrative, ndërmjetësimi, arbitrazhi etj.

Çdo procedurë finalizohet me një vendimmarrje që konkretizohet me një akt, i cili sipas natyrës së procesit mund të jetë një akt gjyqësor (vendimi i gjykatës i dalë nga një proces gjyqësor) ose administrativ, i dalë nga një procedurë administrative, ose arbitrazhi, vendim i dhënë nga arbitri.

Sipas rastit, nëpërmjet ankimit individual mund të goditen vendimet e gjykatave ose aktet administrative.⁵⁾

Këtu mund të përmendim, vendimin e Kuvendit për propozimin e shkarkimit të Prokurorit të Përgjithshëm, Dekretin e shkarkimit të tij të nxjerrë nga Presidenti i Republikës etj.⁶⁾

Një rast tjetër kur Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar akte administrative të nxjerra në një procedurë ku nuk janë respektuar të drejtat për një proces të rregullt ligjor, ka qenë kur Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë i cili, në fund të një procedimi disiplinor kundër një gjyqtari mori masën disiplinore “largim nga puna”, vendim ky i marrë në shkelje të parimeve për një proces të rregullt ligjor.

Në të gjitha këto raste është ankimuar në Gjykatë Kushtetuese një akt administrativ nga individi, për shkelje të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor.⁷⁾

5 Shih vendimin nr. 21 dt. 01.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

6 Shih Vendimin nr. 16, datë 27.04. 2007 të Gjykatës Kushtetuese.

7 Vendimi nr. 21, datë 01.10.2008 “Gjykata Kushtetuese, bazuar edhe në praktikën e saj të mëparshme, arriti në përfundimin se kërkuesi legjitimohet për të kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën si të vendimit të Kuvendit, ashtu edhe të dekretit të Presidentit për shkarkimin e tij nga detyra. Neni 131/f i Kushtetutës në lidhje me nenin 134/1/g të saj, i jep të drejtë individit të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese për një proces të rregullt ligjor pasi të jenë shterruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave, d.m.th, pasi individi të jetë drejtuar e të ketë marrë përgjigje nga organet e tjera kompetente shtetërore. Në rastin e kërkesave kundër

Kuptohet se në këto raste kanë pasur për objekt akte administrative të natyrës së veçantë, ku Gjykata Kushtetuese i ka shqyrtuar me arsyetimin se në sistemin gjyqësor të zakonshëm ato nuk mund të jenë objekt gjykimi. Përveç arsyetimit të Gjykatës Kushtetuese, të gjitha këto akte kanë qenë vendime të marra në mbyllje të procedurave ligjore të shkarkimit apo të marrjes së masës disiplinore. Kësisoj, duhet të ishin respektuar garancitë e një procesi të rregullt ligjor, në të kundërt kjo legjitimon individin për të investuar Gjykatën Kushtetuese për shkeljen e të drejtave për një proces të rregullt ligjor.

3.9 Nisur nga sa u tha më lartë, arrijmë në përfundimin se mund të goditen me anë të ankimit të individit, të gjitha aktet gjyqësore (vendimet e gjykatave), por sipas rastit rastit edhe aktet administrative të cilat janë nxjerrë në shkelje të rregullave për një proces të rregullt ligjor (jo ligjet).⁸ Me anë të ankimit individual mund të kundërshtohen ligjet vetëm atëherë kur vendimi gjyqësor që kundërshtohet, është dhënë mbi bazën e një ligji antikushtetues.

Ankimi i individit konsiderohet edhe si mjeti i fundit ankimor (efektiv) në sistemin e brendshëm të drejtësisë shqiptare, i cili pasi të jetë përdorur nga individit hap rrugën e një ankimi të mundshëm në Gjykatën e Strasburgut. Me këtë mjet ankimor mbyllet cikli i të gjitha mjeteve të ankimit në sistemin e drejtësisë në vendin tonë, por duhet theksuar se nuk mund të konsiderohet një shkallë e zakonshme gjykimi, pasi në sistemin tonë të drejtësisë kushtetuese, e drejta për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, është një e drejtë e kufizuar, vetëm për shkeljen e të drejtave për një proces të rregullt ligjor⁹.

Megjithatë, ai konsiderohet nga Gjykata e Strasburgut si mjeti i fundit efektiv në sistemin e brendshëm kombëtar, pasi nëpërmjet tij arrihet që çështja të rishqyrtohet nga ana e gjykatave të zakonshme, nëpërmjet dërgimit që Gjykata Kushtetuese bën

vendimit të Kuvendit dhe përkatësisht të dekretit të Presidentit për shkarkimin nga detyra, kërkesit nuk mund të vënë në lëvizje ndonjë organ tjetër shtetëror për shqyrtimin e tyre veç Gjykatës Kushtetuese, sepse asnjë prej organeve të tjera shtetërore nuk ka në kompetencë shqyrtimin e këtyre kërkesave.

8 Xhezair Zaganjori, *Efektiviteti i mjeteve të brendshme të sistemit shqiptar, në kuptimin e nenit 13 të Konventës Europine të të Drejtave të Njeriut*, në Konferencën me temë, *Përmirësimi i cilësisë së zbatimit të KEDNJ nëpërmjet zgjerimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve vendase*, organizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Këshilli i Europës, shtator, 2007.

9 Çështja "Gjyli kundër Shqipërisë" Ankimi nr. 32907/07, Gjykata e Strasburgut.

në rastet kur janë shkelur të drejtat e procesit të rregullt ligjor.

Ankimi i individit ngjason së tepërmi edhe me ankimin në Gjykatën Europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (neni 34 i KEDNJ). Kjo e fundit mund të investohet vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet e brendshme juridike që sistemi i drejtësisë ofron. Dallimi me ankimin individual që parashikohet nga Kushtetuta jonë qëndron në numrin e kufizuar të të drejtave të njeriut që mbrohen, ndërsa me anë të ankimit në gjykatën e Strasburgut, mund të mbrohen të gjitha të drejtat e sanksionuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

4. Adoptimi i ankimit individual në sisteme të ndryshme të drejtësisë kushtetuese

4.1 Në përfundim, është e rëndësishme të bëjmë një tablo të përgjithshme mbi institutin e ankimit individual në vende të ndryshme. Siç e kemi evidentuar edhe në fillim, tendenca e sotme e klasifikimit të sistemeve të drejtësisë kushtetuese është përqëndruar më shumë te parashikimi ose jo i ankimit individual. Jemi larguar së tepërmi nga ndarja klasike midis sistemit amerikan dhe atij evropian. Sistemet të cilat parashikojnë ankimin individual konsiderohen edhe sisteme të lirisë dhe të drejtave themelore të njeriut. Megjithatë, edhe brenda tyre duhen bërë disa dallime, midis sistemeve ku ankimi individual mund të ushtrohet kundër çdolloj shkeljeje të të drejtave themelore siç janë ai gjerman, spanjoll etj, dhe atyre sistemeve ku ankimi individual ushtrohet vetëm për disa shkelje të caktuara si rasti i Zvicrës, Austrisë, Shqipërisë (vetëm për shkelje të procesit të rregullt ligjor) etj. Por, kemi vende si Italia ku ankimi individual nuk njihet fare dhe nuk mund të mendohet për një juridiksion kushtetues i cili garanton liritë themelore (në kuptimin e ngushtë), sepse Gjykata Kushtetuese atje ofron një garanci të tillë vetëm në mënyrë indirekte.

4.2 Pjesa më e madhe e sistemeve të drejtësisë kushtetuese, janë krijuar për të mbrojtur përgjithësisht dy interesa themelore. I pari ka të bëjë me përshtatjen e rendit juridik të vendit me parimet kushtetuese, si një interes i përgjithshëm publik.

Ndërsa interesi i dytë ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave

themelore të njeriut. Ka vende të cilat i kanë dhënë prioritet vetëm njërit interes (P.sh Italia), por ka edhe vende të tjera të cilat i mbrojnë pak a shumë me të njëjtin intensitet këto interesa, siç është Shqipëria.

4.3 Në Francë, vihet re se Këshilli Kushtetues (*Conseil Constitutionnel*) aktualisht mbron edhe të drejtat themelore të njeriut. Progresi është i dukshëm, mjafton të mendosh se ky organ me Kushtetutën e vitit 1958 nuk kishte funksione të mirëfillta të kontrollit kushtetues e megjithatë sot ka arritur të mbrojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në të njëjtin nivel me shumë organe të drejtësisë kushtetuese të cilat janë pararojë në këtë drejtim. Sistemi i drejtësisë kushtetuese në këtë vend, u pasurua edhe me një gjykim të ri kushtetues, kontrollin incidental, i cili u parashikua për herë të parë me reformën kushtetuese të vitit 2008.

4.4 Edhe në Belgjikë, Gjykatës së Arbitrazhit (Cour d'arbitrage) i janë atribuar funksione të reja dhe sistemi i drejtësisë kushtetuese atje ka pësuar ndryshime të mëdha.

Pak vite më parë kjo gjykate ishte krijuar me qëllimin e zgjidhjes së konfliktit të kompetencave ndërmjet organeve kushtetuese, ndërsa tani është kompetente edhe për çështjet e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Madje ky është funksioni kryesor i saj. Në ushtrimin e kontrollit kushtetues ajo bën një interpretim të zgjeruar të parimeve të barazisë dhe të mosdiskriminimit, të kombinuara natyrisht me parime të tjera kushtetuese dhe me parimet që vijnë nga e drejta ndërkombëtare e zbatueshme në rendin e brendshëm juridik. Ankimi individual në Belgjikë paraqitet jo më përpara se 6 muaj nga nxjerrja e aktit. Gjithashtu, këtu njihet edhe forma e kontrollit kushtetues e tipit incidental.

4.5 Interesant duket rasti i Portugalisë, ku kontrolli kushtetues është i strukturuar në këtë mënyrë: ai është një kontroll konkret, janë gjyqtarët e zakonshëm ata të cilët në kuadrin e mosmarrëveshjes që paraqitet për zgjidhje ushtrojnë paraprakisht kontrollin kushtetues, por ky nuk është përfundimtar sepse fjalën e fundit e ka Gjykata Kushtetuese.

Pra, shohim një kombinim midis modelit të shpërndarë dhe modelit të centralizuar të drejtësisë kushtetuese. Ndërsa mbrojtja

e të drejtave të njeriut nuk realizohet drejtpërdrejtë nga individit, pasi në këtë sistem nuk parashikohet ankimi i individit, por ky i fundit duhet t'i drejtohet fillimisht me anën e një peticioni organeve publike si, *Provedor de Justiça* i ngjashëm me Avokatin e Popullit, për të mbrojtur të drejtat e tij.

Qëllimi i paraqitjes së këtij kuadri, është për të evidentuar se vende të ndryshme kanë parashikuar ankimin e individit, por edhe brenda këtyre sistemeve vihen re karakteristika të veçanta dhe kjo lidhet me përpjekjet për të përshtatur këtë institut me nevojat sociale, kulturore apo politike të secilit vend.

Përfundime dhe rekomandime

Zgjedhja e kushtetutbërësit për futjen e ankimit të individit në rendin juridik shqiptar që me themelimin e drejtësisë kushtetuese, ishte një zgjedhje e drejtë.

Këtu kemi parasysh periudhën historike (pas rënies së murit të Berlinit) të ndryshimit të regjimeve politike në vendet e Europës Qëndrore e Lindore. Në të gjitha këto vende, përfshirë edhe Shqipërinë, ishte i domosdoshëm jo vetëm krijimi i Gjykatave Kushtetuese si rojë të Kushtetutave, por nga ana tjetër edhe mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të njeriut sepse deri në atë kohë çënimi i tyre ishte masiv. Këto vende, pas anëtarësimit në Këshillin e Europës, morën angazhime serioze në lidhje me respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, megjithatë, vazhdojnë të paraqesin probleme në këtë drejtim, ndaj dhe mundësia që i jepet individit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese forcon sistemin e mjeteve ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Edhe pse në vendin tonë individit mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese në mënyrë të kufizuar, vetëm për shkelje të parimeve për një proces të rregullt ligjor, ky është një mjet efektiv për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe luan një rol të rëndësishëm në sistemin e mjeteve të ankimit në vendin tonë.

Në mbyllje, duhet të nënvizojmë rëndësinë thelbësore të ankimit të individit në sistemin e drejtësisë kushtetuese

shqiptare, pasi ai paraqet një garanci më shumë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në rrugën e vështirë të demokracisë dhe forcimit të shtetit të së drejtës. Duke e parë në këtë rrafsh, mendoj se prania e këtij instituti është e domosdoshme dhe luan një rol të rëndësishëm në forcimin dhe rritjen e mbrojtjes të të drejtave të njeriut. Në këtë drejtim, do të rekomandohej një reformë në lidhje me zgjerimin e rrethit të të drejtave që mund të mbrohen nëpërmjet ankimit të individit, jo vetëm në kuadër të procesit të rregullt ligjor, por edhe më gjerë.

Bibliografi

1. E. MALFATTI, S. PANIZZA, R. ROMBOLI. “*Giustizia Costituzionale*” Torino, 2007
2. H. Fix-Zamudio, E.Ferrer, Mac-Gregor, *El derecho de amparo en el mundo*, Mexico, 2006.
3. L. CARLASSARE “*Le garanzie giurisdizionali dei diritti fondamentali*”, Padova, 1988.
4. J. LUTHER, R.ROMBOLI, R.TARCHI, “*Esperienze di giustizia costituzionale*”, Torino, 2000.
5. A.CERRI, *Corso di giustizia costituzionale*, Milano, 2004.
6. A.PUGGIOTO, *Sindacato di costituzionalita, e “diritto vivente”*. Genesi, uso e implicazioni, Milano, 1994.
7. A.RUGGERI, ASPADARO, *Lineamenti di giustizia costituzionale*, Torino, 2004.
8. G.ZABREGELSKY, *La giustizia costituzionale*, Bologna, 1988.
9. L. OMARI, A. ANASTASI, “*E drejta Kushtetuese*”, Tiranë, 2010.
10. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998.
11. Konventa Europiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut 1950.
12. Ligji nr. 8577 datë, 10.02.2000. “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.
13. Çështja “Gjyli kundër Shqipërisë” Ankimi nr. 32907/07, Gjykata e Strasburgut.
14. Xh. ZAGANJORI, *Efektiviteti i mjeteve të brendshme të sistemit shqiptar, në kuptimin e nenit 13 të Konventës Europine të të*

Drejtave të Njeriut, në Konferencën me temë, Përmirësimi i cilësisë së zbatimit të KEDNJ nëpërmjet zgjerimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve vendase, organizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Këshilli i Europës, shtator, 2007.

15. Vendimi nr.20, datë 10.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese.
16. Vendimi nr. 22 dt. 26.07.2006 të Gjykatës Kushtetuese.
17. Vendimi nr.16, datë 27.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese.
18. Vendimi nr. 21, datë 01.10. 2008 të Gjykatës Kushtetuese.
19. Vendimi nr. 6, datë 04.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese.
20. Vendimi nr. 34, datë 25.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese.
21. Vendimi nr. 41, datë 28.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese.
22. Vendimi nr. 33 datë 24.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese.

TRAFIKIMI I QENIEVE NJEREZORE SI FENOMEN DHE SI VEPER PENALE

Doktorante Elizabeta Imeraj¹

Hyrje

Trafikimi i qënieve njerëzore si fenomen në shoqërinë shqiptare ka lindur pas ndryshimeve të mëdha të ndodhura pas viteve 90-të. Ndryshimet e mëdha të karakterit politik dhe ekonomik të vendit sollën pasojë të menjëherëshme përballjen me disa fenomene të panjohura më parë. Duhet parë e lidhur ngushtë situata rezultaive duke qënë se ekzistenca e këtyre faktorëve shtytës drejt fenomenit është në përshtatëshmëri të plotë me faktorët pritës të cilët iu referohen kërkesës për punë, krijimi i standarteve më të larta të jetesës, dhe perceptimit në shumë shoqëri të varfra se mundësia e jetesës është më e mirë në vende me zhvillim më të madh apo në rastin konkret krijimit të perceptimit në shoqërinë shqiptare se jetesa jashtë kufijve të vendit është shumë më e mirë.

Trafikimi është fenomen në përhapje dhe ka njohur rritje në dekadat e fundit së bashku me globalizimin.

Faktori kryesor që ndikon në rritjen e trafikimit është ekzistenca e kërkesës e cila e bën këtë fenomen një biznes në zhvillim të përherëshëm. Në përgjithësi ka një ndërgjegjësim shumë të madh të individëve të cilët sillen në mënyrë të matur kur bëhet fjalë për përfitimin nga trafiket e paligjshme të lëndëve narkotike apo dhe armëve, ndërsa në rastet e trafikimit të

¹ Prokurore pranë Prokurorisë Për Krime të Rënda, Tiranë, Magjistrate.

personave, individët përfitojnë nga shërbimet e ofruara, qofshin ato shërbime seksuale apo shërbime pune, pa u menduar gjatë se çfarë fshihet pas këtij shërbimi. Përkundrazi, ata janë të kënaqur duke qënë se iu është dhënë mundësia e përfitimit me çmim të mirë dhe konkruës. Njerëzit janë të prirur të punësojnë apo dhe të përfitojnë seksualisht, duke mundësuar në këtë mënyrë krijimin dhe ndikimin në zhvillimin e terrenit për trafikimin e personave.

Veprat penale që lidhen me trafikimin e qënieve njerëzore parashikohen si të tilla në Kodin Penal dhe kompetencën lëndore të ushtrimit të ndjekjes penale në lidhje me këto vepra, sipas parashikimeve të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale e ka Prokuroria Për Krime të Rënda, Tiranë.²

Legjislacioni penal parashikon si vepra penale për Trafikimin e Qënieve Njerëzore;

Trafikimi i personave, neni 110/a i Kodit Penal.

Trafikimi i të miturve, neni 128/b i Kodit Penal.

Ndarja e mësipërme bazohet në subjektin e dëmtuar ose më saktë në karakteristikat që ka ai.

Në rastin e trafikimit të personave sipas parashikimeve të nenit 110/a të Kodit Penal, subjekti i dëmtuar nga vepra, e quajtur ndryshe “viktima” është çdo person që rekrutohet, transportohet, transferohet etj, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose forma të tjera të shfrytëzimit.

Me ndryshimet e fundit të ndodhura në legjislacionin tonë penal me ligjin Nr 144/2013 u shfuqizua neni 114/b i Kodit Penal, në të cilin parashikohej se subjekti i dëmtuar nga vepra penale, “viktima” ishte çdo femer e rritur që rekrutohet, transportohet, transferohet etj, me qëllimin e shfrytëzimit të prostitucionit ose forma të tjera të shfrytëzimit. Sipas parashikimeve të nenit 110/a i Kodit Penal person i trafikuar do të konsiderohet çdo person femër apo mashkull i rritur që rekrutohet, transportohet, transferohet etj, me qëllimin e shfrytëzimit të prostitucionit ose forma të tjera të shfrytëzimit.

Në rastin e trafikimit të të miturve sipas parashikimeve të Kodit Penal³, subjekti i dëmtuar ose viktima është çdo i mitur,

² Li g j nr.9110, datë 24.7.2003 ‘Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krime të Rënda’

³ Neni 128.b i Kodit të Procedurës Penale

femër ose mashkull që rekrutohet, transportohet, transferohet me qëllimin e shfrytëzimit seksual ose çfarëdo lloj forme tjetër të shfrytëzimit.

Trafikimi i qenieve njerëzore si figurë e veprës penale përfaqëson një nga figurat e veprës penale, e cila paraqet një sërë vështirësish në hetimin e saj.

Kjo vjen si rezultat i natyrës së kësaj veprë, karakterin e marrëdhënieve juridike që ajo çënon si dhe format e mënyrat me të cilat kryhet.

Për këtë arsye organet e ngarkuara me hetimin e tyre si prokuroria dhe policia gjyqësore duhet të jenë profesionale por dhe të kujdesshëm në trajtimin e rasteve të tilla.

Funksionet e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale përcaktohen në parashikimet ligjore sipas nenit 24 të Kodit të Procedurës Penale.

Është detyrë e prokurorit të ushtrojë ndjekjen penale, të kryejë hetime, të kontrollojë hetimet, të perfaqësojë akuzën në gjykim, të marrë masa për ekzekutimin e vendimeve etj.

Siç e shohim, në secilin hap procedural që nga momenti i parë i fillimit të çështjes penale e në vazhdimësi prokurori është 'bashkëudhëtar', me viktimën e trafikimit në rastin kur kallëzuese është viktima e trafikimit apo me familjarët e saj në rastin kur janë ata kallëzues të veprës së kryer.

Shprehemi në këtë mënyrë, duke qënë se viktima e trafikimit është e interesuar të marrë pjesë në secilën prej fazave procedurale.

Viktima e trafikimit është e interesuar në përfundimin sa më të shpejtë të procesit në tërësi, së pari me qëllim dhënien zgjidhjeje të një fakti jetësor të saj, dhe së dyti marrjen e përgjigjes nga organet e drejtësisë për fenomenin e ndodhur në dëm të saj.

Ndodh në disa raste që ndjekja e procedurave hetimore dhe atyre gjyqësore për shkak të natyrës që kanë këto vepra penale të ndikojnë drejtëpërsëdrejti në jetesën individuale të të dëmtuarës nga vepra penale.

Pikërisht për këtë arsye hetimi i këtyre çështjeve duhet të ndalet dhe në një analizë sociale qoftë të fenomenit tërësor të ndodhur si dhe analizimit të karakteristikave të viktimës së trafikimit.

Ecuria hetimore e veprave penale që lidhen me trafikimin e qënieve njerëzore

Mënyrat e fillimit të procedimit penal në raport me këto vepra penale janë të ndryshme. Në këtë mënyrë hetimi mundet të fillojë nëpërmjet kallëzimit të bërë nga personi i dëmtuar ose e quajtur ndryshe viktimë trafikimi, nëpërmjet kallëzimit të bërë nga persona të tjerë që kanë marrë dijeni për veprën penale të kryer, nëpërmjet rasteve të deportimeve nga jashtë shtetit të viktimave të trafikimit, rasteve që prezantohen nga arrestimet në flagrancë, dhe referimet e bëra nga policia e shtetit.

Sipas mënyrës së fillimit të procedimit, përcaktohet dhe vijimësia e ndjekjes së veprimeve procedurale.

Në rastet në të cilat kallëzuesi është vetë viktimja e trafikimit, marrja në pyetje e viktimës përbën hapin e parë për fillimin e veprimtarisë për ushtrimin e ndjekjes penale.

Në marrjen në pyetje të viktimës së trafikimit mbajmë parasysh realizimin e dy aspekteve të cilat në vetvete përfaqësojnë të njëjtin qëllim.

Analizimi i situatës juridike të rastit konkret qëndron i lidhur ngushtë me analizimin e situatës psikologjike të të dëmtuarës.

Ndaj dhe organi procedues e ka të detyrueshme vënien e një kontakti mirëbesimi me të dëmtuarën.

Në këtë rast, vënia e kontaktit me viktimën e trafikimit është një ndihmesë e madhe duke qënë se kemi mundësi të marrjes së të dhënave jo vetëm në mënyrë të drejtëpërdrejtë por dhe në mënyrë më të saktë.

Në rastin në të cilin kallëzimi është bërë nga persona të tjerë, situata paraqitet më e vështirë, duke qënë se të tretët kanë ardhur në dijeni të figurës së veprës penale në mënyrë jo të drejtëpërdrejtë, dhe nga ana tjetër informacioni i tyre në lidhje me ngjarjen është i limitizuar, ose akoma më keq, situatë e perceptimit të tyre, që për hir të së vërtetës jo në të gjitha rastet i përshtatet realitetit.

Lufta kundër trafikimit të qënieve njerëzore është një ndër prioritet më të mëdha për shoqërinë në përgjithësi dhe për organin e ushtrimit të ndjekjes penale, në veçanti.

Organi i akuzës drejton hetimin dhe kryen të gjitha veprimet që i çmon të nevojshme në funksion të zgjidhjes së çështjes, duke realizuar kështu ushtrimin e detyrave të tij kushtetuese.

Detyra kryesore ka të bëjë me kryerjen e veprimeve të nevojshme me qëllim zbulimin e faktit penal të ndodhur, zbulimit të autorësisë së faktit, dhe të bashkëpunëtorëve të tjerë të përfshirë në të.

Pavarësisht se kush është kallëzuesi për veprën e kryer hetimi përfaqësohet nga të gjitha ato veprime hetimore të detyrueshme për tu kryer të cilat çojnë në mbledhjen e provave.

Në një studim të detajuar të materialit fillestar ku dokumentohet kryerja e veprës së kryer krijohet dhe ideja e provave kryesore që mundet dhe duhet të merren gjatë hetimit.

Në kuadër të realizimit të këtyre veprimeve të nevojshme si një nga provat në procesin penal janë dhe provat me dëshmitarë.

Për efekt analize po paraqesim fillimisht një prezantim të nocionit 'dëshmitar';

Me 'dëshmitar' do të kuptojmë çdo person që zotëron informacion me vlerë për procesin penal, për të cilin ai ose ajo ka dëshmuar ose është i aftë të dëshmojë, dhe që nuk bën pjesë tek 'bashkëpunëtori i drejtësisë'.

Gjatë marrjen në pyetje dëshmitari mundet të pyetet në lidhje me faktet⁴. që përbëjnë objekt prove. Edhe pse në Kodin e Procedurës Penale është parashikuar se dëshmitari nuk mund të dëshmojë për qëndrimin moral të të pandehurit, në rastin e hetimit të veprave penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore një gjë e tillë është e domosdoshme duke qënë se çështja lidhet me fakte që vlejnë për përcaktimin e personalitetit të tij për efekt të analizës në lidhje me veprën penale dhe me rrezikshmërinë shoqërore. Gjatë këtyre procesve pyetja e dëshmitarit mund të shtrihet edhe në marrëdhëniet e farefisnisë dhe të interesave që ekzistojnë ndërmjet dëshmitarit dhe palëve apo dëshmitarëve të tjerë, si dhe mbi rrethanat, vërtetimi i të cilave është i nevojshëm për vlerësimin e besueshmërisë së tij.

Kur flasim për viktimen e krimit, e cila mundet te jetë dëshmitare në procesin penal, është mëse e kuptueshme vlera që ka dëshmia e saj.

4 Neni 153 i Kodit të Procedurës Penale.

Sidoqoftë, nuk mundemi t'i japim më shumë vlerë kësaj dëshmie sesa çdo lloji tjetër prove të marrë gjatë hetimeve, e parë kjo dhe në raport me provat e tjera për të bërë më pas çmuarjen e tyre. Çmuarja e provave është përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre. Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar⁵.

Gjatë punës tonë konstatojme një 'vulnerabilitet' të viktimave/dëshmitare, element ky për të cilin jemi të detyruar të marrim masat mbrojtëse me qëllim pakësimin e efektit të krimit mbi viktimën dëshmitare në proces.

Në realizimin e detyrave të tij, duke përfshirë dhe mbrojtjen e viktimave prokurori bëhet 'bashkëudhëtar' me një sërë institucionesh të tjera.

Ndër këto institucione të tjera do të rendisnim, organet e policisë të cilat me ndjekjen në kohë të rastit është në gjëndje të grumbullojë provat e duhura për procesin, me organizatat jo qeveritare, të cilat i japin mundësinë e akomodimit për viktimën e trafikimit. Sidomos praktika e viteve të fundit ka nxjerrë në pah, një bashkëpunim të frytshëm me OJF-të, të cilat kanë ndikuar pozitivisht në trajtimin e rasteve të ndyshme në kuadër të marrjes në mbrojtje dhe përkujdesje të viktimave dëshmitare në proces. Në praktikën e përditëshme, vepra penale, subjekti i saj dhe viktimat duhen trajtuar si pjesë e të njëjtit problem, të ndërlidhura ndërmjet tyre dhe jo si çështje të ndara, siç mundet të jenë trajtuar rëndom. Kjo bëhet në funksion të luftës me efikasitet kundër kriminalitetit dhe realizimit të interesit parësor, 'mbrojtjes së shoqërisë në përgjithësi'.

Viktimat e trafikimit kanë ecurinë e tyre, që nga momenti i parë i ndodhjes së veprës penale e në vijimësi.

Gjatë gjithë kësaj ecurie, ne vëmë re se viktimat e trafikimit përballen, ose më saktë kalojnë në disa faza që e bëjnë pozitën e tyre akoma më të ndjeshme.

Ajo çfarë ne, duhet të mbajmë parasysh dhe ajo çfarë tejçon fryma e legjislacionit në fuqi, në përfaqje dhe me legjislacionin ndërkombëtar⁶, ka të bëjë me një trajtim dinjitoz të personave që janë dëmtuar nga vepra penale.

5 Neni 152 i Kodit të Procedurës Penale.

6 Konventa e Palermos.

Kur flasim për trajtim dinjitoz, nuk bazohemi thjesht në ndjekjen në mënyrë rigorozë të procedurave ligjore, pasi në fund të fundit një ndjekje e tillë është e detyrueshme, por dhe në trajtimin e viktimës së trafikimit në aspektin psikologjik, social dhe ekonomik.

Në varësi të fazave, në të cilat kalojnë viktimat e trafikimit në aspektin procedural një moment i rëndësishëm për tu trajtuar përfaqësohet nga tërësia e parashikimeve ligjore të cilat sigurojnë mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Me konceptin 'viktimitë krimi'⁷, kuptojmë personat, të cilët individualisht apo në mënyrë kolektive kanë pësuar lëndime, duke përfshirë këtu edhe lëndimet fizike ose mendore, tronditje psikike, humbje ekonomike, ose përkeqësim të të drejtave të tyre themelore, me anë të veprimeve apo mosveprimeve të subjekteve të krimit.

Në kuadrin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe në referencë të mënyrave të kryerjes së këtyre veprave, viktimat e trafikimit⁸ do të quhen personat që janë vënë në pozita të tilla që lidhen me shfrytëzim për prostitucion, realizimin e formave të tjera të shfrytëzimit seksual, shfrytëzimin për punë, shfrytëzimin për shërbime të detyruara, vënia në skllavëri, forma të tjera të shfrytëzimit, si dhe vënia në përdorim apo transplantim të organeve.

Viktimat e trafikimit dhe të drejtat e tyre

Parë në këndvështrimin e një procesi penal, viktimat e trafikimit kanë të drejtat dhe detyrimet e tyre ligjore⁹.

Procedimet penale fillojnë në dy mënyra, nëpërmjet kallëzimit të bërë në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga personi i dëmtuar ose viktimat e trafikimit, dhe me anë të kallëzimit të bërë nga të tjerë.

Në rastin e parë kallëzimi i bërë nga viktimat e trafikimit përfaqëson një të drejtë që ka viktimat e cila është e drejta për të kërkuar ushtrimin e ndjekjes penale.

7 Konventa e Palermos.

8 Konventa e Palermos.

9 Kodi i Procedurës Penale i RSH-së.

Me fillimin e procedimit, vijnë fazat e tjera, që konsistojnë në dhënien e deklarimeve të viktimës para organit procedues fillimisht dhe vazhdojnë me marrjen pjesë në proces, me paraqitjen e kërkesës për prova.

I dëmtuari gjatë fazës së procedimit ka të drejtë të marrë dijeni për veprimet e kryera¹⁰. Marrja dijeni e të demtuarës gjatë procesit penal është shumë e rëndësishme.

Në cdo moment, duhet të mbajmë parasysh trajtimin me dinjitet dhe profesionalizëm të viktimës së krimit.

Një ndër të drejtat e parashikuara në ligj, është e drejta që ka viktima për kompesim, ose shpërblimin e dëmit.

Subjekti i kryerjes së veprës penale ka gjithmonë një qëllim të caktuar në rastin e veprave që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, realizimin e përfitimit monetar, realizimin e cdo lloj forme tjetër të përfitimit. Legjislacioni procedural parashikon si koncept termin ‘i dëmtuar nga vepra penale’, ku përveç kategorive të tjera, bëjnë pjesë dhe viktimat e trafikimit.

Në parashikimet e nenit 58 të Kodit të Procedurës Penale gjejmë të sanksionuara të drejtat që ka një person i dëmtuar nga vepra penale.

I dëmtuari nga vepra penale ka të drejtë të kërkojë procedimin e fajtorit dhe shpërblimin e dëmit.

Këtë të drejtë mundet ta realizojë duke bërë të mundur paraqitjen e kërkesave në organin procedues, kërkesa këto me të cilat mundet të kërkojë marrjen e provave. Në rast mospranimi të kërkesave të bëra para organit procedues i dëmtuari ka të drejtën e ankimit në Gjykatë të vendimarrjes së prokurorit.

Të drejtat që i takojnë të dëmtuarit, shtrihen dhe tek trashëgimtarët e tij, dhe në mungesë të zotësisë juridike të të dëmtuarit, kjo e drejtë i takon dhe perfaqësuesit të tij ligjor.

Një tjetër element që konsiderohet si e drejtë e të dëmtuarit nga vepra penale është dhe padia civile në procesin penal e parashikuar në nenin 61 të Kodit të Procedurës Penale.

Sipas parashikimeve të këtij neni, personi që ka pësuar dëm material nga vepra penale ose trashëgimtarët e tij, kanë të drejtë të ngrenë padi civile në procesin penal kundër të pandehurit ose kundër të paditurit civil duke kërkuar kthim pasurie, dhe

¹⁰ Kodi Penal i RSH-së.

shpërblim dëmi.

Viktimat e trafikimit përveç dëmeve të tjera pësojnë dhe ato që ne i quajmë dëme ekonomike.

Në lidhje me këtë pikë, do të ndalem në një trajtim më të hollësishëm për vetë karakterin e çështjes dhe interesin që ajo paraqet. Të gjitha format me anë të të cilave realizohet trafikimi i qenieve njerëzore bëjnë që viktimat e trafikimit, për aq kohë sa ndodhen në varësinë e subjekteve të krimit janë të kufizuara në të gjitha llojet e të drejtave të tyre, duke përfshirë këtu dhe ato ekonomike.

Një problem mjaft i rëndësishëm duke e parë çështjen në këtë këndvështrim është dhe përcaktimi në mënyrë të drejtë i dëmit që u është shkaktuar këtyre viktimave.

Lind e nevojshme të përcaktohet dhe të përlogaritet jo vetëm dëmi, shpërblimi i tij por dhe mënyra e realizimit të këtij shpërblimi.

Në praktikën e përditëshme gjyqësore, megjithëse kemi raste të shumta të veprave penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, rastet në të cilat padia civile në procesin penal të jetë shqyrtuar dhe të ketë marrë një zgjidhje përfundimtare, të paktën në praktikën e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, mungojnë¹¹.

zhvillimi i gjyqësorisë të çështjes penale në formën e gjyqësorisë të shkurtuar¹². Në disa raste, subjekti ose autori që ka kryer veprën penale kërkon aplikimin e gjyqësorisë të shkurtuar.

Ndërkohë që organi i akuzës, nisur nga parashikimet ligjore që lidhen me, zgjidhjen e çështjes në gjendjen që janë aktet, dhe për ekonomi gjyqësore, pranon zhvillimin e procesit me gjyqësori të shkurtuar.

Problemi i hasur lidhet me fatin që do ndjekë padia civile e paraqitur nga i dëmtuari në procesin penal.

Nga pikëpamja juridike, zgjidhja mund të realizohet në të dy anët, domethënë të pranohet shqyrtimi i padisë civile, në procesin penal qoftë dhe me gjyqësori të shkurtuar, ose të veçohet padia civile e cila më pas mund të ngrihet në gjykatën kompetente.

11 Vendimi nr 66 dt 09.12.2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

12 Neni 403 i Kodit të Procedurës Penale.

Jo vetëm aplikimi i gjykimit të shkurtuar çon në veçimin e padisë civile në procesin penal.

Kjo mund të ndodhë dhe në rastet kur çështja penale shqyrtohet me gjykim të zakonshëm.

Më të komplikuar paraqiten rastet në të cilat ka më shumë se një të pandehur në proces, ndërkohë që padia civile ka lidhje vetëm me njërin prej tyre.

Edhe në këtë rast vendoset veçimi i padisë civile, e cila më pas zgjidhet në një proces civil.

Një moment problematik, lidhet dhe me 'durimin' që paraqet i dëmtuari gjatë 'ecejakeve procedurale'.

Kjo nënkupton, zgjatjen në kohë të realizimit të të drejtave të tij.

Ndarja apo veçimi i padisë civile bën që i dëmtuari nga vepra penale të përballet me dy procese gjyqësore, procesin penal për provueshmërinë e fajësisë së të pandehurit dhe procesin civil që lidhet me realizimin e të drejtave të kërkuara prej tij.

Në rastin e procesit civil, gjykata për ti dhënë zgjidhje padisë civile është e detyruar të presë vendimin e fajësisë në lidhje me veprën penale të kryer nga subjekti.

Përballja me seanca të shumta gjyqësore ndikon jo mirë në gjendjen psikologjike të viktimës e cila shpesh manifeston lodhje. Seicili nga proceset në kuadër të respektimit të procedurave përkatëse kanë të nevojshme një kohe të caktuar, kohë e cila, nuk është aspak e lehtë, për tu kaluar me 'durim', nga i dëmtuari.

Një tjetër problem lind dhe pas daljes së vendimit të Gjykatës që ka pranuar padinë civile, dhe lidhet konkretisht me ekzekutimin e këtij vendimi. Vështirësia në ekzekutim e ka zanafillën tek faktorë të tillë që konsistojnë në qënien e izoluar të subjektit të veprës penale Arsyet e një rezultati të tillë janë nga më të ndryshmet, të cilat në mënyrë të përmbledhur i paraqesim si më poshtë:

Së pari, duke qënë i izoluar, subjekti i kryerjes së veprës penale, nuk siguron të ardhura dhe nuk kryen asnjë lloj aktiviteti¹³.

Së dyti, në shumë raste autorët bëjnë tjetërsimin e pasurisë së vënë nga vepra penale, ku e tjetërsojnë atë për efekt fshehjeje ose dhe efekte të tjera. Ndodh rëndom që regjistrimi i pasurive

13 Të dhënat e përfutura nga hetimet e rasteve të ndryshme në PKR.

të tyre bëhet në emër të personave të tjerë. Në të shumtën e rasteve autorët e veprave penale e regjistrojnë pasurinë e tyre në emër të personave të tjerë, që në kuadër të informalitetit i cili ka karakterizuar shoqërinë shqiptare deri ne ditët e sotme, është e vështirë të kemi një rezultat pozitiv.

Së treti, ka mjaft raste në të cilat autorët e veprave penale, si rezultat i mënyres së jetesës së tyre, humbasin pasuritë e fituara nga vepra penale.

Paraqitëm një sërë faktorësh, të cilët e vështiresojnë apo e bëjnë të pamundur realizmin e të drejtave ekonomike të viktimave të trafikimit nëpërmjet shpërblimit të dëmit.

Viktima mund të kërkojë sinjë drejtësigurim në padisë civile, e drejte kjo e parashikuar në nenin 63 të Kodit të Procedurës Penale. Ky nen parashikon të drejtën që ka personi për të kërkuar sekuestrimin e pasurisë së të pandehurit, me sigurim padie deri në momentin e përfundimit të çështjes penale. Kjo është një e drejtë tjetër që parashikimet tona procedurale i atribuojnë të dëmtuarit nga vepra penale.

Për efekt ilustrimi do të ndalemi në trajtimin e një rasti tjetër praktik në të cilin do të prezantojmë vështirësitë me të cilat haset viktima e trafikimit si rezultat i procedurave të ndjekura gjatë hetimeve paraprake.

E dëmtuara K. F¹⁴. ka depozituar kallëzim për vepër penale të kryer nga i pandehuri A. G, vepër kjo e kualifikuar sipas nenit 114/b të Kodit Penal.

Si rezultat i jetesës së përbashkët për disa vite me radhë, e dëmtuara dhe i pandehuri kanë një fëmijë të mitur.

Me vendim gjykate para fillimit të procesit penal, e dëmtuara K. F ka arritur të njohë atësinë e fëmijës, dhe të përftojë çdo muaj për të, një pension mujor në formën e detyrimit për ushqim.

Forma me të cilën i pandehuri e detyroi për disa vite me radhë të dëmtuarën të ushtronte prostitucion dhe të ardhurat të shkonin në favor të tij, lidhej me premtimin që ai i bënte asaj, se ata të dy, ishin një çift normal dhe në momentin më të parë që do të siguronin një shumë të mjaftueshme të ardhurash për një jetë luksoze, ajo do të shkëputej nga prostitucioni.

Më vonë, me ardhjen në jetë të fëmijës së tyre, e dëmtuara

14 Vendimi nr 66 datë 09.12.2011 i GJSHKR

u detyrua të ushtrojë prostitucion si një mjet i kërkuar nga i pandehuri që ky i fundit të njihete atësinë e fëmijes së lindur.

Vetëm duke ushtruar prostitucion dhe duke siguruar shuma të mëdha të hollash, e dëmtuara ka arritur të marrë atësinë e fëmijës nga i pandehuri pasi, i mituri kishte mbushur moshën tre vjeç.

Problemi me të cilin u has e dëmtuara pas depozitimit të kallëzimit lidhej me faktorë ekonomikë pasi si rezultat i burgosjes së të pandehurit A. Ç., të dëmtuarës iu ndërpre pensioni mujor, si detyrim ushqimor për fëmijën e saj të mitur.

Ndërkohë që u has dhe me probleme psikologjike duke qënë se si rezultat i pasjes së një fëmije me të pandehurin, i mituri ruante marrëdhënie familjare me familjarët e të pandehurit, të cilët filluan të ndikojnë në psikologjinë e fëmijes së mitur. Në këtë mënyrë, e dëmtuara, ndodhej pa mjete monetare për të jetuar dhe nën trysinë psikike të familjarëve të saj.

Kjo ndikoi negativisht në psikologjinë e viktimës, duke e bërë atë të luhatej në pozicionin e mbajtur prej saj si dëshmitare në procesin penal.

Kjo e dëmtuar u dërgua në një qendër ku trajtohen viktimat e trafikimit, e cila i siguroi asaj ndihmë ekonomike dhe trajtim psikologjik.

Kjo ndikoi pozitivisht në psikologjinë e viktimës, duke bërë që ajo të ishte këmbëngulëse për ecurinë e procesit penal.

Raste të tilla, apo të tjera që karakterizohen nga vështirësi të tilla hasen shpesh, dhe kanë ndikimin e tyre në ecurinë e procesit penal.

Normalisht që, synimi ynë parësor është dënimi i autorit të veprës penale, dhe si rezultat i problematikës së përmendur më sipër, ky synim në disa raste mbetet i vetmi.

Megjithatë qoftë dhe për realizimin e këtij synimi ne duhet të vlerësojmë, domosdoshmërinë e mbrojtjes së viktimës nga momenti i pësimit të aktit kriminal dhe deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes penale.

Cdo person i dëmtuar nga vepra penale ka nevojë për mbrojtje të menjëherëshme.

Si persona për t'u ofruar mbrojtje konsiderohen të gjithë ata persona që njëherësh konsiderohen si viktima sipas akteve

kombetare dhe ndërkombëtare, dhe kanë nevojë për një gjë të tillë.

Një problem më vete me rastin e mbrojtjes së viktimave është marrja e masave që të mos ndodhë riviktimizimi i tyre apo i ashtuquajturi viktimizim sekondar.

Ata që kanë mbijetuar nga vepra penale, përballë një trajtimi jo të denjë, përballë mungesës së mbrojtjes, dhe përballë një trajtimi jo të drejtë nga organet e drejtësisë si organi procedues apo gjykata, mundet të provojnë edhe një viktimizim të dytë nga sistemi i drejtësisë.

Fazat në të cilat kalojnë viktimat e trafikimit gjatë procesit penal përfshijnë momente të vështira, me te cilat haset viktimat, e cila është e detyruar, të kujtojë momente të vështira, si dhe të përballet me autorin e veprës penale.

Për evitimin e situatave të tilla, duhet treguar kujdes dhe profesionalizëm.

Jemi munduar që në punën tonë të përditëshme të tregohemi të kujdesshëm në trajtimin e viktimës/dëshmitare, duke patur sukses në një farë menyre.

Kur flasim për sukses, e nisim që nga momenti i parë që lidhet me akomodimin e viktimës, (vendosja në qendra), trajtimin psikologjik të saj, (pasja e kontakteve me psikologë dhe punonjës socialë në mënyrë të vazhdueshme), krijimi i një situatë drejt një jetese normale, (akomodimi në qendër shoqërohet me program trajtues specifik që përfshin shkollim, punësim, etj), si dhe ndjekja e procedurave ligjore për përfaqësimin e padisë civile.

Duke i vendosur viktimat e trafikimit në kushte të tilla trajtimi, kemi mundësinë e mbajtjes së viktimës gjithnjë në korent për procesin penal, gjithnjë të interesuar.

Trajtimi i viktimës së krimit, mbrojtja juridike e saj është një problem i madh i sistemit të drejtësisë penale dhe një ndër synimet tona kryesore.

Të drejtat që u takojnë viktimave të krimit me parashikimin e tyre në akte ndërkombëtare dhe kombetare qëndrojnë në të njëjtin nivel me te drejtat ligjore, dhe si të tilla konsiderohen pjesë e pandarë e të drejtave të njeriut.

Studimet dhe praktikat e ndryshme që janë bërë, tregojnë për një luftë efikase kundër kriminalitetit. Përveç gjyqimit dhe

dënimet të autorit të veprës penale është e domosdoshme që edhe subjektit tjetër të aktit kriminal t'i ofrohet ndihmë dhe mbrojtje juridike.

Për realizimin e ndihmës, me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së nevojshme juridike duhet të merren në konsideratë, nevojat specifike dhe pozita delikate, vunerabel e viktimës si rezultat i ndikimit të viktimizimit në të.

Gjithashtu duhet të mbajmë parasysh se humbjet e viktimës janë të shumta dhe të natyrave të ndryshme.

Nga ana tjetër, ajo çfarë është më e rëndësishme është rregullimi i bazës ligjore në drejtim të realizimit efikas për shpërblimin e viktimave të trafikimit.

Legjislacioni ynë njih dhe marrjen në mbrojtje të dëshmitarit-viktimë trafikimi, por që në rastin e praktikës tonë për veprat penale që lidhen me trafikimin e qënieve njerëzore kemi vetëm një rast të tillë.

Përfundime

Trafikimi i qënieve njerëzore është një fenomen kompleks dhe nën ndikimin e shumë faktorëve, si dhe ka një shtrirje të gjerë në të gjitha shtetet e botës. Pavarësisht nga masat e marra në përgjithësi, prania e viktimave të trafikimit në rang kombëtar apo dhe ndërkombëtar është një dëshmi e drejtëpërdrejtë e ekzistencës së fenomenit dhe rritjes së tij në mënyrë të vazhdueshme.

Në raport të drejtë me realizimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit, të parashikuara si të tilla dhe në kushtetutë, vjen dhe legjislacioni penal. Mbrojtja e dinjitetit të individit është një element thelbësor në disa prej figurave të veprave penale të parashikuara si të tilla në ligjin tonë. Pas ndryshimeve të ndodhura në shoqërinë shqiptare pas viteve 1990- të, edhe legjislacioni si çdo fushë tjetër u përball me problematika të reja, të cilat ishin në dimensione të ndryshme dhe në zhvillim e sipër.

Në këtë artikull u përpoqëm të shpalosim problemet kryesore që lidhen me fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore duke e trajtuar si në aspektin social ashtu dhe në aspektin juridik, dhe duke e parë ecurinë e këtij fenomeni në raport me dimensionet e reja të zhvillimit ligjor, shoqëror dhe politik të vendit tonë.

Me qëllim rritjen e efektivitetit të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore është e domosdoshme:

Së pari, rritja e nivelit profesional të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore nëpërmjet trajnimeve dhe aktiviteteve të ndryshme të karakterit të edukimit të vazhdueshëm në fushën e veprave penale kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Së dyti, lidhur më dëmshpërblimin e viktimave të trafikimit ndryshimet legjislative janë të domosdoshme në mënyrë që t'u jepen zgjidhje problemeve që paraqet aktualisht instituti i padisë civile në procesin penal. Është e nevojshme të bëhet amendimi i nenit 158 i Kodit të Procedurës Penale, që parashikon përjashtimin nga detyrimi për të dëshmuar i bashkëshortit/bashkëjetuesit edhe në rast se ka bërë kallëzim.

Së treti, pyetja e viktimave duhet të bëhet në prani të psikologut ose punonjësit social gjatë hetimit dhe gjykimit, element ky që duhet të parashikohet në dispozita të veçanta të Kodit të Procedurës Penale.

Së katërti, në Kodin e Procedurës Penale duhen bërë ndryshime në nenin 59 të tij që në rastet kur kemi të bëjmë me ato lloj veprash penale ku janë kallëzuesit janë viktimat të dhunës të mos parashikohet ndjekja e tyre me ankimin e të dëmtuarit akuzues pasi të gjithë e dimë se sa të veshtirë e kanë viktimat e dhunës të drejtohen vetë në Gjykatë dhe të iniciojnë një proces. Shpesh kjo ndodh dhe për shkaqe ekonomike, por më së shumti tërheqja e tyre dhe mos paraqitja e kërkesës në Gjykatë ndodh nga frika e mospërsëritjes së dhunës.

Së pesti, në Kodin e Procedurës Penale gjithashtu duhet të ndryshohet dhe neni 316 pika 5, e cila lidhet me mënyrën e pyetjes së dëshmitarit të mitur. Dëshmitari i mitur në çdo rast duhet të pyetet në prani të psikologut dhe kjo duhet të jetë parashikuar konkretisht në ligj. Këtu vlen për tu theksuar domosdoshmëria e pranisë së përhershme të punonjësit social apo psikologut pranë Zyrës së Prokurorisë.

Së gjashti, në Kodin e Procedurës Penale duhet të bëhen ndryshimet e nevojshme edhe për parashikimin në të, të termit ‘viktimë trafikimi’, edhe pse aktualisht kjo i referohet parashikimeve të Konventës. Një gjë e tillë është e nevojshme dhe për shkak të faktit se me Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale punojnë jo vetëm Prokurorët, Avokatët dhe Gjyqtarët por dhe aktorë të tjerë të cilët ndihmojnë në dhënien dhe zbatimin e së drejtës.

Së shtati, të dhënat tregojnë se organet policore përfaqësojnë përballjen e parë të një organi shtetëror qoftë me fenomenin, me viktimën ose dhe me autorin. Prandaj në këtë drejtim Oficerët e Policisë Gjyqësore duhet të kenë kualifikimin e duhur dhe një stabilitet të qëndrueshmërisë së tyre në detyrë. Kjo për shkak të faktit se ka një lëvizje të shpeshtë të punonjësve problem ky që ndikon negativisht në kryerjen e hetimit dhe zgjidhjen e çështjes penale.

Së teti, është e detyrueshme të bëhen ndryshime dhe në rang të parashikimeve ligjore në drejtim të sigurimit të provave nga autoriteti i huaj në një mënyrë më të shpejtë nga rruga e tanishme procedurale me anë të letërporosisë. Ë rekomandueshme do të ishte ndryshimi ligjor për krijimin e skuadrave të përbashkëta hetimore, ku oficerët tanë do kishin mundësi të kryenin veprime me qëllim sigurimin e provave jashtë vendit tonë në bashkëpunim me autoritetin e huaj. Kjo do çonte në përfundimin e çështjes në një mënyrë më të shpejtë.

Së fundi, nga rradha por jo më pak e rëndësishme është politika penale. Në raport me vendet e tjera masat e dënimit të parashikuara në legjisllacionin tonë penal janë të larta.

I duhet kushtuar më shumë vëmendje goditjes së autorit të veprës penale jo vetëm në burgosjen e tij, por sekuestrimin e asetëve të siguruar nga veprimtaria kriminale.

Një arsyetim i tillë qëndron i lidhur ngushtë me faktin se dhe arsyeja e përfshirjes në krim të tyre bëhet për shkak të përfitimit material.

Bibliografia

1. Xh. Zaganjori, A. Anastasi, E. Methasani “Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, Tiranë 2011.
2. ”Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.7.2002, botuar në Fletore Zyrtare nr. 41, dt 25.07.2002,
3. *Protokolli kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare*, ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.7.2002, botuar në Fletore Zyrtare nr. 41, dt 25.07.2002,
4. *Protokolli për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve*, ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.7.2002, botuar në Fletore Zyrtare nr. 41, dt 25.07.2002,
5. Kodi Penal I RSh-së, miratuar me ligjin nr 7895 dt 27.01.1995, (i përditësuar), Tiranë 2014,
6. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin Nr 7905 dt 21.03.1995 (i përditësuar), Tiranë 2014,
7. Vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
8. Vendime të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.
9. Oliver Petre- Grenouilleau “La Tratta degli Schiavi”, 2010.
10. Louise Shelley “Human Trafficking, A globale perspective”, Cambridge University Press 2010.
11. Felia Allum, Franceska Longo, Daniela Irrera, Panos A. Kostakos, “Defining and Defying Organised Crime”, Neë York - USA 2010.
12. Fjalori latinisht -shqip viti 1966
13. Marek Antoni Nowicki, “Rreth konventës europiane”, Tiranë 2003.

MONEDHA ELEKTRONIKE BITCOIN NË KORNIZEN LIGJORE SHQIPTARE

Zaim LAKTI

Hyrje

1. Çfare është Bitcoin dhe si funksionon?

Nevoja për lehtësimin e tregtisë elektronike dekadën e fundit ka bërë që të kemi përmirësime të vazhdueshme në sistemin e pagesave online. Kështu, pavarësisht futjes së kartave të kreditit (Visa dhe Mastercard) dhe një gamë të gjerë shërbimesh të tjera të ashtuquajturat "pagesa alternative" sic janë e-Wallets (Paypal, Google Checkout, dhe WebMoney), po ashtu dhe sistemet e drejtpërdrejta të debitit (si eBillMe) duke mos harruar sistemet e transferimit të parave (si MoneyGram), kane qënë të pamjaftueshme për tregtinë elektronike. Sepse, gjitha shërbimet e mësipërme kanë tre karakteristika të përbashkëta:

1. Janë vendosur në qarkullim mbi bazën e ekzistencës së "monedhave të vërteta"¹ (p.sh Dollari, Euro).
2. Identifikohen përdoruesit gjatë transaksioneve
3. Janë të centralizuara ose gjysëm të centralizuara.

Nevojat e tregut për një zgjedhje tjetër alternative ka bërë të mundur që nëpërmjet zhvillimit të teknologjisë të arrihet krijimi i monedhës së parë dixhitale BITCOIN (BTC).

E ndryshme në esencë dhe që nuk ka karakteristikat e

¹ Ne anglisht: Fiat Money.

përbashkëta të shërbimeve/produkteve të përmenduara më lartë.

Duke qënë se nocioni i Bitcoinit nuk është i elaboruar në Shqipëri lindi nevoja që në këtë analizë së pari të japim përkufizimin pastaj të bëjmë një shpjegim të shkurtër çfarë është dhe si funksionon.

Bitcoin përkufizohet si një monedhë dixhitale, e decentralizuar, pjesërisht anonime, që nuk mbështetet/zotërohet nga shteti apo ndonjë entitet tjetër legal dhe që nuk qëndron si përfaqësues i arit apo ndonjë komoditeti tjetër. Për të ruajtur vazhdimësinë ajo mbështetet në “peer-to-peer networking” (rrjetin e komunikimit direkt) dhe në kriptografi².

Bitcoin, si monedhë elektronike u krijuar në vitin 2008, periudhe në të cilën ndodhi dhe kriza e madhe financiare³. Projekti u iniciua nga Satoshi Nakamoto (pseudonimi i personit që krijoi softwarein open source) me një sistem operativ të quajtur ‘A Peer-to-Peer Electronic Cash System’.

Ajo është monedha e parë dixhitale e decentralizuar.

E decentralizuar do të thotë se nuk është ndonjë bankë qëndrore që e kontrollon dhe dixhitale nënkupton që nuk ka ndonjë vlerë fizike (siç kanë monedhat e argjendit apo të bakrit).

Ndërkohë që monedhat e zakonshme përfaqësojnë një sasi të caktuar ari, Bitcoin-sat janë të gjeneruar nga algoritma matematik⁴. Ky proces i gjenerimit/prodhimit quhet ‘*minig*’ dhe nuk mund të prodhohen bitcoin-sa pa fund dhe pse si proces prodhimi nuk ka limit. Kjo do të thotë që bitcoinsa potencial për të prodhuar në total janë 21 milion me një shtrirje kohore deri në 2140⁵.

Nga perspektiva e përdoruesve, përdorimi i Bitcoinit është si përdorimi i bankingut online dhe pagesave në internet sepse transaksioni mund të bëhet nga një telefon apo kompjuter nëpërmjet një aplikacioni të posaçëm që së fundmi u pranua dhe nga kompania **Apple Inc.** në *AppStore*⁶.

2 Satoshi Nakamoto., “*Bitcoin: A Peer-to-Peer Electronic Cash System*, BITCOINPROJECT”, <http://bitcoin.org/bitcoin.pdf> *FAQ*, BITCOIN WIKI, <https://en.bitcoin.it/wiki/FAQ> *Bitcoin*, WIKIPEDIA, <http://en.wikipedia.org/wiki/Bitcoin> (2013);

3 <http://www.economist.com/news/schoolsbrief/21584534-effects-financial-crisis-are-still-being-felt-five-years-article>

4 Oxford Dictionary, <http://www.oxforddictionaries.com/definition/english/bitcoin>

5 <http://bitcoin.stackexchange.com/questions/161/how-many-bitcoins-will-there-eventually-be>

6 Apple policy update could allow bitcoin payments, Alex Hern, The Guardian. (<http://www.theguardian.com/technology/2014/jun/03/apple-bitcoin-payments-ipad-iphone>)

Për çdo transaksioni i shtohet një vulë elektronike e cila kontrollohet nga kompjuterat që bëjnë procesin e 'mining'.

Të gjitha të dhënat ruhen në një database e cila bën që Bitcoinin potencialisht të mos jetë anonim, por si pasoje e mungesës së një banke qendrore de fakto bën që ai të jetë pjesërisht anonim.

Por, mungesa e kësaj banke qendrore nga ana tjetër ka sjelle që kostot e transaksioneve të jenë shumë të vogla në krahasim me kostot që kanë kartat e kreditit apo pagesat e ndryshme elektronike⁷.

2. Transaksionet tregtare dhe vendet e përdorimit

a. Çfare mund të blejmë me Bitcoin dhe ku?

Shtetet që e kanë ndaluar Bitcoinin janë te pakta. Ndër ato mund të përmendim Rusinë⁸ e cila e ka ndaluar për shkak se në rregullimin fiskal të saj ekzistojnë shumë hapësira ligjore për evazion fiskal dhe pastrim parash. Ka shtete te tjera si Norvegjia⁹, që e kanë kufizuar duke e klasifikuar si komoditet dhe subjekt i taksimit.

Por, pothuajse të gjithë shtetet¹⁰ e tjera e kanë pranuar ose kanë preferuar të heshtin duke ia lënë tregut ta rregullojë.

Ndoshta, kjo ka ardhur për arsye se legjislacioni nuk e parashikon dhe nuk shprehet, këtu mund të marrim rastin e Shqipërisë.

Por ku mund të shesim dhe blejmë me bitcoins?

Praktikisht në çdo shtet të botës dhe çdo produkt ose shërbim të lirë në qarkullim civil¹¹, duke përfshirë dhe Shqipërinë. Përgesja bëhet në agjensitë dhe me metodat e pagesa online si MoneyGram, OKPay dhe PerfectMoney¹². Disa nga institucionet që pranojnë transaksione me BTC janë¹³: *Ukash, OKPay, PaySafeCard, SolidTrustPay, National bank transfer, Pingit, Payza, Tigo-Pesa Tanzania, WebMoney, Paypal, Postal order, Transferwise, Cashier's*

7 REGULATING DIGITAL CURRENCIES: BRINGING BITCOIN WITHIN THE REACH OF THE IMF Nicholas A. Plassaras, fq. 6, 2013

8 <https://bitcointalk.org/index.php?topic=452118.0>

9 <http://motherboard.vice.com/blog/whos-afraid-of-bitcoin-these-countries>

10 <https://spendbitcoins.com/sites/>

11 <https://spendbitcoins.com/places/>

12 <https://localbitcoins.com/country/AL>

13 <https://localbitcoins.com/sell-bitcoins-online/eur/>

check, Western Union, Other online payment, BPAY Bill Payment, Interac e-transfer, Perfect Money, Telegramatic Order, Superflash, International Wire (SWIFT), M-PESA Tanzania (Vodacom), Venmo, Cash deposit, PostePay, EgoPay, Neteller, SEPA (EU) bank transfer, Alipay, CashU, Dwolla, Chase Quickpay, Transfers with specific bank, Moneygram, Cash by mail, MoneyPak, M-PESA Kenya (Safaricom), Vanilla, Moneybookers / Skrill, AstroPay.

Po të kalojmë në rastin e Shqipërisë është interesante se ka vetëm dy qendra, në Tiranë dhe në Fier të cilat korrespondojnë me qytetet më të mëdha në Shqipëri ku evasoni fiskal dhe pastrimi i parave ka më shumë gjasa të ndodhi. Për të ilustruar në 'footnote' janë websitet ku mund të bëhen blerjet apo shitjet e Bitcoins në Shqipëri¹⁴. Nëse shikojmë me vëmendje është shumë e ngjashme me pikat e këmbimit valutor, ku valutat blihen më lirë sesa shiten në menyrë që të nxirret fitimi.

Më sipër folëm ku mund të blejmë dhe shesim Bitcoins. Ndërsa tani do flasim për target grupin e përdoruesve, produktet dhe shërbimet kryesore, pagesa e të cilave bëhet me Bitcoins në tregjet e sipërcituara.

Katër janë kategoritë kryesore:

1. Investuesit financiarë¹⁵ dhe investuesit që mbështesin start up-et (kompanitë e vogla të porsahapura)¹⁶.

2. Individet e thjeshtë për transaksione të përditshme. Individët e interesuar në fusha të ndryshme si teknologjia, te apasionuarit pas privatësisë dhe kriptografisë madje dhe spekulatorët dhe kriminelet financiarë¹⁷. Nga ky këndvështrim një numër i madhë tregtarësh ofrojnë shërbimin online me Bitcoin për produktet:

- o web host
- o kasinotë online
- o tregtimin e drogave të lehta
- o ankandet online
- o kompanitë e konsultimeve teknologjike, financiare dhe

14 <https://localbitcoins.com/country/AL>

15 <https://angel.co/500-fintech-bitcoin> dhe <http://www.forex.com/uk/index.html>

16 Sarah E. Needleman and Spencer E. Ante, "Bitcoin Startups Begin to Attract Real Cash," Wall Street Journal, 8 maj, 2013, <http://online.wsj.com/article/SB10001424127887323687604578469012375269952.html>

17 SPoll: Why Do You Use Bitcoin?, BITCOIN FORUM (2011) <http://bitcointalk.org/index.php?topic=4465.0>

ligjore, të cilat bëjnë pjesë në industrinë e shërbimeve.

Kjo industri në SHBA përfaqëson 70% të GDP, ndërsa në Shqipëri 52.4% të GDP (2011)¹⁸.

o Industria e pedofilisë¹⁹.

3. Një numër i madhe organizatash pranojnë donacione në Bitcoins, si psh Wikileaks²⁰.

4. Gjithashtu dhe një pjesë e vogël i industrive të punimeve artizanale²¹.

b. Vlera e tregut

Vlera e BTC është rritur ndjeshëm duke filluar me pak cent në momentin e lançimit duke arritur deri në vlerën \$428²² në momentin që po flasim. Vlera e kapitalit në treg që operon me bitcoin është mbi \$1 billion²³. Kjo vlerë kaq e madhe e ekonomisë bitcoin ka ardhur si pasoje e operimit të saj në nich market²⁴ dhe ekzistencës vetëm të dy llojeve të produkteve konkurrent që mund ti afrohen në konceptim Bitcoinit:

1. Produktet që operojn me pagesat në internet

2. Produktet që janë të lidhur me arin (psh monedhat e arit)²⁵.

Nga perspektiva ligjore dhe nga gjendja de fakto që është krijuar mund të pretendojm që Bitcoin konkurron monedhën kombetare të secilit shtet. Gjë e cila mund të sjellë marrjen e masave për ndalimin kategorit të saj në treg për interes publik dhe të stabilitetit financiar. Duke qënë se skemi një praktike të gjykatave tona për analogji po i referohemi Gjykatës së Lartë Amerikane dhe perqasjes së saj në çështjen Van Auken²⁶ ky merr në analizë situatën kur kemi konkurrence ndaj monedhës federale (dollarit) duke u mbështetur në “The Stamp Payments Act te

18 Në nivelin makro është e lidhur me faktin që ekonomia po kalon nga product oriente në service oriented. Kjo padyshim rritë dhe rëndësinë e bitcoin sepse kompanite që ofrojnë shërbime po e përdorin gjithnjë e më shumë. <http://www.instat.gov.al/figures/statistical-databases/Present.aspx?rxid=708b98ea-95ad-41b7-839f-5d3243f3e548>

19 Trade, BITCOIN WIKI, <https://en.bitcoin.it/wiki/Trade> (2011).

20 Donate, WIKILEAKS, <http://shop.wikileaks.org/donate#dbitcoin>

21 Joshua Davis, *The Crypto-Currency*, THE NEW YORKER, 2011, at 68.

22 <http://bitcoinexchangerate.org/c/USD>

23 Financial market capitalizationto \$1,457,815,292 as of May 29, 2013.

24 Nich market janë tregët e pa eksploruara dhe si pasoje me fitim të lartë.

25 Bitcoin: An Innovative Alternative Digital Currency by REUBEN GRINBERG. Yale Law School, J.D. 2011; University of Texas at Austin, M.S. 2007; Yale University, B.S. 2005.

26 United States v. Van Auken, 96 U.S. 366, 368 (U.S. 1878).

vitit 1862” vendosi që e-Gold destabilizon tregun financiarë dhe konkurron monedhën kombetare dollarin amerikan.

Ekspertët thonë që Bitcoin nuk përfshihet në këtë ligje nga këndvështrimi i gjykatës për dy arsye. Se pari Bitcoin konkurron me shumë me kartat e kreditit, Papalin apo çeqet. Gjë e cila sjell qasjen e bitcoinit në një treg të lirë ekonomik.

Së dyti, distanca kohore mes ligjit dhe kohës që u lançua Bitcoinin është e madhe, gjë që sjell pa aftësinë objektive të legjislatorit për të parashikuar diçka të tillë në frymën e ligjit të asaj kohe.

Duke qënë se në Shqipëri tregu i BTC është shumë i vogël e bën të pamundur krijimin e një stabilitet financiarë të mundshëm. BTC si një përmirësues i tregtisë elektronike²⁷ (e-commerce) mund të ndikojë potencialisht në tregun financiarë.

Por, le të shikojmë me kujdes detyrat dhe juridiksionin e Bankës së Shqipërisë ku do të vërejmë se ajo ka të drejtë të marrë pjesë, të bashkëpunojë dhe të nënshkruajë marrëveshje bankare me institucionet financiare ndërkombëtare, si dhe me institucionet financiare dhe bankare publike dhe private në vendet e tjera²⁸ ajo kontrollon çdo zyrë bankare dhe këmbimi valutor, llogari bankare dhe dokumente të bankave, si dhe të subjekteve të tjerë që kryejnë veprimtari bankare me licencë. Ajo merr informacionet e nevojshme në formën e përcaktuar nga ligji²⁹. *Po në rastin e Bitcoin me kë i duhet të lidhë marrëveshje Banka në rast se ajo vendos qe de facto ta pranojë Bitcoinin?*

Këtu nuk mund të japim një përgjigje sepse Bitcoin nuk ka një insitucion të centralizuar përveç kompanive dhe organizatave private që llojnë për këtë industri.

C. Industria e shkëmbimit të Bitcoins

Bitcoin nuk është një titull financiar që të mund të tregtohet në burse. Por, nepërmjet pikave të këmbimit (online) mund të nxirren fitime duke bërë blerje dhe shitje. Në Shqipëri këto pika këmbimi sipas nenit 61 te Ligjit Per Banken e Shqiperise janë nën juridiksionin/kontrollin e vetë bankës.

27 Botuar në HASTINGS SCIENCE & TECHNOLOGY LAW JOURNAL fq 168 Vol. 4:1. “Bitcoin: An Innovative Alternative Digital Currency”, REUBEN GRINBERG, fq. Yale University, 2011.

28 L I G J PËR BANKËN E SHQIPËRISËNR.8269, DATË 23.12.1997, NENI 5

29 L I G J PËR BANKËN E SHQIPËRISËNR.8269, DATË 23.12.1997, NENI 12/b

Si fillim, le të shohim si funksionon dhe si ka levizur çmimi i tij krahasur me dollarin. Çdo minute prodhohen 50 bitcoins. Me kalimin e kohës do përgjysmohet numri kështu që pas dy viteve do kemi 25 bitcoins dhe kështu me rrallë.

Pra, sa më shumë bitcoins janë ne tregu aq më e veshtire bëhet prodhimi i bitcoinsave të tjerë dhe aq më shumë i rritet vlera. Kjo deri në një moment ku numri i prodhuar të arrijë shifrën 21 milion bitcoins³⁰ e cila është dhe pritshmeria e prodhimit të BTC gjatë viteve në vazhdim³¹. Ashtu siç e përmendëm më lart për t'iu përshtatur kërkesës në rritje, një rrjet i madh pikash këmbimi online janë ngritur për ofrimin e shkëmbime/exchange mes Bitcoin dhe monedhave tradicionale duke përfshirë dollarin amerikan, Yenin, Euron dhe monedha të tjera dixhitale si Liberty Reserve, Pecunix, and WebMoney³². Këtu mund të përmendim piken Mt. Gox që është një ndër më të njohura në botë³³.

Tregu i këmbimit nuk është akoma i mirë organizuar sepse nuk kemi akoma një përhapje në masë të pikave tradicionale të këmbimit që të bëjnë transaksione në Bitcoin.

Çështja ligjore që ngrihet është: *Duke qënë se sipas ligjit Për Bankën e Shqipërisë liçencimi i pikave të këmbimit bëhet nga Banka Qendrore, çfarë do ndodhi nëse një pikë këmbimi vendos që të operojë me Bitcoins?*

Në baze legjislativi aktual shqiptar nuk është e ndaluar përdorimi i Bitcoin madje është i parregulluar plotësisht si fenomen. Duke u nisur nga kjo, pyetja tjetër që ngrihet është: *Banka e Shqipërisë duke e lejuar ekzistencën e një tregu të tillë mund të themi se ka pranuar në heshtje që transaksionet të vazhdojnë dhe në mënyre implicite e ka pranuar si monedhë (njësoj si dollarin apo Euron)? Problemi thellohet dhe më shumë në rast se jemi para zbatimit të kontratës kur pagesa/çmimi është parashikuar në Bitcoin. Ketu palët mund të dalin me pretendimin se derisa Banka e Shqipërisë ka heshtur atëherë ajo në mënyre implicite ka lënë të kuptojë se e pranon dhe procedurat duhet të vazhdojnë në mënyre normale.*

30 How are new Bitcoins created?, BITCOIN WIKI, https://en.bitcoin.it/wiki/FAQ#How_are_new_Bitcoins_created (2012).

31 Botuar në HASTINGS SCIENCE & TECHNOLOGY LAW JOURNAL fq 164 Vol. 4:1. "Bitcoin: An Innovative Alternative Digital Currency", REUBEN GRINBERG, fq. Yale University, 2011.

32 Shkëmbim i monedhave, BITCOIN WIKI, https://en.bitcoin.it/wiki/Trade#Currency_exchanges

33 MtGox, BITCOIN WIKI, <https://en.bitcoin.it/wiki/MtGox>

Vlera e bitcoin e shprehur në USD ka pësuar ndryshime të vazhdueshme ndër vite, duke filluar nga viti 2011 deri në vitin 2014³⁴. Kjo luhatje nuk duhet ngatërruar me vlerën e Bitcoinit në vetvete. Duke qënë se nuk mund të prodhohen më shumë sesa 21 milion bitcoins në treg do të sjell rritje të vlerës së tyre ndërsa sasia e monedhave tradicionale do të vazhdojë të rritet. Kjo do të thotë se Bitcoinin në vetvete *nuk ka inflacion*³⁵ gjë që është një avantazh kundrejt monedhave tradicionale në aspektin e këmbimit dhe të depozitave.

3. Ligji shqiptar dhe eksternalitetet e BTC

Në legjislationin tonë nuk e kemi infrastrukturë ligjore që të parashikojë diçka të tillë. Por, për analogji le të shohim qasjen që ka bërë ligji federal amerikan dhe dy problematikat ligjore që ka prekur ai.

I. Qeveria Federale ka monopolin për emetimin e monedhave³⁶.

II. Stabiliteti i titujve financiarë.

i. Qeveria si monopol për emetimin e monedhave

Një pjesë e studiuesve shprehen se Qeveria Federale ‘ka të drejten ekzkluzive për të lëshuar monedha’³⁷ sepse kushtetuta e percakton qartë se shtetet e federatës janë të perjashtuar³⁸ dhe Qeveria Federale ka kontrollin mbi emetimin e parasë.

Kjo ka pasur precedentet e saj si në emetimin e “Liberty Dollar” një monedhe alternative me Dollarin, ku, pas emetimit të monedhës Liberty Dollar Departamenti i Drejtësisë është shprehur se: “është thyerja e ligjit federal prodhimi dhe emetimi i një monedhe private që konkuron me dollarin (\$) ”³⁹.

34 <http://bitcoincharts.com/charts/mtgoxUSD#tgMzm1g10zm2g25zcv>

35 Duke qene në treg vetem 21 milion btc potencial për tu prodhuar objektivisht është e pamundur të kemi nje mbi oferte (surplus) në qarkullim.

36 Brian W. Smith & Ramsey J. Wilson, How Best to Guide the Evolution of Electronic Currency Law, 46 AM. U. L. REV. 1105, 1111 (1996–1997)

37 Brian W. Smith & Ramsey J. Wilson, How Best to Guide the Evolution of Electronic Currency Law, 46 AM. U. L. REV. 1105, 1111 (1996–1997).

38 U.S. Const. art I § 8, and prohibits states from “coin[ing] money.” U.S. Const art I § 10.

39 DOJ, Liberty Dollar Conviction Release, supra note 10

Nga ana tjetër, është shumë e paqartë nëse qeveria ka me të vertetë monopolin apo jo të emetoj monedha sepse Kushtetuta amerikane nuk shprehet për këtë pjesë dhe as pjesën kur palet private emetojnë monedha në treg⁴⁰. Për rregullimin e këtij vakumi ligjor kemi aktin që diskutuam më lartë, "The Stamp Payments Act of 1862" i cili në mënyrë explicite shprehet: Kushdo që emeton, qarkullon ose lëshon një leter me vlerë ose ndonjë dicka të ngjashme me kto, më shumë me të vogël se \$1 me qëllim përdorimin e tyre si monedhe ka thyer ligjin federal dhe duhet të denohet me burgim⁴¹. Çështja që shtrohet këtu është se a hyn Bitcoinin në cilësimin që bëhet nga The Stamp Payment Act? Përgjigjia është jo, me arsye që u dhanë më lartë kur u fol për çështjen *Van Auken*⁴².

Ndërsa, qëndrim tjetër mbahet në çështjen "*Shtetet e Bashkuara kundër Rusopulos*", ku Gjykata e qarkut të Minesotës duke cituar çështjen *Van Auken*⁴³ ka hedhur poshtë padinë kundër të pandehurit për dhënien e monedhave metalike që ishin të këmbëshme në treg për 50 cent⁴⁴ për dy arsye. Së pari, për shkak se monedhat ishin të kthyeshme në mallra⁴⁵, ata nuk ishin për pagesa në të holla⁴⁶. Së dyti, Gjykata konstatoi se forma dhe shenjë ishin të ndryshme nga ato të monedhave metalike në qarkullim⁴⁷. "

Në të njëjtën linjë arsyetimi me çështjen *Rusopulos* ecën dhe gjykata e Qarkut të Pensilvanisë në çështjen *Monongahela Bridge Co*⁴⁸, ku hodhi poshtë dënim kundër kompanisë në fjalë të bazuar në arsyetimin se biletat ishin të shtypura si taksë për shërbimin që ofrohej. Ndryshe nga rastet e tjera këto bileta nuk janë të destinuara të përdoren si monedha nga tregtarë apo shërbime të ndryshme. "

40 LEWIS D. SOLOMON, RETHINKING OUR CENTRALIZED MONETARY SYSTEM: THE CASE FOR A SYSTEM OF LOCAL CURRENCIES 95–96 (1996).

41 18 U.S.C. § 336.

42 *United States v. Van Auken*, 96 U.S. 366, 368 (U.S. 1878).

43 *United States v. Van Auken*, 96 U.S. 366, 368 (U.S. 1878)

44 95 F. 977, 978 (D. Minn. 1899)

45 Duke qene se ishin monedha metalike ato kishin vlere reale per shkak te metalit prej te cilit ishin te përbërë.

46 95 F. 977, 978 (D. Minn. 1899)

47 95 F. 977, 978 (D. Minn. 1899)

48 *United States v. Monongahela Bridge Co.*, 26 F. Cas. 1292, 1292 (W.D. Pa. 1863) (No. 15796)

Nga praktika gjygjësore shqiptare nuk kemi asnjë rast po ashtu dhe legjislacioni financiar dhe ligji për Bankën e Shqipërisë nuk ka asnjë klauzolë që të citojë monedhën e decentralizuar dixhitale. Ligji parashikon që Banka Qëndrore është e vetmja bankë që bën emetimin e Lekut por kjo nuk është mjaftueshme për të bërë interpretime për Bitcoin. Për më tepër nga ana praktike banka e ka të pamundur që ta vendosi nën kontroll.

ii. Stabiliteti dhe siguria financiare

Edhe pse industria e Bitcoin është duke u zhvilluar me ritme të shpejta përdoruesit janë të pasigurt për sigurinë teknike dhe për mundësinë mbylljes së aktivitetit nga qeveria⁴⁹.

Një ndër eksterenalitetet e Bitcoinit si monedhë anonime është përdorimi i saj për pastrim parash, evazion fiskal, përdorim për mallra jashtë qarkullimit civil dhe për pedofili. Kjo e fundit u cek në çështjen e E-gold-it ku Qeveria Amerikane mbylli dhe shpalli krijuesit e tij fajtorë për shkelje të ligjeve të kriptografisë, për mashtrim me kartat e kreditit dhe për pedofili⁵⁰.

Por nëse bëjmë një krahasim mes Bitcoinit dhe bankës do dalim në rezultatin që Bitcoin nuk është i njëjtë as në përdorim as në konceptim me E-goldin i cili u bë subjekt i sanksionëve të tilla. Transaksioni me Bitcoin është një përgjithësim i transaksionit të rregullt bankar në sensin që lejon marrjen dhe dhënien e adresave në të njëjtin transaksion, pra shkëmbyesit identifikojnë njëri tjetrin.

Por, ato janë të ndryshëm sepse e-gold dhe bankat mbajnë depozita që i përgjigjen një sasi të caktuar ari ndërsa Bitcoins nuk përfaqësojnë një komoditë konkrete⁵¹. Për më tepër Bitcoin nuk kontrollohet nga një institucion legal apo nga një qeveri qëndrore, ai është i lirë në emetim dhe në kontrollin e askujt. Këto cilësi e bëjnë të dalin nga kuadri ligjor në të cilën është sanksionuar e-gold.

49 *How long until governments outlaw bitcoin usage?*, BITCOIN FORUM (2011), <http://bitcointalk.org/index.php?topic=5110.msg74627#msg74627>

50 Peter C. Tucker, *The Digital Currency Doppelgänger: Regulatory Challenge or Harbinger of the New Economy?*, 17 CARDOZO J. INT'L & COMP. L. 589, 590-92 (2009)

51 *Quantitative Analysis of the Full Bitcoin Transaction Graph* Dorit Ron and Adi Shamir, pg 4. The Weizmann Institute of Science, Israel

Ndërsa po të lexojmë ligjin për Banken do shikojmë se një ndër detyrat e Bankës së Shqipërisë është që në përputhje me objektivin e saj kryesor dhe mbi bazën e tregut të brendshëm bankar, nxit dhe mbështet zhvillimin e regjimit dhe të sistemit të këmbimeve valutore, tregun e brendshëm financiar, sistemin e pagesave, si dhe ndihmon në përmirësimin e kushteve monetare e kredituese, në mbështetje të stabilitetit dhe të zhvillimeve ekonomike të vendit⁵². *Çështja ligjore që ngrihet këtu është a do klasifikohet Bitcoin si monedhë e ligjshme nëse banka merr masa për të rregulluar destabilitetin potencial financiar që mund të krijojë Bitcoin?*

Autoriteti European Bankar (EBA) se fundi ka mbledhur Këshillin Mbikqyrës për ti këshilluar bankat e nivelit të dytë mbi përdorimin e monedhave virtuale. Gjithashtu ajo ka propozuar dhe krijimin e një grupi të posaçëm për mbikqyerjen dhe rregullimin e tregut të monedhave virtuale me qëllimin që në një të ardhme të shkurtër të bëhet rregullimet financiare perkatëse⁵³.

Ndërsa tani do flasim për katër eksternalitetet kryesore që BTC sjell: I. Evasioni fiskal, II. Mashtrimi, III. Pastrimi i parave, dhe IV. Tregtia e mallrave të paligjshëm.

Së pari, është evasion fiskal. Në vitin 2012 evazionin fiskal pësoi rënie në 38 milion lekë⁵⁴, por me hyrjen e Bitcoin rritet mundësia për evasion duke qënë se tregu i Bitcoin në Shqipëri është plotësisht i parregulluar dhe mund të perdoret për të shmangur taksat në shërbimeve sidomos në fushën e konsultimeve siç mund të jenë studio ligjore, firmat konsulente financiare apo lloje të ndryshme biznesesh që operojnë në këto lloj fushash.

Kjo për faktin se Drejtoria e përgjithshme e tatimeve e ka të pamundur të bëjë kontroll apo të identifikojë personat që janë duke bërë shkeljen dhe pse ka aderuar në Konventen për ndalimin e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e Evazionit

52 L I G J PËR BANKËN E SHQIPËRISË NR. 8269, DATË 23.12.1997, NENI 3/2

53 "European Banking Authority takes hard line on regulation of Bitcoin/virtual currencies" - CMS Cameron McKenna. Belinda Schofield, Simon Garrett and John Enoch

(http://www.lexology.com/library/detail.aspx?g=755a3caf-f148-4e36-8986-def525ad10c6&utm_source=Lexology+Daily+Newsfeed&utm_medium=HTML+email+-+Body+-+General+section&utm_)

54 Kontrolli i Lartë i Shtetit, Raporti i Vitit 2012. (<http://open.data.al/sq/lajme/lajm/id/791/Demi-ekonomik-ne-sektorit-e-tatim-taksave-ne-vitet-2008-2012>)

fiskal⁵⁵, për të cilën kemi dhe një udhëzim të posaçëm⁵⁶.

Situtata këtu duhet parë në dy këndvështrime:

1. E shikuar nga këndvështrimi i monedhes, me anë të pagesave në Bitcoin në shmangim tatimet sepse nuk do na figurojë në sistem transaksioni i kryer. Kjo do sillte një prirje të bizneseve për të pranuar pagesa me Bitcoins sidomos në fushën e shërbimeve (psh. Konsultimet ligjore dhe ekonomike/financiare).

2. Nëse e shikojmë bitcoinin si komoditet atëherë efënca e mbledhjes së taksave për këto produkte do të ulët për shkak të anonimitetit që ka. Kjo do të bëjë që paratë e pista që ndodhen në Shqipëri të kthehen në Bitcoin.

Në të dy situatat kemi një rast potencial për evazion fiskal deri në momentin që nuk kemi një rregullim specifik nga legjislatori ynë. Norvegjia, ashtu siç e përmendëm dhe më lartë, e ka zgjidhur duke e njohur Bitcoinin si asset i cili do jetë subjekt i taksës mbi kapitalin dhe në rast transaksionësh do zbatohet taksë e shitjes⁵⁷. Kjo do sjell një zvogëlim të përdorimit dhe të efikasitetit të Bitcoinit në tregun norvegjisë. Edhe në këtë rast nga ana praktike përsëri mund të kemi shmangie nga tatimet e taksat. Por, këtë herë nuk do cilësohet si evazion fiskal por si mashtrim, veprë të cilën dhe denimi është më i madh.

Ndërsa Amerika (shteti i New York-ut) në projektligjin që pritet të miratohet ka vendosur që për monedhat elektronike dhe konkretisht mbi Bitcoinin kushtin që Brenda 45 ditëve të gjitha bizneset që do kryejn transaksione me bitcoin duhet të marrin leje "BitLicence" në të kundërt do hasen me sanksione⁵⁸.

Ndërsa Kina nga ana tjetër e ka zgjidhur duke e ndaluar përdorimin si për kontratat direkte me korporatat ashtu dhe nëpërmjet institucioneve specifike si bankat apo kompanitë private si paypal apo të tjera të ngjashme me paypal-in.⁵⁹

55 Konventa bilaterale për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal – Ligj Nr. 8701, datë 01.12.2000

56 Udhëzimi -Nr. 6, datë 10.02.2004 - Per Marreveshjet Bilaterale per Shmagjen e Taksimit te dyfishte dhe parandalimin e Evazionit Fiskal

57 <http://motherboard.vice.com/blog/whos-afraid-of-bitcoin-these-countries>

58 "New York State proposes "BitLicenses" and comprehensive rules for virtual currency firms", Arnold & Porter LLP. Marcus A. Asner, Andrew Joseph Shipe, Catherine Barnard and Willow White Noonan (<http://www.lexology.com/library/detail.aspx?g=72b2c15e-c946-4f63-b5a6-bb2ec0b15ec5>)

59 www.ft.com (2014)

Se si do ta zgjidhe legjislatori ynë mbetet për tu shikuar.

Së dyti, mashtrimi⁶⁰ është një nga implikimet që ka Bitcoin, ne e kemi të parashikuar në Kodin Penal neni 143/a:

“Organizimi dhe vënia në funksionim e skemave mashtruese dhe piramidale të huamarrjes, me qëllim fitimi, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet. Po kjo vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda do të dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet”.

Shëmbuj nga praktika për këtë veper penale nuk mungojn ku numrin më të lartë të të dënuarve për mashtrim e shënon viti 2012 me 414 persona të dënuar. Karakteristikë është rishfaqja e mashtrimit përmes skemave piramidale që shënon tetë deri trembëdhjetë raste në vitet pas 2008-ës. Po kështu ka filluar të procedohet në gjykatat shqiptare edhe mashtrimi kibernetik ku vetëm në vitin 2012 kemi 13 raste autorësh të dënuar⁶¹.

Edhe pse ky është një nga implikimet që ka bitcoin në praktikën e gjykatave shqiptare nuk kemi akoma raste.

Por, si shembull jashtë Shqipërisë është çështja ligjore ku konsumatorët amerikanë akuzuan për mashtrim Mt. Gox (një ndër qendrave më të medha të shkëmbimit të bitcoinit) menjëherë sapo filloi procedurat për falimentim⁶². Nga ky aspekt nuk kemi nevojë për shtesa të reja në legjislacionin përpara I përket kësaj figure të veprës penale sepse e kemi të rregulluar po ashtu dhe praktiken ligjore (kam parasysh raportin e sipër cituar). Por, kemi nevojë për një specifikim më të detajuar dhe gjithëpërfshirës me qëllimin që të mos lindin keq interpretime në gjykata.

Eksternaliteti i tretë i Bitcoinit është *pastrimi i parave*. Përgjegjës për pastrimin e parave në Republikën e Shqipërisë është Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, e cila i raporton drejtpërdrejt Ministrin të Financave dhe shërben si Njësi e Inteligjencës Financiare të Shqipërisë⁶³, e cila në vitin 2007 kishte 748 raste të aktiviteteve financiare

60 Ne anglisht “Fraud”

61 Ministria e Drejtësisë, Raporti i Vitit 2012 (<http://open.data.al/sq/lajme/lajm/id/905/Te-denuar-per-mashtrim-falsifikim-dhe-kontrabande-2004-2012>)

62 <http://www.bloomberg.com/news/2014-02-28/mt-gox-bitcoin-exchange-sued-in-u-s-for-misappropriation-1-.html> (2013)

63 LIGJI Nr.9917, datë 19.5.2008 “ PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANÇIMIT TË TERRORIZMIT” (ndryshuar me ligjin nr. 10 391, datë 3.3.2011)

të dyshimta⁶⁴. Sipas frymës së përgjithshme të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT”, monedhat dixhitale përfshihen në konceptim e pronësisë⁶⁵ por çështja shtrohet nëse arrihet të evidentohen përdoruesit e llogarive në Bitcoin në mënyrë që të merren masa për parandalimin e pastrimit të parave. Dhe nëse arrihet kjo, çështja që vjen me pasë është a ka juridiksion ligji shqiptare për llogarite e hapura jashtë republikës së Shqipërisë?

Këto janë çështje që do i lihen kohës të shikojë se si do reagojnë autoritetet kompetente por deri tani ska gjasa që të arrihet një kontroll qoftë dhe nga autoritetet shtetërore për arsye të vështirësis objektive.

Së katërtri është tregtia e mallrave të paligjshëm. Edhe pse Bitcoin për shkak të natyrës së decentralizimit do jetë e vështirë të mbyllet plotësisht por një kriminalizim që qeveria mund ti bëjë, do të shkaktoj lëkundje të mëdha të përdoruesit e tij sepse asnjë nuk do që monedha e tij të jetë e lidhur me një aktivitet kriminal dhe që nga momenti në moment mund të ndalohej për qarkullim.

Për të gjitha veprat penale të sipërcituara është shumë e vështirë nga ana objektive që të bëhet identifikimi dhe arrestimi i autorëve sidomos duke pasur parasysh karakterin gjysëm anonim të BTC dhe mjeteve të lundrimit që fshehin ip e vërtetë si TOR BROWSER⁶⁶.

64 Raporti I DPPP-Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave. (<http://open.data.al/sq/lajme/lajm/id/837/Raportimi-i-transaksioneve-t%D1%91-dyshimta-sipas-subjekteve-raportuese-n%D1%91-Drejtorine-e-Pergjithshme-te-Parandalimit-te-Pastrimit-te-Parase-ne-vitet-2006-2012>.)

65 LIGJI Nr.9917, datë 19.5.2008 “ PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT” (ndryshuar me ligjin nr. 10 391, datë 3.3.2011) Neni 2/13

66 <https://www.torproject.org/projects/torbrowser.html.en>

4. Mund të zabtojme një kontrate nëse pagesa është në Bitcoin?

Nga këndveshtimi im, duke qënë se FMN⁶⁷ është institucioni që bën rregullimin e monëdhave në qarkullim (për vendet që kanë aderuar) dhe studion impaktin e tyre në treg para dhënies së lejës së operimit dhe ky institucion nuk është shprehur.

Na lë të hapur rrugën që në gjykata ti përqasemi më shumë mendimit se Bitcoin është komoditet kjo për faktin e mungesës së ligjit material.

Kodi ynë Civil në nenin 659 parashikon se *“kontrata është veprim juridik me anë të se cilës një ose disa pale krijojn, ndryshojn ose shuajn një marrëdhënie juridike”* ndërsa vete Bitcoinin përveç kësaj mbështetet dhe në tre lloje konsensusi në momentin që palët pranojn të bëhen pjesë e tij: (1) Vullneti për të pranuar vlefshmërinë dhe rregullat (2) në baze të cilave ndodh transaksioni në sistem dhe (3) që ky transaksion ka një vlerë të caktuar. E rëndësishme të përmendim është që këto pika janë kumulative⁶⁸. Me fjalë të tjera kjo do thotë që për të bërë një transaksion me bitcoin secila nga palët duhet të pranojn rregullat dhe procedurat që ofron softwari, sistemin në të cilin ai operon dhe së fundi për këtë veprim/transaksion që kryejn duhet të pranojë se ka një vlerë të caktuar (shuma e bitcoinsave).

Duke qënë se gjatë gjykimit duhet të shikohet konsensi i kontratës (në mënyrën tradicionale në bazë të Kodit Civil) dhe konsensusi i vete Bitcoinit. Për ti mos i hyre kësaj analise mënyra më e lehtë për të zbatuar një kontrate që është bërë në Bitcoin bëhet kërkimi në gjykate shpërblimin si komoditet dhe jo si monedh, pra si kontrate shkëmbimi, duke qënë se gjykata në pamundësi objektive për ti bërë një interpretim të sakte formave të vullnetit që kërkon Bitcoinin mund të mos e pranoj kërkese padinë për mangësi e të kerkoj plotësimin e saj duke kërkuar dëmbshpërblimin në njërin nga monëdhata e caktuar ndërkomtarisht. Për analogji, shumica e juristëve në SHBA bien dakort se Bitcoin nuk e kalon Hower test⁶⁹ i cili shërben

67 www.imf.org

68 The Economics of Bitcoin Mining or, Bitcoin in the Presence of Adversaries Joshua A. Kroll, Ian C. Davey, and Edward W. Felten. Princeton University

69 John William Nelson, *Why Bitcoin Isn't a Security Under Federal Securities Law*, LEX

për ta klasifikuar si kontratë investimi dhe si pasojë bie nën juridiksionin e Security Act⁷⁰. Për më tepër në mars të 2014 IRS-ja lëshoi vendimin *Notice 2014-21*⁷¹, në të cilin përkrahur se si do zbatohen parimet e përgjithshme të taksimit në rastin e monedhave online, si Bitcoin. Ky vendim shprehet që Bitcoin nuk është para/monedhë e mirëfillët⁷²

Pra, nëse do jemi në rolin e avokatit të palës që kërkon zbatimin e kontratës do ishte më efikase nëse dalim para gjykatës me pretendimin që kontrata duhet shikuar si kontratë shkëmbimi. Kjo është një mënyrë më e sigurt sesa po ta kërkojmë bitcoinin si monedhë sepse në këtë nuk kemi ligje që ta ndalojë Bitcoinin si komoditet. Ndërsa pretendimi si monedhë nuk është i rregulluar nga legjislacioni ynë aktual.

Konkluzione

Pra, transfertat dhe pagesat me BTC bëhen në të njëjtën mënyrë me dërgimin e e-maileve. E rëndësishme të theksojmë se Bitcoin operon akoma në një zonë të pasigurt ligjore dhe ekonomike në rrafshin global. Por, si risi mund të përmendim rritje të lirisë së qarkullimit të të mirave, ulje të kostove monetare, rritje të efikasitetit, reduktim të kostos kohë si dhe nuk ka inflacion që mund të çojë në kriza financiare.

Nga ana tjetër kemi një sërë eksternalitetesh ligjore dhe financiare si:

1. Evasion Fiskal
2. Mashtrim
3. Pastrim I Parave
4. Tregti E Mallrave të Paligjshëm

TECHNOLOGIAE, <http://www.lextechnologiae.com/2011/06/26/why-bitcoin-isnt-a-security-under-federal-securities-law>

70 Securities Act of 1933 § 2(a)(1).

71 <http://www.irs.gov/pub/irs-drop/n-14-21.pdf>

72 http://www.mondaq.com/unitedstates/x/306484/tax+authorities/+Says+Bitcoin+Isnt+Money&email_access=on (2014)

Këto eksternalitete janë pare në driten e legjislacionit tonë aktual duke u mbeshtetur here pas here në analogjinë me vendet e tjera si ShBA-ja, BE-ja, Kina dhe Norvegjia.

U hapen çështje të ndryshme në lidhje me hapesirat ligjore ekzistuese në legjislacionin tonë si:

- *Në rastin e Bitcoin me kë i duhet të lidhë marrëveshje Banka në rast se ajo vendos që de facto ta pranojë Bitcoinin?*

- *Duke qënë se sipas ligjit Për Banken e Shqipërisë licensimi i pikave të kembimit bëhet nga Banka Qendrore, çfarë do ndodhi nëse një pikë këmbimi vendos që të operoj me Bitcoins?*

- *Banka e Shqipërisë duke e lejuar ekzistencën e një tregu të tillë mund të themi se ka pranuar në heshtje që transaksionët të vazhdojnë dhe në mënyre implicite e ka pranuar si monëdhë (njësoj si dollarin apo Euron)?*

- *Ceshtja ligjore që ngrihet këtu është a do e klasifikohet Bitcoinin si monëdhë e ligjshme nëse banka merr masa për të rregulluar destabilitetin potencial financiar që mund të krijojë Bitcoin?*

- *Nëse arrihet të evidentohen përdoruesit e llogarive në Bitcoin në mënyrë që të merren masa për parandalimin e pastrimit të parave. Dhe nëse arrihet kjo, çështja që vjen më pase është a ka juridiksion ligji shqiptarë për llogaritë e hapura jashtë republikës së Shqipërisë?*

Së fundi, u analizuar dhe situata që do krijohet në rast se do kërkohet para gjykatës zbatimi i kontrates e cila çmimin e ka te caktar në Bitcoin. Cili do ishte vakumi ligjor që do krijohet dhe u dol në perfundimin se mënyra më e sigurve për të zbatuar një kontratë të tillë është pretendimi i saj si kontratë shkembimi që do të thote ta shikojm Bitcoinin si komoditet dhe jo si monedhë. Në fakt ky është dhe versioni i fundit zyrtare që ka dhenë IRS⁷³ në ShBA.

Ndalimi i bitcoin nuk e ule rrezikun e mos rregullimit të tij prandaj, do jetë më efektive nëse i bëjmë një rregullim sepse është e pamundur që në çdo cep të botës të ndalohet, dhe sapo të ndalohet si monedhe/komoditet do marri akoma vlere më të larte në tregun e zi të atyre vendeve që e pranojnë.

73 IRS është agjencia federale per zbatimin e legjislacionit të taksave si dhe pergjegjese për mbledhjen e tyre, në Shqipëri Dretoria e Përgjithshme e Tatimeve (<http://www.tatime.gov.al>)

Diskutimet ligjore dhe ekonomike do të vazhdojnë por do jetë shumë e vështirë për ta legalizuar e rregulluar Bitcoinin deri në momentin që nuk kemi një pranim në arenën politike dhe gjeopolitike globale.

Bibliografia

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
2. Kodi Civil, RSH.
3. Kodi i Procedures Civile, RSH.
4. Kodi Penal, RSH.
5. Ligji Për Bankën E Shqipërisë Nr.8269.
6. Ligji Nr.9917,“ Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit” (Ndryshuar Me Ligjin Nr. 10 391).
7. Konventa Bilaterale Për Shmangjen i Taksimit ië Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiscal – Ligj Nr. 8701.
8. Udhezim -Nr. 6, Date 10.02. 2004 - Per Marreveshjet Bilaterale Per Shmagjen e Taksimit te Dyfishte dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal.
9. Ministria e Drejtësisë, Raportii Vitit 2014.
10. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Raporti i vitit 2012.
11. Kontrolli i Lartei Shtetit, Raporti i Vitit 2012.
12. U.S Constitution.
